

ECONOMICUS NR 7/2011

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT EKONOMIK

Kryeredaktor

Prof. Dr. ADRIAN CIVICI

Redaktore

BESARTA VLADI

Këshilli botues

Prof. Dr. SULO HADËRI

Prof. Dr. LULJETA MINXHOZI

Prof. Asoc. Dr. FATOS IBRAHIMI

Prof. Asoc. Dr. ENGJELL PERE

Dr. KRESHNIK BELLO

Dr. ZEF PREÇI

Dr. ARJAN KADARE

Dr. ELVIN MEKA

Dr. SELAMI XHEPA

Dr. NEVILA XHINDI

Dr. SHKËLZEN MARKU

ILIR HOTI, MSc

Arti grafik

Ilir Drizari

ISSN 2223-6295

Miratur si revistë shkencore nga komisioni i vlerësimit të titujve akademikë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nr. 153 datë 08.10.2010

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS / TIRANË
Bulevardi "Gjergj Fishta" / www.uet.edu.al / info@uet.edu.al



përmbajtja

ANALIZA DHE DEBATE

Financimi i arsimit të lartë: zhvillimi midis sektorit publik dhe atij privat..... 7

Prof. Asoc Dr. Engjell Pere

Prof. Dr. Luljeta Minxhozi

Obligacionet e shoqërive tregtare.

Një formë e re e financimit të bizneseve në Shqipëri31

Dr. Elvin MEKA

Forcimi dhe edukimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.....41

Dr. Kreshnik Bello

M.A. Edmond Bello

Decentralizimi i pushtetit, progresi dhe zgjerimi i autonomisë vendore në Shqipëri....51

Dr. Migena Leskoviku

ANALIZË HISTORIKE

“Depresioni i madh” i kapitalizmit liberal: 1929–33. Një analizë retrospektive63

Prof. Dr. Adrian CIVICI

Ari shqiptar në labirintet diplomatike73

Prof.Dr. Ksenofon Krisafi

Dossier: EKONOMIA DHE DEMOKRACIA

“Revolucionet arabe” dhe Kina: Si duhen lexuar sot Marksii dhe Brzezinski95

Fatos Tarifa, PhD

Reformat ekonomike dhe demokratizimi i rajonit Afrikano-Verior

nën ndikimin European105

Dr. Nevila Xhindi

*Cilat janë grupet e interesit që kanë më tepër influencë në vendimmarrjen e BE-së?*113
Besarta Vladi

Roli i të ardhurave ekonomike për lëvizjen e lirë në Bashkimin European 123
Erjona Canaj, PhD

*Kriza greke dhe solidariteti European*137
Arlinda Hoti, Doktorante

*Fuqia e shtetit dhe Krizat e globalizmit*145
Dr. Lavdosh Ahmetaj

* * *

*Eksperienca europiane në përcaktimin e zonave malore më pak të avantazhuara:
aplikimi në kushtet e Shqipërisë*155
Dr. Shkelzen Marku

*Cila është vlera e tokës? Informacione nga krijimi i tregut në
zonën bregdetare shqiptare*163
Dr. Fatmir Guri
M.Sc. Elena Kokthi

*Analizë e disa problematikave të legjislacionit për falimentimin
ndërkufitar në Shqipëri.....*171
Erion Manohasa, Doktorant
Nina Radulovic, PhD

*Pastrimi i parave dhe efektet negative në ekonomi.....*183
Av. Ma. Naim MËÇALLA, Doktorant

*Partneriteti Publik-Privat: PRO DHE KUNDRA*193
Dr. Ali Turhani

*Implementimi i Standardeve të Kontabilitetit në Analizën e
Pasqyrave Financiare*203
Lirola Këri, Msc
Prof. Dr. Flutura Kalemi

*Disa teknologji moderne për implementimin e një aplikimi ne web*209
Prof. Asoc. Dr. Tamara Luarasi

*ABSTRACTS*225

Analiza dhe Debate

Financimi i arsimit të lartë: zhvillimi midis sektorit publik dhe atij privat

____ Prof. Asoc. Dr. Engjell Pere (UET) _____

____ Prof. Dr. Luljeta Minxhozi (UET) _____

Abstrakt. Në teoritë e reja të rritjes ekonomike, rritja e nivelit arsimor e profesional zë një vend qendror, si një element themelor i cili karakterizon kapitalin human. Nga ana tjetër, zhvillimet shoqërore në mjaft vende, kanë ndryshuar strukturën sociale të shoqërisë, duke rritur në mënyrë të ndjeshme kërkesën për arsim. Në këtë këndvështrim, reformat në arsimin e lartë paraqesin prej disa vitesh një dukuri ndoshta nga më karakteristiket e zhvillimit të përgjithshëm social ekonomik në mjaft vende.

Problemet me të cilat është ndeshur dhe ballafaqohet ky zhvillim përfshijnë një spektër mjaft të gjerë e të diskutueshëm. Ato prekin mjaft dukuri të rëndësishme sasiore dhe cilësore. Ky punim nuk synon të trajtojë tërësinë e këtyre aspekteve. Këndvështrimi i tij është kryesisht ai i trajtimit të anës ekonomike e financiare që karakterizon zhvillimin e arsimit të lartë sot. Ky aspekt, megjithëse nuk trajtohet shpesh në diskutimet publike, në fakt shoqëron të gjitha ndryshimet që vihen re në këtë fushë, në mos po në disa raste, ai është në themel të këtyre ndryshimeve. Më gjerë problemi mund të shikohet si një tendencë e transformimit të vetë sektorit publik, duke kaluar kështu në debatin e diskutueshëm të partnershipit midis këtij sektori dhe atij privat.

Në këtë këndvështrim punimi synon: së pari, të trajtojë në tërësi përmbajtjen e reformave të financimit të arsimit të lartë, duke vënë në qendër të vëmendjes raportet midis zhvillimit të arsimit publik dhe atij privat; së dyti, punimi trajton rastin konkret të reformës së diskutueshme në Shqipëri mbi mënyrën e financimit të arsimit të lartë, e cila mendohet të shenojë një ndryshim rrënjësor në zhvillimin e arsimit në këtë vend. Ideja kryesore e punimit është të trajtojë dhe të argumentojë, si në rrafshin teorik, ashtu edhe në atë praktik, se zhvillimi i arsimit të lartë sot bën të domosdoshme harmonizimin e zhvillimit të arsimit publik me atë të financimeve privat në këtë fushë.

Fjalë kyçe

Financimi i arsimit; arsimi publik dhe ai privat; reformat në arsim.

Hyrje

Prej kohësh është i njohur roli i arsimit në përgjithësi si një nga faktorët kryesor të rritjes ekonomike. Zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqënies mbështetet në tre faktorët kryesorë: punën, investimin kapital dhe zhvillimin e teknologjisë. Harmonizimi dhe efektiviteti i këtyre faktorëve mund të realizohet vetëm nëpërmjet arsimit dhe rritjes së nivelit profesional. Në të gjitha fushat zbatimi i teknologjive të reja mund të realizohet vetëm nëpërmjet individëve të arsimuar e të kualifikuar. Në mjaft studime theksohet se modeli i “ri i rritjes” (“new growth” model) evidenton qartë rolin e arsimit në rritjen ekonomike dhe në gjenerimin e teknologjive të reja. Në veçanti, arsimi i lartë është idendivikuar si mjaft i rëndësishëm në zhvillimin e kërkimeve dhe aftësinë për t’i zbatuar ato në praktikë. Në disa punime të OECD, mbi bazën e modeleve të gjëra empirike, evidentohet se aftësimi i kapitalit human ka qënë një nga faktorët kryesor të proceseve të rritjes në vende të veçanta, si në Gjermani, Itali, Greqi apo Spanjë, në vitet ‘80. Në këto vende mendohet se aftësimi i kapitalit human ka ndikuar në më shumë se 0,5% në akselerimin e rritjes ekonomike në krahasim me dekadën paraardhëse. Për vendet e OECD në tërësi mendohet se mesatarisht, çdo vit më shumë shkolim, (që i korespondon një rritje në kualifikimin e kapitalit njerëzor me 10%), shoqërohet me një rritje prej 6% të outputit për frymë¹. Në këtë këndvështrim, investimi në arsim është një nevojë gjithnjë e më aktuale e zhvillimit në tërësi.

Nga ana tjetër, investimi në arsim karakterizohet nga një ndërthurje e interesave individuale me ato të publikut në tërësi. Dihet se zhvillimi i arsimit konsiderohet jo thjeshtë si një përfitim individual por edhe si një eksternalitet pozitiv për shoqërinë në tërësi. Kjo gjë ka lindur prej kohësh dilemën se si duhet trajtuar ky “sherbim”, sa është ai një e mirë publike dhe sa një e mirë private. Ky karakter miks i investimit në arsim ka lindur edhe pyetjen se si duhet trajtuar financimi i këtij investimi, duhet financuar ai vetëm nga fondet publike apo duhen angazhuar edhe burimet private?

Zhvillimi ekonomik në vendet e industrializuara, por edhe transformimet në vendet e Europës Lindore pas viteve ‘90, kanë sjellë edhe ndryshime sociale. Këto ndryshime janë shoqëruar edhe me rritjen e konsiderueshme të kërkesës për arsimin e lartë e cila lidhet jo vetëm me rritjen e popullsisë, por edhe me kërkesat për një vend pune më të stabilizuar, për më shumë mobilitet në tregun e punës, për paga më të mira, etj. Kjo kërkesë e rritur për arsim ka vënë në vështirësi buxhetet e mjaft vendeve, duke kërkuar burime të tjera jo vetëm publike, për zhvillimin e arsimit.

Në këtë këndvështrim, nisur nga roli i arsimit të lartë në shoqëritë e zhvilluara, mjaft vende kanë ndërmarrë reforma të thella arsimore. Këto reforma duke patur në qender të tyre rritjen e cilësisë në arsimin e lartë, janë shoqëruar me ndryshime të rëndësishme në aspektin e financimit të tij. Thelbi i këtyre ndryshimeve ka qënë ai i

¹ P. Santiago; K. Tremblay; E. Basri; E. Arnal – *Tertiary Education for Knowledge Society* – OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volum 1, 2008

harmonizimit të fondeve publike me ato private të destinuara për arsimin e lartë. Në këtë frymë kanë qënë për shembull reformat arsimore të ndërmarra në Kili në mesin e viteve '90, në Australi në vitin 2003, në Francë në 2007, apo ajo e fundit në Itali në 2010. Në Shqipëri debati mbi reformën financiare në arsimin e lartë është mjaft aktual e i ndjeshëm dhe mund të përbëjë një eksperiment të re në aspektin e zbatimit të kësaj reforme.

Finacimi i arsimit të lartë: Sektori publik dhe ai privat i financimit të arsimit të lartë

Fillimisht mendojmë të qartësojmë se çfarë kuptohet realisht me sektorin publik dhe atë privat në arsimin e lartë. Dallimi konceptual i universiteteve publike nga ato private shpesh herë nuk është i qartë dhe i thjeshtë. Në vendet e Europës Lindore, të cilat kanë një eksperiencë modeste në këtë fushë, ndryshimi midis universiteteve publike dhe private bazohet drejtpërdrejtë tek mekanizmi sipas të cilit ato funksionojnë: janë fitim-prurëse apo jo. Ndërsa, eksperimentin e vendeve të zhvilluara perendimore, dhe veçanërisht e SHBA-së, dallimin midis këtyre institucioneve e mbështet më shumë në mënyrën se si realizohet vendimmarrja e tyre, nëse ajo bëhet në mënyrë të centralizuar nga organet qeverisëse, apo bëhet nga një trupë e caktura e cila drejton universitetin, (psh. Senati, Keshilli Drejtues, etj). Kështu, sipas OECD, universitetet publike konsiderohen ato institucione të arsimit të lartë, drejtimi i të cilave kryhet nga një organizëm publik, i cili në përgjithësi emërohet nga qeveria. Ndërsa universitetet private janë ato institucione të cilat drejtohen dhe organizohen nga një bord drejtues, në përgjithësi jo i emëruar nga organet e qeverisë. Sipas këtij përcaktimi, universitetet private funksionojnë më shumë në formën e organizatave jo fitimprurëse. Pra dallimi midis publikut dhe privatit në arsimin e lartë, megjithëse mbështetet në dallimin e formës së pronësisë, nuk është i njëjtë me atë që kemi në sektorët e aktiviteteve të tjera ekonomike. Në arsim ky dallim është i përafërt me dallimin që kanë dy sektorët e veçantë institucional të ekonomisë: sektori i institucioneve të administratës publike dhe ai i institucioneve sociale private (jo fitimprurëse). Nga ana tjetër, prona private mbi të cilën mbështeten, i ka kthyer disa universitete private edhe në qendra të biznesit; dhe kjo vihet re jo vetëm në vende të zhvilluara si për shembull SHBA, etj, por edhe në vendet e Europës Lindore. Në këtë këndvështrim, këto universitete ngjasojnë më tepër me institucionet fitimprurëse. Shihet se dallimi publik – privat në arsim nuk është aq i thjeshtë sa në sektorët e tjerë; këtu në sektorin privat mund të kemi organizata jo fitimprurëse, por edhe fitimprurëse.

Por pavarësisht nga kjo, duke ruajtur përcaktimin e OECD për dallimin midis universiteteve publike dhe private dhe duke u interesuar më shumë në aspektin e financimit të universiteteve, mund të evidentojmë këtë fakt: në universitetet publike shërbimi i arsimit si dhe financimi i tij i ofrohen studentit, por duke mos qënë drejtpërdrejt nën kontrollin e tij. Siç treguam me siper, në universitete publike

vendimmarrja bëhet nga organet qendrore qeverisëse dhe të emëruarit prej saj. Financimi gjithashtu kryhet nga fondet publike, mbi bazën e taksimit të përgjithshëm. Nga ana tjetër, në universitetet private, studenti dhe financimi që vjen prej tij, mund të zgjedhë midis formave të ndryshme të ofertës për arsim, duke qënë në këtë mënyrë më aktiv ndaj shërbimit dhe cilësisë së ofruar.

Modelet kryesore të financimit të arsimit të lartë

Megjithëse mund të diskutojmë mbi dy mënyrat kryesore të financimit të arsimit të lartë, sistemet e arsimit në vendet e industrializuar karakterizohen nga një ndërthurje midis arsimit publik dhe atij privat. Secili vend mund të ketë mënyrën e tij të organizimit të arsimit të lartë me karakteristika të veçanta. Në përgjithësi, çdo vend dallon për rrugën e zgjedhur dhe bile ndoshta është e vështirë të gjejmë dy vende të cilat zbatojnë në mënyrë rigorozë të njëjtin sistem. Megjithatë, duke u nisur nga format e financimit të tyre, nëse janë ato kryesisht publike apo private, sot dallohen modelet kryesore të mëposhtme të sistemeve arsimore²:

• Modeli evropian, kontinental

Sipas këtij modeli, universitetet janë institucione publike dhe financohen nga buxheti i shtetit. Senati i një universiteti të tillë, i përbërë nga anëtarë të stafit akademik, ka një peshë të madhe në drejtimin e universitetit. Në vendet që aplikojnë këtë model, burimi kryesor i fondeve përcaktohet nga qeveria. Shpesh në këto universitete janë të ingranuar edhe institucione kërkimore – shkencore të cilat gjenerojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre, por që nuk përbëjnë një burim të drejtpërdrejtë për financimin e procesit mësimor. Ndërtimi i këtyre universitetete trashëgon parimet e shtetit të mirëqënies sociale, të cilat e konsiderojnë arsimin si një e drejtë për cilindo. Mbi këtë bazë, në këto vende studentëve u kërkohet të paguajnë fare pak për studimet e tyre të larta, gjë që do të thotë se mundësitë për të financuar sistemin e arsimit të lartë përmes të ardhurave nga regjistrimet e studentëve janë tepër minimale. Kështu, financimi publik në vendet e Bashkimit Evropian (EU 19) për vitin 2006 zinte rreth 81,9% të totalit të shpenzimeve për arsimin e lartë, ndërsa ai i sektorit privat ishte rreth 18,9%³. Grafiku 1 tregon peshën e shpenzimeve të sektorit publik dhe të atij privat për disa vende Europiane.

Spektori publik në arsim është në veçanti i rëndësishëm në Norvegji, ku në vitin 2009 ai zinte rreth 97,0% të shpenzimeve për arsimin e lartë; Danimarka 96,4%; Finlanda 95,5% dhe Belgjika 90,6%. Ndërsa ai zë një peshë më të vogël në Portugali 66,7%; Poloni 70,4% dhe Itali 73,0%⁴.

Megjithëse arsimi i lartë publik mbetet dominues në vendet europiane, duhet


² G. Psacharopoulos – "Public versus Private University System" CESifo DICE Raport 4/2004.

³ Including subsidies attributable to payments to educational institutions received from public sources.

⁴ Education on Glance 2009 – OECD Indicators

thënë se pesha e tij relativisht ka ardhur duke u ulur. Për vendet e EU 19 në tërësi, ndërsa në vitin 2000 ai zinte rreth 85,2 % të shpenzimeve për këtë arsim, në 2006 kjo peshë ka rënë në 81,9%. Rritja e fondeve publike për arsimin e lartë në EU 19 në 2006 në krahasim me 2000 ishte rreth +25%, ndërsa ajo e fondeve private +108%.

Graph 1: Shpërndarja e burimeve të fondeve publike dhe private për institucionet edukative pas transferimeve nga burimet publike 2005 (%).



Burimi: *Education on Glance 2009 – Indikatorët e OECD dhe përlogaritjet e vetë autorëve.*

• Modeli amerikan, (SHBA dhe Kanada).

Sipas modelit amerikan të SHBA universitetet janë në pjesën më të madhe institucione private të arsimit të lartë. Kjo do të thotë se financimi i tyre vjen kryesisht nga pagesat për shkollim, donacionet apo kontributet e ndryshme dhe një pjesë më e vogël nga buxheti i qeverisë federale apo lokale. Një gjë e tillë sjell që edhe administrimi i këtyre universiteteve apo kolegjeve të ketë në qender titullarin, i cili njihet edhe si president i institucionit, si dhe të ashtuquajturin “board of trustees”.

Një tipar dallues i sistemit amerikan është se aktivitetet arsimore dhe ato kërkimore në universitetet e këtij vendi kanë qenë dhe janë të lidhura mjaft ngusht midis tyre, dhe kjo që nga koha kur Presidenti Abraham Linkoln themeloi Akademinë Kombëtare të Shkencave në 1863 (Tarifa, F. 2010). Një lidhje e tillë institucionalisht organike midis mësimin dhe kërkimit ka mundësuar që idetë, stafet akademike si dhe resurset njerëzore e financiare të qarkullojnë më mirë midis universiteteve dhe sektorëve të tjerë të shoqërisë. Në vitin 2006 shpenzimet publike në arsimin e lartë në SHBA zin vetem 34,0% të totalit, ndërsa ato të sektorit privat pjesën dominuese, 66,0%. Ky organizim e ka bërë sistemin amerikan

të arsimit të lartë një nga më të suksesshmit. Sot, në Top 100 universiteteve më të shkëlqyera në Botë, 31 janë universitetet e SHBA-së (2010).

I ngjashëm me sistmin e arsimit të lartë në SHBA është edhe ai i Kanadasë. Shkalla e privatizimit këtu është më e ulët se në SHBA, në vitin 2006 në Kanada shpenzimet publike në arsimin e lartë zinin 53,4% ndërsa ato të arsimit privat rreth 46,6%.

• **Modeli Britanik, (UK, Irlandë) dhe ai Spanjoll.**

Këto modele përfaqësojnë një formë të veçantë të universiteteve private. Ato dallohen si nga modeli amerikan, ashtu edhe nga ai europian, pasi nuk janë ekzaktësisht as institucione shtetërore dhe as private. Ato janë institucione publike, të cilat mbështeten dhe subvencionohen nga qeveria, por nuk financohen krejtësisht prej saj. Financimi i tyre bëhet nga British Exchequer, një agjenci e veçantë qeveritare (e krijuar qysh në shekullin e 12-të nga Mbreti Henri I), përmes një procesi i cili ruan një barrierë midis universiteteve dhe qeverisë, duke u dhënë universiteteve britanike më shumë autonomi nga ajo që gëzojnë universitetet publike në Europë⁵. Në modelin britanik tarifa për ndjekjen e studimeve është më e lartë se në universitetet e tjera Europiane. Njëkohësisht, tërheqja e stafëve akademike më ekselente është një tjetër karakteristikë e sistemit Britanik. Në vitin 2006 shpenzimet publike të arsimit të lartë në UK zinin 64,8% ndërsa ato private 35,2% të totalit, pra larg nga niveli mesatar Europian. Rreth 75% e fondeve private të arsimit e përbënte kontributi i familjeve.

I ngjashëm me modelin britanik të financimit konsiderohet edhe sistemi spanjoll. Karakteristikat e këtij sistemi qendrojnë kryesisht në decentralizimin e burimeve të financimit. Në këtë vend, roli i ministrisë përgjegjëse për arsimin, Ministria e Shkencës dhe Inovacionit, në aspektin financiar është i limituar dhe kjo përgjegjësi i është lënë Komunave Autonome, gjë që sjell shpesh diferencime në alokimin e burimeve nga një komunë në një tjetër⁶.

• **Modeli Japonez dhe ai Australian.**

Ky model konsiderohet si lider në fushën e privatizimit të sistemit arsimor, pra është ekstremi tjetër krahasuar me sistemin kontinental. Ashtu sikurse në vendet e tjera të Azisë Lindore, edhe në Japoni ekziston një traditë karaktersistike për financimin e arsimit të lartë nga familja⁷. Në kuptimin fiskal, kjo gjë pasqyrohet në rolin kryesor që luan familja në financimin e arsimit të lartë, krahasuar kjo me rolin modest të shpenzimeve publike. Në vitin 2006 financimi i sektorit privat zinte 67,1% të totalit të shpenzimeve për arsimin e lartë, ku 51,4%, pra më shumë se gjysma, ishte financimi i familjeve. Ndërsa financimet publike zinin në të njëjtin

⁵ F. Tarifa – “*The American Triumph*” – MAPO 22.07.2010.

⁶ P. Santiago, J. J. Brunner, G. Hang, S. Malo, P. Pietragiacomo – *OECD Reviews of Tertiary Education – Spain*; 2009

⁷ H. Newby, Th. Weko, D. Breneman, Th. Johanneson, P. Maasen – *OECD Reviews of Tertiary Education – Japan*; 2009

vit vetem 32,2% të totalit. Me këtë strukturë financimi, për nga pesha e sektorit privat në arsimin e lartë, sistemi Japonez ndodhet ndër vendet e OECD-se i dyti, vetem pas Koresë, ku financimi i sektorit privat kap rreth 76,9% të shpenzimeve për arsimin e lartë (2006). Roli domethënës i sektorit privat ka bërë nga ana tjetër që në Japoni t'i kushtohet një vëmendje e veçantë licencimit të universiteteve private, në mënyrë që të sigurohet që në treg të funksionojnë vetem ato institucione të cilat plotësojnë në mënyrë të qartë kriteret cilësore të përcaktuara nga shteti.

I ngjashëm është edhe modeli i financimit të arsimit të lartë në Australi. Australia bën pjesë në grupin e vendeve ku financimet private në arsim zënë pjesën më të rëndësishme. Në vitin 2006 rreth 52,4% të shpenzimeve në arsimin e lartë e përbënin financimet private dhe vetem 47,6% ato publike.

Por “kampioni” në drejtim të privatizimit të arsimit të lartë, gjykuar kjo mbi bazën e strukturës së shpenzimeve publike apo private, sot e përbën Kili. Në sistemin Kilian të arsimit të lartë 83,9% të shpenzimeve financohen nga sektori privat dhe vetëm 16,1% nga ai publik. Mund të nevizojmë këtu se edhe reforma e financimit të arsimit të lartë e cila po diskutohet në Shqipëri është mbështetur pikërisht në këtë model.

Katër modelet kryesore të financimit të arsimit të lartë trajtuar më sipër, në mënyrë të sintetizuar mund t'i klasifikonim në këtë mënyrë: a. modeli kontinental, i bazuar kryesisht në universitetet publike; b. modeli britanik dhe ai spanjoll, i cili qëndron midis sektorit publik dhe atij privat; c. modeli amerikan, kryesisht institucione private të arsimit të lartë dhe d. modeli japonez dhe ai australian, të cilët përbëjnë ekstremin privat të institucioneve të arsimit të lartë. Sigurisht, nisur nga mënyra e financimit, këto modele paraqesin edhe një formë të caktuar të konceptimit të zhvillimit të arsimit, nëse duhet ai të mbështetet në financimin publik të të gjithë shoqërisë apo duhet menduar më shumë si një shërbim i cili lidhet me individin. Mbi të gjitha këto modele shtrohet pyetja: cila formë është më e mira në drejtim të cilësisë të cilën ajo ofron? Përgjigja këtu nuk është e thjeshtë pasi në cilësinë e arsimit të lartë nuk ndikon vetem mënyra e financimit. Deri në mesin e shekullit të kaluar, universitetet Europiane ishin qendra të ekselencës në arsim, por nga 50-60 vitet e fundi ky trend ka ndryshuar në drejtim të universiteteve amerikane. Megjithëse shkaqet e këtij ndryshimi janë mjaft komplekse, korelacioni midis privatizimit dhe nivelit akademik mund të evidentohet qartë. Kështu, duke qënë në elitën e univesiteteve në rrafshin global, universitetet amerikane konsiderohen edhe si shembull në fushën e privatizimit. Tabela 1 praqet 100 Top universitetet për vitin 2010 sipas modeleve arsimore të paraqitura më sipër, si dhe përqindjen që zënë financimet private për arsimin e lartë ndaj totalit të tyre. Megjithëse në cilësinë e arsimit të lartë ndikojnë edhe shumë faktorë të tjerë, tabela tregon në përgjithësi një korelacion pozitiv midis universiteteve të mbështetura në financimin privat dhe numrit të tyre në Top 100.

Tabela nr. 1. *Top 100 Universitetet e Botës për vitin 2010 dhe përqindja që zënë financimet private në arsimin e lartë*

Modeli	Përqindja që zënë financimet private në edukimin e lartë (%)	Numri i universiteteve në Top 100
(1)	(2)	(3)
<u>Kryesisht Publike</u> <u>(Europiane)</u>		<u>21</u>
Belgjika	9,4%	1
Danimarka	3,6%	2
Finlanda	4,5%	1
Franca	16,3%	2
Gjermania	15,0%	5
Hollanda	15,7%	4
Norvegjia	3,0%	1
Suedia	10,9%	2
Zvicra	na	3
<u>Ndwmjet publikut dhe</u> <u>privatit</u>		<u>20</u>
UK	35,2%	19
Irlanda	14,9%	1
Spanja	21,8%	0
<u>Kryesisht Private</u> <u>(Amerikane)</u>		<u>35</u>
Shtete e Bashkuara	66,0%	31
Kanadaja	46,6%	4
<u>Lieder në privatizim</u>		<u>12</u>
Japonia	67,8%	5
Australia	27,6%	7
<u>Other</u>		<u>12</u>

Burimi: "Rankimi i Top 100 Universiteteve në Botë 2010" <http://www.university-list.net/index.htm>
& "Education on Glance 2009" – OECD Indicators (të dhëna për 2006).

Financimi privat apo publik: argumentat dhe tendencat

Pavarësisht se universitetet apo kolegjet private përbëjnë elitën e universiteteve më të njohura, universitetet publike vazhdojnë të jenë në tërësi baza e arsimit të lartë. Nga ana tjetër, diskutimi mbi mënyrën e financimit të arsimit të lartë, nëse duhet t'i jepet më shumë peshë investimit privat apo ai duhet të mbetet kryesisht publik, ka përbërë gjithnjë një nga debatet më të mprehta të tij. Argumentat janë shpesh kontradiktore. Ato sillen në përgjithësi rreth pyetjes nëse arsimi i lartë është një e mirë për shoqërinë në tersi, apo ai duhet të konsiderohet kryesisht si një e mirë individuale. Teorikisht mbështetja apo subvencionimi publik i një aktiviteti të caktuar mund të

argumentohet me faktin që ky aktivitet të përbëjë një të mirë publike. Të mira të tilla duhet të zotërojnë dy karakteristika kryesore: të jenë jo rivale dhe jo përjashtuese. Në fakt arsimit nuk ka asnjë nga këto karakteristika: ai është rival në “konsumin” e tij, përderisa numri i nxënësve apo studentëve sidoqoftë është i kufizuar; gjithashtu është përjashtues, pasi është e lehtë të pengosh përfitimin e këtij shërbimi nga një individ i caktuar. Në këtë këndvështrim, arsimit në përgjithësi konsiderohet më shumë si një e mirë private sesa një e mirë publike. Atëherë, cilat janë disa nga argumentat kryesore pro apo kundër financimit publik të arsimit të lartë?

• Barazia sociale

Arsimi i lartë konsiderohet si një e drejtë të cilën shoqëria duhet t’ja ofrojë çdo anëtar të saj, pavarësisht nga të ardhurat që ai disponon. Një gjë e tillë shpesh sanksionohet edhe në kushtetutën e mjaft vendeve. Sigurimi i të drejtave të barabarta në arsimin e lartë, pavarësisht nga të ardhurat, sigurisht është në favor të universiteteve publike, pasi individët me të ardhura më të pakta mund të mos përballojnë dot koston e universiteteve private. Ky argument në favor të arsimit publik është më shumë social sesa ekonomik, pasi ai merr parasysh më shumë drejtësinë sociale sesa efikasitetin ekonomik.

Megjithatë, disa studiues, (S. Blöndal, S. Field, N. Girouard, 2002; dhe P. Tsakoglou, M. Antoninis, 1999), argumentojnë se sigurimi i kësaj të drejte është shpesh një iluzion. Ky argument mbështetet në dy aspekte: së pari, financimi i arsimit publik bëhet nëpërmjet taksimit të përgjithshëm, i cili në fakt nuk lidhet drejtpërdrejtë me arsimimin e individëve, megjithëse sistemi fiskal mund të jetë progresiv; së dyti, studimet tregojnë se përfituesit kryesorë të arsimit publik janë shtresat e popullsisë me të ardhura më të larta. Megjithëse e drejta për arsim mund të jetë “pa kosto”, shpenzimet që duhen për të ndjekur vitet e shkollimit, në raport me të ardhurat e individëve janë relativisht më të larta për familjet me më pak të ardhura sesa ato me më shumë të ardhura (Psacharopoulos dhe Papakonstantinou 2005). Në këtë mënyrë, nëpërmjet të drejtave të barabarta për të ndjekur arsimin publik, në fakt krijohet një rishpërndarje e të ardhurave në favor të shtresave më të pasura.

• Arsimi si një eksternalitet pozitiv.

Një tjetër argument për mbështetjen publike të arsimit të lartë është edhe fakti se ai konsiderohet si një aktivitet i cili shoqërohet me një eksternalitet pozitiv për shoqërinë në tërësi. Një aspekt i rëndësishëm i këtij eksternaliteti është fakti se rritja e nivelit arsimor shërben si një mundësi për rritjen e nivelit të demokratizimit dhe civilizimit të shoqërisë në tërësi. Glaeser, Ponzetto dhe Shleifer, në punimin e tyre “Why Does Democracy Need Education”⁸ në mënyrë empirike argumentojnë se ekziston një korrelacion i caktuar midis nivelit të arsimimit dhe qeverisjes demokratike. Gjithashtu D. Acemoglu (2005) konsideron se demokracia ka një lidhje korrelacioni me numrin mesatar të viteve të arsimimit, vendet që kanë mesataren më të lartë të viteve në arsimim

⁸ E. L. Glaeser, G. A. M. Ponzetto and A. Shleifer - “Why Does Democracy Need Education” - NBER Working Paper No. W12128; April 2006

janë edhe më demokratike. Sigurisht, duhet të theksojmë se në nivelin civilizues dhe demokratik të një shoqërie ndikojnë dhe faktorë të tjerë, por studimet e kryera, nëse mund të shihen me kujdes, kur bëhen krahasime midis vendeve, ato janë krejtësisht të argumentuara nëse shihen brenda të njëjtit vend.

Por një aspekt tjetër i rëndësishëm i arsimit si një eksternaliteti pozitiv, evidentohet edhe në drejtim të përfitimit ekonomik që i sjell ai, jo thjesht individit, por edhe shoqërisë në tërësi. Në mjaft statistika të OECD evidentohet se investimi në arsim shoqërohet me përfitime si private ashtu edhe sociale. Në tabelën 2 jepen përfitimet neto private dhe publike sipas vendeve të OECD.

Tabela 2: *Përfitimet neto private dhe publike (USD) sipas vendeve të OECD (2005)*⁹

Vendet	Përfituesit Privat		Përfituesit Publik	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Australia	48.714	61.374	47.368	31.357
Austria	60.519	42.915	37.586	25.911
Belgjika	63.414	60.792	96.186	81.858
Kanada	69.235	45.365	23.875	12.839
Republika Ceke	146.673	80.418	160.834	29.239
Danimarka	7.342	11.983	14.236	-22.702
Finlanda ¹	64.664	26.392	55.612	24.003
Franca	40.260	-1.908	36.730	40.903
Gjermania	48.024	10.450	63.604	13.554
Hungaria	127.691	43.432	94.804	63.921
Irlanda ¹	104.410	78.158	74.219	46.027
Italia ¹	173.889	25.806	63.756	32.887
Korea ²	85.586	129.516	21.280	13.752
Zelanda e Re	40.036	33.571	28.193	13.732
Norvegjia	23.306	34.032	17.851	-1.116
Polonia ¹	146.539	84.266	57.221	33.925
Portugalia	186.307	123.357	50.271	66.975
Spania ¹	55.695	73.495	19.752	21.012
Suedia	18.802	5.097	17.197	-10.923
Turqia	41.090	47.695	10.346	12.255
Shtetet e Bashkuara	169.945	75.492	100.119	43.469
Mesatarja	82.007	51.986	51.954	27.279

Burimi: *Education on Glance 2009 – Indikatorët e OECD*

1. Viti i referimit 2004.

2. Viti i referimit 2003

⁹ Parë për here të fundit: 19-Aug-2009.

Në këto llogaritje përfitimi neto privat, apo ai social, tregon se sa janë përfitimet neto nga një individ i cili kryhen arsimin e lartë, duke marrë parasysh shpenzimet gjatë viteve të arsimimit dhe përfitimet bruto gjatë gjithë jetës së tij. Shihet se përfitimi publik neto, mesatarisht për meshkuj i kalon 50.000 USD, ndërsa për femrat është më shumë se 27.000 USD për student. Duke marrë parasysh shpenzimet publike direkte për student, të cilat janë mesatarisht 21.003 USD për meshkujt dhe 20.970 USD për femrat¹⁰, shihet se përfitimi publik neto për meshkujt është rreth dy herë më shumë se sa shpenzimi i kryer, ndërsa për femrat diferenca është më e vogël.

Këto të dhëna janë një argument për subvencionimin e arsimit të lartë nga ana e sektorit publik. Nga ana tjetër, shihet se përfitimi neto privat, është edhe me i konsiderueshëm se ai publik. Kështu mund të shtrohet edhe pyetja, përderisa ekziston një stimul dhe nxitje e vetë individit për kryerjen e studimeve të larta, a duhet konsideruar subvencioni i arsimit të lartë si rruga më e mirë për të “rregulluar” këtë eksternalitet?

• Argumenta të tjerë për mbështetjen e arsimit publik

Përveç argumentave kryesorë të përmendur më sipër, zhvillimi i arsimit të lartë shpesh argumentohet edhe me faktorë të tjerë. Një prej tyre është për shembull mos funksionimi i tregut për marrjen e kredive për qellime studimi (H. S. Rossen, T. Gayer 2009). Kjo për faktin se kapitali human nuk përbën një kolateral për marrjen e kredive. Në këtë mënyrë argumentohet edhe mbështetja publike me kredi për kryerjen e studimeve të larta, e cila nuk është e njëjtë me subvencionim klasik të këtij arsimi.

Po kështu, argument për arsimin publik është edhe mungesa e informacionit nga individët për mundësitë e gjetjes së punës pas përfundimit të studimeve (G. Psacharopoulos 2004). Në këtë drejtim arsimit publik mendohet se mund të orientojë më mirë studentët nëpërmjet kuotave që ai mund të përcaktojë për çdo degë. Por edhe këtu pyetja shtrohet nëse vetë qeveria mund të përlllogarisë saktë vendet e punës sipas profesioneve. Faktet tregojnë se shpesh herë numri i të drejtave të studimit në sektorin publik, sidomos në degët ku investimet kapitale nuk janë të konsiderueshme, merr parasysh më shume kërkesat për studim sesa nevojat reale të ekonomisë.

• Problemet dhe tendencat në financimin e arsimit publik

Faktorët e mësipërm argumentojnë nevojën e financimit publik të arsimit të lartë. Megjithatë, qoftë në aspektin teorik, këto argumenta lënë vend për diskutim. Nga ana tjetër, jashtë trajtimeve të mësipërme teorike, zhvillimi i arsimit publik duhet të marrë parasysh edhe mundësitë reale që disponon një ekonomi, burimet financiare.

Në këtë drjetim, karatersitikë e përgjithshme e arsimit, në mjaft vende është rritja e konsiderueshme e kërkesës për të. Ai konsiderohet si një nga sektorët dhe aktivitetet ekonomike me “boom-in” më të madh në vitete e fundit. Kështu në SHBA, shpenzimet e qeverisë federale dhe të shteteve të veçanta për arsim tejkalojnë shumën prej rreth 750 milion USD (2009).

¹⁰ Education on Glance 2009 – OECD Indicators.

Në vendet e OECD përqindja e hyrjes (entry rate) të nxënësve që mbarojnë shkollën e mesme (secondary education) në shkollën e lartë (tertiary education), nga viti 1992 në 2005 është rritur mesatarisht rreth 20%, duke shkuar nga 37% në 55%. Në vitin 2007 në disa vende si në Australi, Finlandë, Suedi, Poloni etj., kjo përqindje ishte mbi 70% (tabela 3).

Tabela 3: *Përqindja e hyrjes në arsimin e lartë për disa vende % (1995–2007)*

	1995	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Australia	na	59	65	77	68	70	82	84	86
Finlanda	39	71	72	71	73	73	73	76	71
Hungaria	na	64	56	62	69	68	68	66	63
Islanda	na	66	61	72	83	79	74	78	73
Korea	41	45	46	46	47	49	51	59	61
Zelanda e Re	83	95	95	101	107	86	79	72	76
Norvegjia	59	67	69	75	75	72	76	67	66
Polonia	36	65	68	71	70	71	76	78	78
Sllovakia	28	37	40	43	40	47	59	68	74
Suedia	57	67	69	75	80	79	76	76	73
Shtetet e Bashkuara	na	43	42	64	63	63	64	64	65
Kili	na	na	32	33	33	34	48	43	41
Mesatarja e OECD	37	47	48	52	53	53	55	56	56
Mesatarja EU19	35	46	47	49	50	52	53	55	55

Burimi: *Education on Glance 2009 – Indikatorët e OECD*

Një tendencë e tillë vihet re jo vetëm në vendet e zhvilluara por edhe për vendet në zhvillim. Kjo karakteristikë shprehet qartë edhe në rritjen e indeksit të përgjithshëm të *enrolment rate*, i cili paraqet përqindjen e nxënësve dhe studentëve aktualë në të gjitha nivelet e arsimit, ndaj atyre potencial. Sipas Bankës Botërore në raportin e saj të fundit, për të gjitha vendet në zhvillim ky tregues është rritur nga 81% në 1996 në 86% në vitin 2006.

Një rritje e tillë e kërkesës për arsim shpjegohet në tërësi si me rritjen e popullsisë, ashtu edhe me kërkesat për një vend pune më të stabilizuar, për më shumë mobilitet në tregun e punës, për paga më të mira, etj. Gjithashtu zhvillimi i arsimit konsiderohet si një nga rrugët kryesore për transformimin cilësor të shoqërisë, rritjen e mirëqënies, sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, reduktimin e varfërisë, etj.

Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë rritjen graduale të shpenzimeve për një student (për frymë). Për 19 vende të BE-së shpenzimet mesatare për student në vitin 2006 janë rritur rreth 11%, ndërsa për vendet e OECD rreth 13%.

Me gjithë rritjen në masë absolute, pesha e shpenzimeve publike për arsimin e lartë në përqindje ndaj GDP-së si dhe ndaj totalit të shpenzimeve publike ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Kështu, mesatarisht ndaj GDP-së shpenzimet për arsimin e lartë për 19 vende të BE-së dhe për ato të OECD në 2006 ka qënë përkatësisht 1,3% dhe 1,4%; ndërsa ndaj totalit të shpenzimeve publike, kjo peshë zinte përkatësisht 2,9% dhe 3,1%.

Në këtë këndvështrim, mund të nënvizohen tre faktorë kryesorë, të cilët karakterizojnë financimin e shpenzimeve për arsimin e lartë:

- a. Rritja e ndjeshme e kërkesës për arsimin e lartë.
- b. Rritja e shpenzimeve për një student.
- c. Kufizimet buxhetore në financimin e arsimit publik.

Të tre këto faktorë kanë rritur kërkesën për financime në arsimin e lartë, duke e konfrontuar atë me buxhetet e kufizuara dhe duke vënë në vështirësi ekonomike mjaft vende, qofshin këto edhe të zhvilluara.

Cila mund të ishte rruga kryesore për të përballuar këto tendenca dhe vështirësi? Mjeti kryesor në këtë drejtim konsiderohet zhvillimi i arsimit privat krahas atij publik. Sipas Bankës Botërore, partnerhipi midis sektorit publik dhe atij privat është rruga kryesore për t'ju përgjigjur nevojave gjithnjë në rritje për arsim. *World Economic Forum* i organizuar në prill të viti 2010 në Kolumbi¹¹, theksoi edhe një herë nevojën e angazhimit të sektorit privat në fushën e arsimit, nëpërmjet një partnerhipi më të mirë, me qëllim rritjen e numrit të të arsimuarve, nxitjen e zhvillimit të njohurive dhe transformin e tyre në prosperitet.

Rrugët kryesore për angazhimin e sektorit privat në arsim mund të jenë dy:

Së pari, është ajo e investimeve të drejtpërdrejta të sektorit privat në arsim. Ky drejtim ka të bëjë me trajtimin teorik dhe praktik të mekanizmit të tregut edhe në arsimin e lartë. Qëllimi i adoptimit të mekanizmave të drejtpërdrejtë të tregut mund të synojë objektiva të ndryshëm, ndër të cilët, më të rëndësishmet mund të përmenden: a) mbulimi i kërkesës për arsim të lartë në degë të caktuara; b) gjenerimin e burimeve financiare suplementare në arsimin e lartë; c) përmirsimi i cilësisë së mësimdhënies; d) rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit në arsimin e lartë nëpërmjet konkurrencës¹².

Rruga e investimeve të drejtpërdrejta private në arsim është karakteristike për Japoninë, Korenë si dhe SHBA-në dhe Kanadanë. Në Japoni 90% e 'junior colleges' dhe 'professional training colleges' janë private, ndër të cilët afërsisht 78% janë universitete. Në Kore rreth 85% e universiteteve janë private, gjithashtu në Kinë tendenca e tregut të arsimit të lartë është në zgjerim të vazhdueshëm. Zhvillimi i sektorit privat të arsimit në SHBA ka arritur sot përmasa të bizneseve gjigande në kuptimin e plotë të këtij termi. Sipas EIA (*Education Industry Association*) arsimi përfaqëson në këtë vend një nga bizneset më të qëndrueshme, duke kapur shifrën e afërt me 1 trilion USD. Në

¹¹ World Bank - *World Economic Forum – 2010*; Cartagena, Colombia 6-8 prill 2010

¹² F. Kaiser - "Market type mechanisms in higher education: a comparative analysis of their occurrence and discussions on the issue in five higher education systems", CHEPS report / Higher Education Monitor Thematic report -1999.

SHBA “industria” e arsimit përfaqëson rreth 10% të GDP-së, duke u renditur e dyta në aktivitetin ekonomik pas shëndetësisë. Krahas formave klasike të universiteteve dhe kolegjeve private, ky zhvillim pasqyrohet dhe në rritjen e korporatave të vërteta që veprojnë në sferën e arsimit. Kështu, mund të përmendet për shembull “*DeVry University*” në Illinois me 90 filiale në SHBA dhe Kanada; “*Estacio Participacoes SA*” në Brazil, një kompani e përbërë nga 6 organizata fitimprurëse në fushën e arsimit dhe kualifikimit; “*Apollo Group*” me një aktivitet të gjerë në fushën e edukimit, trainimeve dhe arsimit; “*Illinois-based Career Education*” e shtrirë në ShBA; Britaninë e Madhe; Francë dhe Itali duke operuar në fushën e arsimit pas atij të mesëm; ndërsa në rajonin e Azisë përmendet “*Raffles Education*” në Singapor, e cila operon me 34 kolegje të arsimit të lartë në 31 qytete të 12 vendeve të ndryshme të rajonit.


Së dyti, rrugë tjetër e tërheqjes së investimeve private në arsim është edhe ajo e reformës së financimit të shpenzimeve publike. Spektri i këtyre reformave është mjaft i gjërë¹³, por të gjitha këto reforma mbështeten në harmonizimin sa më të mirë të interesave të të gjithë aktorëve që përfitojnë nga arsimi i lartë, duke synuar zgjerimin e mundësive për involvimin e arsimit privat, brenda standarteve të caktuara, në mbështetjen financiare të arsimit të lartë. Baza teorike e tyre mbështetet në trajtimin që bëjnë më lart: ofrimi i arsimit publik është një detyrim ndaj shoqërisë, por njëkohësisht edhe një e mirë me karakter “privat”. Ky detyrim shtrihet në kufij të caktuar, siç mund të jenë për shembull ciklet e arsimit të ulët apo të mesëm, nevojat e shtresave në vështirësi ekonomike, etj. Më tej, ky shërbim “publik” merr karakterin e një të mire me karakter “privat”, që e diferencon mirëqenien e një individi nga një tjetër. Në këtë këndvështrim ofrimi i arsimit publik, e në veçanti i arsimit të lartë, synon sot të tërheqë në financim edhe sektorin privat e individin. Le të shohim për shembull transformimin themelor të sistemit të arsimit të lartë, të mirënjohurin “Sistem i Bolonjës”. Thelbi i tij qëndron në përshtatjen më të mirë të sistemit arsimor ndaj nevojave të tregut. Por a ka ky transformim impakt edhe në aspektin financiar. Sigurisht që po. Më pare, cikli i arsimit të lartë normalisht ishte 4 vjet, të cilat financoheshin kryesisht nga sektori publik. Sot me sistemin e Bolonjës, vetëm 3 vitet e para, pra një më pak, (diploma “*bachelor*”), mund të konsiderohet si një shërbim të cilin shoqëria duhet t’ja ofrojë të gjithë individëve. Pas kësaj, kryerja e diplomave master apo të doktoraturës, vlerësohet si një e mirë “private” që lidhet me individin. Për këtë arsye edhe kryerja e tyre parashikohet me një kontribut të caktuar edhe të individit, duke realizuar kështu në fakt një financim të përbashkët publik – privat.

Reformat e financimit të arsimit të lartë mbështeten më shumë në ndarje të kostove të shkollimit midis: qeverisë (nëpërmjet taksimit të përgjithshëm); familjeve; studentëve dhe donatorëve të mundshëm (sektori privat). Tendenca e përgjithshme në këtë bashkëfinancim është rritja e peshës së burimeve të sektorit privat dhe zvogëlimi i asaj të sektorit publik. Në grafikun 2 dhe 3 jepet ndryshimi i kësaj strukture në sektorin privat dhe atë publik:

¹³ P. Santiago; K. Tremblay; E. Basri; E. Arnal – *Tertiary Education for Knowledge Society* – OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volum 1, 2008


Format e bashkëfinancimit dhe njëkohësisht mënyrat e alokimit të burimeve publike për të tërhequr në arsimin e lartë edhe burime të sektorit privat mund të jenë të ndryshme. Në vazhdim do të japim modelin e propozuar për reformën në financimin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Grafiku nr. 2: *Përqindja e burimeve private në financimin e arsimit të lartë*



Burimi: *Education on Glance 2008 & 2009 – Indikatorët e OECD*

Grafiku nr. 3: *Përqindja e burimeve publike në financimin e arsimit të lartë*




Burimi: *Education on Glance 2008 & 2009 – Indikatorët e OECD*

Reforma financiare e arsimit të lartë dhe prirjet në zhvillimin e arsimit të lartë në Shqipëri

Karakteristika më domethënëse e arsimit të lartë në Shqipëri në 10 vjeçarin e fundit është rritja e konsiderueshme e kërkesës për arsimin e lartë, pra rritja e numrit të studentëve, e cila siç treguam përbën një prirje të përgjithshme të zhvillimit edhe në vendet e tjera. Në vitin 2010 - 2011 numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë në krahasim me vitin 2000 - 2001 u rrit rreth 3 herë (grafiku 4). Si rezultat, përqindja e tërheqjes së nxënësve nga arsimi i mesëm në atë të lartë ka ardhur duke u rritur: nga 57% që ishte ky tregues në vitin 2004 - 2005, në vitin 2009 - 2010 ai ariti në 79,6%. Indeksi *enrolment rate* në Shqipëri për arsimin e lartë, nga 11-15% në vitin 2002 - 2003, në vitin 2006 arriti në 28% dhe në vitin 2008 në rreth 42%, gjithashtu numri i studentëve për 10.000 banorë nga 79 në vitin 2005 arriti në 116 në vitin 2009.

Megjithë rritjen e konsiderueshme, përsëri indeksi i *enrolment rate* është më i ulët në krahasim me mjaft vende të tjera, duke përfshirë edhe ato të rajonit, si për shembull Greqinë, ku indeksi është 92%, Italinë 67%, Rumaninë 66%, Bullgarinë 51%, etj¹⁴.

Grafiku nr. 4: *Numri i studentëve në periudhën 1995 - 2010*



Burimi: INSTAT & Ministria e Edukimit dhe Shkencës(2010)

Rritja e numrit të studentëve është shoqëruar me rritjen e shpenzimeve publike për arsimin e lartë. Sidoqoftë, kjo rritje ka qënë më e ulët në krahasim me rritjen e numrit të studentëve (tabela 4). Nga të dhënat shihet gjithashtu se rritja e shpenzimeve për arsimin në tërësi ka qënë graduale, por rritmet e rritjes kanë rënë në vitet e fundit

¹⁴ Burimi: UNESCO të dhënat aktuale për 2008.

2009 – 2010. Kjo rënie mund të shpjegohet edhe me ndikimin e krizës globale dhe me përpjekjet për të mbajtur të kontrolluar defikëtin buxhetor.

Shpenzimet publike në arsim zënë rreth 3,0% – 3,1% të GDP, ndërsa ato të arsimit të lartë rreth 0,6% - 0,7% të GDP. Këto indekse janë akoma më të ulta sesa ato të vendeve të zhvilluara europiane, për shembull, për 19 vende të BE-së, mesatarisht për vitin 2006 shpenzimet për arsimin zinin rreth 5,5% të GDP-së, ndërsa ato për arsimin e lartë rreth 1,3% të GDP-së.

Table 4: *Shpenzimet Publike për Arsimin e Lartë në Shqipëri (%)*

	2006	2007	2008	2009	2010
Shpenzimet publike në arsim (krahasuar me vitin e mëparshëm)	3,9%	12,9%	22,4%	4,4%	1,2%
Shpenzimet publike në arsim ndaj GDP	2,91%	3,00%	3,26%	3,23%	3,05%
Shpenzimet publike në arsimin e lart ndaj GDP	0,55%	0,56%	0,57%	0,80%	0,65%
Arsimi i lartë publik ndaj totalit të shpenzimeve publike në edukim	18,9%	18,8%	17,5%	24,9%	21,4%
Numri i studentëve (krahasuar me vitin paraardhës)	16.4%	13.3%	18.3%	1.1%	22,94%

Burimi: Ministria e Financave (2010)

Pa dashur të hyjmë në detaje të analizës, nga të dhënat e mësipërme (tabela 4) mund të evidentohen qartë tre karakteristika kryesore:

a. Shqipëria, të paktën në aspektin e zhvillimit sasior, ka trashëguar një zhvillim të kufizuar të arsimit të lartë, gjë që konkretizohet si në *enrolment rate* ashtu edhe në numrin e studentëve për 10.000 banorë.

b. Në 10-15 vitet e fundit, vendi është ballafaquar me një kërkesë mjaft të lartë për arsimin e lartë, e cila shprehet në rritjen e numrit të studentëve nga viti në vit.

c. Mundësitë financiare për mbështetjen e kërkesës për arsim nga ana e sektorit publik kanë qënë të kufizuara. Megjithatë shpenzimet publike për arsimin e lartë janë rritur, peshë e tyre në raport me GDP ka pësuar një rritje mjaft të vogël duke mbetur larg në krahasim me mesataren europiane.

Duke pasur parasysh këto aspekte, një burim suplementar për financimin e nevojave për arsimin e lartë, është konsideruar zhvillimi i arsimit të lartë privat. Përveç aspekteve të përmbajtjes, të cilat lidhen me hapjen e tregut dhe nxitjen e konkurrencës në sektorin e arsimit, arsimi i lartë privat ka ndikuar pozitivisht në përballimin e kërkesës së rritur për arsimim. Zhvillimi i tij realisht mund të konsiderohet në hapat e para, megjithatë, ashtu sikurse në vendet e tjera të Europës Lindore, karakteristik

është zhvillimi i tij i shpejtë. Universiteti i parë privat u hap në vitin 1992, (University New York of Tirana -UNYT), deri në vitin 2005 numri i institucioneve private të arsimit të lartë ishte vetëm 5, ndërsa në 2010 numri i tyre ishte 37. Në vitin akademik 2003/2004 arsimi i lartë privat zinte vetëm 0,8% të totalit të numrit të studentëve, në vitin 2005/2006 rreth 2,3% ndërsa në vitin 2007/2008 rreth 10,5%. Aktualisht vlerësohet që ai kap rreth 12% të numrit të studentëve.

Aktualisht, arsimi i lartë privat është kryesisht (vetëm me një përjashtim) në formën e institucioneve private fitimprurëse, pra të mbështetur në investimet private të individëve duke patur si qëllim fitimin.

Problemet me të cilat është ndeshur dhe ballafaqohet zhvillimi i arsimit në Shqipëri, si ai i sektorit publik ashtu edhe ai i sektorit privat, përfshijnë një spektër mjaft të gjerë e të diskutueshëm, ato prekin mjaft dukuri të rëndësishme sasiore dhe cilësore të tij. Sidoqoftë, ky punim nuk synon të trajtojë këto aspekte. Këndvështrimi i tij është kryesisht ai i anës ekonomike e financiare mbi të cilën ai mund të mbështetet dhe zhvillohet. Ky aspekt, megjithëse mund të duket i shkëputur nga reformat e ndryshme që janë ndërmarrë në arsim, në fakt shoqëron të gjitha ndryshimet që vihen re në këtë fushë, ku në disa raste, ai është në themel të këtyre ndryshimeve.

Reforma e financimit të arsimit të lartë në Shqipëri.

Reforma e financimit të arsimit të lartë në Shqipëri është një etapë shumë e rëndësishme në reformimin e të gjithë sistemit arsimor. Aktualisht ky sistem sot mbështetet në sistemin klasik të bazuar në institucionet e arsimit publik dhe ato private. Institucionet publike të arsimit të lartë subvencionohen në mënyrë të detajuar nga shteti, ndërsa me të ardhurat sekondare që krijojnë ato mund të kryejnë shpenzime sipas një strukture të caktuar (kryesisht investime). Ndërsa institucionet private të arsimit të lartë janë investime të biznesit privat dhe financohen nga studentët. Të dyja këto institucione janë përfshirë dhe aplikojnë të ashtuquajturën “Kartë të Bolonjës”.

Reforma financiare në arsimin e lartë synon të realizojë dy objektiva kryesore: së pari, rritjen e nivelit të cilësisë së studimeve në arsimin e lartë nëpërmjet futjes së mekanizmave të tregut dhe nxitjen e konkurrencës; së dyti, masivizimin e arsimit të lartë, nëpërmjet nxitjes së institucioneve private për gjenerimin e fondeve suplementare për financim. Ndryshe nga sistemi aktual, reforma financiare e propozuar për arritjen e këtyre dy objektivave mbështetet në transformimin e mënyrës së subvencionimit publik të arsimit të lartë.

Aktualisht subvencionimi i arsimit të lartë kryhet vetëm për institucionet publike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra nëpërmjet institucioneve publike të financuara nga buxheti i shtetit, studentit i ofrohet një “shërbim” i caktuar, pothuajse pa pagesë. Studenti ndodhet përpara pyetjes, nëse duhet ta pranojë këtë shërbim i cili i jepet “falas” (kundrejt një pagese minimale), apo të zgjedhë midis univeristeteve privat, duke e financuar tërësisht vetë arsimimin e tij. Duke qënë se faktorët e tjerë, përveç mënyrës së financimit, janë pothuajse të njëjtë (stafet akademike, infrastruktura, etj), në përgjithësi studentët zgjedhin rrugën e parë, pra atë të ndjekjes së studimeve në një universitet publik. Ky pozicion i vendosë universitetet publike në pozita të

avantazhuara, duke mos nxitur përpjekjet për rritjen e cilësisë së shërbimit të cilën ato ofrojnë. Duke e parë këtë problem thjesht nga pozitat e “përfituesit” të fondeve publike, pra në këtë rast të studentit, duket se mënyra e përdorimit të këtyre fondeve mund të mos jetë efektive.

Sistemi i ri i financimit që propozohet është ai që subvencionimi të bëhet direkt tek përfituesi i tij, tek studenti, i cili nëpërmjet këtij subvencioni mund të zgjedhë ofertën më të mirë midis të gjitha institucioneve të arsimit të lartë të cilat ofrohen në treg. Pra fondet publike të mos shkojnë drejtpërdrejt tek institucionet publike të arsimit të lartë por të “ndjekin” studentin. Në këtë mënyrë mendohet se nga njëra anë do të nxiten përpjekjet e institucioneve të arsimit të lartë për të rritur cilësinë e tyre, ndërsa nga ana tjetër do të nxisë fondet private të investojnë në arsim, duke konkurruar për përfitimin e fondeve publike dhe duke u ndodhur në të njëjtat kushte konkurrence sikurse institucionet publike të cilat ofrojnë të njëjtin shërbim. Sistemi që propozohet njihet ndryshe si sistemi me “bazë studentin”

Realizimi i kësaj skeme bazohet së pari në dy shtylla kryesore: së pari, përcaktimi i saktë dhe ligjor i universiteteve të cilët do të mund të përfitojnë fondet publike; dhe së dyti, përcaktimi kritereve për studentët të cilët do të mund të përfitojnë financim.

Nisur nga dimensionimi i parë, institucionet e arsimit të lartë që mund të përfitojnë nga fondet publike duhet të plotësojnë dy kritere themelore:

- Ato duhet të jenë jo fitimprurëse.
- Duhet të plotësojnë nivelin cilësor të pranuar në Shqipëri.

Përfshirja e universiteteve private në skemën e financimit me bazë studentin do të përcaktohet së pari nga statusi juridik i tyre. Universitet private duhet të jenë të regjistruara si organizata jo-fitimprurëse për të përfitur nga fondet publike. Kriteri jo fitimprurës lidhet me idenë se fondet publike nuk duhet t’u shpërndahen universiteteve të cilët kërkojnë të maksimizojnë fitimin e tyre. Ky kriter konsiderohet mjaft i rëndësishëm pasi shpesh arsimin si një aktivitet dhe investim social, nga synimi ekonomik për rritjen e fitimit të një biznesi privat. Në këtë mënyrë edhe universitetet private do të orientojnë më mirë në rritjen e të ardhurave të tyre, duke synuar rritjen e cilësisë.

Nga ana tjetër, qeveria shqiptare do të financojë nga fondet publike vetëm ato Institucione të arsimit të lartë (publike dhe private) të cilat janë mbi një nivel (prag) cilësie të përcaktuar dhe të qartë. Kjo bëhet për të mbrojtur publikun e gjerë, përfituesit e drejtpërdrejtë (studentët, familjarët e tyre), si dhe fondet publike. Për këtë, një rol të rëndësishëm do të ketë Këshilli i Akreditimit, i cili do të përcaktojë për institucionet e arsimit të lartë “pragun e cilësisë” të domosdoshëm për tu përfshirë në skemën e financimit, si dhe në përzgjedhjen e institucioneve të cilët e plotësojnë këtë kriter cilësie. Vlerësimi i cilësisë së universiteteve në raport me “pragun e përcaktuar të cilësisë” do të kthehet në një aspekt të rëndësishëm të rutinës së vlerësimit të jashtëm të cilësisë së universiteteve.

Aktualisht, vlerësimi i cilësisë nga Këshilli i Akreditimit nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur reformën financiare. Vlerësimi aktual i standarteve dhe cilësisë së universiteteve nga Agjencia Publike e Akreditimit të arsimit të lartë (APAAL)

nuk përfshin vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, e identifikuar si një nga sfidat e rëndësishme për universitetet shqiptare. Nisur nga rëndësia absolute që ka sigurimi i cilësisë, paralelisht me reformën financiare, qeveria shqiptare duhet të forcojë autoritetin e Këshillit të Akreditimit duke bërë më rigoroz dhe kërkuar procesin e vlerësimit të cilësisë.

Implementimi i reformës financiare kërkon një set indikatorësh të vlerësimit të cilësisë i cili të jetë i observueshëm dhe i matshëm në mënyrë të besueshme. Këta indikatorë do të përdoren për të përcaktuar pragun e cilësisë dhe për të identifikuar institucionet e arsimit të lartë të përshtatshme për tu përfshirë në skemën e financimit me bazë studentin.

Disa nga sygjerimet e deritanishme mbi indikatorët minimal të cilët duhet të përfshihen në vlerësim janë:

- Programet e akredituara.
- Numri i personelit akademik (punësuar me kohë të plotë) për student (për fushë studimi).
- Numri i fakulteteve, departamenteve dhe stafit akademik.
- Sipërfaqja standarte për student.
- Numri i titujve në bibliotekën e universitetit për student.
- Akses i studentëve në internet (broadband) etj.

Ky prag i cilësisë, (i matshëm), do të përdoret për të vlerësuar përshtatshmërinë e universiteteve private dhe publike për tu përfshirë në skemën e financimit me “bazë studentin”. Mund të ndodhë që ndonjë nga universitetet publike të mos plotësojë të gjitha normat e përcaktuara të cilësisë. Nisur nga fakti që universitetet publike janë një aset shumë i rëndësishëm kombëtar, qeveria shqiptare do t’u kërkojë këtyre universiteteve që për një periudhë të përcaktuar kohore të përmirësojë treguesit e cilësisë deri në nivelin e kërkuar. Qeveria Shqiptare duhet të mbështesë financiarisht universitetet në këtë përpjekje nëpërmjet Fondit të Zhvillimit Strategjik.

Dimensionimi i dytë i reformës së financimit është ai i kriterëve të cilat do të përdoren për të përcaktuar studentët të cilët do të përfshihen në skemën e financimit publik. Institucionet e arsimit të lartë do të jenë të lirë të vendosin standartet e tyre në pranimin e studentëve, por për studentët të cilët do të përfshihen në skemën e financimit do të aplikohet një kufi minimal i pikëve të maturës shtetërore si kusht për përfitimin e fondeve publike. Ky kusht synon të mbrojë cilësinë dhe të ulë riskun që universitetet të pranojnë studentë të cilësisë së ulët, thjesht për të rritur numrin e studentëve nga i cili varen dhe fondet publike që ato përfitojnë. Në këtë drejtim Ministria e Arsimit dhe Shkencës po përgatit rritjen e numrit të provimeve të maturës për të përfituar “Diplomën e Gjimnazit” (nga 3 në 4 provime, provimi i gjuhës së huaj të parë që do të futet në provimet e detyruara në 2012).

Në skemën e financimit me “bazë studentin”, universitetet do të konkurojnë për të tërhequr studentë, çka do të thotë se universitetet do të operojnë në kushtet e “tregut”. Ashtu sikurse në të gjitha fushat, edhe në arsim, që tregu të jetë transparent dhe efikas, studentët (“konsumatorët”) duhet të jenë të informuar për të marrë vendimet e tyre (parimi i informacionit përfekt –jo asimetrik). Në këtë drejtim Ministria e Arsimit dhe

e Shkencës do të sigurojë ekzistencën e informacionit të mjaftueshëm për studentët në mënyrë që ata të njohin një program të caktuar studimi, të njohin perceptimin e përgjithshëm mbi cilësinë akademike të tij si dhe vlerësimin që vjen nga tregu i punës. Për këtë qëllim, si parakusht për të përfutur nga financimi, çdo universiteti do t'i kërkohej të bëjë një paketë informative për studentët potencialë, si dhe të përcaktojë pika kontakti.

Dy dimensionet e mësipërme, përcaktimi i bazës ligjore të institucioneve dhe i kriterëve që duhet të plotësojnë studentët për tu përfshirë në skemën e re të financimit, përcaktojnë përbajtjen cilësore të reformës së propozuar. Në aspektin teknik rëndësi paraqet gjithashtu edhe përlllogaritja e fondit të financimit dhe financimi publik për student.

Fondi total i financimit do të varet nga financimi për një student dhe numrit të studentëve të cilët do të përfitojnë nga fondet publike:

F fondi i financimit

f financimi për student

S numri i studentëve

Nga ana tjetër, vlera e financimit për student (f) do të jetë një funksion i:

- Kostos së programit të studimit.
- Fushës së studimit.
- Rajonit.
- Politikave për zhvillimin e arsimit të lartë.

Kështu do të merret parasysh fakti se programet e studimit në ciklin e parë (batchelor) do të kenë një kosto më të ulët për vit akademik se sa ato të ciklit të dytë (master). Në aspektin teknik, të gjitha profilet (degët) e studimit do të grupohen në 10 fusha kryesore, diferencimi brenda të njejtës fushë do të jetë i vogël dhe kjo do të thjeshtojë problemin e llogaritjes së financimit sipas profileve. Diferencimi i financimit do të bëhet duke marrë parasysh edhe rajonet e veçanta të vendit, duke ditur se rajone të ndryshme kanë kosto jetese të ndryshme. Kështu për shembull, mendohet se në Tiranë kosto e jetesës është rreth 30% më e lartë se në qytetet e tjera, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në financimin për student në këtë qytet. Gjithashtu politikat dhe prioritetet e qeverisë për zhvillimin e arsimit të lartë do të pasqyrohen në koeficientë preferencialë në vlerësimin e financimit për student; objektiva të tilla mund të jenë nxitja e studimeve të larta profesionale (diplomat 2-vjeçare post-secondary), zhvillimi i programeve ndër-disiplinore, nxitja e programeve të veçanta në universitetet rajonale etj.

Financimi i kostos së studimit

Aktualisht Ministria e Financave ka përcaktuar koston mesatare të studimit për një student. Për studentët që do të fitojnë nga fondet publike, dhe do të shkojnë në universitetet publike, kjo kosto do të financohet pjesërisht nga financimi publik


dhe pjesërisht nga tarifa që do të paguajnë studentët në këto universitete. Ndërsa për studentët të cilët fitojnë të drejtën e financimit, por do të ndjekin studimet në universitetet private, tarifa e studimit në këto universitete faktikisht do të zvogëlohet me pjesën e financimit publik (e cila normalisht i shkon universitetit privat jo fitimprurës).

Ndërsa studentët të cilët nuk plotësojnë kriteret për përfitimin e financimeve publike, do të duhet të financojnë individualisht të gjithë koston e studimit, pra si pjesën e munguar të financimit publik ashtu edhe tarifën e studimit në universitetet publike, apo të gjithë tarifën e studimit në universitetet private.

Skema e përgjithshme e financimit ka edhe elemente të tjera të rëndësishme, siç janë ato të financimit të veprimtarisë kerkimore – shkencore; financimin për zhvillimin akademik të stafit, manaxhimin e degeve dhe fakulteteve pa kërkesa, etj.

Skema e përgjithshme e financimit me “bazë studentin” paraqitet në figurën 1:

Figure 1: Modeli i financimit në edukimin e lartë –Shqipëri



Konkluzione

Zhvillimi i arsimit të lartë duke qënë një nga elementët themelor i cili karakterizon kapitalin human, përbën një nga faktorët kryesor të rritjes ekonomike. Studime të ndryshme, mbështetur në ndërtimin e modeleve empirike, kanë treguar se aftësimi i kapitalit human ka qënë një nga faktorët kryesor të rritjes ekonomike.

Zhvillimi i arsimit të lartë, rritja e numrit të studentëve, përbën një dukuri të përgjithshme sociale në mjaft vende. Kjo rritje mund të shpjegohet jo vetëm me rritjen e popullsisë, por edhe me kërkesat për një vend pune më të stabilizuar, për më shumë mobilitet në tregun e punës, për paga më të mira, etj.

Kostoja për financimin e arsimit të lartë është në një rritje gradule të vazhdueshme si rezultat i dy faktorëve kryesorë: rritjes së numrit të studentëve si dhe rritjes së shpenzimeve mesatare për një student. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se pesha relative e shpenzimeve të buxheteve publike, e destinuar për arsimin e lartë, ka mbetur pothuajse konstante. Këta faktorë kanë vënë në vështirësi qeveritë në mjaft vende për financimin publik të arsimit të lartë.

Nevojat në rritje për financimin e arsimit të lartë kërkojnë një harmonizim më të mirë të fondeve publike me ato private. Rritja e financimit të arsimit privat përbën një dukuri të përgjithshme. Kjo rritje shpjegohet si me rritjen e kërkesës për arsim ashtu edhe me vështirësitë ekonomike të financimit nëpërmjet fondeve publike.

Pjesmarrja e financimeve private në arsimin e lartë mund të jetë e ndryshme, por karakteristikë e përgjithshme është: financimi i drejtpërdrejtë privat si dhe kryerja e reformave për nxitjen e financimeve private, nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në konkurimin për fonde publike.

Sistemi i ri i financimit që propozohet në Shqipëri është ai që subvencionimi të bëhet direkt tek perfituesi i tij, tek studenti, i cili nëpërmjet këtij subvencioni mund të zgjedhë ofertën më të mirë midis të gjitha institucioneve të arsimit të lartë të cilat ofrohen në treg. Pra fondet publike të mos shkojnë drejtpërdrejt tek institucionet publike të arsimit të lartë por të “ndjekin” studentin.

Skema e reformës financiare në Shqipëri bazohet në dy shtylla kryesore: së pari, përcaktimi i saktë dhe ligjor i universiteteve të cilët do të mund të përfitojnë fondet publike; dhe së dyti, përcaktimi kriterëve për studentët të cilët do të mund të përfitojnë financim.

Nëpërmjet skemës së financimit mbi bazë studentin, synohet nga njëra anë të nxiten përpjekjet e institucioneve të arsimit të lartë për të rritur cilësinë e tyre, ndërsa nga ana tjetër, ajo do të nxisë fondet private të investojnë në arsim, duke konkuruar për përfitimin e fondeve publike dhe duke u ndodhur në të njëjtat kushte konkurrence sikurse institucionet publike të cilat ofrojnë të njëjtin shërbim.

Bibliografia

- Arellano Marin, J. P. 2001. Education reform in Chile CEPAL Review 73, 2001
- Gleaser, E. L. and Ponzetto, G. A. M. and Scleifer, A. 2006. *Why Does Democracy Need Education*, NBER Working Paper No. W12128; April 2006.
- Hatakenaka, S and Thompson, Q 2006. *Albanian Higher Education Report* Submitted from European Investment Bank, March 2006.
- Hough, J. R. 1993. *Educational cost-benefit analysis* - Education Research Paper No. 02, 1993
- Kaiser, F. 1999. *Market type mechanisms in higher education: a comparative analysis of their occurrence and discussions on the issue in five higher education systems*, CHEPS report / Higher Education Monitor Thematic report -1999.
- Mueller, U and Tiemeyer, R and Ziegele, F. 2004. *Finanzielle Effekte von Studiengebühren* Centrum für Hochschulentwicklung, Arbeitspapier Nr. 58, August 2004
- Newby, H.et.al 2009. *OECD Reviews of Tertiary Education - Japan*; 2009
- OECD Indicators - Education on Glance 2009*.
- Psacharopoulos, G. 2004. *Public versus Private University System* CESifo DICE Report 4/2004.
- Psacharopoulos, G. 1993. *Returns to Investment in Education* World Bank, Working Paper – Education and Employment, January 1993.
- Rankings of Top 100 Universities in the World 2010*. [online] Available on <http://www.university-list.net/index.htm>.
- Santiago, P. et al., 2009. *OECD Reviews of Tertiary Education - Spain*; 2009
- Santiago, P. et.al. 2008. *Tertiary Education for Knowledge Society* OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volume 1, 2008.
- Santiago, P. et al., 2008. *Tertiary Education for Knowledge Society* – OECD Thematic Review of Tertiary Education; Volume 1.
- Schmidtchen, D. 2005. *Mehr Markt im Hochschulbereich: Zur Effizienz und Gerechtigkeit von Studien gebuehre* German Working Papers in Law and Economics, Paper 4, Volume 2005.
- Tarifa, F.2010. *The American Triumph* – MAPO 22.07.2010.
- World Bank - World Economic Forum – 2010*. Cartagena, Colombia 6-8 April 2010

Obligacionet e shoqërive tregtare. Një formë e re e financimit të bizneseve në Shqipëri

Dr. Elvin MEKA

ABSTRAKT. *Kriza ekonomike dhe financiare globale e vitit 2008, ndonëse goditi tërthorazi ekonominë e Shqipërisë, biznesin dhe sistemin bankar shqiptar, ajo shpalosi qartë dukurinë e varësisë së financimit në kushte karteli të ekonomisë, dhe kryesisht të biznesit nga ana e bankave tregtare. Ky burim financimi i ekonomisë, i derivuar nga modeli tërësisht bankar i ekonomisë shqiptare tejçon dhe shkarkon drejt biznesit të gjithë problematikën që e shoqëron aktivitetin e sistemit bankar, sidomos në periudha tkurrjeje ekonomike apo krizash, në formën e shtrëngimit të kushteve të huadhënies dhe mungesës së financimit me kushte, kosto dhe afate konkurruese.*

Ky punim synon të hedhë dritë dhe të propozojë përdorimin e mundshëm të obligacioneve të shoqërive tregtare, si një alternativë e munguar, por eficiente e konkurrenente financimi për bizneset (e mesme e të mëdha) shqiptare, në raport me huamarrjen nga bankat. Në punim paraqiten dhe avantazhet e emetimit të obligacioneve kundrejt huamarrjes bankare, të cilat në kushtet e hapësirave ligjore të krijuara së fundi për emetimin e tyre, mund të shfrytëzohen me lehtësi nga shoqëritë tregtare shqiptare.

HYRJE

Pas sekuestrimit të Fabrikës së “Birra Norga”, Përmbartimi bllokoi (31.5.2011) edhe fabrikën e pijeve freskuese të kësaj kompanie, me pronarë Agron dhe Bukurie Haxhirajn. Prej dy ditësh, përfaqësuesit e kësaj zyre kanë mbërritur në ambientet e fabrikës, duke u komunikuar sekuestron për shkak të mosshlyerjeve të kësteve të fundit të kredisë prej 10 milionë Eurosh në “Raiffeisen Bank”...¹

Paragrafi i mësipërm, i shkëputur nga kronika e një gazete të përditshme në Shqipëri, evidenton një nga shumë rastet terminale të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit në Shqipëri. Ky fenomen (ekzekutimi i kolateralit) filloi të njohë rritje,

¹ “Bllokohen dy fabrika të “A&B Grup”, Gazeta PANORAMA, 1 qershor 2011

veçanërisht gjatë vitit 2009, kur filloi të vihej re rritja e vazhdueshme e huave me probleme, brenda sistemit bankar shqiptar (shih Tabela.2 më poshtë).

Ekzekutimi i kolateralit, si një vendim ekstrem i bankës, në kushtet e pamundësisë praktike nga ana e bankës për të recuperuar huatë me problem arkëtimi, shënon një zhvillim të një natyre disi të pazakontë, me të cilën është përballur biznesi shqiptar gjatë viteve të fundit. Kjo problematikë e mprehtë, e kombinuar me efektet goditëse të krizës globale financiare dhe shtrëngimin e kushteve të huadhënies nga sistemi bankar në tërësi, e vendosi biznesin shqiptar përballë një sfide të vërtetë, lidhur me sigurimin e qëndrueshëm të burimeve të financimit, veçanërisht për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Kreditimi i shoqërive tregtare gjatë 2009–2011: Varësia e plotë nga financimi prej sistemit bankar.

Viti 2009 ishte viti i parë i përballjes së ekonomisë, sistemit bankar dhe biznesit shqiptar me efektet goditëse të krizës globale dhe asaj financiare. Megjithatë goditjen indirekte që pësoi dhe ndërhyjes energjike të Bankës së Shqipërisë për mbajtjen e një niveli të kënaqshëm likuiditeti, si dhe ruajtjen faktike të shëndetit financiar të të gjithë sistemit bankar, nuk u arrit të shmangej përballja e biznesit me “një sjellje konservatore të bankave në kredidhënie dhe me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik.”²

Siç do të pohonte dhe Banka e Shqipërisë: “Bankat shtrënguan ndjeshëm kushtet e kredidhënies, fillimisht në përgjigje të një situatë të vështirë dhe të pasigurt likuiditeti, shkaktuar nga tërheqja e depozitave dhe paniku në tregjet ndërkombëtare financiare në fundin e vitit 2008. Në të njëjtën kohë, sjellja gjithnjë e më konservatore e bankave reflektoi edhe shqetësimin për rënien e vazhdueshme në cilësinë e portofolit të kredisë. Kushtet mbetën të shtrënguara edhe në muajt që pasuan, ndonëse me ritëm gjithnjë e më të ulët. Në gjysmën e dytë të vitit, standardet e shtrënguara të kredidhënies dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik kanë ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.”³

Nga deklarimi institucional i Bankës së Shqipërisë mund të identifikohen qartë dy elementë përbërës të goditjes së ekonomisë dhe biznesit nga kriza globale financiare, të cilët në mënyrë të shkëmbyeshme shërbejnë si shkak-pasojë për njëri-tjetrin:

1. rritja e huave me probleme dhe
2. shtrëngimi në bllok i kredidhënies nga ana e sistemit bankar.

1. Pavarësisht se në rritjen e kredive me probleme gjatë 2009 ka kontribuar dhe rritja me ritme të shpejta e kreditimit gjatë 5-6 viteve të fundit është e pashmangshme se, një kontribues i rëndësishëm është dhe kriza globale ekonomike e financiare.⁴

² BANKA E SHQIPËRISE, Raport Vjetor 2009, f.67

³ BANKA E SHQIPËRISE, Raport Vjetor 2009, f.67

⁴ Meka, E. dhe Filipi, Gj.: “Bursa e Kapitaleve - një sfidë ende për t’u ndërmarrë. Realiteti i Shqipërisë”, Revista ECONOMICUS 5, Pranverë 2010, f.84.

Shqipëria duke mos qenë e integruar me tregun global financiar, por me ekonominë reale botërore, nëpërmjet rrjetit të tregtisë ndërkombëtare, ishte lehtësisht e kuptueshme që, biznesi shqiptar do të përballej, fillimisht, tangencialisht me goditjet dhe presionet e krizës ekonomike e financiare globale. Por nëse goditja e parë kaloi tangencialisht, pasgoditjet do të ishin të pashmangshme. Këto pasgoditje do të materializoheshin në formën e uljes së konsumit të brendshëm, qoftë ky për mallra të qëndrueshëm e jo të qëndrueshëm, pakësimit të likuiditetit, rënies së qëndrueshme të dërgesave të emigrantëve dhe uljes së ritmit të investimeve në makineri e pajisje (shih Tabela 2 dhe Grafiku 1 më poshtë), që normalisht mbështesin zgjerimin e aktivitetit të biznesit në përgjithësi (kryesisht atij prodhues e të shërbimeve).


Tabela 1. Ecuria e huasë për biznes në Shqipëri Q4 2008 – Q2 2011

në milion LEK

PERIUD HA	Q4 2008	Q1 2009	Q2 2009	Q3 2009	Q4 2009	Q1 2010	Q2 2010	Q3 2010	Q4 2010	Q1 2011	Q2 2011
BIZNES E (total)	254.010	268.991	270.120	279.454	291.214	299.321	308.343	310.040	330.386	340.110	351.758
Overdraft	75.671	86.869	90.698	92.451	96.769	99.859	101.383	100.650	108.305	107.719	111.582
Kapital qarkullues	48.753	49.591	45.475	46.648	49.602	50.479	53.148	51.551	55.029	57.758	61.267
Blerje pajisjesh	68.346	71.701	64.857	72.297	77.057	78.238	79.501	81.528	87.992	86.077	88.199
Pasuri të paluajtshme	61.240	60.830	69.090	68.058	67.786	70.745	74.311	76.311	79.060	88.556	90.710

Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 1. Ecuria e huasë për biznes në Shqipëri Q4 2008 – Q2 2011



Burimi: Banka e Shqipërisë

Të gjithë këta faktorë (kryesisht makroekonomikë), mbi të cilët ka patur një ndikim të madh pikërisht kriza globale ekonomike e financiare, kanë sjellë pashmangshmërisht dhe uljen e aftësisë paguese të huamarrësve në banka, e përkthyer si rritja e huave me probleme.


Tabela 2. Ecuria mujore e huave me probleme në Shqipëri Q4 2008 – Q2 2011

Q4 2008	Q1 2009	Q2 2009	Q3 2009	Q4 2009	Q1 2010	Q2 2010	Q3 2010	Q4 2010	Q1 2011	Q2 2011
6.6	7.6	8.7	9.7	10.5	11.7	12.2	13.8	13.8	14.7	17

Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) – (sipas SNK-ve)

Kjo rritje e kredive me probleme përkeqësoi jo vetëm aftësinë paguese të shoqërive tregtare, duke rritur rrezikun e besueshmërisë së tyre, por inicioi dhe një mekanizëm automatik dhe të njëkohshëm të “mbrojtjes” së të gjithë sistemit bankar, atë të shtrëngimit të menjëhershëm të kushteve të huadhënies nga bankat tregtare, duke vepruar pjesërisht si një mekanizëm i njëkohshëm shkak-pasojë (*kredi me probleme ó shtrëngim të kushteve të huadhënies*). Ndërkohë që, kjo sjellje e bankave ishte e justifikuar në kushtet e shpërthimit të krizës globale ekonomike e financiare, përballë nevojës për financim në vijim të ekonomisë dhe bizneseve shqiptare, ajo mbeti gjithsesi në kuadrin e një sjellje tipike prej karteli financues, përballë biznesit vendas. Kjo pasi, nga vetë pesha që zenë aktivet e bankave dhe ndërmjetësimi bankar, brenda sistemit financiar (shih Figura 2 dhe Tabela 3 më poshtë), e vendos sistemin bankar në pozicionin e ofruesit thuajse unik të financimit për biznesin.

Figura 2



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në këto kushte, në mungesë të kanaleve apo alternativave të tjera konkurruese të financimit, të ndryshme nga huadhënia bankare, biznesi ka qenë i “detyruar” të pranojë kushtet e shtrënguara, të ofruara thuajse në unison nga të gjitha bankat e sistemit, si dhe ofertën e kufizuar për huadhënie nga bankat, gjatë gjithë periudhës 2009-2010.


Tabela 3. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në përqindje)⁵.

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Sistemi financiar	Vitet					
		2005	2006	2007	2008	2009	2010
Banka e Shqipërisë	Sistemi bankar	60.4	69.6	75.9	76.7	77.5	80.9
	Institucione jobanka	1.32	1.52	1.48	1.66	2.2	2.7
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.46	0.52	0.63	0.7	0.77	0.78
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.24	1.29	1.36	1.45	1.5	1.4
	Fondet e pensionit	-	-	-	-	0.01	0.01

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Këtë e tregon dhe rritja e pretendimeve ndaj jorezidentëve të korporatave paradepozituese (bankat tregtare) (shih më poshtë Grafiku 2), që për periudhën Q3 2009–Q1 2011 kanë transferuar jashtë vendit një shumë më të madhe sesa teprica e kredisë së re të ofruar si hua për biznesin. Në këto kushte, biznesi shqipar ka qenë, në mënyrë objektive ose jo, i ‘përrjashtuar’ nga mundësia e një oferte kreditimi me kosto më të ulët nga bankat, pavarësisht nga fakti i rritjes së qëndrueshme të depozitave këto vitet e fundit.

Grafiku 2



Për rrjedhojë, mungesa e instrumenteve të tjera alternative të kredisë për shoqëritë tregtare në Shqipëri nuk u ka dhënë mundësi këtyre të fundit “të tërhiqnin likuiditete, të origjinuara nga burime të ndryshme nga kanalet bankare (individë dhe investues të

⁵ BANKA E SHQIPERISE, “DSF – Raporti i Stabilitetit Financiar, gjashtëmuajori i dytë 2010”, mars 2011.

tjerë institucionale), për të zbutur në këtë mënyrë shtrëngimin e kushteve të kredisë bankare të vërejtur së fundi, si dhe amortizuar disi efektet goditëse të krizës globale financiare, si brenda sistemit financiar ashtu dhe brenda ekonomisë reale.”⁶

Në konkluzion, mund të pohohet se, jo vetëm gjatë periudhës që pasoi efektet goditëse të krizës financiare globale, por dhe në vijim, biznesi në Shqipëri vazhdon të përballojë kosto shtesë, financiare dhe jofinanciare, lidhur me financimin e tij afatmesëm e afatgjatë, kryesisht ai pasojë e mungesës së konkurrencës ndërsektoriale dhe mungesës së instrumenteve alternative konkurrencte me huadhënien bankare. Kjo nxjerr si imperativ për bizneset shqiptare gjetjen dhe konsiderimin e mundësive dhe rrugëve të reja për grumbullimin e fondeve për kryerjen e investimeve afatgjata të tyre, ku emetimi i obligacioneve do të ishte alternativa më praktike dhe më efiçiente.

Obligacionet e shoqërive tregtare, një formë e re e financimit të shoqërive tregtare në Shqipëri

Emetimi dhe përdorimi i obligacioneve të shoqërive tregtare njihet si një nga tre format e financimit të aktivitetit ekonomik të një shoqërie, krahas huasë bankare dhe emetimit të aksioneve. Nëse dy alternativat e fundit janë tashmë të mirënjohura dhe të përdorura nga biznesi shqiptar (megjithëse ende pritet emetimi i parë publik i aksioneve, por shoqëri aksionere ekzistojnë), ajo që mbetet ende e pashfrytëzuar është alternativa e emetimit të obligacioneve.

Deri në sot, mospërdorimi i këtij instrumenti alternativ dhe konkurrent i huasë bankare, mund të jetë justifikuar me stadin e zhvillimit ekonomik të vendit dhe kohës së nevojshme që është dashur për konsolidimin e instrumentit të huasë bankare, brenda mekanizimit të funksionimit të ekonomisë së tregut. Megjithatë, kjo mund të lidhet dhe me ekzistencën e disa elementëve të tjerë themelorë, si më poshtë:

-Stadi i zhvillimit institucional dhe organizativ të vetë biznesit të mesëm e të madh shqiptar. Konkretisht, bizneset e mëdha e mesme shqiptare janë në fazat e para të zhvillimit të tyre, në kontekstin e ekonomisë shqiptare, si një ekonomi e re kapitaliste. Në këto kushte, ajo mund të klasifikohen tipikisht si shoqëri në rritje, “të cilat përgjithësisht zgjedhin burime private dhe jo publike për financim, pasi është më e lehtë rinegociimi i një huaje me probleme me një (ose disa) bankierë, sesa të negociohet me qindra mbajtës obligacionesh, për të ristrukturuar kushtet dhe afatet e një obligacioni të emetuar publikisht.”⁷

-“Efekti ‘përjashtues’ që luajnë investimet e huaja të drejtpërdrejta”⁸, duke qenë pjesa dërrmuese e investimeve të huaja të rëndësishme në Shqipëri vijnë nga shoqëri të

⁶ Meka, E. dhe Filipi, Gj.: “Bursa e Kapitaleve - një sfidë ende për t’u ndërmarrë. Reliteti i Shqipërisë”, *ECONOMICUS* 5, pranverë 2010, f.85.

⁷ Barclay, M.J., Smith, Jr., C.W. and Watts, R.L. “The determinants of corporate leverage and dividend policy”, in D. H. Chew, Jr., ed., *The New Corporate Finance. Where Theory Meets Practice*, Boston, McGraw-Hill, 1999.

⁸ Iakova, Dora / Wagner, Nancy (2001): *Financial Sector Evolution in the Central European Economies: Challenges in Supporting Macroeconomic Stability Growth*, IMF Working Paper No. 01/141, Sept. 2001.

listuara në bursa apo me akses të lehtë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

-Mungesa e klasifikimit të mundshëm të këtyre titujve nga agjenci të specializuara dhe kostot që shoqërojnë jo vetëm procesin e emetimit të tyre, por dhe detyrimet për raportim të vazhdueshëm.

Pavarësisht nga sa më lart, gjykohet se momenti aktual është mëse i përshtatshëm për shoqëritë shqiptare, për të konsideruar emetimin e obligacioneve, duke patur parasysh një sërë konsideratash favorizuese që ekzistojnë për to, në këndvështrimin teorik, praktik dhe ligjor.

Konsiderata e avantazhe teorike e praktike

Në kuadër të diversifikimit të burimeve të financimit të shoqërive, përsa i përket strukturës së borxhit, “alternativa më e mirë është sigurimi i një strukture më pak të ndjeshme ndaj krizave.”⁹ Për më tepër, “si një nga burimet e financimit, obligacionet shërbejnë si një instrument kompensues për luhatjet në ofertën e përgjithshme për fonde nga jashtë biznesit. Megjithëse financimi me obligacione varet nga cikli ekonomik, luhatja e tyre nuk është aq e theksuar sesa ajo e huave bankare”¹⁰.

Gjithashtu, ekzistenca dhe përdorimi i instrumentit të obligacioneve të shoqërive aksionere (mundësisht dhe të tregtuara në bursën e letrave me vlerë), “kushtëzon një rritje më të moderuar të paaftësisë paguese të bizneseve të mëdha (huaja me probleme e të cilëve rrit në amplitudë më të madhe e më me shpejtësi fondin e provigjioneve dhe humbjet e bankave sesa kreditë me probleme të individëve), pasi në momentet me vështirësi likuiditeti ato mjaftohen kryesisht vetëm me pagesat e kuponave dhe jo me shlyerje principali (si në rastin e kësteve të huasë).”¹¹

Konsiderata ligjore

Tashmë në Shqipëri ekziston kuadri ligjor bazë, ligji nr.10 158, datë 15.10.2009 “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”, që u mundëson shoqërive tregtare shqiptare të emetojnë lloje të ndryshme obligacionesh.

Ndikimi i zhvillimit të tregut të obligacioneve të shoqërive tregtare

Fllimi i emetimit të obligacioneve nga ana e shoqërive tregtare do të mundësonte dhe fillimin e funksionimit të një tregu zyrtar sekondar për këto tituj, duke sjellë të tjera ndikime dhe avantazhe, për sistemin financiar, tregje të tjera, grupe të ndryshme interesi dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Disa nga avantazhet dhe aspektet pozitive që do të mundësonte ekzistenca e këtij tregu mund të përmenden:

⁹ Fernandez, R. B., Pernice, S., and Streb, J. M., “Determinants of the Development of Corporate Bond Markets in Argentina: One Size Does Not Fit All” (April 2007). Documento de Trabajo 348.

¹⁰ Davis, Ph., E., 2001, Multiple Avenues of Intermediation, Corporate Finance and Financial Stability, IMF Working Paper, No 115

¹¹ Meka, E. dhe Filipi, Gj.: “Bursa e Kapitaleve - një sfidë ende për t’u ndërmarrë. Reliteti i Shqipërisë”, ECONOMICUS 5, pranverë 2010, f.85.

1). Zvogëlimin relativ të madhësisë dhe peshës specifike që zë sektori bankar brenda sistemit financiar, duke reduktuar disa efekte negative që sjell dominimi thuajse absolut i këtij sektori, si:

-Përqendrimin e vendimarrjes për financimin e ekonomisë në pak duar dhe qendra pushteti financiar. Zhvillimi i tregut të obligacioneve e decentralizon këtë pushtet vendimarrje, duke e vendosur atë edhe në dorë të forcave të tregut, si dhe duke sjellë më shumë transparence dhe informacion,

-Krijimin e “kapitalizmit kronik”, në formën e bashkëpunimit të ngushtë, afatgjatë, jotransparent dhe në dëm të interesave të depozituesve, midis bankierëve dhe bizneseve, si dhe në formën e mbajtjes së tejzgjatur të huave të këqija në librat kontabël,¹²

-Administrimin jo gjithnjë eficient të fondeve të grumbulluara nga depozitat, ”duke çuar në huadhënie të tepërt, ulje të standardeve të huadhënies dhe kryerjen e investimeve që çojnë në kapacitete të tepërta biznesi, norma të ulta kthimi dhe rritje të huave me probleme.”¹³

-Rrezikun sistematik, pasi bankat janë institucione me përdorim të madh të levës financiare. Funksionimi i tregut të obligacioneve të shoqërive tenton balancimin e këtij tregu me atë bankar, duke zvogëluar natyrshëm këtë rrezik.

2). Ofimi i më shumë alternativave investuese për publikun. Obligacionet i japin mundësi publikut “të diversifikojë kursimet e tij në një gamë më të gjerë alternativash investimi”¹⁴, jo vetëm në këndvështrimin e menaxhimit të rrezikut, por dhe në drejtim të “orientimit të kursimeve të tij drejt investimeve prodhuese”¹⁵, duke rritur kështu mirëqenien sociale.

3). Sigurimi i alternativave të investimit për fondet e pensioneve dhe shoqëritë e sigurimeve, duke u mundësuar këtyre të fundit krijimin e produkteve dhe skemave afatgjata të kursimit dhe investimit.¹⁶

4). Investuesit në obligacione, paktikisht kanë treguar se e vlerësojnë më mirë rrezikun sesa bankëret. Përveç kësaj, “tregu i obligacioneve mund të shërbejë si një kanal transmetimi dhe për politikën monetare, duke ndihmuar me strukturën kohore të normave të interesit që ai përcakton.”¹⁷

¹² Hakansson, Nils H., “The Role of a Corporate Bond Market in an Economy--and in Avoiding Crises”, June 1999.

¹³ Hakansson, Nils H., “The Role of a Corporate Bond Market in an Economy--and in Avoiding Crises”, June 1999.

¹⁴ Herring, R., J., Chatusripitak, N., 2000, The Case of the Missing Market: The Bond Market and Why It Matters for Financial Development, The Wharton Financial Institutions Center, The Wharton School, University of Pennsylvania, Working Paper No.01-08,

¹⁵ Herring, R., J., Chatusripitak, N., 2000, The Case of the Missing Market: The Bond Market and Why It Matters for Financial Development, The Wharton Financial Institutions Center, The Wharton School, University of Pennsylvania, Working Paper No.01-08,

¹⁶ Haiss, P.R. and Marin, S., “Corporate Bonds as Financing Vehicle in Central - and Eastern Europe (2003)”. Proceedings of the 11th Annual Conference on Marketing and Business Strategies for Central and Eastern Europe, Vienna, 2003.

¹⁷ Thiel, M., 2001, Finance and economic growth – A review of theory and the available evidence, Economic Paper No. 158, European Commission, Directorate General for Economic and Financial Affairs .

5). Siç u përmend dhe më lart, tregu i obligacioneve mund të ndihmojë në ndërtimin e një strukture kohore të normave të interesit, e cila pasqyron qartë koston oportune të fondeve për çdo afat maturimi. Kjo strukturë normash interesi ndihmon në zhvillimin eficient të tregjeve të instrumenteve derivate, që i mundëojnë agjentëve ekonomikë manaxhimin e rreziqeve financiare.¹⁸

6). Zhvillimi i tregut të obligacioneve do të ishte një element përbërës kyç i tregut të kapitalit, prej të cilit do të mund të financoheshin një pjesë e mirë e projekteve të rëndësishme të infrastrukturës, duke mos lejuar eksportimin e kapitaleve në formë investimesh jashtë vendit.

Konkluzion

Tashmë shoqëritë shqiptare mund të konsiderojnë si një imperativ për vijueshmërinë e financimit të qëndrueshëm dhe eficient të aktivitetit të tyre, emetimin e obligacioneve të shoqërive. Kuadri ekzistues ligjor, por dhe shumë avantazhe praktike të emetimit të këtyre titujve, do t'i mundësonin atyre shmangien dhe minimizimin e përballjes me efektet dhe dukuritë jofavorizuese, që lidhen me rrezikun sistematik të sistemit bankar (veçanërisht në periudha tkurrjeje ekonomike dhe krizash) dhe fuqinë e vogël negociuese, përballë këtij të fundit, për sigurimin e financimeve afatmesme e afatgjata.

BIBLIOGRAFI

BANKA E SHQIPERISE, “Raport Vjetor 2009”, mars 2010.

BANKA E SHQIPERISE, “DSF – Raporti i Stabilitetit Financiar, gjashtëmujori i dytë 2010”, mars 2011.

BARCLAY, M.J., SMITH, Jr., C.W, and WATTS, R.L. “The determinants of corporate leverage and dividend policy”, in D. H. Chew, Jr., ed., *The New Corporate Finance. Where Theory Meets Practice*, Boston, McGraw-Hill, 1999.

DAVIS, Ph., E., 2001, “Multiple Avenues of Intermediation, Corporate Finance and Financial Stability”, IMF Working Paper, No 115.

FERNANDEZ, R. B., PERNICE, S., and STREB, J. M., “Determinants of the Development of Corporate Bond Markets in Argentina: One Size Does Not Fit All” (April 2007). Documento de Trabajo 348.

Gazeta PANORAMA, “Blllokohen dy fabrika të A&B Grup”, 1 qershor 2011.

HAISS, P.R. and MARIN, S., “Corporate Bonds as Financing Vehicle in Central- and Eastern Europe (2003)”. Proceedings of the 11th Annual Conference on Marketing and Business

¹⁸ Herring, R., J., Chatusripitak, N., 2000, The Case of the Missing Market: The Bond Market and Why It Matters for Financial Development, The Wharton Financial Institutions Center, The Wharton School, University of Pennsylvania, Working Paper No.01-08.

- Strategies for Central and Eastern Europe, Vienna, 2003.
- HAKANSSON, Nils H., “*The Role of a Corporate Bond Market in an Economy--and in Avoiding Crises*”, June 1999.
- HERRING, R.,J., CHATUSRIPITAK, N., “*The Case of the Missing Market: The Bond Market and Why It Matters for Financial Development*”, The Wharton Financial Institutions Center, The Wharton School, University of Pennsylvania, Working Paper No.01-08, 2000.
- IAKOVA, D, WAGNER, N., “*Financial Sector Evolution in the Central European Economies: Challenges in Supporting Macroeconomic Stability Growth*”, IMF Working Paper No. 01/141, Sept. 2001.
- MEKA, E. dhe FILIPI, Gj., “*Bursa e Kapitaleve – një sfidë ende për t’u ndërmarrë. Realiteti i Shqipërisë*”, Revista ECONOMICUS 5, Pranverë 2010.
- THIEL, M., “*Finance and economic growth – A review of theory and the available evidence*”, Economic Paper No. 158, European Commission, Directorate General for Economic and Financial Affairs, 2001.

Forcimi dhe edukimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

Dr. Kreshnik Bello, UET

M.A. Edmond Bello, UET

Abstrakt. *Një ndër çështjet më të diskutuara sot në fushën e pronësisë intelektuale është forcimi i të drejtave të pronësisë intelektuale si edhe edukimi për mos shkeljen e këtyre të drejtave. Sot zhvillimet teknologjike kanë arritur maja të larta dhe dhunimi apo shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale është një prioritet për shumë organizma ndërkombëtar dhe për shumë vende që kanë sisteme të përparuara të pronësisë intelektuale.*

Sot në epokën dixhitale, kur teknologjia kompiuterike po i afrohet gjithnjë e më shumë imagjinatës më të largët, të drejtat e pronësisë intelektuale janë bërë gjithnjë e më shumë të çënueshme. Në këtë këndvështrim është e rëndësishme që këto të drejta të forcohen në mënyrë që të kemi nxitje të mendjes dhe krijimtarisë humane, dhe që këto punë të mund të shpërblehen. Këtu një rol shumë të rëndësishëm luan edukimi i mbarë shoqërisë, në mënyrë që ajo (shoqëria) të përfitojë, dhe të eci përpara. Pikërisht synimi i këtij punimi është të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe edukimin e pronësisë intelektuale.

Rregullimi ligjor dhe forcimi i pronësisë intelektuale

Vitet e fundit po ndodh një zgjerim në ligjet e pronësisë intelektuale. Kjo mund të shihet në zgjerimin e ligjeve kundrejt llojeve të reja të çështjeve si për shembull bazat e të dhënave; në rritjen e kushteve të mbrojtjes; në heqjen e kufizimeve mbi të drejtat ekskluzive; në zgjerim të përkufizimit të “autorit”, për të përfshirë korporatat si krijues legjitim dhe zotërues të punëve etj. Natyra dhe qëllimi i asaj çka përbën pronësinë intelektuale gjithashtu është zgjeruar. Në kontekstin e markave, ky zgjerim është nxitur prej përpjekjeve ndërkombëtare për të harmonizuar përkufizimin e “markës”, sikurse ilustrohet edhe prej TRIPS (Agreement on Trade Related Aspects of Intellectual Property Rights).

Duke vazhduar me TRIPS-in, çdo shenjë e cila është “*e aftë për të siguruar dallueshmëri*” për produktet ose shërbimet e një biznesi, prej produkteve ose shërbimeve të një biznesi tjetër, është e aftë për të formuar një markë. Nën këtë përcaktim, marka të tilla si slogani i mikroshtetit “*Ku doni të shkoni sot?*” përgjithësisht konsiderohen si të regjistrueshme. Ndërsa funksioni thelbësor i një marke është që të identifikojë ekskluzivisht origjinën komerciale të produkteve ose shërbimeve, çdo shenjë e cila përmbush këtë qëllim, mund të regjistrohet si një markë.

Në kontekstin e patentave, dhënia e patentave në disa juridiksione mbi disa forma algoritme software-sh, dhe modele biznesesh, ka çuar në polemika të vazhdueshme përsa i përket qëllimit të duhur, në çështjen e patentueshmërisë.

Disa konsiderojnë që zgjerimi i ligjeve të pronësisë intelektuale prish ekuilibrin midis inkurajimit dhe thjeshtësimit të krijimtarisë dhe novacionit, dhe përhapjes së ideve dhe krijimeve të reja në fushën publike për të mirat e përbashkëta. Ata konsiderojnë se, ndërsa shumë ide të reja kanë derivuar prej ideve të tjera, ligjet e pronësisë intelektuale tentojnë të reduktojnë nivelin e përgjithshëm të avancimit kreativ dhe shkencor në shoqëri. Ata debatojnë që novacioni dhe konkurrenca në fakt është ndrydhur prej zgjerimit të ligjeve të pronësisë intelektuale, ndërsa zotëruesit e të drejtave të pronësisë intelektuale, që bëjnë padi gjyqësore, kërkojnë në mënyrë agresive të mbrojnë portofolet e tyre.

Era elektronike ka parë një rritje në përpjekjet për të përdorur mjete të menaxhimit të të drejtave dixhitale, të bazuara mbi software, për të përkufizuar kopjimin dhe përdorimin e punëve me bazë dixhitale. Kjo mund të ketë efektin e limitimit të përdorimit të ndershmë të parashikimeve të ligjit të së drejtës së autorit. Kjo do të lejojë në thelb, krijimin e një libri, i cili do të shpërbëhet pas një leximi. Ndërsa individët kanë dalë të aftë në shmangien e këtyre masave në të shkuarën, shumë zotërues të së drejtës së autorit, kanë lobuar në mënyrë të suksesshme për ligje të tilla si Digital Millennium Copyright Act, i cili përdor kodin penal, për të forcuar sistemet e menaxhimit të të drejtave dixhitale.

Parashikime të ngjashme për të ndaluar shmangien e mbrojtjeve të së drejtës së autorit kanë ekzistuar për një kohë edhe në Bashkimin Europian, dhe janë zgjeruar më tej, si për shembull, artikulli 6 dhe 7 i Direktivës Copyright (E drejta e autorit). Në të njëjtën kohë rritja e Internetit, dhe në mënyrë të veçantë e shpërndarjes së driverave (motorëve) të kërimit, përfaqësojnë një sfidë për politikën e të drejtave ekskluzive. Rregullimi ligjor dhe forcimi i të drejtave të pronësisë intelektuale lidhet ngushtë me: *direktivën mbi forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, edukimin e pronësisë intelektuale dhe çështjet e piraterisë.*

A. Direktiva mbi forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale

Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të Europës e 29 prillit 2004 për forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, është një direktivë e BE në fushën e ligjit të pronësisë intelektuale, e bërë nën parashikimet e tregut të brendshëm të traktatit të Romës. Direktiva mbulon aspektet korrigjuese që ekzistojnë në çështjet civile, por jo sulmet kriminale. Nën artikullin 3 (1), shtetet anëtare mund

të çensurohen nën gjykatën Europiane të Drejtësisë, nëse procedurat e tyre civile për dhunimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, janë *“të kushtueshme ose përmbajnë limite kohore të pa arsyeshme, të pa garantuara”*. Gjithashtu direktiva harmonizon rregullat mbi qëndrimin, evidentimin, kapjen, vendimet e gjykimit, dëmtimet, kostot dhe publikimet gjyqësore.

B. Edukimi i pronësisë intelektuale

Edukimi i pronësisë intelektuale është mësimi dhe shpjegimi i argumenteve, që përfshin ligjet e pronësisë intelektuale, veçanërisht të drejtën e autorit dhe dhunimet që kanë të bëjnë me të. Besimtarët debatojnë, që një edukim i tillë, duhet të zbatohet për shkak të rritjes së shkëlqesës së drejtës së autorit, prej studentëve dhe popullatës në përgjithësi. Kritikët debatojnë, që një edukim i tillë, është i barazvlefshëm me “indoktrinimin të detyruar”.

Shumë avokat të ligjeve ekzistuese të së drejtës së autorit, kanë dalë në konkluzionin e kundërt: teknologjia dixhitale do të thotë, që të gjithë qytetarët duhet të mësojnë të kuptojnë dhe respektojnë të drejtën e autorit, ashtu sikurse ai është. Në mënyrë të veçantë, ndërsa mund të jetë në interesin individual për të dhunuar të drejtën e autorit, dhe për të siguruar diçka pa paguar për të, mund të debatohet që shoqëria si një e tërë do të humbasi, sepse më pak punë me të drejtë autori do të krijohen. Përderisa ligjet e së drejtës së autorit, bien ndesh me interesat individuale të përdoruesve, do të duhet një masë e madhe edukimi për të parandaluar dhunimin e këtyre ligjeve.

Në vendin tonë edukimi për pronësinë intelektuale jepet formalisht në institucione të mësimdhënies, në disa universitete dhe fakultete. Nderkohë, në mënyrë të veçantë edukimi në lidhje me pronësinë intelektuale, duhet të zhvillohet në mënyra të ndryshme në shumë universitete dhe fakultete të vendit tonë, pasi aty gjenerohet një masë e madhe e pronësisë intelektuale, por jo vetëm kaq, por aty ndodhet një pjesë e madhe e rinisë e cila duhet të edukohet për të qenë kontribuese në krijimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe jo në shkeljen e saj.

C. Pirateria

Pirateria e produkteve është një prej aspekteve negative që, përballen marketerët me emra markash globale të mirënjohura. Çdo aspekt i produktit është i dobët kundrejt piraterisë, duke përfshirë emrin e markës, logon, dizenjën, dhe paketimin. Impakti mbi fitimet e viktimizuara të kompanisë është i dyfishtë. Dukshëm ekzistojnë humbje që rrjedhin prej të ardhurave të shitjeve të humbura. Humbjet monetare për shkak të piraterisë janë marramendëse. Kampion në këtë fushe është Kina ku çdo vit shiten të paktën rreth 16 miliard dollar produkteve jo origjinale. Nje prirje e re shqetësuese është rritja e eksportit të produkteve të rreme që bëhen në Kinë.

Nëpër botë vlera e shitjeve me pakicë të muzikës të piratuar e vlerësuar, është rreth 2.5 miliard dollar në 1999, ose 6% e shitjeve ligjore. Falsifikatorët gjithashtu ushtrojnë presion mbi fitimet e shumëkombësive (MNC) në mënyrë indirekte. Në shumë tregje MNC-të shpesh janë detyruar të ulin çmimet e tyre me

qëllim që të mbrojnë pjesën e tyre të tregut kundrejt konkurrenteve fallsifikatorë. Madje më shumë shqetësuese se humbjet monetare janë dëmtimet që produktet e rreme mund t'i shkaktojnë emrit të markës. Produktet e rreme janë me cilësi të dobët dhe si rezultat pirateria shkakton problem për sa i përket reputacionit të markës të ndërtuar gjatë viteve. Risqe të tilla janë veçanërisht të mëdha në tregjet në zhvillim ku konsumatorët vetëm kohët e fundit janë ekspozuar me markën origjinale dhe, fallsifikatorët shpesh tejkalojnë vetë produktet reale me një koeficient domethënës.

Organizata Botërore e Shëndetit vlerëson se nga 5 në 7% e medikamenteve janë kopjime me pak përbërës aktivë, shumë papastërtira, ose etiketa që mbulojnë datën e skadencës. Disa faktor shtrihen prapa rritjes së piraterisë në vende si Kina. Përhapja e teknologjisë së avancuar është një katalizator. Kanalet globale të furnizimit gjithashtu luajnë një rol kyç. Tregtarët shpesh përdorin web-in dhe distributorë të pa autorizuar për të shitur produktet e rreme nëpër botë. Pra si përfundim fitimet që mund të sigurohen janë shumë të mëdha.

Aplikimi i konceptit të mbrojtjes të së drejtës së pronësisë intelektuale

Një nga çështjet kyçe për të cilat kanë mosmarrëveshje biznesi dhe qeveria, apo qeveritë mes tyre është e drejta e pronësisë intelektuale. Të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI) shoqërojnë si pasuritë industriale, të tilla si shpikjet dhe shenjat dalluese të kompanive dhe produkteve, ashtu edhe pasuritë artistike, të tilla si librat, regjistrimet, filmat, dhe programet e kompjuterave. Kompanitë me asete të paprekëshme dëshirojnë mbrojtje të detyrueshme përmes patentave, markave tregtare, dhe të drejtave të autorit, kështu që ato mund të fitojnë të gjitha shitjet dhe përfitimet si kthim të investimeve që ato bëjnë për të krijuar këto pasuri.

Ato argumentojnë se përfitimi social i mbrojtjes është pozitiv, pasi në të kundërtën, do të ishte më pak stimuluese të zhvillojnë pasuri të reja industriale dhe artistike. Megjithatë, kritikët argumentojnë se mbrojtja krijon një kosto sociale me çmime të larta monopolistike. Mes ligjeve dhe detyrimeve vendet ndryshojnë krejtësisht në mbrojtjen e DPI-ve. Edhe kur dy vende kanë nivele të ngjashme mbrojtjeje, mënyrat e tyre të mbrojtjeve ndryshojnë. Dy çështje kyçe të aplikimit të konceptit të mbrojtjes së të drejtës së pronësisë intelektuale janë: *mbrojtja e të drejtës së autorit dhe mbrojtja e pronave industriale.*

A. Mbrojtja e të drejtës së autorit

Për shkelje të së drejtës së autorit, nëse nuk arrihet një marrëveshje midis paleve, personat e interesuar mund t'i drejtohen gjykatës që ta zgjidhë konfliktin në një gjykim civil. Për të gjykuar nëse ka shkelje të së drejtës së autorit duhen provuar këta elemente:

Duhet provuar që vepra është nga ato, të cilat mbrohen nga e drejta e autorit. Por jo të gjitha veprat mbrohen me të drejtë autori. Ketu duhet parë se sa origjinale është vepra,

nëse ajo ka aq krijueshmëri, sa që të mbrohet me të drejtë autori. Mbetet në vlerësimin e gjykatës për të përcaktuar se ç'nivel krijueshmërie duhet për një vepër që të quhet vepër origjinale.

Duhet identifikuar e drejta që është shkelur dhe duhet vërtetuar që paditësi është mbajtësi i asaj të drejte. Kur paditësi është vetë autori, atëherë kjo është e thjeshtë, sepse autori prezumohet mbajtësi i parë i të gjitha të drejtave ekonomike të autorit. Në qoftë se paditësi nuk është autori, por personi, të cilit i kanë kaluar të drejtat, gjykata duhet të kërkojë licensën apo kontratën e tjetërsimit dhe të shikojë nëse bëhet fjalë për shkeljen pikërisht të asaj të drejte, që ka kaluar me licensë, apo kontratë tjetërsimi (shitje, dhurim, etj.). Për t'u legjitimuar në ngritjen e padisë, paditësi duhet të jetë pronari i së drejtës që pretendohet se është shkelur, ose mbajtësi i licensës ekskluzive për atë të drejtë. Ndërsa mbajtësi i një license joekskluzive, mund të vijë në gjykatë si person i tretë.

Duhet provuar që përdorimi i të paditurit është i paligjshëm. Përdorim të paligjshëm përbën kryerja e çdo veprimi, që bën pjesë në të drejtat ekonomike të autorit, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tij. Kështu, riprodhimi i veprës, përkthimi i saj, përgatitja e veprave të prejardhura, importimi, deklarimi i veprës para publikut, komunikimi i veprës për publikun, përbëjnë shkelje të së drejtës së autorit, në qoftë se kryhen pa pëlqimin e tij.

Një mënyrë tjetër mbrojtjeje mund të ishte edhe pretendimi se afatet e mbrojtjes së veprës kanë skaduar dhe tashmë vepra është në zoterim të publikut. Ose, në rast se bëhet fjalë për shkelje të së drejtës së riprodhimit, i padituri mund të mbrohet duke thënë se ai ka kopjuar vetëm ato elemente të veprës, që nuk mbrohen me të drejtë autori, si p.sh. idete, faktet, të dhënat, procedurat, proceset, sistemet, shprehjet popullore, mënyrat e veprimit, konceptet, parimet, ose zbulimet, dhe jo mënyrën e shprehjes së tyre që mund të mbarte krijueshmëri dhe, për rrjedhojë të jetë e mbrojtshme me të drejtë autori.

Në përfundim të gjykimit gjykata vendos një dëmshpërblim për autorin, në qoftë se gjen shkelje të të drejtave të tij. Dëmshpërblimi përfshin humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar. Në qoftë se shkelësi, përveç dëmit që i ka shkaktuar tjetrit, ka pasur edhe një fitim të dukshëm, me kërkesën e palës së dëmtuar, gjykata mund ta llogarisë këtë përfitim në shpërblimin e dëmit. Ky duhet parë në kombinim me fitimin e munguar, sepse shpesh mund të jetë e njëjta gjë.

B. Mbrojtja e pronave industriale

Mbrojtja e të drejtave të pronës industriale realizohet nëpërmjet konsolidimit të mjedisit ligjor vendas dhe marrveshjeve dy dhe shumëpaleshe dhe rolit të institucioneve ndërkombëtare. Thelbi i këtij bashkëpunimi është gjetja e rrugëve dhe mënyrave ligjore për të bërë të mundur uljen në vazhdimësi të dhunimit të të drejtave mbi pronat industriale. Në kushtet e ekonomisë globale kjo domosdoshmeri rritet dhe dikton nga pikpamja ekonomike, bashkëpunim në një kuadër global të vendeve nëpërmjet marrveshjeve dhe organizmave botërore.

Në masën që vendet përfshihen në rrjetin e sistemit ekonomik botëror, ato bëhen më të interesuara për mbrojtjen e të drejtave të pronave industriale, pra edhe aderimin në marrveshje globale të cilat po bëhen gjithnjë e më imponuese për antarët.

Një ndër çështjet kryesore me interes në rritje, është përllogaritja e humbjeve që pësojnë bizneset dhe shteti nga dhunimi i të drejtave për pronën industriale. Në Shqipëri imitimi i produkteve përbën një kërcënim me rëndësi në zhvillimin e bizneseve vendase dhe një nga aspektet me domethenë për nxitjen apo frenimin e investimeve të huaja në vendin tonë.

Zhvillimi ekonomik botëror po karakterizohet nga integrimi rajonal dhe global, tregtia dhe investimet ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më të lira nëpërmjet marrveshjeve dy e shumë palëshe. Kjo bën të mundur transferimin e shpejtë dhe pa pengesa të teknologjisë, kapitalit, punës, njohurive etj, si një proces që rrit shanset për një prosperim të përgjithshëm shoqëror. Nga ana tjetër kjo “liri” e shoqëruar me sofistikimin e produkteve dhe të teknologjisë së komunikimit, po bën gjithnjë e më të vështirë mbrojtjen e pronave intelektuale. Aq i rëndësishëm dhe i vështirë është bërë ky kontroll sa që është objekt i veçantë dhe nga më të rëndësishmit të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Shqipëria, ka ndërmarr në vazhdimësi hapa të rëndësishëm, duke synuar krijimin e kushteve optimale për integrim Evropian dhe më gjërë. Në këto zhvillime mbrojtja e PI-ve është ndër drejtimit parësor për nxitjen e biznesit vendas dhe investitorëve të huaj, për t’u bërë palë në krijimin e një klime gjithnjë e më pozitive në përshtatje me zhvillimet globale botërore.

Pronesia intelektuale në universitetet e vendit tonë

Duke qenë se në shumë universitete dhe fakultete të vendit tonë, gjenerohet një masë e madhe e pronësisë intelektuale, dhe duke pasur parasysh që aty ndodhet një pjesë e madhe e rinisë e cila duhet të edukohet për të qenë kontribuese në krijimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, me qëllim studimin e faktit se si behet edukimi në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale në këto vatra të dijes, në disa prej tyre u shpërnda një pyetësor drejtuar si stafit akademik ashtu edhe studentëve. Pas shpërndarjes së pyetësoreve nëpër fakultete të ndryshme dhe mbledhjes së të dhënave, me to u ndërtuan baza të dhënash të cilat shërbyen për realizimin e analizave. Më poshtë po paraqesim disa prej gjetjeve të pyetësorit.

A. Prezantimi i gjetjeve prej pedagogëve

Pyetjes “A zotëron pronësi intelektuale institucioni juaj”, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur pozitivisht, dhe 100% e këtyre është përgjigjur se institucionet akademike zotërojnë “të drejta autori”. Kjo përgjigje mbështet faktin që në universitete krijohen shumë punime që duhet të mbrohen me të drejta autori.

Për pyetjen *“A ekziston në institucionin tuaj ndonjë strategji mbi pronësinë Intelektuale?”*, përgjigjet qëndrojnë: po 9%, jo 59%, nuk e di 32%. Pra shumë pak të intervistuar mendojnë se institucioni i arsimit të lartë ka një strategji të pronësisë intelektuale.

Pyetjes *“A ka institucioni juaj politika të shkruara në lidhje me zotërimin e pronësisë intelektuale”*, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur negativisht, dhe pjesa tjetër nuk kanë pasur informacion. Kjo mbështet faktin që në institucionet akademike, nuk ekziston një politikë për zotërimin e pronësisë intelektuale.

Pyetjes *“A vendos në dispozicion institucioni juaj dokumentacion, për të vlerësuar pronësinë Intelektuale në mënyrë të veçantë për studentët?”*, të intervistuarit i janë përgjigjur: po 20%, jo 35%, nuk e di 45%, ç’ka tregon se vetëm pak të intervistuar mendojnë se institucioni vendos në dispozicion dokumentacion për të vlerësuar pronësinë intelektuale

Pyetjes *“Ju lutemi shprehni opinionin tuaj personal në lidhje me pohimin e mëposhtëm: Institucioni i Arsimit të Lartë për të cilin punoj, e konsideron të rëndësishme për krijuesit e PI-ve, komercializimin e ideve të tyre”*, të intervistuarit janë i përgjigjur: totalisht dakort 22%, dakort 35.5%, i pavendosur 22.5%, nuk jam dakort 10.5%, nuk jam fare dakort 9.5%, ç’ka tregon që shumica e pranon faktin që institucioni e konsideron të rëndësishme për krijuesit e pronësisë intelektuale, komercializimin e ideve të tyre.

Pyetjes *“A marrin njohuri studentët tuaj mbi pronësinë intelektuale në kurse të ndryshme”*, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur pozitivisht. Kjo tregon se studentëve u jepet informacion mbi pronësinë intelektuale.

Pyetjes *“Shprehni opinionin, a e vlerëson pronësinë intelektuale institucioni i arsimit të lartë, për të cilin punoni”*, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur se është dakort, 12.3 % nuk janë dakort, 15.3 % janë totalisht dakort dhe pjesa tjetër të pavendosur. Opinionet negative tregojnë që në institucionet akademike, pronësia intelektuale jo gjithmone merr vlerën e duhur.

Pyetjes *“A ka menduar ndonjëherë institucioni i arsimit të lartë, për të cilin punoni, të komercializojë pronësinë intelektuale që zotëron”*, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur pozitivisht në masë 50 %, 45.9 % jo dhe 4.1 % nuk e di. Këto shifra mbështesin faktin që në institucionet tona akademike ka paqartësi mbi faktin nëse ato duhet të përfitojnë prej pronësive intelektuale që ato zotërojnë, gjë që mbështetet edhe nga fakti që këto institucione nuk kanë politika të mirefillta mbi pronësinë e tyre intelektuale.

B. Prezantimi i gjetjeve prej studentëve

Pyetjes *“A keni kursë të posaçme për PI (Pronësi Intelektuale)?”* të intervistuarit i janë përgjigjur: po 25.5%, jo 74.5%, ç’ka tregon që në disa institucione të arsimit të lartë ka kurse të posaçme për pronësinë intelektuale.

Pyetjes “*A ka institucioni juaj politika në lidhje me zotërimin e pronësisë intelektuale prej studentëve*”, pjesa më e madhe e të intervistuarve i është përgjigjur negativisht, 40 % nuk e di, dhe vetëm 12.3 % pozitivisht. Pra institucionet nuk kanë politika formale për zotërimin e pronësisë intelektuale nga ana e studentëve, rrjedhojë kjo e mungesës së përgjithshme të politikave mbrojtëse të PI.

Pyetjes “*A egzistojnë burime financiare për të mbështetur studentët që të komercializojnë pronësinë e tyre Intelektuale?*”, të intervistuarit i janë përgjigjur: po 6.7%, jo 40%, nuk e di 53.3%. Kjo tregon që ka mungesë informacioni në këtë pikë, gjë që mbështet faktin që institucionet nuk kanë burime financiare për të mbështetur studentët që të komercializojnë pronësinë e tyre intelektuale.

Pyetjes “*A keni pasur kontakt me website të ndryshme (mbi PI) të organizatave të tilla si WIPO etj?*”, të intervistuarit i janë përgjigjur: po 15%, jo 85%, ç’ka tregon që vetëm pak studentë e njohin ekzistencën dhe website-n e WIPO apo website të tjera që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale. studentët që i njohin ato i kanë përdorur për qëllime si: studim tregu, mbledhje informacioni, etj.

Pyetjes “*A e dini çfarë është pirateria?*”, të intervistuarit i janë përgjigjur: po 100%, ç’ka tregon që të gjithë e dinë ç’farë është pirateria.

Pyetjes “*A keni kryer ndonjëhere veprime piraterie*”, studentët i janë përgjigjur pozitivisht në masën 47.67 %, gjë e cila tregon se pavarësisht se ata e dinë se pirateria është veprim i dëmshëm, përsëri ata kryejnë veprime të tilla.

Pyetjes “*A ka pasur raste të përdorimit të pa autorizuar (vjedhje) prej pedagogëve të ndryshëm të pronësisë intelektuale të studentëve*”, studentët i janë përgjigjur pozitivisht në masën 27 %, 13 % nuk e di dhe 60 % jo, gjë e cila tregon që pavarësisht se pedagogët e dinë që ky nuk është një veprim korrekt dhe është i dënueshëm, ka patur raste të përfitimit prej pronësisë intelektuale të studentëve nga pedagogët.

Konkluzione

Muzika, filmat, librat, arti shpikjet e ndryshme, si edhe format e tjera të krijimtarisë dhe të shprehjes janë tregues të progresit social dhe cilësisë së jetës. Si pronësi private të krijuesve të tyre origjinal, ato janë vlerësuar dhe mbrojtur nga shoqëria për rolin e tyre ekonomik, politik dhe kulturor – si shprehje e trashëgimisë dhe përpjekjeve njerëzore.

Ligjet egzistuese të vendit tonë për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, janë në një shkallë “mesatarisht” funksionale, që të mundësojnë mbrojtje të plotë të të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe ato kanë nevojë të përmiresohen. Kuadri ligjor,

përsa i përket fushes së pronësisë intelektuale, nuk është i plotë dhe ai egzistuesi duhet të plotësohet dhe përmirësohet me tej.

Në vendin tonë nuk ka informacion të mjaftueshëm (botime\website\forma të tjera) për çështje të ndryshme, që prekin mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale; me gjithëse në universitete krijohen shumë punime, që duhet të mbrohen nga të drejtat e pronësisë intelektuale dhe në shumicën e rasteve me të drejtë autori, Në institucionet akademike, nuk ekziston ndonjë politikë dhe nuk ka strategji për zotërimin e pronësisë intelektuale.

Në institucionet e arsimit të lartë, pronësia intelektuale jo gjithmonë merr vlerën e duhur. Studentëve u jepet informacion mbi pronësinë intelektuale, por këto institucione nuk vendosin në dispozicion dokumentacion për të vlerësuar pronësinë intelektuale. Institucionet e arsimit të lartë e konsiderojnë të rëndësishme për krijuesit e pronësisë intelektuale, komercializimin e ideve të tyre por ato nuk janë përfshirë në procese të tilla.

Në vendin tonë ka ndonje institucion të arsimit të lartë, ku jepen kurse të posaçme për pronësinë intelektuale por si subjekt akademik trajtohet në shumë lëndë të tjera jo të posaçme. Por institucionet e arsimit të lartë, nuk kanë ende politika formale për zotërimin e pronësisë intelektuale nga ana e studentëve, nuk mbështesin studentët financiarisht dhe me staf, për ti ndihmuar për të mbrojtur dhe komercializuar pronësinë e tyre intelektuale.

Të gjithë studentët e dinë ç'farë është pirateria. E pranojnë që pirateria është veprim i dëmshëm, por pavarësisht përsëri ata kryejnë veprime të tilla. Një përfundim jo i mirë është fakti që ka përpjekje të pedagogëve për të përfituar në mënyrë të paligjshme prej pronësisë intelektuale të studentëve.

Literatura

Audretsch, D.B., "*The Economics of Science and Technology*", Journal of Technology Transfer, 27, 2002.

Basberg, B., "*Patents and the measurement of technological change: A survey of the literature*", Research Policy, North Holland, 1987.

Claas Junghans, Adam Levy, "*Intellectual property management*", Germany, Wiley – VCH, 2006.

David Rubenstein, "*Patent Profits: How Lawyers and Engineers Milk the Intellectual*

<http://www.wikipedia.org>, The Free Encyclopedia.

<http://www.wipo.org>, "World Intellectual Property Organization, Botime në Internet.

Joanna R. Jeremiah, "*Merchandising intellectual property rights*", England, John Wiley & Sons Ltd, 1997.

John J. Wild, Kenneth L. Wild, Jerry C.Y. Han, "*International Business*", USA, Prentice Hall, 2004.

Masaaki Kotabe, Kristiaan Helsen, "*Global Marketing Management*", USA, John Wiley & Sons, Inc, 2003.

- Reilly, Robert F., Bruce L. Richman, "*Identification and Valuation of Individual Intangible Assets*", New York, John Wiley & Sons, 1996
- Tullett, A., "Enterprising Intellectual Property", Ministry of Economic Development, Wellington, 2003.
- Schmookler, J., "*Innovation in business*", Readings in management, New York, 1975.
- Sharpe, William F., "*Investments*", Englewood Cliffs, NJ, Prentice Hall, 1981.
- WIPO, "*WIPO Intellectual Property Handbook*", World Intellectual Property Organization, Geneva, 2001.

Decentralizimi i pushtetit, progresi dhe zgjerimi i autonomisë vendore në Shqipëri

— Dr. Migena Leskoviku, UET —

Hyrje

Në shoqëritë demokratike qeverisja vendore mbetet një nga shtyllat kryesore të funksionimit të sistemit politik e social të vendit. Shqipëria pas përmbyesjes së sundimit të sistemit komunist gjysëmshekullor, në fillimin e viteve 90-të hyri në rrugën pluralizmit politik duke hedhur bazat e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Për herë të parë në korrik të vitit 1992 qytetarët zgjodhën me votë të lirë dhe të drejtëpërdrejtë kryetarët e bashkive dhe komunave dhe përfaqësuesit e tyre në këshillat përkatës. Funksionimi i qeverisjes vendore pas zgjedhjeve të lira dhe demokratike u shoqërua në tërësi me probleme, sepse pushteti vendor nuk zotëronte kompetencat dhe burime të mjaftueshme për të kryer funksionet e veta. Shpesh njësitë e qeverisjes vendore ishin në pamundësi investimesh publike lokale dhe sistemi finaciare ishte tërësisht i centralizuar. Në përgjithësi njësitë e qeverisjes vendore ishin të dobëta ekonomikisht dhe mundësia për të gjeneruar burime të veta pothuajse ishte minimale.

Në vijim qeverisja lokale në mënyrë graduale filloi të marrë kompetenca mbi territorin, shërbimet publike, investimet lokale dhe rajonale duke ofruar shërbime gjithnjë e më pranë qytetarëve të cilët filluan të kuptojnë dhe dobijnë e pushtetit vendor. Por vetëm në fillimin e viteve 1999 procesi i decentralizimit filloi të vlerësohej si një proces konsensual¹, i pranuar nga të gjithë aktorët dhe faktorët politik, duke u mbështetur, vlerësuar dhe asistuar nga faktori ndërkombëtar.

Një vend të dallueshëm në reformë pati decentralizimi fiskal, i cili është zhvilluar

¹ Robert J. Benett, "Local Government in post-socialist countries", OSI, Budapest, 1997

në përputhje me parimet themelore të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, duke krijuar shtratin e përshtatshëm për konsolidimin e skemave financare vendore, rritjes së autonomisë fiskale dhe financave vendore. Gjithsesi nga pikëpamja e konsolidimit të qeverisjes vendore duhet thënë se niveli parë i qeverisjes vendore (bashkitë dhe komunat) kanë qenë dhe mbeten më të konsoliduara në raport me nivelin e dytë (Këshillat e qarqeve), të cilat ende nuk janë të plotësuar në mënyrë të qartë me funksionin dhe rolin që do të luajnë në nivel rajonal. Por, në vazhdim të thellimit të reformave Qeveria Shqiptare në vitin 1999 hartoi Strategjinë e Decentralizimit, dokument i cili në vazhdimësi është pasuruar dhe përditësuar deri ditët e sotme, duke qenë kështu një dokument unik, koherent, konsensual dhe i rëndësishëm për të udhëhëqur një proces pa kthim i cili mbështet në disa parime kryesore ku më të dallueshmet janë:

- Decentralizimi ku autoritet vendore përfaqësojnë parimet bazë të demokracive të konsoliduara.
- Të drejtën e qytetarëve për të marrë pjesë në administrimin e punëve publike e drejtë e cila ushtrohet direkt dhe në mënyrë efikase.
- Ekzistenca e njëjësive të qeverisjes vendore, të pajisur me përgjegjësi lejon administrimin e punëve publike me efikasitet, efektivitet dhe pranë qytetarëve.
- Konsolidimi i autonomisë lokale dhe statusi i të zgjedhurve vendorë, si një kontribut i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie demokratike.
- Decentralizimi dhe autonomia vendore nënkupton ekzistencën e njëjësive të qeverisjes vendore të paisura me organe të zgjedhura të cilat janë të ndërtuara në mënyrë demokratike, kanë autonomi dhe kompetenca të gjëra dhe pamvarësi financiare.
- Mbështetja në autonominë e qeverisjes vendore, si e drejtë dhe kapacitet efektiv për hartimin dhe zbatimin e programeve afatshkurtra, afatgjata të zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal.

Në vitet e fundit po maturohet gjithnjë e më shumë mendimi se Shqipëria ka nevojë për një reformë administrative dhe territoriale në funksion të një qeverisjeje më të mirë të vendit, si dhe në funksion të vendosjes së qytetarëve në qendër të përfitimeve nga burojnë këto reforma. Prandaj një nga qëllimet kryesore të këtij punimi, është analiza për situatën aktuale të reformës në përgjithësi dhe asaj territoriale në vecanti, si një domosdoshmëri e zhvillimit rajonal. Nëpërmjet thellimit të procesit të decentralizimit në disa sektore publik të rëndësishëm si : furnizimi me ujë të pijshëm, arsimi parauniversitar, shërbimin parësor shëndetsor, ndihma ekonomike dhe shërbimet sociale është hedhur një hap drejt rritjes së rolit të rajoneve në Shqipëri e cila duhet shoqëruar me reforma të tjera dhe kryesisht me atë administrativo-territoriale.

Sot në Evropë reformat territoriale janë në qendër të debateve². Por në përgjithësi debatet për kufinjtë optimale të komunave apo bashkive janë të vjetra sa çështje e vjetër teoria e shtetit. Platoni thoshte se komunat nuk duhet të kenë më shumë se 5040 banorë, kurse Aristoteli thoshte se një komunë apo qytet-shtet sipas tij duhet të

2 Instituti i Politikave Efektive Publike, "Reforma Territoriale dhe Decentralizimi"; Ideart, 2005, fq 58,136

jetë në gjendje të mbajë veten, pra të jetë suficiente, të ketë aq njerez sa ata të njohin karakterin e njeri-tjetrit për të vendosur drejtësinë, si dhe të jetë aq e madhe sa krejt territori i saj të shihet nga maja e një kodre³.

Sot sigurisht që debatet për madhësinë e një komune apo bashkie nuk kanë marrë një përgjigje. Europa ka modele të ndryshme por nuk ka një standart madhësie të përcaktuar i cili duhet të respektohet nga shtetet. Kemi modele të ndryshme nga Anglia, në vendet Skandinave e deri tek modelët italiane, greke apo franceze. Pra çështja është që kufinj të komunave dhe bashkive duhet të jenë në atë masë sa i lejon atyre që të japin standart të lartë shërbimesh për komunitetet e tyre⁴, gjithashtu e njëjta gjë mund të thuhet për rajonin si njësi territoriale dhe ekonomike.

1. *Kuadri ligjor*

Ndarja aktuale administrativo-territoriale bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë ku është përcaktuar struktura e njësive vendore dhe kompetenca, me ligj nga Kuvendi, për miratimin e ndarjes në tërësi dhe të çdo ndryshimi të nevojshëm. Në nenin 108 të Kushtetutës⁵ thuhet: “*Ndarjet administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkëta ekonomike e traditës historike*”. Mbi bazë dhe në zbatim të Kushtetutës, në vitin 2000, u miratuan tre ligje që kanë të bëjnë me ndarjen administrativo-territoriale.

Në Ligjin nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në një kapitull të veçantë për herë të parë jepet koncepti i ndarjes administrative dhe përcaktohen disa detyrime procedurale për riorganizimin administrativo-territorial të pushtetit vendor.

Ky ligj:

- Përcakton qartë misionin e pushtetit vendor me synim rritjen e vlerave të qeverisjes në nivel vendor;
- Përcakton parimet themelore të funksionimit të organeve të njësive të qeverisjes vendore;
- Përcakton të drejtat e njësive të qeverisjes vendore ku përfshihen e drejta e qeverisjes, e drejta e pronësisë, e drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe e bërjes së shpenzimeve, e drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike, e drejta e bashkëpunimit, e drejta e personit juridik dhe të drejta të tjera;
- Përcaktohen qartë funksionet e organeve të qeverisjes vendore, të ndara në funksione të veta, funksione të përbashkëta dhe funksione të deleguara. Në mënyrë të

³ Aristoteli “Politika”, përkthyer dhe përshtatur nga Plejad, Tiranë, 2003.

⁴ Page, C., Goldsmith, M, “Marrdhëniet mes qeverisjes Qendrore-Lokale », London:Sage publications, 1987.

⁵ Neni 108, pika 2 e Kushtetutës së RSH.

veçantë evidentohet në ligj bashkëpunimi ndërkomunal për kryerjen e funksioneve;

- Përcaktohen financat e njësive të qeverisjes vendore. U jepet me ligj mbështetje e plotë organeve të qeverisjes vendore për të zhvilluar financat e tyre për plotësimin e funksioneve dhe kompetencave përkatëse;

- Përcaktohen mënyra e krijimit, përbërja, organizimi dhe ndarja e kompetencave të organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore dhe mënyra e procedurat për riorganizimin administrativo-territorial të pushtetit vendor.

Në një kapitull të veçantë “Dispozita Kalimtare” bëhen përcaktime kohore për kalimin e funksioneve dhe kompetencave në pushtetin vendor. Në këtë ligj përcaktohet që:

- Ndryshimi në ndarjen administrativo-territoriale mund të bëhet pa ndryshim të kufijve ekzistues. Këtu përfshihet ndryshimi i emërimit, ndryshimi i qendrës së njësisë përkatëse etj.

- Ndryshime në ndarjen administrativo-territoriale që shoqërohen me ndryshim kufijsh. Këtu përfshihen ndarje apo bashkime të njësive, kalime të pjesëshme ose edhe forma të kombinuara⁶.

Ligji tjetër nr.8653, dt.31.07.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, u përcaktua ndarja administrativo-territoriale që, në fakt ishte situata e mbartur pa ndryshime në nivelin e bashkive e komunave por, duke krijuar 12 qarqet në shkallë vendi. Gjithashtu njësitet vendore do të kenë nëndarjet e tyre të brendshme, por që si rregull nuk kanë organe të zgjedhura. Ndryshimet në ndarjen territoriale në të ardhmen bëhen me ligj sipas procedurave të përcaktuara në një kre të veçantë të këtij ligji. Në ligj, përcaktohet që në bashki e komuna krijohet organi i këshillit përkatës i zgjedhur drejtpërdrejtë nga populli si organ vendimmarrës, si dhe kryetari i bashkisë apo komunës i zgjedhur gjithashtu drejtpërdrejt nga populli, si organ ekzekutiv vetqeverisës. Në qark krijohet këshilli i qarkut, i zgjedhur me përfaqësues nga çdo bashki e komunë në raport me numrin e banorëve.

Miratimi i ligjit nr. 8654 date 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës” bëri që të përcaktohet që Bashkia e Tiranës, krahas unitetit të saj si qytet, është e ndarë në 11 Njësi Bashkiake me organe të zgjedhura të ngjashme me bashkitë dhe komunat e tjera, por me kompetenca të kufizuara. Në mënyrë të veçantë përmendim që mbeten kompetenca ekskluzive të Bashkisë së Tiranës e drejta e përfaqësimit si person juridik, pronat dhe financat. Njësitë Bashkiake marrin burime financiare dhe prona nga bashkia dhe i administrojnë ato sipas përcaktimeve që bën Këshilli i Bashkisë së Tiranës.

Njësitë bashkiake organizohen e funksionojnë njëllëj si bashkitë e tjera të vendit,

⁶ Migena Leskoviku “Reforma e decentralizimit në qeverisjen vendore”- tema për mbrojtjen e gradës “Master in Public Administration”, Fakulteti Ekonomik, UT në Bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, SHBA, Tiranë 2005.

me përjashtim të kompetencave më të kufizuara që kanë këto njësi, pasi mjaft kompetenca ushtrohen nga vetë Bashkia e Tiranës⁷.

2. Argumentimi për ndryshime në ndarjen administrativo-territoriale

Pavarësisht nga fakti kush e ushtron të drejtën e iniciativës për të propozuar projektligje për ndryshime në ndarjen administrativo-territoriale, kërkohet respektimi i disa kërkesave që duhen plotësuar duke argumentuar çdo propozim për ndryshim. Këtu përfshihen:

- Arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative për nevojën dhe avantazhet e tij;
- Mënyrat dhe materialet ose dokumentet e përdorura për informimin e publikut mbi organizimin dhe çështjet që lidhen me të;
- Mendimin e popullatës që banon në njësitë e qeverisjes vendore që do të riorganizohet, si dhe mendimi “pro” dhe “kundër” këtij riorganizimi, sipas çdo rasti të veçantë, nga subjekte ose grupe të interesuara drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë në këtë riorganizim;
- Mënyrat e marrjes së mendimeve me mbledhje të hapura, seanca këshillimore me publikun, dëgjime publike, sondazhe opinioni të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrimi i shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose me ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme;
- Hartat administrativo-territoriale në të cilat pasqyrohen edhe ndryshimet që rrjedhin nga riorganizimi;
- Efektet e parashikuara të karakterit ekonomik, financiar, social demografik, si edhe detyrimet civile dhe administrative që rrjedhin, mbarten ose ndahen;
- Mënyrat e parashikuara të rregullimit të çështjeve financiare, pasurore, të detyrimeve ndaj të tretëve ose ndaj njëra - tjetrës të njërive të qeverisjes vendore të përfshirë në ndarje.

Në këtë kontekst, marrja e mendimit të banorëve është një detyrim ligjor që buron nga standarti demokratik i organizimit territorial në dobi të komunitetit që përfshihet në të. Vihet re se mënyrat e marrjes së mendimit janë të ndryshme, kurdoherë marrja e mendimit do të jetë shprehje e lirë e mendimit dhe e dokumentuar. Në të njëjtën mënyrë kjo kërkesë shprehet edhe në Kartën Europiane të Autonomise Vendore. Në nenin 5 të saj thuhet: *“për çdo ndryshim të kufijve territorialë, bashkësive lokale përkatëse duhet t’u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë të referendumit, aty ku e lejon ligji”*⁸. Në këtë mënyrë, referendumi përbën një nga mënyrat e marrjes së mendimit dhe jo domosdoshmëri. Krahas marrjes së përgjithshme të mendimit të banorëve, ligji

⁷ Shih për më tepër ligjin nr. 8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”.

⁸ Keshilli i Europes; Karta Europiane e Autonomise Lokale; Strasburg; 1991; fq 7

në nenin 68 përcakton organet të cilave u duhet marrë detyrimisht mendimi si dhe detyrimi për të shprehur mendimin nga:

- -Këshillat komunalë, bashkiakë e të qarqeve që janë të përfshira drejtpërdrejt si dhe kryetarët e tyre japin mendimin e tyre zyrtar si dhe, nëse ka, mendime “kundër” të një pjese të këshilltarëve të këshillit përkatës.
- -Këshilli i Ministrave, kur ky i fundit nuk është propozues dhe, institucione të tjera qendrore që nuk varen nga Këshilli i Ministrave, të interesuar për organizimin përkatës.

2.1. Kriteret për shkrirje dhe/ose bashkim

Për të arritur në përfundime sa më realiste, për të ballafaquar në mënyrë sa më objektive kërkesat për ndryshime me gjendjen aktuale të faktorëve që ndikojnë në funksionimin sa më optimal të njësive vendore, në përputhje me veprimtarinë dhe kompetencat që ushtrojnë njësitë vendore, përcaktohen disa kriteret⁹. Secili nga kriteret konsiderohet se ka ndikim në veprimtarinë e njësive vendore por, disa kanë ndikim më të dukshëm dhe të drejtpërdrejtë ndërsa të tjera këtë ndikim e kanë në mënyrë më të tërthortë dhe në kompleks me faktorët e tjerë¹⁰.

Në shqyrtimin e situatës për njësitë vendore plotësimi i kriterëve merret si faktor detyrues ose plotësues, përmbushja ose jo e tyre vlerëson se sa ato janë në gjendje për t’u vetqeverisur. Mbi bazën e analizës së grupeve të njësive vendore në mënyrë të krahasueshme dhe, në përputhje me një vlerësim real me kushtet aktuale të vendit tonë mundet që, për çdo kriter të përcaktojmë përkatësisht nivelin tregues të matshëm, nëpërmjet të cilëve të vlerësohet çdo njësi nëse përfshihet brenda kriterëve apo nuk i plotëson ato. Në këtë logjikë, vendosim në ballancë çdo njësi. Kriteret në mënyrë të grupuar paraqiten në tabelën e mëposhtme. Siç shikohet nga tabela kriteret janë ndarë në dy grupe kryesore. Kriteret për shkrirje dhe kriteret për bashkim. Përsa i përket aplikimit të kriterëve, fillimisht do të aplikohen kriteret për shkrirje. Kriteret për shkrirje A dhe B do të aplikohen në sistem. Kjo do të thotë që njësia plotëson kushtet për t’u shkrirë në qoftë se nuk plotëson njëkohësisht të dy kriteret A dhe B, ose i ka negative njëkohësisht 6 treguesit e parë. Kriteri C do të aplikohet për të përforcuar mendimin për njësi të cilat janë në kufi dhe në limite të kriterëve për shkrirje¹¹.

⁹ Ministria e Brendshme; Strategjia Ndersektorale për Zhvillimin Rajonal; Tiranë; 2007; fq 42

¹⁰ Po aty

¹¹ Migena Leskoviku “Reforma e decentralizimit në qeverisjen vendore”- tema për mbrojtjen e gradës “Master in Public Administration”, Fakulteti Ekonomik, UT në Bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, SHBA, Tiranë 2005.

TABELA E KRITEREVE PER SHKRIRJEN E NJESIVE

Kriteret	Indikatoret
A. Madhesia (Kriter percaktues)	1- Numri i banoreve 2-Tendenca e levizjes
B. Menaxhim efektiv (kriter percaktues)	3-Raporti i shpenzime administrative ndaj totalit te shpenzimeve (%). 4-Te ardhura te veta perkundrejt buxhetit total (%). 5-Ngarkesa e punonjesve te administrates per 1000 banore 6-Numri i bizneseve per njesi.
C. Garantim i sherbimeve (kriter plotesues)	7-Numri i organizmave per sherbimet dhe I institucioneve 8-Shtrirja e rjetit social kulturor 9-Shtrirja e infrastruktures

Tabela e kriterëve për bashkim

Kriteri	Idikatori
Garantimi i sherbimeve	-faktori gjeografik -shtrirja e infrastructures -dendesia e popullsise
Krijimi i uniteteve tradicionalo-historik kompakte dhe te qendrueshme	-analize historike, gjeografike dhe shoqerore e njesive te mundeshme per tu shkrire

3. Decentralizimi administrativ, i funksioneve dhe kompetencave

Të nisur nga një shtet i centralizuar në mënyrë të skajshme, decentralizimi përbën një nga reformat shumë të rëndësishme demokratike. Nëpërmjet decentralizimit në Shqipëri do bëhet e mundur që, nëpërmjet transferimit të funksioneve në organet e qeverisjes vendore, këto të fundit po bëhen partnerë të vërtetë qeverisës. Legjislacioni i hartuar vitet e fundit dhe rezultatet e arritura në mjaft njësi vendore tregojnë vlerat e pazëvendësueshme të kësaj reforme në shërbim të ndërtimit të shtetit demokratik dhe përmirësimit sa më të shpejtë të nivelit të shërbimeve ndaj banorëve. Decentralizimi në kuptim të transferimit të funksioneve nga pushteti qendror në atë vendor, paralel me privatizimin në ekonomi përbëjnë thelbin e reformës në sistemin qeverisës¹².

Kështu, janë bërë **përparime në hartimin e legjislacionit** i cili ka krijuar terren mjaft të përshtatshëm për konsolidimin e organeve të qeverisjes vendore në ushtrim të rolit të tyre qeverisës. Kushtetuta, ligji organik për organet e qeverisjes vendore, ligjet për pronat shtetërore dhe për transferimin e pronave në pushtetin vendor, paketa fiskale, si dhe disa ligje sektoriale si: për statusin e nëpunësit civil, etj, janë akte që kanë hedhur themele të qëndrueshme në procesin e decentralizimit. Mjaft nga **funksionet dhe kompetencat kanë filluar të ushtrohen në mënyrë plotë nga organet e qeverisjes vendore**. Autonomia në vendimarrje, ushtrimi i funksioneve në

¹² Banka Botërore; "Shqipëria Decentralizimi në Tranzicion", Vëllimi I; Tiranë; 2004; fq 35

shërbimet publike sidomos për rrugët vendore, shërbimin e pastrimit të qendrave të banuara, grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave, dhënia e shesheve dhe lejeve të ndërtimit, administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara, administrimi i tregjeve, pyjeve dhe kullotave me karakter vendor, zhvillimi i veprimtarive kulturore e sportive etj, tanimë në mënyrë tepër bindshëm drejtohen nga organet e qeverisjes vendore. Këshillat e qarqeve kanë filluar të hartojnë programe të zhvillimit rajonal ndonëse për këtë ende nuk është përcaktuar qartë ndarja e struktura e programeve për problematikën me karakter rajonal dhe te kompetenca e tyre për të marrë përsipër zgjidhjen e tyre¹³.

Organeve të qeverisjes vendore u është hapur rrugë dhe ato tani **realizojnë kompetenca të plota në organizimin e tyre të brendshëm**, në përcaktimin e administratës dhe plotësimin e saj, në përzgjedhjen e formave ligjore në krijimin dhe administrimin e ndërmarrjeve që ato krijojnë për ushtrimin e kompetencave, në krijimin e policisë së bashkisë apo komunës, në përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve për punonjësit, në organizimin e marrëdhënieve me komunitetin, me partnerë të ndryshëm brenda e jashtë vendit, në organizimin e bashkëpunimit në organizata dhe forma të tjera të bashkëpunimit ndërkomunal në ushtrim të funksioneve. Organeve të qeverisjes vendore po u krijohet terren gjithnjë e më i gjerë për **ushtrimin e funksioneve nëpërmjet përmirësimit të situatës financiare të tyre**, në fushën e transferimit të pronave, zhvillimit të aktiviteteve trajnuese të të zgjedhurve dhe punonjësve të administratës së tyre etj. Këtu janë evidente përmirësimet në mënyrën e shpërndarjes së burimeve financiare nga buxheti i shtetit pasi, duke filluar nga viti 2002 kjo bëhet nëpërmjet një formule e cila, duke respektuar disa tregues sintetik, shmang mjaft karakterin subjektiv. U zgjerua sistemi i taksave vendore ku në mënyrë mjaft të dukshme marrin vlera të mëdha kalimi në pushtetin vendor i tatimit mbi biznesin e vogël, tatimit për tokën bujqësore, taksa për regjistrimin e automjeteve, etj. Të gjitha këto kanë bërë që të përmirësohet dukshëm struktura e të ardhurave të organeve të qeverisjes vendore.

3.1. Decentralizimi fiskal

Decentralizimi fiskal, si pjesë e reformës së decentralizimit në Shqipëri ka ecur në raport me tërë zhvillimin ekonomik, vazhdimësinë e procesit të reformave ekonomike dhe politike, organizimin e institucioneve financiare dhe monetare, diferencat ekonomike të rajoneve dhe grupeve të caktuara të popullsisë. Në periudhën 1992-1996 njësitë e qeverisjes vendore pothuajse nuk kishin fare autonomi financiare ku, të gjitha shpenzimet që kryente pushteti vendor financoheshin nga buxheti i shtetit me transferta të kushtëzuara.

Transferta e pakushtëzuar u aplikua për herë të parë në vitin 2001 e cila shënon fillimin e decentralizimit fiskal. Kjo transfertë është rritur çdo vit dhe do të vazhdojë këtë tendencë rritjeje, në përputhje me shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit,

¹³ Ministria e Brendshme; "Rishikimi i Ndarjes Administrativo-Territoriale"-studim; Tiranë; 2007.

madje sipas SKZHI¹⁴ ka një angazhim të qeverisë për të rritur fondet e disponueshme për arsimin, pjesë e së cilës i alokohet njësisë të qeverisjes vendore me anë të transfertës së pakushtëzuar.

Nëpërmjet *decentralizimit fiskal* gjatë këtyre viteve është synuar dhe arritur:

- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për pushtetin vendor për të ushtruar funksionet e përcaktuara me ligj;
- Dhënia e autoritetit të nevojshëm pushtetit vendor në vendosjen e taksave vendore dhe përdorimin e tyre;
- Përmirësimi i skemave financiare të ndarjes së transfertave të pakushtëzuara që buxheti i shtetit alokon për pushtetin vendor;
- Aplikimin e skemave të ekuilizimit, me qëllim kompensimi i njësisë të qeverisjes vendore me mjete të pamjaftueshme financiare për garantimin e shërbimeve publike për të gjitha njësitë vendore;
- Hartimi dhe harmonizimi i strategjive të zhvillimit ekonomik vendor me strategjitë rajonale dhe kombëtare të zhvillimit.

Si konkluzion, për këtë punim mund të themi se që nga fundi i viteve 90-të është hartuar një qasje më konsistente decentralizimi, si dhe po zbatohet një strategji e qartë për këtë qëllim. Shqipëria për shkak të popullsisë dhe pozicionimit të saj, për shkak të territorit dhe varietesë së saj, për shkak të diferencave në administrim, duhet që procesi i rishkimit territorial të jetë një proces i pandërprerë. Ka një sërë arsyes përse në Shqipëri duhet të ndërmerret reforma administrative-territoriale. Ndryshimet e thella demografike të pas viteve 90, kanë bërë që të rritet numri faktik i komunave me një popullsi të vogël. Kjo ka bërë që në këto zona të ketë një dinamikë më të vogël të proceseve dhe veprimtarive me karakter publik dhe efektiviteti i punës dhe shpenzimeve është më i ulët, e kundërta ndodh në ato komuna ku dendësia e popullsisë është më e madhe. Ekzistenca e njësisë vendore të vogla dhe tendenca për zvogëlimin e tyre për shkak të lëvizjeve demografike të popullsisë, shoqërohet me një kosto të lartë të administrimit¹⁵. Një arsye tjetër është edhe niveli i pamjaftueshëm në efektivitetin e shërbimeve publike nga disa njësi vendore si dhe mundësia e kufizuar për krijimin e të ardhurave të veta. Njësitë vendore me numër të vogël banorësh sigurojnë nivele të ulta të të ardhurave vendore, në raport me të ardhurat e përgjithëshme të tyre në buxhetin e pavarur.

Proçesi i zbatimit të ndryshimeve në ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore është një nga mekanizmat që duhet të përdoren në procesin

¹⁴ Sistemi i Planifikimit të Integruar, i cili u miratua nëpërmjet Vendimit 692 të Këshillit të Ministrave në Nëntor 2005, vendos kuadrin e planifikimit strategjik. Kjo është përpunuar më tej nëpërmjet: (a) vendimit të Komitetit të Planifikimit Strategjik për planifikimin strategjik (Mars2006); dhe (b) Udhëzimi për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (Maj 2006).

¹⁵ Migena Leskoviku "Reforma e decentralizimit në qeverisjen vendore"- tema për mbrojtjen e gradës "Master in Public Administration", Fakulteti Ekonomik, UT në Bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, SHBA, Tiranë 2005.

reformues në lidhje me përmirësimin e rolit të organeve të qeverisjes vendore në qeverisje, për të qenë sa më mirë në gjëndje t'i përgjigjen plotësisht nga ana e tyre të funksioneve që u transferohen në procesin e decentralizimit.

Ndryshimet në ndarjen administrativo-territoriale nuk shihen si qëllim në vetvete, madje të pashoqëruara me mekanizmat e tjera nuk mund të luaj një rol të dukshëm. Kjo kërkon që të punohet intensivisht për të zhvilluar dhe mbështetur bashkëpunimin ndërkomunal si një masë shumë e dobishme për të përmirësuar plotësimin e funksioneve dhe kompetencave që u transferohen njësive vendore sidomos atyre të nivelit të parë, si nga ana sasiore dhe shtrirjes së tyre dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e standarteve më të larta të mundshme në nivele zonale.

Forcimi i rolit të këshillit të qarkut si organe të qeverisjes vendore, ku përfaqësohet vullneti i organeve të nivelit të parë, është me efekte më pozitive, sidomos duke marrë parasysh që ai, në brendi të funksionit të tij për hartimin dhe zbatimin e programeve të zhvillimit rajonal ka pikërisht harmonizimin dhe për pasojë edhe lehtësimin e plotësisht të misionit të vetqeverisjes vendore në kuadër rajonal. Në këtë kuadër, këshilli i qarkut, duke patur përpara programet kombëtare të zhvillimit si dhe ato të cdo njësie në vecanti duhet të jetë më mirë në gjëndje të plotësojë detyra konkrete për zhvillimin e infrastrukturës rajonale, të mbështetjes dhe orientimit më të programuar të politikave sektoriale që kërkojnë nga njëra anë bashkërendim me pushtetin qendror dhe nga ana tjetër zhvillimin e sektorit privat në kushtet e unifikuara të rajonit¹⁶. Ndërkohë, të pazëvendësueshmë janë masat për përsheptimin dhe zbatimin pa ekuivok të politikave fiskale me efekte të mëdha dhe të pazëvendësueshme në sigurimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar të potencialeve financiare të njësive vendore. Kjo do të shoqërohet me çuarjen deri në fund të procesit të nisur të transferimit të pronave në njësitë vendore në lidhje me funksionet që u transferohen atyre. Hartimi i politikave që lidhen p.sh. me programin e zhvillimit të qarkut apo programin e zonave jo të favorizuara dhe strategjive sektoriale (SNZHR) në shkallë kombëtare, përmirësimi i legjislacionit përkatës për një konkretizim të qartë të të gjithë instrumentave që u jepen organeve të qeverisjes vendore për të ushtruar funksionet dhe kompetencat janë një tjetër moment dhe mekanizëm i domosdoshëm për të përmirësuar nivelin qeverisës nga organet vendore.

¹⁶ Ministria e Brendshme; "Rishikimi i Ndarjes Administrativo-Territoriale"-studim; Tiranë; 2007.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998
- Ligji nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
- Ligji nr. 8654, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”
- Ligji nr.8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”
- Karta Europiane e Autonomisë Vendore, Këshilli i Europës, 1991
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, (SKZHI), Këshilli Ministrave, Tiranë
- Migena Leskoviku “*Reforma e decentralizimit në qeverisjen vendore*”- tema për mbrojtjen e gradës “Master in Public Administration”, Fakulteti Ekonomik, UT në Bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës, SHBA, Tiranë 2005.
- Page, C., Goldsmith. M, “*Marrëdhëniet mes qeverisjes Qendrore-Lokale* », London:Sage publications, 1987
- Aristoteli “*Politika*”, përkthyer nga Plejad, Tiranë, 2003
- Robert J. Benett, “*Local Government in post-socialist countries*”, OSI, Budapest, 1997
- Instituti i Politikave Efektive Publike, “*Reforma Territoriale dhe Decentralizimi*”; Ideart, 2005.
- Ministria e Brendshme; “*Rishikimi i Ndarjes Administrativo-Territoriale*”-studim; Tirane; 2007.
- Banka Botërore; *Shqipëria Decentralizimi në Tranzicion Vëllimi I*; Tirane; 2004
- Të dhëna të Ministrisë së Brendshme të RSH

“Depresioni i madh” i kapitalizmit liberal: 1929–33

Një analizë retrospektive

Prof. Dr. Adrian CIVICI, UET

Abstrakt. *Kriza e vitit 1929 është tronditja e parë e madhe e kapitalizmit dhe përfshin periudhën nga tetori 1929 deri në fillimin e luftës së dytë botërore. Ajo ishte një krizë tipike burse që shpërtheu në bursën e New York-ut periudhën 24–29 tetor 1929 dhe dalëngadalë, gjatë dy viteve të ardhshme u shtri pothuajse në gjithë botën. Ky eveniment shënoi fillimin e « depresionit të madh » që shumë shpejt u shndërrua në krizën ekonomike më të madhe të shek. XX-të. Ditët e shfaqjes së kësaj krize u quajtën « e enjtja e zezë e 24 tetorit », « e hëna e zezë e 28 tetorit » dhe « e marta e zezë e 29 tetorit ». Historia e ekonomisë dhe financave nuk kishte njohur dhe nuk njehej asnjë rast të cilësimeve të tilla kaq cinike dhe negative. Për nga pasojat e saj ekonomike (ulje çmimesh, falimentime bankash e biznesesh, reduktim të konsumit, kriza superprodhimi, çuleftësim monedhash, papunësi e jashtëzakonshme, etj.) dhe politike (zhdukje regjimesh politike si p.sh., Republika e Waimar-it në Gjermani, forcimin e diktaturave fashiste e naziste si dhe mjaft regjimeve autoritare si p.sh., në Spanjë, Portugali, Uruguai, etj.), ajo përbën ngjarjen më tronditëse që kaloi bota në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.*

Periudha e viteve 1920 shënon një nga periudhat me rritjen më të madhe ekonomike në SHBA. Gjatë viteve 1920–29 prodhimi industrial amerikan u rrit me 50%. I gjithë ky « boom » ekonomik u shoqërua me një zgjerim e rritje të panjohur deri atëherë të tregjeve financiare dhe bursës. Qarkullimi i kapitaleve filloi të bëhej gjithnjë e më shumë autonom në raport me prodhimin dhe tregëtinë. Spekulumet në bursë e shpejtuan shumë ritmin e qarkullimit të parasë, pavarësisht nga shpejtësia dhe eficaenca e operacioneve ekonomike. Vetëm gjatë periudhës janar 1925–janar 1929, vlera totale e aksioneve të kuotuar në bursën e Wall Street-it u rrit 250%, duke dhënë kështu përshtypjen e një prosperiteti të qëndrueshëm. E njëjta gjë ndodhi edhe me kreditë

bankare : ato kaluan nga 550 milion dollarë në 31 dhjetor 1924, në 6640 milion dollarë në 4 tetor 1929. Por e gjithë kjo rendje e përqendrim vetëm tek bursat dhe kapitalet financiare filloi të japë ndikim e saj tek ekonomia reale e cila shfaqti shenjat e para të dobësimit. Në gjysmën e parë të vitit 1929, prodhimi i automobilave ra me 32%, prodhimi industrial u zvogëluar me 7% dhe përgjithësisht gjithë aktiviteti ekonomik shfaqti shenja të dukshme asfiksie : kapitalet e disponueshme « vraponin » nëpër bursa në vend që të orientoreshin drejt ekonomisë reale. Në 3 shtator 1929, indeksi « Dow Jones »¹ arriti në nivelin 381.17, më të lartin e njohur ndonjëherë në historinë e tij, duke bërë që ekonomisti Irving Fisher të deklaronte se « vlerat në bursë kanë arritur në maja përjetësisht të paimagjinueshme ». Por, ky do të ishte dhe fillimi i shpërthimit të fluskës financiare.

Të enjten në 24 tetor 1929 filluan të shfaqen shenjat e para të panikut. Të gjithë donin të shisnin ndërkohë që askush nuk dëshironte të blinte dhe për pasojë vlera e aksioneve filloi të binte me shpejtësi. Vetëm brenda pak orëve, treguesi Dow Jones humbi 22.6% të vlerës së tij. Në bursën e New York-ut shpërtheu një rrëmujë e vërtetë sepse me mijëra aksionerë u sulën drejt galerive për të shitur aksionet e tyre, ndërkohë që bursat e Cikagos dhe Buffalo-s tashmë ishin mbyllur. Mbas disa tentativave për ta qetësuar situatën² dhe ndërhyrjes së bankave për ta stabilizuar disi kursin e aksioneve u duk se situata u qetësua, volumi i veprimeve u rrit ndjeshëm dhe vlera e aksioneve ju afrua shifrave normale.

Por, në 28 tetor, « të hënën e zezë » paniku shpërtheu përsëri, ndërkohë që bankat nuk ndërhyjnë më. Indeksi Dow Jones humbi përsëri 13% të vlerës, humbje që do të përsëritej në të njëjtat përmasa vetëm në krizën e vitit 1987. Vlerat e aksioneve të disa prej kompanive kryesive u shembën : General Electric humbi 48 pikë, Kodak 42 pikë, Westinghouse 34 pikë, etj. E njëjta situatë katastrofike vazhdoi dhe të martën 29 tetor (« e marta e zezë ») ku Dow Jones humbi përsëri 12% të vlerës së tij. John Kenneth Galbraith do të shkruante se « këto ishin dy ditët më shkatërruese në historinë e bursës së New York-ut dhe ndoshta në gjithë historinë e bursës »³.

Në periudhën ndërmjet 22 tetorit dhe 13 nëntorit, indeksi Dow Jones u ul nga 326.51 në 198.69 (-39%), duke pësuar një humbje prej 30 miliard dollarësh, ose dhjetë herë më shumë se buxheti federal amerikan. Në humbjet nga më spektakolaret mund të përmenden : vlera e aksioneve të Goldman Sachs që nga 104 dollarë në 1929 ra

¹ Aktualisht ky tregues përmbledh vlerën e aksioneve të 31 kompanive nga më të rëndësishmet në SHBA dhe botë të tilla si American Express, Boeing, Coca cola, DuPont, General Electric, General Motors, Hewlett-Packard, Microsoft, McDonald's Corporation, Walt Disney Company, etj. Është i vetmi tregues i vlerës në bursë që ka pothuajse 120 vjet që llogaritet e publikohet rregullisht.

² Mbas një mbledhjeje urgjente të pesë bankierëve më të rëndësishëm të New York-ut, të mbajtur në zyrat e J.P.Morgan&Co., Thomas Lamont deklaronte se «ka patur vetëm një sasi të vogël shitjesh me humbje në bursë...kjo ka ndodhur për shkaqe teknike të funksionimit të tregjeve....ne si grup bankierësh kemi rënë në konsensus se pjesa më e madhe e kuotimeve të bursës sot nuk shpreh situatën reale...situata do të shkojë drejt përmirësimit..».

³ John Kenneth Galbraith, *La Crise économique de 1929, anatomie d'une catastrophe financière*, Payot, 1989

në 1.75 dollarë në 1932, American Founders Group nga 75 në 0.75 dollarë, General Motors nga 1075 në 40, General Electric nga 1612 në 154 dollarë, J.P.Morgan humbi 60 milion dollarë, familja Rockefeller humbi 80% të pasurisë së saj, etj.

Dëshpërimi dhe humbja e besimit si pasojë e krisës së bursës infektoi menjëherë konsumin dhe investimet. Investitorët që i kishin përdorur në bursë fitimet dhe kreditë e tyre nuk mund të paguanin më bankat, të cilat nga ana e tyre bllokuan menjëherë kredinë deri sa të qartësohej nëse kreditë e reja të kërkuara do të përdoreshin për pagesën e humbjeve në bursë apo do të investoheshin në ekonominë reale. Pjesa dërrmuese e kompanive dhe ndërmarrjeve u gjendën pa likuiditet dhe bllokuan si shlyerjen e kredive ashtu dhe pagat duke ndërprerë prodhimin dhe duke kaluar në falimentim. Depozituesit e thjeshtë të bankave, të panikuar nga situata u sulën drejt bankave për të tërhequr kursimet e tyre duke bërë që shumë banka të falimentonin. Në vitin 1930, kriza e bursës u bë një krizë e mirëfilltë bankare (2298 falimentime bankare në vitet 1930-31 në SHBA). Si pasojë e ndërprerjes së kredisë, konsumit, investimeve dhe prodhimit, në vend shpërtheu papunësia e cila u dhjetëfishua brenda 3 viteve. Në vitin 1931, kriza u bë edhe një krizë totale ekonomike. Në vitin 1933, niveli i papunësisë në SHBA arrit në 24.9% të popullsisë aktive.

Menjëherë mbas SHBA, kriza filloi të përhapej në gjithë botën. Fillimisht ajo u shfaq në Europë, sidomos në vendet, bankat e të cilëve kishin lidhje të ngushta me bankat amerikane. Paralelisht me bankat, si pasojë e rënies ekonomike dhe politikave proteksioniste amerikane u prek gjithë tregëtia botërore. Franca, Anglia, Hollanda dhe Spanja i drejtuan sytë nga kolonitë për të kompensuar tregtinë dhe mbështetur ekonominë e tyre. Në skenë doli përsëri « preferenca imperiale » e ndaluar nga Konferenca e Berlinit e vitit 1885 e cila rregullonte marrëdhëniet e fuqive koloniale me kolonitë dhe me njëra-tjetrën. Brenda vitit 1931, e gjithë Europa dhe Rusia ishin prekur rëndë nga kriza. Franca u përfshi nga një krizë e jashtëzakonshme deflacioniste (ulje drastike çmimesh e pagash); Gjermania nga një papunësi që shkonte deri në 25% duke ushqyer deziluzionin dhe revoltën e popullsisë për qeverinë dhe përgatitjen e kushteve për ardhjen në fuqi të nazizmit në 30 janar 1933 ; Italia u përfshi nga një çrregullim i madh ekonomik dhe papunësi e lartë duke i hapur rrugën fashizmit dhe Musolinit; Spanja dhe Portugalia me ardhjen në fuqi të Frankos dhe Salazarit adoptuan regjime ushtarake të ekstremit të djathtë, etj.

Në Amerikën e Jugut, Azi dhe Afrikë u prodhuan e ashtuquajtura « krizë e produkteve të shkretëtirës » e shkaktuar nga ulja e fortë e fuqisë blerëse në Europë dhe Amerikën e Veriut. Në Brazil, për shembull, për të limituar rënien e pandalshme të çmimit të kafesë, u dogjën publikisht trena të tërë të mbushur me thasë kafeje.

Presidenti republikan Herbert Hoover, mandati i të cilit u përputh plotësisht me periudhën më të egër të krizës (mars 1929-mars 1933) u përpoq pa sukses të minimizonte efektet shkatërruese të saj dhe stabilizimin e vendit. Duhej të vinte në pushtet demokrati Franklin Delano Roosevelt dhe të zbatonte programin e tij të reformave të quajtur « New Deal » që ekonomia dhe financat amerikane ti ktheheshin stabilitetit dhe rritjes. Nëpërmjet një politike tipike voluntariste e proteksioniste,

« New Deal » synonte ndërhyrjen e shtetit në ekonomi ndërmjet programeve masive qeveritare, mbështetjen e shtresave të varfëra të popullsisë, rindërtimin e tregjeve financiare, reformimin e sistemit bankar, ridinamizimin e ekonomisë amerikane, reduktimin e papunësisë, etj. Roosevelti e filloi mandatin e tij me shprehjen e famshme « e vetmja gjë nga e cila ne duhet të kemi frikë, është vetë frika »⁴. Me gjithë kritikën e shumta si nga e majta, ashtu dhe nga e djathta⁵, programi dhe politikat e Rooseveltit dhanë rezultate pozitive, dhe brenda pak vitesh, në fillim të luftës së dytë botërore, SHBA u kthyen përsëri si një superfuqi botërore në të gjitha fushat.

Roosevelti në qendër të vëmendjes

Në mediat më të mëdha botërore, në diskutimet politike e ato akademike vihet re vazhdimisht një vëmendje e madhe për Franklin Roosevelt-in, Presidentin amerikan të viteve 1933–45. Ndoshta sepse është i vetmi në gjithë historinë e SHBA që qëndroi në postin e tij për tre mandate rresht. Ndoshta sepse drejtoi me sukses të padiskutueshëm SHBA në dy nga sfidat më të mëdha të shekullit të XX-të: krizën e tmerrshme financiare apo siç quhet ndryshe depresionin e madh të viteve 1929–33 dhe luftën e dytë botërore. Por, duket se në vitet 2009–11, interesi me kaq intensitet të lartë për të dhe thelbin e qeverisjes së tij lidhet me dy faktorë thelbësorë : së pari, me debatet dhe paqartësitë e mëdha në rang ndërkombëtar për mënyrën më efektive dhe politikat më të përshtatshme për të dalë nga kriza financiare, ekonomike e sociale e këtyre viteve të fundit; së dyti, me zhgënjimin në shumë vende nga sjellja, cilësitë dhe performanca e mjaft liderëve kryesorë politikë apo qeveritarë. Në raste të tilla, streha më e mirë dhe më e sigurtë për të kërkuar një “shembull të mirë” duket se është historia. Duket se Roosevelti e ka fituar “duelin” e vështirë me historinë. Në mediat botërore është bërë modë që kryeministrit apo presidentët e tyre të krahasohen me Roosevelt-in. Mediat italiane e kritikojnë Berlusconi duke thënë se ai “është shumë larg figurës së Roosevelt-it”, ato franceze thonë se “Sarkozy nuk mund të jetë veçse një Roosevelt shumë i vogël”, mediat amerikane shkruajnë se “Obama po tregohet jo efektiv në rimëkëmbjen e ekonomisë amerikane..se vendit i duhet një Roosevelt”, në Rusi, Kryeministri Putin i pëlqen ta krahasojnë me Rooseveltin, etj. Por, për cilat arsye figura e tij rishfaqet kaq shumë në skenë si element krahasimi apo si standard vlerësimi? Komplexiteti i figurës së tij në panoramën e historisë politike dhe ekonomike të shekullit të XX-të e shpjegon më së miri “rievokimin” në ditët e sotme, të mbushura me ankthe financiare e ekonomike, me shifra alarmante papunësie, me sfida bankash e monedhash, me

⁴ A. Kaspi, Franklin Roosevelt, Fayard, 1988, p.29

⁵ Milton Fridman, shkolla e Çikagos dhe përgjithësisht liberalët e djathtë e kritikojnë politiken e Rooseveltit si shumë intervencioniste në ekonomi, si ndërhyrje të papranueshme të shtetit në politikën monetare, për krijimin në SHBA të “Etat-providence” me natyrë social-demokrate, etj. John T Flynn ë librin e tij “The Roosevelt Myth » të vitit 1948 e cilësonte New Deal si « formë e degjeneruar e socializmit ». Ndërkohë, e majta amerikane e konsideronte këtë reformë si « shumë konservatore », si një politikë në favor të padronëve të mëdhenj....si një politikë që ruajti tiparet më negative të kapitalizmit.

shtete që rrezikohet të falimentojnë, me alternime të frikshme pesimizmi dhe optimizmi në ekonominë më të mëdha të botës, etj.

Në fushën ekonomike, Roosevelti konsolidoi dhe rriti performancën e sistemit të mbrojtjes dhe ndihmës sociale duke i amortizuar në maksimum efektet negative të krizës financiare, legjitimoi rolin institucional të sindikatave duke i shkëputur plotësisht ato nga ndikimi politik apo kontrolli mafioz, futi rregulla të rrepta për supervizionin dhe rregullimin e aktivitetit bankar dhe financiar, mundi konkurrencën e padrejtë në të gjitha llojet e tregjeve, fitoi betejën me monopolet, zgjeroi prezencën dhe rolin e shtetit në ekonomi në mënyrë që të reduktonte papunësinë dhe zhvillonte infrastrukturën e mëdha, e bëri monedhën e vendit të tij një faktor thelbësor në zhvillimin ekonomik-social, etj. Me fjalë të tjera, duket se zotëronte “çelësin magjik” për të zgjidhur pjesën dërrmuese të problemeve të sotme, duke i lënë politikave dhe vendimeve të tij një vend të rëndësishëm në trashëgiminë botërore të politikave dhe liderëve të suksesshëm.

Në thelb, Roosevelti mbrojti me fanatizëm idenë dhe parimin se “Shteti duhet të luajë një rol të rëndësishëm në ekonomi” qoftë dhe pa ndërhyrë direkt në të. Shteti apo qeverisja duhet të ketë në vëmendje maksimale “korrigjimin e devijimeve dhe inefiçencës së tregjeve”, të “ndjekë e ti përgjigjet me politika konkrete cikleve ekonomike” në çdo vend apo dhe atyre të ekonomisë botërore për aq sa është e mundur për çdo ekonomi nacionale, “të integrojë mekanizma gjenerues e garantues për tregun” që ai të ketë garancinë dhe lirinë maksimale të veprimit. Roosevelti mbronte gjithashtu idenë se në raste të veçanta “me interes kombëtar”, qeveritë mund të mbrojnë sektorë të veçantë të prodhimit apo shërbimeve nga konkurrenca e huaj, qoftë kjo edhe në një kohë të limituar.

A mund të vlejë Roosevelti dhe aksioni i tij politik si shembull që mund të ndiqet edhe sot? Duke se përgjigjja është pohuese. Siç ka evidentuar Conrad Blank, njëri nga biografët më të mirë të tij, “Roosevelti ka shpëtuar demokracinë liberale kundër tentacioneve qeverisëse autoritare të zhvilluara si pasojë e krizës së rëndë financiare”. Ndërkohë, Benjamin Friedman, një tjetër autor që ka analizuar periudhën e Rooseveltit në SHBA, në librin e tij “Pasojat morale të rritjes ekonomike”, nënvizon tezën e Rooseveltit se rritja ekonomike gjeneron tolerancë, demokraci dhe mendje të hapura....se rritja ekonomike nuk është e mirë vetëm sepse shton pasurinë, por sepse ajo përmirëson njeriun dhe e bën atë më të përgjegjshëm dhe më etik. Ashtu siç është e vërtetë dhe e kundërta : recesioni dhe situatat e vështira ekonomike me rritje të dobët varfërojnë ndjenjat morale dhe sjelljen politike, legjitimojnë autoritarizmin dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, bizneseve dhe vetë tregut të lirë. Në periudhën 1929-45, e shtrirë kjo deri në vitin 1989, Europa njohu një nga periudhat më të errëta të historisë së saj me fashizmin, nazizmin dhe komunizmin sovjetik. Sot, shumë analistë politikë e historianë mendojnë se duhet t’ja dedikojmë Rooseveltit mbijetesën e sistemit social dhe ekonomisë së tregut që dominon në botën e sotme, një sistem në të cilin ekonomia e tregut dhe liria e biznesit bashkëjetojnë me sistemin e mbrojtjes dhe përkrahjes sociale. Kjo është një nga trashëgimitë më të rëndësishme të Rooseveltit.

Franklin D. Roosevelti është prototipi i udhëheqësit politik që kërkon ti zgjidhë

problemet e vendit të tij nëpërmjet vendimeve kurajoze, që nuk trembet të sfidojë lobet dhe fuqinë ekonomike e shpesh presionin korruptues të bizneseve e firmave të mëdha. Pa rënë në populizëm, ai arriti të mbante ekuilibrin e domosdoshëm ndërmjet interesave të përgjithshme sociale (të sindikatave, punonjësve të sektorit publik, fermerëve, tregëtarëve të vegjël, etj.) dhe interesave të biznesit të madh (industrisë, bankave, shoqërive tregëtare, etj.).

“Aktualiteti” dhe debatet mbi krizën e depresionit të madh

Reflektimet, analizat dhe komentet mbi shkaqet që prodhuan krizën e madhe të 1929-33, mbi arsyet e transformimit të saj nga recesioni në depresion apo mbi efektin dhe racionalitetin e politikave dhe masave të ndërmarra për daljen prej saj vazhdojnë deri në ditët e sotme, pa arritur të gjendet një konsensus i pranuar nga të gjithë. Sasia e artikujve, librave, studimeve, konferencave, etj., kushtuar kësaj teme është e pafundme. Çdo shkollë e mendimit ekonomik është përpjekur ta shpjegojë në këndvështrimin dhe tezat e saj krizën, njëkohësisht me hedhjen poshtë të argumenteve të të tjerëve⁶. Shpjegimet e ekonomistëve marksistë dhe keynes-ianistë se «kriza erdhi si pasojë e përqendrimit dhe diferencimit të pabarabartë të pasurisë» kundërshtohet si e pamjaftueshme për të argumentuar shumë nga detajet e krizës. Shpjegimi «monetarist» i Milton Friedman-it dhe Anna Schwartz i dhënë në librin «Historia monetare e SHBA» (1963)⁷ konsiderohet si i pjesshëm ; një version i ekonomistit francez Jacques Rueff i trajtuar gjerësisht në librin e tij «Mëkati monetar i perëndimit»(1971), në të cilin analizohet thellësisht periudha përpara shpërthimit të krizës, tenton ti shpjegojë më qartë shkaqet e shpërthimit të saj ; ndërkohë, një nga ekspertët më të mirë në botë në fushën e historisë së ekonomisë, Charles Kindleberger vlerëson se « për ta shpjeguar këtë krizë, është e domosdoshme të merren në konsideratë një numër shumë i madh faktorësh »⁸.

Grupimi i parë i interpretimeve përmbledhet në shpjegimin e saj si pasojë dhe efekt i spekulimeve në bursë. Origjina e krizës është çmenduria e bursës dhe papërgjegjshmëria e bankierëve që i dhanë para pafund spekulatorëve. Aktiviteti financiar dhe ai bankar, në vend që të financonin ekonominë reale, financuan spekulimet e dyshimta duke bërë që bursa të njihte avancime të paimagjinueshme. Ndërkohë, kur bursa u shemb, kreditë dhe huatë bankare nuk mund të paguheshin më dhe bankat u asfiksuan. Kudo mbretëroi paniku i cili provokoi bllokimin e sistemit monetar dhe financiar duke bërë që mbi 8000 banka të falimentonin në periudhën 1929-34. Ekonomia, e privuar nga kreditë dhe financimet u paralizua krejtësisht duke bërë që kriza të përhapej dhunshëm edhe në ekonominë reale.

Grupi i dytë i interpretimeve bazohet në një shpjegim « monetar ». Sipas tyre,

⁶ Ben Bernanke, *Essays on the Great Depression*, Princeton University Press, 2005

⁷ M.Friedman et AnnaSchwartz, *A monetary history of the United States, 1867-1960*

⁸ Charles Kindleberger, 1986, *La Grande Crise Mondiale 1929-1939*, Economica première édition 1973

ishite « krijimi monetar i ç'frenuar » i viteve 1920 ai që krijoi fluskën inflacioniste dhe shpërthimin e krizës. Kjo edhe si pasojë e paaftësisë së sistemit të rezervës federale në SHBA për të kontrolluar situatën monetare të vendit. Sipas njërit prej ekonomistëve më të shquar, Ludwig von Mises, shembja e sistemit financiar ishte rrjedhim logjik dhe pasojë fatale e presionit të jashtëzakonshëm të ushtruar për të ulur përqindjet e interesit në mënyrë që sigurohej një ekspansion galopant i kreditit. Edhe Milton Friedman, gjykonte se ishte politika monetare kufizuese e Bankës qendrore amerikane (Federal Reserve) në vitin 1928 ajo që shkaktoi shkaktoi frenimin dhe zvogëlimin e kredive. Sipas tij, gabimi që shkaktoi krizën ishte një devijim nga rregullimi monetar i domosdoshëm në këto raste, sepse Fed duhej të kishte bërë pikërisht të kundërtën, ta furnizonte tregun dhe sistemin bankar me likuiditet të bollshëm.

Autorë të tjerë të shquar si Ben Bernanke, Presidenti aktual i Fed, theksojnë se banka qendrore në vend që të mbante një qëndrim të ngurtë, duhet të kishte mbushur tregun me likuiditet dhe lehtësuar maksimalisht kredinë bankare. Të njëjtin pozicion mban dhe ish presidenti i Fed Alan Greenspan. Të dy këta presidentë të Fed e zbatuan teorinë e tyre në përballimin e të gjitha krizave financiare e monetare që prekën SHBA në periudhën 1987-2010.

Ndërkohë, ekonomisti Jacques Rueff e shikon origjinën e krizës tek sistemi i « Gold Exchange Standart » i miratuar në konferencën e Gjenevës të vitit 1920⁹. Në sistemin e « etalonit-ar », çdo deficit i bilancit të pagesave provokonte një dalje jashtë të arit dhe për pasojë, një kufizim proporcional të kreditit. Ky ishte një efekt stabilizues që e mbante sistemin në ekuilibër. Por, në një sistem të « etalonit-ar » ku një monedhë e privilegjuar mund të ruhet si rezervë monetare, vendi i privilegjuar, ka tendencë të rrisë pa limit borxhin e tij. Në këtë aspekt, borxhi i SHBA para vitit 1929 arriti deri në 370% të PBB. Efekti marxhinal i kapitaleve u zvogëlua dhe spekulimi në bursë zëvendësoi investimet në ekonominë reale. Bursa njohu një ekspansion spektakolar të pandalshëm. Por, si përfundim, gjithë piramida e borxheve u shemb duke provokuar krizën totale. Ndërkohë që kjo piramidë i kishte rrënjët në dizekuilibrat financiare botërore, e gjithë bota u trondit menjëherë nga shembja e saj. Shumë ekonomistë, bëjnë të njëjtin krahasim dhe shikojnë të njëjtin mekanizëm edhe për krizën financiare globale të viteve 2008-2010.

Shpjegimi tjetër ka natyrë « marksiste », dhe bazohet në arsyetimin se akumulimi i kapitalit dhe ulja e fitimit janë origjina kryesore e krizave të sistemit kapitalist. Superakumulimi i kapitalit krijon super prodhim të mjeteve të prodhimit në raport me sendet e konsumit duke provokuar kriza. Ekonomistët marksistë mendojnë se këto janë kriza ciklike organike në vetë natyrën e kapitalizmit dhe zhvillimi apo ekzistenca e tij kalon detyrimisht nëpërmjet krizave të tilla ciklike të pashmangshme. Edhe Keynes-i jep pak a shumë të njëjtin shpjegim për këtë fenomen. Sipas tij, përqendrimi

⁹ Marrëveshja e Gjenevës e vitit 1922 parashikonte që vetëm dy monedha, ajo amerikane dhe britanike mund të konvertoheshin në ar; ndërkohë që monedhat e tjera thjesht e përcaktonin vlerën e tyre në raport me arin; vendet e tjera nuk ishin të detyruar ti paguanin në ar detyrimet e tyre, por mund ti paguanin ato në dollar ose livra sterlina, të pranuar edhe si rezerva valutore nga bankat qendrore respektive.

i pasurisë i zvogëloi shumë mundësitë e konsumit që aparati prodhues kishte nevojë për tu zhvilluar në ekuilibër duke prodhuar papunësi masive. Vetëm ndërhyrja e shtetit nëpërmjet investimeve publike mund të rikthente punësimin e plotë dhe të pengonte krizën ose të minimizonte efektet e saj.

Një shpjegim i përafërt jepet dhe nga të ashtuquajturit « teoricienë të rregullimit » të cilët mendojnë se ekonomitë e zhvilluara destabilizohen si pasojë e progresit teknologjik dhe organizimit shkencor të punës, ose « taylor-ismit ». Avancimi shumë i shpejtë i prodhimit në raport me pagat, pra me mundësinë e konsumit, shpjegon sipas tyre situatat e superprodhimit të cilat bëhen shkak për kriza monetare, recesioni apo depresioni.

Ngjashmëritë dhe diferencat ndërmjet Depresionit të Madh dhe Krizës financiare 2007-2010

A ka pika të përbashkëta ndërmjet krizës së vitit 1929 dhe asaj të vitit 2007-2010? Në shumë nga analizat krahasuese të zhvilluara, rezultojnë të paktën tre pika të forta të përbashkëta.

Së pari, “natyra ekonomike e choc-ut”. Shfaqja e deflacionit dhe një borxhi financiar kolosal, origjina e të cilit rrjedh nga politika monetare jashtëzakonisht liberale të cilat inkurajuan krijimin e fluskave financiare spekulative në tregjet amerikane të aksioneve në fund të viteve 20-të të shekullit të XX-të; dhe fluskave financiare spekulative në tregjet e pasurive të patundshme dhe atyre të kreditit në vitet 2000.

Së dyti, diz-ekuilibret e modelit ekonomik : (1) kufizime të mëdha të prodhimit si pasojë e saturimit të kërkesës dhe çrregullimeve monetare e financiare, pasoja të luftës së parë botërore dhe viteve “të çmendura” pas saj; (2) divergjenca të jashtëzakonshme në fillim të shekullit të XXI-të ndërmjet një grupi vendesh si SHBA, Anglia, Spanja, etj., që merrnin vazhdimisht borxhe për të konsumuar dhe importuar, dhe një grupi tjetër vendesh si Kina, Japonia, Gjermania, etj., që kursenin për të investuar dhe eksportuar.

Së treti, këto kriza shënojnë jo thjesht një ndryshim të natyrës apo evolucionit të kapitalizmit, por një “hap historik” të tij : dyshime të forta mbi aftësinë e “shtetit minimal” për të qenë totalisht e kurdoherë efikas në zgjidhjen e problemeve të zhvillimit ekonomiko-social, dyshimet mbi “leadershipin e përjetshëm amerikan” në botë, antagonizmi ndërmjet demokracisë dhe totalitarizmit gjatë dy luftërave botërore; fundi i monopolit të perëndimit si udhëheqës dhe “pronar” i kapitalizmit botëror, rënia relative e superfuqisë amerikane në ekonominë dhe financat botërore, zhvendosjen e qendrës së gravitetit të globalizimit drejt Azisë, etj., në këtë fillim shekulli të XXI-të.

Ndërkohë, diferenca kryesore ndërmjet dy krizave qëndron tek politikat ekonomike e financiare të aplikuara për përbalimin dhe daljen prej tyre. Thelbi dhe synimi kryesor i politikave “anti-krizë” gjatë viteve 2007-2010 ishte krijimi “në mënyrë paqësore” i mundësive për një ringritje graduale të aktivitetit ekonomik e financiar. Në 1929, shembja e bursës së Wall Street-it u transformua në një depresion të madh të ekonomisë

e financave amerikane me pasoja negative në të gjithë botën. Si pasojë e politikës monetare tejet shtrënguese të Rezervës Federale, politikës proteksioniste amerikane dhe strategjisë “së ekuilibrit buxhetor” të ndjekur nga administrata e Presidentit Hoover, në SHBA falimentuan mbi 10 000 banka, duke shkaktuar njëkohësisht një deflacion të përgjithshëm botëror, një zhvlerësim të shumë monedhave të botës dhe një krizë të madhe 10-15 vjeçare në tregtinë botërore.

Krejt e kundërta ndodhi në vitin 2009. Të nesërmen e falimentimit të bankës Lehman Brothers, si pasojë edhe e mësimëve të krizës së viteve 1929-33, politikat ekonomike, financiare e monetare në pothuajse të gjithë vendet e botës u përqendruan në tre prioritete bazë : (1) shpëtimi i bankave (u mobilizuan mbi 17 000 miliard dollarë në shkallë botërore); (2) mbështetja e biznesit dhe punësimit nëpërmjet shpenzimeve publike (vetëm vendet e zhvilluara dhe ato me ekonomi emergjente shpenzuan rreth 5000 miliard dollarë për këtë qëllim); (3) dënimi dhe frenimi i çdo lloji forme proteksionizmi individual dhe kërkimi i zgjidhjeve në mënyrë sa më globale (takimet e shpeshta të G7, G dhe G20).

Literatura

Van der Yeught, “Une histoire de Wall Street”, Edition ESKA 2009, Paris.

Sobel, Robert (1988). *Panic on Wall Street: A Classic History of America's Financial Disasters*. New York: Dutton.

SAPIR J. (2000b), “L'ordre démocratique et les apories du libéralisme”, *Les Temps Modernes*, n° 610, septembre-novembre 2000, pp. 309-331.

Naomi Klein « *La Stratégie du choc : la montée d'un capitalisme du désastre* » [« The Shock doctrine. The rise of disaster capitalism »], Léméac/Actes Sud, Paris, 2008, 669 p.,

Murray N. Rothbard. *A History of Money and Banking in the United States: The Colonial Era to World War II*. Publisher : Ludwig Von Misses Institute, 2002, Hardcover, 560 p.

Mishkin Frederic, “Monnaie, banque et marchés financiers”, Pearson Education France 2010, 960 pages.

Kindleberger et Robert Aliber, *Manias, Panics, and Crashes: A History of Financial Crises (5th ed.)*, John Wiley & Sons, Hoboken, New Jersey, 2005

John Kenneth Galbraith, *La Crise économique de 1929, anatomie d'une catastrophe financière*, Payot, 1989

Hans-Peter Martin et Harald Schumann, « Le Piège de la mondialisation », Actes Sud (novembre 2000).

Charles Kindleberger, 1986, *La Grande Crise Mondiale 1929-1939*, Economica première édition 1973

Ben Bernanke, *Essays on the Great Depression*, Princeton University Press, 2005

Ari shqiptar në labirintet diplomatike _____

_____ Prof.Dr. Ksenofon Krisafi, UET _____

ABSTRAKT. Rikthimi i rezervës së ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë u vlerësua si një ndër çështjet që duhet të trajtohej me përparësi nga ana e diplomacisë shqiptare qysh në ditët e para pas çlirimit të vendit ishte. Politika dhe diplomacia e qeverisë së Shqipërisë së porsadalë nga lufta do të angazhoheshin për një kohë gati gjysëmshkulllore për trajtimin e këtij problemi me karakter ekonomiko-financiar, por me rëndësi të veçantë. Rikthimi i rezervës së saj në ar, apo arit shqiptar, siç ka hyrë në historinë e diplomacisë shqiptare, imponohet si imperativ për rifillimin nga puna të Bankës Kombëtare të Shqipërisë si dhe për garantimin e veprimtarisë normale të këtij institucioni të rëndësishëm bankar. Në kundërshtim me përcaktimet e Statutit të saj, ajo ishte transferuar nga Tirana në Romë.

Përpjekjet për kthimin e arit shqiptar ishin pjesë e tratativave të shumta për zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga pushtimi fashist i Shqipërisë prej fuqive të Boshtit, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Çështja e rikthimit të arit të grabitur, mund të konsiderohet si një ndër kapitujt e rëndësishëm të historisë moderne të diplomacisë shqiptare. Për faktin që formalisht ngërthente një numër elementësh të karakterit teknik, ajo u përdor si kanal i favorshëm komunikimi me faktorët ndërkombëtarë vendimmarrës të kohës, duke synuar ndërkohë të kontribuonte në thyerjen e izolimit të Shqipërisë. Nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutime në forume ndërkombëtare, furnizimit të dokumentacionit provues, parashtrimit dhe argumentimit të pozitës dhe të pretendimeve të saj, diplomacia e shtetit shqiptar të pasluftës përpigjej të afirmonte ekzistencën e tij normale dhe të jepte imazhet e personalitetit të një subjekti që përmbushte kriteret e domosdoshëm politikë e juridikë.

Ari shqiptar, për të cilin flitet në vijim të këtij shkrimi, u mor në fillim nga autoritetet fashiste italiane dhe në vijim nga autoritetet ushtarake të Gjermanisë naziste. Ai nuk ishte ari i ish familjes mbretërore, të Ahmet Zogut, sikurse mendohet ngandonjëherë gabimisht. Ari ishte produkt i natyrshëm i veprimtarisë së zakonshme të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, aktiviteti i së cilës nisi në vjeshtën e vitit 1925.¹ Ishte kapitalizimi i punës dhe i sakrificave,

¹ Për më gjerë rreth Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe çështjes së arit monetar shqiptar shih Ksenofon Krisafi Në kërkim të arit, historia e arit shqiptar të rrëmbyer gjatë Luftës së Dytë Botërore, Dita 2000, UET-PRESS, Tiranë, 2009

i kursimeve dhe i privacioneve të shumë brezave të popullit shqiptar. Banka, nëpërmjet politikave që adoptoi, tërhoqi në depozitat e saj sasira të konsiderueshme ari e monedhash që ndodheshin e përdorreshin në tregun shqiptar përpara fillimit të veprimtarisë, grumbulloi objekte zbukurimi e prodhime të tjera metalesh me vlerë, ar, argjend e platin, si dhe mbledhi valutën që dërgonin në atdhe shqiptarët e mërguar. Kjo rezervë arrinte së paku në 8.062.827 fr. ari.²

Rikthimi i arit shqiptar, për të cilën do të flitet me hollësi në faqet vijuese, u bë objekt diskutimesh në Konferencën e Pages në Paris, 1946, u pasqyrua në dispozitat e Traktatit të Pages me Italinë, vazhdoi të trajtohej më tej me palën italiane, me palën britanike dhe u shqyrtua nga një varg institucioneesh të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë arbitrazhin ndërkombëtar dhe Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Autoritetet naziste gjermane në Bankën Kombëtare të Shqipërisë

Nga selitë e Bankës së Romës dhe të Bankës së Italisë më 16 shtator 1943, u transferua për në Gjermani një sasi prej 2 338,7565 kg ar shqiptar.³ Sasia e mësipërme përbëhej nga 24 qeska (çanta) me monedha ari me një vlerë prej 435 070 franga ari dhe 78 qeska (çanta) me shufra dhe lingota ari me një vlerë prej 7 627 756, 90 franga ari.⁴ Kurse 116, 118 kg ar u mor nga pushtuesit gjermanë në Tiranë. Ajo përbehej nga sasira ari të të grabitura ose të marra me dhunë prej autoriteteve gjermane të pushtimit, legatës e konsullatës gjermane dhe institucioneve të tjera pushtuese. Në total sasia e arit të grabitur nga nazistët gjermanë në Romë, më 16 shtator 1943 dhe në Tiranë, në vitin 1944 arrinte në 2 454, 8745 kg ar.⁵

Bashkë me rezervën e arit shqiptar prej 8 062 826, 90 fr. ari në atë kohë, në Romë u mor rezerva e kartmonedhave me peshë rreth 12 tonë, në shumën 120 523 902 franga shqiptare, si dhe gjithë klishtët e stampimit të kartmonedhave.⁶

Klishtët, ari dhe devizat u depozituan fillimisht në Berlin, në Reichsbank, “për qëllime politike dhe ushtarake”, ndërsa kartmonedhat do të niseshin për në Shqipëri.⁷

² Po aty.

³ Sipas Alessandro Roselli, Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period, Botuar në 2006 nga I.B.Tauris & Co.Ltd, London, fq. 130.

⁴ Telegram shifër i ambasadës gjermane në Romë, dërguar MPJ të Gjermanisë, më datë 16 shtator 1943, material i Arkivit të MPJ të Gjermanisë, i depozituar në arkivin e MPJ të Shqipërisë, citohet sipas Pirro Vito, Historia e grabitjes së arit monetar shqiptar, Temë disertacioni, Kopje e depozituar në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ) të Shqipërisë, Kapitulli I, fq. 5.

⁵ Sipas Décision de la Commission Tripartite pour la Restitution de l'Or Monétaire, prise le 17 novembre 1950, concernant les demandes de restitution du Gouvernement Italien et du Gouvernement Albanais de 2,338,7565 kgs d'or fin pris à Rome, le 16 septembre 1943, par les allemands, p.1

⁶ Iljaz Fishta dhe Esmeralda Uruçi, në Historia e Bankës Qëndrore në Shqipëri, Tiranë, 2003, fq. 62-63 dhe sipas Pirro Vito, ibid., kapitulli I, fq. 6.

⁷ Iljaz Fishta, Esmeralda Uruçi, ibid., ff. 62-63.

“Legalizimi” fiktiv i grabitjes së Arit të rrëmbyer në Romë

Operacioni i grabitjes së arit nga Roma dhe transportimi i tij në Berlin, nuk iu njoftua të ashtuquajturve autoritete shqiptare as edhe drejtuesve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Pak më vonë funksionari gjerman, Nojbaher, do t’iu tregonte shqiptarëve të vërtetën e depozitimit të arit shqiptar në Berlin, duke pohuar se ajo ndodhej në një vend të sigurt.⁸

Në shkurt 1944, një delegacion shqiptar, që kryesohej nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Vehbi Frashëri, shkoi në Berlin. Në përfundim të bisedimeve të zhvilluara prej 4 deri 6 prill 1944, midis përfaqësuesve shqiptare dhe atyre gjermanë, u nënshkrua një protokoll sekret, sipas të cilit Gjermania njihnte formalisht pronësinë shqiptare të arit, që do të vazhdonte të qëndronte në Gjermani në emër të Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Sipas një procesverbali që i bashkëngjitej Protokollit, tërësia e arit shqiptar, u ambalazhua në 55 arkëza, me inicialet AN 1 deri në AN 55 dhe u vendos në depot e Reichbankut, si ar që i përkiste Drejtorisë Qëndrore të Bankës Kombëtare të Shqipërisë.⁹

Kështu, ari monetar shqiptar mbeti në Gjermani dhe u zhvendos së bashku me gjithë depozitat e Reichbankut nga Berlioni në tunelet e minierës së kripës në Kaiseroda, në Merkers, në jug të qytetit të Muelhausen, ku u gjet nga forcat aleate në prill të vitit 1945.

Përpjekjet për marrjen e arit nga Italia

Qeveria shqiptare e ardhur në fuqi pas çlirimit të vendit filloi demarshet për kërkimin e arit që u grabit nga pushtuesit e huaj dhe rikthimin e tij në atdhe. Rivendikimet e para u drejtuan natyrshëm ndaj Italisë. Autoritetet civile e ushtarake italiane, vunë dorë edhe mbi arin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Ato mblodhën gjithashtu nga popullata dhe çuan në Itali sasira të rëndësishme ari, argjendi, stolish, arturinash, objektesh prej ari, argjendi, platini etj.

Kërkesat e veta ndaj Italisë për restitucionin e arit monetar, qeveria shqiptare ia paraqiti *Konferencës së Pages me Italinë* dhe aletatët e tjerë të Gjermanisë naziste, e cila zhvilloi punimet në Paris, prej 29 korrikut deri më 15 tetor 1946. Në seancën e 9 tetorit 1946 të kësaj Konference delegacioni shqiptar propozoi që në tekstin e Projekttraktatit të Paqës me Italinë, të fiksohej detyrimi i qeverisë italiane për t’i kthyer Shqipërisë rezervën e arit të ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë, propozim i cili u kundërshtua nga përfaqësuesit e disa vendeve.¹⁰ Thelbi i qëndrimit kundër shfaqet qartë në fjalët e njerit prej pjesëmarrësve në Konferencë, i cili tha ndër të tjera:

⁸ Sipas Pirro Vito, vep.cit., Kapitulli I, f. 9.

⁹ Sipas P. Vito, vep.cit. f.13.

¹⁰ Shih Recueil des Traités - Traités et accords internationaux enregistrés ou classés et inscrits au Répertoire du Secrétariat de l’Organisation des Nations Unies, Volume 49, 1950, I Nr. 747 më poshtë do të citohet Recueil de l’ONU... Volume IV, ff. 105-108.

„... Traktati do të duhej të vendoste një rregull të përgjithshëm përsa i përket detyrimit të Italisë për të kthyer arin monetar. Propozimi shqiptar i imponon Italisë detyrimin absolut që të kthejë arin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, pa patur parasysh çështjen në se faktet në lidhje me kërkesën e Shqipërisë ose zbatimin e këtyre fakteve sipas rregullit të përgjithshëm të vendosur nga paragrafi 8 i nenit 65 do të justifikojnë rivënien e Shqipërisë tërësisht në posedimin e arit të mbajtur nga Italia”.¹¹ Në fakt delegacioni shqiptar, përpara se të bënte propozimin e mësipërm iu kishte paraqitur organeve përkatëse të Konferencës fakte e të dhëna, për pronësinë e arit të grabitur në Shqipëri nga fashistët italianë, të cilat të shqyrtuara më vonë nga organe të tjera ndërkombëtare, u konsideruan të plota e bindëse. Kërkesa shqiptare për arin monetar që detyrohej Italia nuk u shqyrtua nga Konferenca e Paqes. Megjithatë ajo gjeti pasqyrim në Traktatin e Paqes. Neni 75/8 i tij i jepte fuqi juridike kërkesës shqiptare për t’u vënë në posedim të arit në fjalë. Në të thuhej :“ Qeveria italiane do t’i kthejë qeverisë së kombit të bashkuar të interesuar të gjithë arin monetar që ka pasë qënë objekt grabitjeje nga Italia apo që ishte transferuar padrejtësisht në Itali, ose do t’i livrojë qeverisë së kombit të bashkuar të interesuar një sasi ari të barabartë në peshë dhe në titull me sasinë e grabitur apo të transferuar padrejtësisht. Qeveria italiane pranon që ky detyrim nuk preket nga transferimet ose rrëmbimet e arit që kanë mundur të kryhen në territorin italian në dobi të ndonjë fuqie të Aksit (Boshtit fashist- K.K.) ose të ndonjë vendi neutral”.¹²

Qeveria shqiptare, mendonte se kjo dispozitë, e interpretuar në kontekstin e paragrafit të dytë të nenit 29 të Traktatit të Paqes, e mbështeste kërkesën e saj për restitucionin e arit monetar. Ai thoshte se “klauzolat ekonomike të këtij Traktati, të cilat mund të kenë vlerë për Fuqitë Aleate e Shoqe do të aplikohen edhe në pasuritë e tjera italiane si dhe për marrëdhëniet e tjera ekonomike midis Shqipërisë dhe Italisë”¹³. Mbështetur në sa më sipër, me notën e 19 shkurtit 1948, që iu dorëzua qeverisë italiane më 11 mars 1948,¹⁴ kërkohej sasia e plotë e arit të grabitur, duke theksuar se ari që Shqipëria mund të merrte eventualisht nga Gjermania, do të zbritej nga kjo masë. Kërkesa u përsërit edhe në negociatat shqiptaro-italiane gjatë viteve 1954-1957. Për shkak se insistimi për përmbushjen e saj rrezikonte të bllokonte krejt bisedimet, si dhe nisur nga fakti se çështja po trajtohej paralelisht edhe në organizma të tjera ndërkombëtare, qeveria shqiptare hoqi dorë përkohësisht nga kërkesa e vet. Më 2 prill 1956, qeveria shqiptare i transmetoi Romës rezervën e saj për nenin 75 paragrafi 8, të Traktatit të Paqes në lidhje me arin monetar, çështje që ajo mund ta ngrinte në të ardhmen, në se do ta quante oportune.¹⁵

¹¹ Po aty, Vol.II, f. 475.

¹² Shih Recueil ..., Vol. 49, 1950, I No. 747, f.40, Vol. 49, 1950, I. No. 747.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

Përpjekjet në drejtim të Gjermanisë

Siç u tha autoritetet shqiptare kishin filluar dhe vazhdonin përpjekjet edhe në drejtim të Gjermanisë krahas demarsheve me palën italiane. Arsyeja kishte të bënte me faktin që rezerva në ar e Bankës Kombëtare të Shqipërisë, e cila mbahej në Romë, siç u tha, u grabit nga gjermanët dhe u transferua në Gjermani, për t'u depozituar në stokun e përgjithshëm, të formuar nga sasitë e arit që gjermanët grabitën në vendet e pushtuara prej tyre.

Ari shqiptar në tunelet e minierës së kripës në Merkers

Në fillim të prillit të vitit 1945, ushtritë e Armatës së Tretë të forcave amerikane që thyen rezistencën e trupave gjermane në frontin e perëndimit, ndaluan në minierën e kripës në Kaiseroda, në Merkers, në jug të qytetit të Muelhausen. Kur hynë në tunelet e minierës ushtarët zbuluan 31 depo ku ruhej një stok i konsiderueshëm ari e argjendi. Aty Gjermania naziste kishte depozituar 297 tonë ar dhe 377 tonë argjend si dhe arka të shumta me monedha ari, miliona marka gjermane, sasira të mëdha valutash të huaja si dollarë USA, franga franceze, lira angleze, monedha spanjolle, portugeze, turke, norvegjeze, një thesar të konsiderueshëm me gurë të çmuar, diamante, arturina dhe metale me vlerë etj. Hitleri kishte përdorur për financimin e luftës mbi 637 tonë ar.¹⁶

Kjo pjesë e thesarit të Reichsbankës gjermane e inventarizuar nga Ushtria amerikane, me asistencën e zyrtarëve kompetentë të Thesarit amerikan, kishte vlerën e 238.5 milionë USD, që e konvertuar në kursin e pasluftës arrinte në 2.5 miliardë USD. Në ditët në vijim forcat ushtarake amerikane zbuluan në degët e Reichsbankës edhe një tjetër sasi ari në vlerën prej 14 milionë USD si dhe në vende të tjera një sasi prej 9.7 milionë USD.

Depozita u vendos në ndërtesën e Reichsbankës në Frankfurt, në ruajtjen dhe në përgjegjësinë e Foreign Exchange Depository (FED), e cila në bashkëpunim me qeveritë e tjera aleate, me autoritetet e pushtimit dhe me Komisionin Tripalësh të Arit, realizoi inventarizimin fizik të thesarit të zbuluar dhe mori masat e nevojshme organizative për shpërndarjen e tij tek shtetet e interesuar.¹⁷

Sipas vlerësimeve amerikane, rezulton se gjermanët kishin grabitur thesarin e 11 shteteve europiane që okupuan gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ata rrëmbyen dhe depozituan në Gjermani apo vende të tjera të deklaruara neutrale gjatë Luftës, një sasi prej 579 milionë USD të asaj kohe, që në ditët tona vlerësohej në 5.6 miliardë USD.¹⁸

Në Merkers, bashkë me arin e rrëmbyer në Austri, Çekosllovaki, Poloni, Jugosllavi, Francë, Belgjikë, Holandë, Rumani, Hungari, Itali etj., ndodhej edhe një pjesë e arit

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Sipas Holocaust Era Research Collections, "Records of the Tripartite Commission for the Restitution of Monetary Gold, 1946-1998", LexisNexis, Compilation by Congressional Information Service, Inc, 2002, f. V.

¹⁸ Sipas Les transactions sur l'or pendant la Seconde Guerre Mondiale: Vue d'ensemble avec les statistiques et commentaires, Une contribution à la Conférence de Londres sur l'or nazi, Londres, 2-4 décembre 1997, Berne, 1977.

shqiptar, që ishte marrë nga italianët e gjermanët. U provua se në depozitat e Merkersit, ishin vendosur edhe 55 arkëzat me arin shqiptar, që ishte thesari i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, i grabitur nga nazistët në Romë, në shtator 1943.

Kërkesa drejtuar autoriteteve ndërkombëtare

Qeveria shqiptare po punonte të realizonte kthimin e arit. Ajo po grumbullonte dokumentacionin e nevojshëm për t'ia përcjellë organizmave ndërkombëtare përkatëse që u ngritën për të administruar dhe shpërndarë depozitën e arit, e cila u gjet në Gjermani në mbarim të Luftës së Dytë Botërore. Pasi mori njoftim për zbulimin e arit në galeritë e minierave të kriposës së Merkersit, ajo iu drejtua menjëherë *Komisionit të Reparacioneve*, i cili e kishte selinë në Moskë dhe më pas Konferencës së Reparacioneve, që u mbledh në Paris, në nëntor-dhjetor 1945. Në seancën e 21 nëntorit 1945, Konferenca e Reparacioneve shqyrtoi kërkesën shqiptare dhe e gjykoi me vend që ta pranonte Shqipërinë si antare të saj me të drejta të plota. Ky vendim, i pari i kësaj natyre në ato kohë, ishte një konfirmim zyrtar kolektiv, qoftë edhe i tërthortë, i pjesëmarrjes së popullit shqiptar në Koalicionin Antifashist të popujve përkrah aleatëve të mëdhenj.

Konferenca e Parisit përgatiti Marrëveshjen e reparacioneve, që u nënshkrua më 14 janar 1946. Ajo përmbante në pjesën e tretë një nen të titulluar «Restitucioni i arit monetar». Dispozita e mësipërme i kushtohej çështjes së arit dhe përcaktonte se ari që do të gjendej në Gjermani, do të grumbullohej dhe do të shpërndahej si restitucion midis vendeve të pranura për të përfituar, në përputhje me humbjet përkatëse të shkaktuara nga grabitjet e autoriteteve ushtarake apo civile gjermane.¹⁹

Në bazë të kësaj marrëveshjeje u krijua Komisioni Tripalësh i Arit Monetar, që filloi nga puna, në Bruksel, më 27 shtator 1946, i cili do të merrej me shpërndarjen e arit që ishte grabitur nga Gjermania apo që ishte transferuar në territorin e saj. Vendet e ndryshme duhet t'iu transmetonin qeverive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Francës dhe të Mbretërisë së Bashkuar, me cilësinë e anëtarëve të Komisionit Tripalësh për Arin, të dhëna mbi arin e grabitur nga Gjermania.²⁰ Qeveritë e mësipërme do të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të grumbulluar gjithë sasinë e arit që mund të gjendej si dhe do të organizonin ndarjen e tij, në konformitet me dispozitat e kësaj pjese.²¹

Komisioni Tripalësh i Arit arriti në një kohë relativisht të shkurtër të identifikonte dhe të grumbullonte sasira të konsiderueshme ari në Gjermani ose në vende të treta, ku

¹⁹ Agence Interalliée des Réparations, Premier rapport du Secrétaire Général pour l'année 1946, f.50.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

ishite transferuar nga autoritetet pushtuese gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore.²²

Ari i gjetur u depozitua në Federal Reserv Bank of New York dhe në Bank of England. Një pjesë e tij u depozitua dhe u mbajt në Foreign Exchange Depositary në Frankfurt, duke iu besuar në ruajtje autoriteteve ushtarake të SHBA.²³

Pas fillimit të veprimtarisë Komisioni bëri shpërndarjet e para të arit. Në shkurt të vitit 1948 mbërriti në Tiranë nga Brukseli njoftimi se më 13.2.1948, Asambleja e Agjencisë Ndëraleate të Reparacioneve kishte adoptuar një rezolutë në lidhje me kthimin e devizave shqiptare të kërkuara.²⁴ Njoftohej gjithashtu se dokumentet e paraqitura nga autoritetet shqiptare për arin, Komisioni Tripalësh i Arit Monetar i konsideronte të rregullta.²⁵ Në seancën e 13 shkurtit 1948, Komisioni mori vendimin e parë për Shqipërinë, duke i caktuar asaj 350. 858,7 kg ar, sasi e cila më 16 shkurt 1948, u shtua në 1.104, 2606 kg.²⁶ Më 3 qershor 1948, ari që do të merrte Shqipëria u shtua edhe me 17,1911 kg dhe arriti në 1121.4517 kg. Kjo nuk ishte e gjithë sasia që kërkohej prej saj. Siç thuhej aso kohe, ari shqiptar ishte gjetur dhe identifikuar i tëri. Por, do të zbatohej rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit të gjithë shteteve që kërkonin arin e grabitur nga Gjermania, do t'u jepej vetëm një pjesë e tij. Shqipëria mund ta merrte sasinë e caktuar, në ar të pastër, në Londër, veçse duhet të njoftonte pa vonesë Komisionin Tripalësh të Arit për preferencat e saj konkrete.²⁷ Mirëpo, pikërisht kur autoritetet shqiptare po përgatiteshin të ndërmerrnin dhe plotësonin procedurat për marrjen e tij, u shfaqën papritmas një varg komplikacionesh.

²² Ndarja e arit filloi në vitin 1947 dhe vazhdoi deri në 22 tetor 1996, kur Shqipëria, shteti i fundit, tërhoqi pjesën e vet. Pas këtij veprimi do të mbetej ende në dispozicion të Komisionit edhe rreth 5 tonë e gjysëm ar i pashpërndarë,. Zyrtarë, akademikë etj. nga 41 shtete dhe përfaqësues të disa organizatave çifute, të mbledhur në Londër, në 2-4 dhjetor të vitit 1997, kërkuan që ai të përdorej për financimin e veprimtarive të një fondacioni dhe të nevojave të familjeve të persektuara. Shpërndarjet e fundit të sasisë së mbetur prej 179 920, 311 once ar, nga Komisioni Tripalësh i Arit u bënë gjatë vitit 1998, midis 22 prillit deri në 13 korrik 1998, sipas kërkesave të shteteve përfitues. Mbeti ende pa u shpërndarë edhe 33 612, 04 kg ar që i përkiste ish Jugosllavisë, e cila u la në ruajtje nga tre qeveritë në Bankën e Anglisë, deri në arritjen e marrëveshjes midis shteteve sukseduese të ish Jugosllavisë.

Pas shpërndarjeve të fundit Komisioni Tripalësh i Arit, më 9 shtator 1998, në një ceremoni solemne të zhvilluar në Ke d'Orsei, në Paris, shpalli zyrtarisht mbarimin e veprimtarisë dhe të ekzistencës së vet. Dokumentacioni dhe arkivat, që pasqyronin veprimtarinë 52 vjeçare të Komisionit, të ambalazuara në 110 kartona, u transferuan në Arkivin Kombëtar të Francës. Në arkivat e Komisionit Tripalësh të Arit, janë identifikuar së paku 7 kutia (bokse) me dokumente që kanë të bëjnë me kërkesën shqiptare.

²³ Është përlogaritur se prej fillimit të veprimtarisë së Komisionit Tripalësh të Arit, më 27 shtator 1946, deri në operacionet më të fundit, livrimin e arit Shqipërisë, më 29 tetor 1996, sasia e përgjithshme e arit të identifikuar dhe të vënë në dispozicion të tij, arriti në 10 817 021,139 once, e cila vlerësohet në 336 446, 0667 kg ar i pastër (me kursin 1 kg ar baras me 32, 1507465 once).Depozita e arit u deklarua e mbyllur përfundimisht nga përfaqësuesit e të tre qeverive më 13 korrik 1998Final Report, Tripartite Commission for the restitution of Monetary Gold, Brussels (September 13, 1998), f. 2.

²⁴ AMPJ Fondi IARA,D.Nr.17,v.1948.

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Shih notën CC/ALB, Nr. 488, të 30 qershorit 1948 të KTA, në Arkivin e MPJ, Dosja e Arit monetar.

Italia pretendonte arin shqiptar

Në vitin 1947, para se Komisioni të vendoste për fatin e kërkesës shqiptare, në Sekretariatin e tij mbërriti një letër nga Italia, e cila e njoftonte Komisionin që të refuzonte kërkesën e qeverisë shqiptare si të pabazuar, pasi ari që pretendohet prej saj ishte i Italisë, për shkak se thesari i Bankës Kombëtare të Shqipërisë u formua në vitin 1925, mbi bazën e kapitaleve të investuara nga një grup financiar italian.

Autoritetet shqiptare, të cilave po iu krijoheshin vështirësi të tjera, mbledhën dhe paraqitën në Sekretariatin e Komisionit Tripalësh të Arit Monetar provat e nevojshme që përgënjeshtrojnë pretendimet italiane. Në dosjen e dorëzuar nga qeveria shqiptare kishte një material voluminoz që bënte fjalë për historikun e krijimit të Bankës, për veprimtarinë dhe rolin e saj në jetën politike dhe ekonomiko-financiare të Shqipërisë gjatë periudhës 1925-1943 etj. Qeveria shqiptare provonte se ari që gjermanët grabitën në Romë e që reklamohej prej qeverisë italiane ishte pronë e popullit shqiptar, ishte mbulesa e biletave bankare që Banka Kombëtare Shqiptare kishte vënë në qarkullim.

Mirëpo, edhe pse Komisioni Tripalësh i Arit Monetar i gjeti të besueshme provat dhe argumentat e paraqitura nga qeveria shqiptare, njoftoi se çështja e transferimit të arit në Shqipëri do të mbetej ende pezull, pasi qeveria italiane kishte paraqitur pretendime “të reja”, të cilat duheshin studiuar.²⁸ Përgjigja e mësipërme ngjalli pakënaqësi dhe reagime të ashpra të qeveria shqiptare. Pas një vit e gjysëm heshtjeje Komisioni njoftoi zyrtarisht qeverinë shqiptare se zbatimi i vendimeve do të pezullohej, pasi për arin që i ishte caktuar asaj kishin lindur pretendime nga të tretë.²⁹

Qeveria italiane kishte përsëritur pretendimin për pronësinë e arit shqiptar. Për këtë arsye ai e shpalli veten inkompetent dhe ia referoi çështjen për zgjidhje qeverive të SHBA, Britanisë së Madhe dhe të Francës. Kërkesat e Italisë, në një farë kuptimi, i referoheshin një gjëje të gjykuar, pasi Komisioni kur kishte adoptuar vendimet e shkurtit, marsit dhe qershorit 1948 në favor të Shqipërisë, kishte shqyrtuar dhe nuk i kishte marrë në konsideratë rivendikimet italiane të parashtruara gjatë viteve 1946 dhe 1947. Në pretendimet e përsëritura të Italisë, rezultonte se nuk kishte asnjë element të ri që mund të shërbente si motiv për rishikimin e vendimeve të vitit 1948.³⁰

Qeveria shqiptare ndërhyri sërish, duke i kërkuar Komisionit Tripalësh të Arit respektimin e dispozitave të Marrëveshjes së krijimit të tij dhe zbatimin e vendimeve që kish marrë në favor të Shqipërisë, në vitin 1948.³¹

Shpallja e inkompetencës së Komisionit Tripalësh të Arit dhe kalimi i çështjes

²⁸ Po aty.

²⁹ Sipas Décision de la Commission Tripartite pour la restitution de l'Or Monétaire, prise le 17 novembre 1950, concernant les demandes de restitution du gouvernement italien et du gouvernement albanais de 2 338, 7565 kgs d'or fin pris à Rome, le 16 septembre 1943 par les allemands, f. 16, në Arkivin e MPJ, Fondi i Arit monetar shqiptar, dosja 16 e vitit 1958.

³⁰ Sipas Pirro Vito, vep.cit. Kapitulli VI, f. 15.

³¹ Shih tekstin e notave përkatëse të 26 shkurtit 1951 dhe 3 majit 1951, në Arkivin e MPJ, Fondi i Arit monetar shqiptar, dosja 16, e vitit 1951.

për shqyrtim qeverive të SHBA, Britanisë së Madhe dhe të Francës, do ta pezullonte për një kohë të gjatë, angazhimin e tij institucional. Qeveritë e lartpërmendura e gjykuan të udhës që konflikti italo-shqiptar për përkatësinë e arit, të bëhej objekt shqyrtimi i procedurave gjyqësore ndërkombëtare. Kjo u sanksionua përfundimisht me Marrëveshjen e Uashingtonit, të 25 prillit 1951,³² e cila stipulonte kalimin e çështjes për gjykim në arbitrazhin ndërkombëtar. Gjyqtari zviceran George Sauser Hall, i caktuar për shqyrtimin e çështjes, më 19 shtator 1951 deklaroi mbylljen e hetimit, kurse më 20 shkurt 1953 shpalli vendimin, sipas të cilit rezultonte e provuar që 2 338, 7565 kg ar monetar, që ishte grabitur nga gjermanët në Romë, në vitin 1943, i përkiste Shqipërisë në kuptimin e Pjesës së Tretë të Marrëveshjes së Parisit, të datës 14 janar 1946.³³ Pra, arbitri ndërkombëtar shpalli pronësinë e shtetit shqiptar mbi arin e pretenduar nga Italia. Tashmë nuk duhet të kishte më pengesa që Shqipëria të merrte arin që i ishte caktuar nga Komisioni. Por nuk ndodhi kështu.

Pretendimi britanik për arin shqiptar

Më 25 prill 1951, atë ditë që qeveritë e SHBA, Britanisë së Madhe dhe të Francës nënshkruan në Uashington Marrëveshjen për kalimin në arbitrazhin ndërkombëtar të mosmarrëveshjes që kishte lindur nga kontestimi italian mbi arin shqiptar, u nënshkrua gjithashtu edhe një Deklaratë, e cila iu bashkëngjit Marrëveshjes si pjesë përbërëse e saj.³⁴ Deklarata parashikonte që në qoftë se arbitri ndërkombëtar do të shprehej dakord me vendimet e Komisionit Tripalësh të Arit Monetar për arin shqiptar, ai nuk do t'i jepej Shqipërisë, por... Anglisë (!), si shpërblim i pjesshëm i dëmeve të shkaktuara në incidentin e ndodhur në Kanalin e Korfuzit në tetor të vitit 1946.³⁵ Britanikët mbështeteshin në vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të 9 prillit 1949, që e konsideronte Shqipërinë përgjegjëse për incidentin e ndodhur në Kanalin e Korfuzit, më 22 tetor 1946, ku u dëmtuan dy luftëanije dhe humbën jetën 44 oficerë e marinarë anglezë si dhe në vendimin e 15 dhjetorit 1949, me të cilin ajo u shpreh se Shqipëria duhet të shpërblente Britaninë e Madhe në shumën 843 947 sterlina.³⁶ Por, ari do t'i jepej Britanisë së Madhe vetëm nëqoftëse Shqipëria nuk do t'i drejtohej

³² Accord entre les Gouvernements de la République Française, Du Royaume-Uni de Grande Bretagne et d'Irlande du Nord et des Etats Unis d'Amérique, soumettant à un arbitre certains réclamations concernant de l'or pillé par les allemands à Rome, ff, 1-3, në Arkivin e MPJ, Fondi i Arit monetar shqiptar, dosja 16, e vitit 1951.

³³ Sipas Décision de la Commission Tripartite pour la restitution de l'Or Monétaire, prise le 17 novembre 1950, concernant les demandes de restitution du gouvernement italien et du gouvernement albanais de 2 338, 7565 kgs d'or fin pris à Rome, le 16 septembre 1943 par les allemands, f. 15, në Arkivin e MPJ, Fondi i Arit monetar shqiptar, dosja 16, e vitit 1958.

³⁴ Department of State Bulletin, Vol. 24 (1951), f. 785-787.

³⁵ Po aty.

³⁶ Cour Internationale de Justice, Recueil des arrêts, avis consultatifs et ordonnances - Affaire du Détroit de Corfou, - (Fixation du montant des réparations dues par la République Populaire d'Albanie au Royaume-Uni de Grande-Bretagne et d'Irlande du Nord) - Arrêt du 15 décembre 1949, Leyden, Société d'édition A.W.Sijthoff, ff. 244- 250

Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë brenda një afati 90 ditor nga data e shpalljes së vendimit të arbitrit ose në qoftë se Italia nuk do t'i drejtohej, po ashtu, Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të vendosur për përparësinë e pretendimeve të saj për arin shqiptar. Ka shumë gjasa të mendohet se vendimi i arbitrit ndërkombëtar në favor të Shqipërisë, i gjykuar në kontekstin e Deklaratës së Uashingtonit të 25 prillit 1951, tregon se paralel ishin ndërtuar procedura të sofistikuara juridike që në fund të fundit ari i identifikuar si pronë e Shqipërisë të mos rikthehej në Tiranë.

Pas vendimit të arbitrit, e para që reagoi ishte Italia, e cila iu drejtua Gjykatës Ndërkombëtare. Më 19 maj 1953, brenda afateve të përcaktuara në Deklaratën e Uashingtonit, qeveria italiane depozitoi në Sekretariatit e Gjykatës aktet për fillimin e procesit: "*Çështja e arit monetar të marrë në Romë në vitin 1943*". Italia kërkonte që qeveritë franceze, britanike dhe amerikane t'ia dorëzonin asaj arin monetar që i takonte Shqipërisë, për shpërblimin e pjesshëm të dëmeve që iu shkaktuan nga ligji i 13 janarit 1945 (mbi nacionalizmin e Bankës Kombëtare Shqiptare). Ajo kërkonte gjithashtu që e drejta e Italisë të kishte përparësi kundrejt pretendimit të Mbretërisë së Bashkuar për ta marrë arin për zbatimin e vendimit të incidentit të Kanalit të Korfuzit.³⁷

Në përfundim të shqyrtimit, më 15 qershor 1954, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë u shpreh se nuk mund ta zgjidhte dot çështjen sepse Shqipëria nuk e njohu juridiksionin e saj. Ajo nuk mund të merrte vendim as mbi përparësinë e pretendimeve italiane kundrejt atyre të qeverisë angleze, sepse zgjidhja e saj varej nga shqyrtimi dhe zgjidhja në themel e pretendimit të Italisë mbi arin.³⁸ Vendimi i 15 qershorit 1954 ishte ekuivalent me hedhjen poshtë të kërkesës italiane.

Ari shqiptar dhe incidenti i Kanalit të Korfuzit

Prej kësaj kohe, çështja e arit u ndërthurr me konfliktin anglo-shqiptar për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe, e bllokuar, së bashku me të, do të përshkonte dekada të tëra pa mundur të veçohej prej saj, por as edhe të zgjidhej më vete.

Në vitet '50, '60 e '70 të shekullit të kaluar pati jo pak përpjekje për gjetjen e zgjidhjeve nëpërmjet negociatave. Kjo alternativë u ideua në disa forma, si bisedime direkte midis Anglisë e Shqipërisë, midis Anglisë e Italisë apo edhe midis Anglisë, Italisë dhe Shqipërisë. Dy variantet e fundit mbetën vetëm skenarë të pazbatuar. Kurse varianti i parë u provua në vitet 1950-1951, por pa sukses.

³⁷ Cour Internationale de Justice, Recueil des arrêts, avis consultatifs et ordonnances - Affaire de l'or monétaire pris à Rome en 1943, (Question préliminaire) (Italie c. France, Royaume-Uni de Grande Bretagne et d'Irlande du Nord et Etats - Unis d'Amérique), Arrêt du 15 juin 1954, - Déclaration du Gouvernement des Etats Unis d'Amérique, Leyde, Société d'édition A.W.Sijthoff.

³⁸ Po aty.

Bisedimet e para shqiptaro-britanike, 1950-1951

Ndërkohë që Tirana negocionte direkt apo tërthorazi për plotësimin e kërkesës së saj për zgjidhjen e çështjes së arit³⁹, si dhe ndiqte procedurat me Komisionin Tripalësh të Arit, nuk linte jashtë vëmendjes edhe veprimin në drejtim të Londrës. Pikërisht në këto kohë shfaqet befasisht një episod tepër interesant në marrëdhëniet shqiptaro-britanike, të cilat fillimi i viteve '50 do t'i gjente pothuajse inekzistente. Paralel me betejën publike ideologjike Tirana kishte nisur demarshet për dialog konfidencial me Londrën për identifikimin e një zgjidhjeje të pranueshme kompromisi. I gjykuar pas rreth 50 vjetëve dhe për më tepër i vendosur në konturet e qëndrimeve të njohura dogmatike të asaj kohe ai shfaqet si një lëvizje taktike, politike e diplomatike interesante, e ideuar me elegancë të admirueshme diplomatike.

Gjatë viteve 1950 - 1951, u zhvilluan në Paris, katër raunde negociatash, për dy nga çështjet më madhore të dosjes shqiptaro-britanike, zbatimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe lidhur ngushtë me të, kthimin e arit monetar Shqipërisë. Behar Shtylla për palën shqiptare dhe Sir Eric Beckett funksionar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Komonuelthit për palën britanike, do të dialogonin dhe do të ballafaqonin mendimet e qeverive të tyre, në përpjekje për një marrëveshje zyrtare. Qëndrimet divergjente çuan në ndërprerjen e bisedimeve dhe çështja do të niste një rrugë të gjatë, duke u bërë objekt shqyrtimesh jo vetëm në instanca gjyqësore ndërkombëtare, të cilat u përshkruan më lartë, por edhe në takime të tjera diplomatike dy e shumëpalëshe.

Zhvillime problematike në Shqipëri në vitet '80

Në fillimin e viteve '80 të shekullit të kaluar Forin Ofisi kishte modifikuar disi qëndrimin e vet përsa i përkonte vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Ndryshe nga më parë, kur refuzohej ndërmarrja e çdo hapi të tillë, pa u zbatuar nga pala shqiptare vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në incidentin e Kanalit të Korfuzit, tashmë pranohej mundësia e vendosjes së tyre edhe në mungesë të zgjidhjes së kësaj çështjeje.⁴⁰

Por, fleksibilitetit të manifestuar nga Londra për fillimin e negociatave direkte të pakushtëzuara, i kundërvihej qëndrimi shqiptar që ishte kategorikisht kundër. Ai qe përcaktuar nga lideri i asaj kohe, Enver Hoxha, i cili deklaronte: "Nuk i hyjmë diskutimit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Anglinë në rast se kjo nuk ia kthen këtë pasuri (arin – shenim i autorit) popullit shqiptar."⁴¹

³⁹ Është fjala për traktativat për fillimin e bisedimeve shqiptaro-italiane për zbatimin e Traktatit të Paqes me Italinë në vitet 1948-1950, për të cilat u fol me lartë.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Enver Hoxha, Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë, Kujtime, Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982, fq.409.

Këto zhvillime përkuan me kohë tepër të rënda për Shqipërinë, cila, e asfiksuar nga politika autarkike, e mbyllur maksimalisht ndaj botës së jashtme, kishte hyrë në një periudhë vështirësish ekonomike. Jeta e shqiptarëve keqësohej vazhdimisht. Zhvillimet e brendshme problematike në Shqipëri po i ndiqnin me kujdes Britania e Madhe, Franca, SHBA dhe në përgjithësi Perëndimi, me qëllim që të ndikohej për ndryshime në politikën shqiptare. Ato mendonin të vepronin drejtëpërsëdrejti me Tiranën, duke shfrytëzuar si rrugë imediate komunikimi çështjen e arit.⁴²

Në vitin 1983, në disa organe të medias së shkruar në SHBA e më pas në Britaninë e Madhe dhe në vende të tjera perëndimore, u shfaqën lajmet e para rreth arit shqiptar. Shkruhej se amerikanët dhe britanikët ishin të gatshëm të jepnin pëlqimin në Komisionin Tripalësh për kthimin e arit shqiptar dhe e shihnin me interes të ndërsjellë rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë. Udhëheqja shqiptare, edhe pse krejtësisht e mbyllur për shkak të qëndrimeve të saj të ideologjizuara deri në ekstrem, nuk i la në heshtje sinjalet që vinin nga anglo-amerikanët. Shkaku kishte të bënte me vështirësitë tepër serioze ekonomike dhe ballafaqimin e përditshëm me pakënaqësitë e hapura brenda vendit për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të nivelit të jetesës së popullit.

Në vijim, kur interesi i palës shqiptare, i ndrojtur, i matur e tepër i rezervuar, u shfaq qartë anglo-amerikanët ndërmorrën një hap të drejtëpërdrejtë për shkrirjen e akujve në marrëdhëniet me Shqipërinë. Qeveria britanike, së bashku me qeverinë amerikane zgjodhën Francën për propozimin e dialogut me qeverinë shqiptare.

Bisedimet shqiptaro-britanike në Paris, 1985

Më 20 prill 1984, ambasadori francez në Tiranë, në një takim të kërkuar prej tij, i dorëzoi zëvendesministrit të jashtëm shqiptar, Sokrat Plaka një copë letër, pa titull, pa datë, pa firmë e pa vulë, diçka jo shumë e zakonitë në praktikën diplomatike, që spontanisht do të merrte emrin konvencional "Propozimi prej 7 pikësh". Në të thuhej se

"Qeveria franceze është e lutur nga ana e qeverive të SHBA dhe të Britanisë së Madhe që të ngrejë para Qeverisë Suaj mundësinë e zgjidhjes së çështjes që ka të bëjë me dhënien Shqipërisë të arit të caktuar për të. Elementët e këtij propozimi janë:

I.- Komisioni Tripalësh për Arin do t'i caktonte Qeverisë së Shqipërisë rreth 1 574 kilogramë ar, që është "identifikuar për t'iu dhënë asaj që më parë" (me një vlerë prej rreth 20 milionë dollarësh amerikanë, me çmimin e tregut të tanishëm).

II.- Kur të jepet ari, Shqipëria do të plotësojë për Komisionin Tripalësh dokumentet standarde të marrjes dhe livrimit (që janë plotësuar nga të gjithë marrësit e arit të mbajtur nga Komisioni Tripalësh).

III.- Njëkohësisht, por pa lidhje me livrimin e arit, Shqipëria do t'i paguajë, ose

⁴² BoE, 3°150/9, FO telegram, 5 November 1982; citohet sipas Alessandro Roselli, Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period, Botuar në 2006 nga I.B.Tauris & Co.Ltd, London, p. 141-142.

do t'i bëjë pagesën (nëpërmjet një pale të tretë) Qeverisë amerikane të një shume minimale (më pak se dy millionë dollarë amerikanë) në lidhje me pretendimet për shpronësimin e papaguar të pasurisë amerikane.

IV.- Njëkohësisht, por pa lidhje me livrimin e arit, Shqipëria do t'i paguajë, ose do t'i bëjë pagesën Qeverisë britanike të një shume minimale (më pak se ekuivalentin në sterlina të dy milionë dollarëve amerikanë) në lidhje me shpërblimin e papaguar të caktuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në favor të Britanisë së Madhe.

V.- Njëkohësisht me marrjen e shumës së saj, Qeveria amerikane do t'i konfirmojë Shqipërisë në mënyrë të njëanshme, me shkrim, që kjo pagesë përbën një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare të pretendimeve amerikane për shpronësimin.

VI.- Njëkohësisht me marrjen e shumës së saj, Qeveria e Britanisë së Madhe do t'i konfirmojë Shqipërisë në mënyrë të njëanshme, me shkrim, që kjo pagesë përbën një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare të shpërblimit të caktuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

VII.- Shqipëria nuk është e domosdoshme të nënshkruajë asnjë dokument që do të njihte vlefshmërinë e pretendimeve amerikane e britanike, apo të ndonjë roli për rregullimin e këtyre pretendimeve.

VIII.- Nuk do të ketë kushte të tjera lidhur me këtë ofertë, por Qeveria franceze nuk është në gjendje të vlerësojë se për sa kohë do të ishin të vlefshme keto kushte. Qeveria franceze e kupton se ato nuk do të vazhdonin për një kohë të pafund dhe në qoftë se Qeveria shqiptare nuk do t'i pranojë kushtet e kësaj oferte, Qeveria amerikane dhe Qeveria britanike do të rezervonin të drejtën të rishikonin pozitën e tyre.”⁴³

Propozimi u përkthye me urgjencë të veçantë dhe, i shoqëruar me një informacion të shkurtër, tepër i rezervuar në komente apo shfaqje mendimesh, iu përcoll përnjëherësh Enver Hoxhës, Sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Ramiz Alisë, Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Adil Carçanit, Kryetar i Këshillit të Ministrave.

Reagimi ishte i shpejtë dhe i menjëhershëm në sensin pozitiv. U vendos të ngrihej një grup pune, i përbërë nga disa prej specialistëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Grupi duhet ta studionte “Propozimin prej 7 pikësh”, me predispozicionin e gjetjes së pikave të takimit, pa përjashtuar mundësinë e kundërpropozimeve për modifikime eventuale të çështjeve që trajtoheshin në të.⁴⁴ Atij iu la të kuptonte se duhet të eksploronte mundësitë e fillimit të bisedimeve direkte me anglezët, duke sugjeruar edhe mendime rreth qëndrimit që duhej mbajtur.

U bë e qartë se qëndrimi në parim pritej të ishte pohues. Ai tashmë ishte përcaktuar

⁴³ Propozim i ambasadorit francez në Tiranë Marcel Martin, dorëzuar Zv.ministrit të Punëve të Jashtme, Sokrat Plaka, më 20 prill 1984, në Arkivi i MPJ, Fondi i Arit Monetar, Dosja e vitit 1984.

⁴⁴ Autori ka qënë pjesëtar i grupit të punës së MPJ dhe anëtar i delegacionit shqiptar në bisedimet e viteve 1985-1992. Ai ruan në arkivin personal kopje origjinale të “Propozimit prej 7 pikësh”, të propozimeve, të memorandumeve dhe të dokumenteve të ndryshme të shkëmbyera me ambasadën franceze dhe palën britanike, të procesverbaleve të bisedimeve shqiptaro-britanike, etj. Hollësitë e përmendura si dhe citimet e dokumentave etj, i referohen pikërisht këtij dokumentacioni, i cili natyrisht ndodhet edhe në Arkivin e MPJ.

nga udhëheqja e lartë. Ministria e Punëve të Jashtme si institucioni kompetent dhe grupi i punës si struktura operative përkatëse, duhej të identifikonin, të formulonin e të parashtronin konkretisht argumentet politike e juridike për ta zyrtarizuar.

Në rrethin e ngushtë të funksionarëve, që ishin caktuar në grupin e punës të Ministrinë e Jashtme, u përftua ndjesia se në horizont po shfaqej një reze drite që paralajmëronte transformime pozitive në marrëdhëniet shqiptaro-britanike, madje jo vetëm në to, por në krejt spektrin e shfaqjes dhe të prezencës së Shqipërisë në botën e jashtme. Nuk ishte shumë e vështirë të nuhateshin, madje të dalloheshin shenja ndryshimesh të pritshme të imponuara, në vijën dhe qëndrimet politike të udhëheqjes shqiptare të asaj kohe.

Pala shqiptare i kërkoj palës britanike që formulimi i pikave IV dhe VI të propozimit prej 7 pikësh të ndryshonte duke hequr prej tyre referimet për incidentin e Kanalit të Korfuzit dhe vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Londra pranoi. Pas një heshtjeje disamujore, më 12 shkurt 1985, qeveritë e SHBA dhe të Britanisë së Madhe transmetuan një mesazh, në të cilin thuhej ndër të tjera se ato “sugjeronin që përfaqësuesit e Qeverisë së Anglisë të takohen pa vonesë në Paris me përfaqësuesit e Qeverisë shqiptare për të diskutuar këto çështje. Përfaqësuesi i Qeverisë angleze do të vepronte si zëdhënës i Qeverisë amerikane për çështjet që kanë të bëjnë me pretendimet e Qeverisë amerikane. Takimi dhe përmbajtja e tij do të bëhen mbi baza konfidenciale dhe pa u publikuar...”⁴⁵

Pak ditë më vonë palët shkëmbyen mesazhe dhe u morën vesh që takimi të zhvillohej në Paris, më 15 mars 1985. Pala shqiptare u shpreh dakord që përfaqësuesit britanikë të ishin njëkohësisht edhe si zëdhënës të Qeverisë së SHBA.⁴⁶

Më 15 mars 1985, në selinë e ambasadës shqiptare në Paris, nisën bisedimet e para shqiptaro-britanike. Misioni i të dy delegacioneve ishte i rëndësishëm, delikat dhe njëkohësisht emocionant. Në Tiranë, në Londër e Uashington, por edhe në Paris, pritej me kureshtje ecuria dhe rezultati i negociatave. Fjala ishte vërtetë për kthimin e një sasive ari në Shqipëri, por në thelb të gjithë ishin të ndërgjegjshëm se të dy delegacionet kishin mbi vete një peshë shumë më të madhe se 1 574 kilogramë ar. Ata mbanin peshën e restaurimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me Perëndimin, kishin misionin e rikthimit të Shqipërisë në Europë, në familjen e popujve, të cilës i përkiste që nga lashtësia.

Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë konstruktive. Kryetari i delegacionit britanik John Birç, pasi ripërsëriti në mënyrë tërësore “Propozimin prej 7 pikësh”, të modifikuar sipas sugjerimeve të pranuar nga të dyja palët theksoi se “ky propozim duhet të konsiderohet si një i tërë. Natyra e njëkohshme, por edhe e veçantë e elementëve të ndryshëm është një tipar thelbësor.”⁴⁷

Kryetari i delegacionit shqiptar, Andon Bërxfholi, lexoi gjithashtu një deklaratë me shkrim, në tekstin e së cilës përsëritej se pas kthimit në Shqipëri të arit së bashku me

⁴⁵ Mesazhi anglo-amerikan në vazhdim të përgjigjes shqiptare të datës 8 nëntor 1984, në Arkivi i MPJ, Fondi i Arit Monetar, Dosja e vitit 1985.

⁴⁶ Përgjigje për mesazhin anglo-amerikan të 12 shkurtit 1985, në Arkivi i MPJ, Fondi i Arit Monetar, Dosja e vitit 1985.

⁴⁷ Po aty, fq. 5.

interesat do të procedohej me diskutimin e pretendimeve britanike e amerikane, të përmendura në “Propozimin prej 7 pikash”. Kjo mënyrë diskutimi bëri që bisedimet të shtyheshin për në qershor të atij viti. Edhe ky raund në përgjithësi u karakterizua nga një ngurtësim qëndrimesh, çka do të çonte në një tjetër ndërprerje, për të rifilluar sërish pas një muaji dhe përsëri pa rezultat.

Kryetari i delegacionit britanik kundërshtoi propozimin shqiptar që të zgjidhej në fillim çështja e arit dhe më vonë të diskutohej pagimi i një shume për shlyerjen e pretendimeve financiare britanike. Ai tha se ne nuk mund ta mbrojmë dot veten as para parlamentit dhe as para opinionit publik, po të dorëzojmë arin pa marrë shumat që kërkojmë. Opinioni britanik, vazhdoi ai, është shumë i ndjeshëm ndaj kësaj çështjeje. Prandaj përsëriti që ajo të zgjidhej paralelisht dhe njëkohësisht.⁴⁸

Digresion në aktet diversioniste anglo-amerikane në Shqipëri në vitet 1948-1953

Edhe pse mund të gjykohej i pranueshëm arsyetimi dhe insistimi i Bërçit për këtë çështje, ishte me shumë vend dhe i argumentuar bukur edhe qëndrimi i palës shqiptare. Kryetari i saj i rikujtoi atij se opinioni shqiptar është shumë i ndjeshëm dhe e mban mirë parasysh historinë. Nëpërmjet një digresioni historik në vitet 1948-1953, ai përmendi shkurtimisht se në ato kohë, qarqe politike angleze e amerikane, organizonin dërgimin e bandave të armatosura me diversantë, që vranë njerëz të pafajshëm, që kryen sabotime, hodhën në erë ura, rrugë, shkolla, vepra të ndryshme industriale e ekonomike, që dogjën shtëpi, dëmtuan prodhime bujqësore e blegtorale, të mbjella etj dhe shkaktuan dëme materiale e humbje të konsiderueshme njerëzore. Ato janë të dokumentuara nga ne si palë e interesuar, por edhe nga personalitete angleze. Ai iu referua librit të Lordit Nikolas Bethel, *“Tradhëtia e Madhe” – Historia e patreguar e grushtit dërmues të Kim Filbit*,⁴⁹ librit të D. Smajl *“Me detyrë në Shqipëri”*⁵⁰ si dhe një programi të posaçëm televiziv të prodhuar dhe të transmetuar nga BBC, i titulluar *“The cost of Treachery” – “Çmimi i tradhëtisë”*, ku dëshmohej me dokumente autentike britanike për veprimet e kundërligjshme që ishin kryer kundër Shqipërisë në vitet 1948-1953. “Ju, vazhdoi Bërçholi, na folët për të humburit në incidentin e Kanalit të Korfuzit, për të cilin ne nuk kemi asnjë faj, që, siç është thënë, arrijnë në 44 vetë. Të vrarët në Shqipëri, në vitet 1948-1953, nga veprimet subversive anglo-amerikane dhe bandat e dërguara prej tyre, arrijnë në qindra vetë. Edhe ata i kanë gjallë vëllezërit, motrat, fëmijët e të afërmit e tyre, të cilët nuk e harrojnë se kush dhe pse ua ka vrarë. Ju më pyetët se si do t’i thoni opinionit, parlamentit dhe Kongresit për dorëzimin e arit. Unë do t’ju thoshja, tregoni realitetin. Kjo do të ishte një provë e dëshirës së mirë dhe e vullnetit të mirë ndaj Shqipërisë.”⁵¹

Përfaqësuesi britanik u kap ngushtë nga futja e diskutimeve në subjekte të tilla

⁴⁸ Po aty, fq. 18-19

⁴⁹ Nikolas Bethel, *“Tradhëtia e Madhe” – Historia e patreguar e grushtit dërmues të Kim Filbit*, Qendra botuese ekonomike “Progresi”, Tiranë, 1993

⁵⁰ D. Smajl *“Me detyrë në Shqipëri”*, Shtëpia botuese enciklopedike, Tiranë, 1993

⁵¹ Po aty, fq. 24

delikate dhe jo lehtësisht të përgënjeshtroeshme. Për të dalë nga kjo situatë, ai përsëriti sugjerimin për të hequr dorë nga pretendimi për interesat mbi arin ose fitimin e munguar, si i papranueshëm dhe si pengesë serioze për të ecur përpara në bisedime. Pala shqiptare nuk ishte e gatshme për ta pranuar këtë propozim.

Ndërprerja e bisedimeve

Një qëndrim i tillë si dhe synimi për të përjashtuar nga *zgjidhja paketë* plotësimin e pretendimeve financiare të qeverive angleze dhe amerikane, bënë që bisedimet të ndërpriteshin. Analiza e përgjithshme e tyre, e kryer pas shumë vjetësh, kur janë zbehur e larguar emocionet e çastit, me keqardhje të çon në konkluzionin që sapo u duk se diçka e rëndësishme po inagurohej jo vetëm në marrëdhëniet shqiptaro-britanike, por në krejt politikën e jashtme shqiptare, demonët e së kaluarës në politikën shqiptare u zgjuan dhe masakruan pa mëshirë rezultatet e arritura me shumë përkushtim. Entuziazmi i kujdesshëm dhe tepër i matur, i shfaqur në fillimet e negociatave, u davarit shpejt. Dikush nga zyrat e censurës politike, për motive ende të paqarta, ndoshta edhe thjeshtë banale, për të marrë meritën apo lavdinë e zgjidhjes së një çështjeje kruciale, u vërsul mbi atë arritje për ta zhbërë. Në emër të parimeve politike false, duke shpërfillur dhe injoruar nevojën e kompromisit, si e vetmja zgjidhje në ato kushte, do të imponoheshin qoftë edhe tërthorazi qëndrime që ngandonjëherë tejkalonin caqet e mirësjelljes diplomatike dhe në thelb i largoheshin frymës së kompromisit.

Ndrojtja nga qortimet e pamerituara, madje edhe frika nga akuzat dhe ndëshkimet, që mund të formuloheshin me lehtësi në ato kohë, që sundonin mbi anëtarët e delegacionit, dhe jo vetëm tek ata, ushtronte një trysni permanente. Ato i përpunonin dhe i standartizonin mendimet e tyre, i ndrydhnin brenda sloganeve të kohës. Qëndrimet që mbetën të pandryshuara, nuk u afruan, nuk u shtendosën dhe nuk konverguan drejt gjetjes së zgjidhjeve të çështjes. Dominoi intoleranca, e kamufluar në trajtat e deklaramit të ekspozëve të strukturuar dhe të formuluar me tone emfatike, që ngjallnin monotoni dhe nuk shprehnin thuajse asgjë thelbësore. Kërkohej zgjidhje, por nuk ofrohej bashkëpunim konstruktiv, dëshirohej që ari të kthehej në Shqipëri dhe marrëdhëniet me Britaninë e Madhe të restauroheshin e të zhvilloheshin, por anatemohej fryma e lëshimeve. Bisedimet e zgjatura që konsumuan shumë energji nuk mundën t'i shkrinin akujt, nuk mundën të shmangnin kontrastet e thella që ekzistonin në marrëdhëniet midis dy vendeve. Ato nuk arritën të personifikonin një frymë të re kooperimi racional, nuk u bënë bartëse të saj dhe nuk ndërtuan një realitet të ri, të veçantë dhe të shumëpritur nga popujt e të dyja palëve.

Për të gjykuar më drejt se ç'po ndodhte, duhet parasysh se prej kohësh ishte kristalizuar objektivi strategjik që midis dy vendeve duheshin eliminuar problemet që pengonin normalizimin e marrëdhënieve. Elementë të tillë pengues ishin kthimi i arit dhe zbatimi i vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për incidentin e Kanalit të Korfuzit. Organet e specializuara kishin përpunuar qëndrimet që do të mbaheshin dhe kishin përcaktuar veprimet që do të ndërmerreshin për përballimin e tyre. Mbi këtë

pozicion strategjik dhe në këtë optikë realiste u zhvilluan diskutimet dhe u hartuan platformat për fillimin e negociatave me anglezët në gjysmën e parë të vitit 1985, të cilat karakterizoheshin nga racionalizmi dhe objektiviteti. Por, siç u përmend edhe më sipër, fill pas bisedimeve të para, në Paris, kur u pa se ekzistonte një perspektivë optimiste e një zgjidhjeje të drejtë dhe dinjitoze, mbi bazën e një kompromisi të pranueshëm nga të dyja palët, u ndërhy befasisht dhe gjithë rrjedha e mëtejshme e bisedimeve ndryshoi. Qëndrimi i palës shqiptare pas këtij momenti, për vite të tëra, do të karakterizohej nga inkosekuenca, rezultat I padyshimtë i interferencave të vazhdueshme nga faktorë ekstraprofesionale etj. Ishin pikërisht ato që, me vetëdije apo jo, çuan në dështimin e fazës së parë të bisedimeve shqiptaro-britanike.

Rifillimi i dialogut

Do të kalonin gati 5 vjet, që të rifillonin bisedimet dhe pas përfundimit të tyre edhe 3-4 vjet të tjerë për zbatimin e marrëveshjes së arritur. Përfaqësues të të dy vendeve që takoheshin herë pas here në Nju Jork e mbajtën gjallë frymën e dialogut dhe në vitin 1990 konkluduan se kishte ardhur koha që bisedimet të rifillonin. U vendos që takimi të bëhej në Romë, në të njëjtin nivel si në negociatat e Parisit, 1985.

Bisedimet e Romës që filluan më 5 nëntor 1990, u zhvilluan në kushte të veçanta, në një kohë ndryshimesh të mëdha në Europë e në botë. Ndjehesh një ulje e tensionit politik dhe largim nga fryma e konfrontimit në shkallë europiane e botërore. Në vendet e Lindjes Europiane kishin filluar procese transformimesh të rëndësishme. Sistemi komunist i brejtur nga kontradikta të brendshme, po binte gradualisht në të gjithë vendet ish komuniste, duke filluar nga ish Bashkimi Sovjetik. Këto zhvillime po trokisnin edhe në dyert e mbyllura hermetikisht të Shqipërisë dhe dukej qartë se do ta përfshinin shumë shpejt. Udhëheqja shqiptare, megjithë përpjekjet e dëshpëruara për t'i shmangur e larguar, u detyrua të bënte koncensione. Në drejtim të hapjes së vendit me botën e jashtme u ndërmorën veprime të paimagjinueshme pak kohë më parë, si p.sh. ngritja e rangut të përfaqësimit diplomatik me vendet e ish bllokut sovjetik nga i ngarkuar me punë në nivel ambasadori, rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me RF të Gjermanisë, fillimi i negociatave me sovjetikët për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike, negociatat për rivendosjen e marrëdhënieve me SHBA, aplikimi për t'u anëtarësuar në Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Europë etj. Shqipëria, me shumë ndrojtje dhe doemos e imponuar, edhe pse qëndronte në periferi të këtyre proceseve, ndiqte me vëmendje situatat dhe përpiquej të përfshihej me kujdes, por aq sa të mos rrezikonte shkatërrimin e sistemit komunist. Këto zhvillime, që e detyruan Tiranën zyrtare të adoptonte fleksibilitet në qëndrimet e saj ndërkombëtare, jepnin shpresë se atmosfera në bisedimet e Romës do të ishte më ndryshe nga më parë.

Dhe vërtetë delegacioni shqiptar shkoi në Romë me një platformë, në themel të së cilës ishte gatishmëria dhe dëshira për mirëkuptim dhe bashkëpunim konstruktiv me delegacionin britanik. Por, delegacioni shqiptar u gjend i befasuar. Pritej që pala britanike të avanconte propozimin e rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike si pikën

e parë të rendit të ditës, për të cilën delegacioni shqiptar ishte porositur të shprehej dakord, duke kërkuar që bisedimet të përfshinin diskutimin e arit dhe çështjet e tjera të konstestueshme. Britanikët kërkuar që takimi t'i kushtohej vetëm rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Diskutimi i çështjeve të tjera të fillonte nga kompensimi i dëmeve të incidentit të Kanalit të Korfuzit, duke e lënë çështjen e arit për më vonë, nën pretekstin se ishte e komplikuar, meqënëse përfshinte aspekte të shumta teknike që kërkonin kohë dhe plotësimin e formaliteteve. Për më tepër për trajtimin e saj lypsej veprimi i Komisionit Tripalësh të Arit si dhe pëlqimi i SHBA dhe i Francës.

Këto bisedime përfunduan pa asnjë rezultat. Të njëjtin fat patën edhe bisedimet e zhvilluara rreth një muaj më vonë në Gjenevë, më 18 dhe 19 dhjetor 1990. Në përfundim të takimit shtypit iu dha njoftimi standard i mëposhtëm: "Delegacionet britanike dhe shqiptare u takuan në Gjenevë më 18 dhe 19 dhjetor 1990 për të diskutuar çështjet bilaterale, përfshirë edhe rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Bisedimet u zhvilluan në një atmosferë konstruktive."⁵²

Më 29 maj 1991, një komunikatë e përbashkët shpalli rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe. Më 7 korrik 1991, delegacionet e të dyja palëve do të takoheshin sërish në Gjenevë, tashmë në një atmosferë tjetër, që duhet të dominohej nga kjo ngjarje e madhe në marrëdhëniet midis dy vendeve. Por, nuk ndodhi kështu. Negociatat për arin u futën në një periudhë ngricash krejtësisht të paparashikuar nga pala shqiptare, çka shkaktoi habi, madje zhgënjime e pikëpyetje rreth zhvillimeve që ishin projektuar në Londër për ecurinë e zgjidhjes së kësaj çështjeje. Qëndrimi anglez ishte jo vetëm i papritur, por edhe befasues, një surprizë e vërtetë. Anglezët propozuan një takim tjetër po në Gjenevë, në dhjetor 1991. Aty u vu re se qëndrimi i Londrës kishte ndryshuar edhe më shumë në sensin negativ. Pretendimi i tyre financiar tashmë ishte shumëfishuar, nga 1.9 milionë USD i kërkuar me ndrojtje dhe me rezervën e diskutimit të saj, në bisedimet e Parisit, 1985, tashmë kishte shkuar në ... 6 milionë USD. Madje kërcënuan se propozimi për këtë shumë kishte vlerë vetëm në se pranohej në këtë takim, përndryshe në se lihej për më vonë, ajo do të shtohet në shifra të tjera. Në fund u ra dakord që delegacionet të takoheshin përsëri, në Tiranë.

Në një rikapitulim të bisedimeve të Romës dhe të Gjenevës, nuk është vështirë të kuptohet se situatat dhe qëndrimet e palëve kishin ndryshuar ndjeshëm. Në bisedimet e Parisit 1985, qëndrimi anglezëve përshkohej nga fryma dhe gatishmëria për kompromis dhe arritjen e shpejtë të zgjidhjes. Në bisedimet e Romës dhe Gjenevës, Londra ishte pozicionuar në vendosjen e kushteve gati ultimative për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Me sa duket shkaku kishte të bënte pikërisht me ndryshimin rrënjësor të rrethanave në Shqipëri. Në vitet 1984-1985 Perëndimi shfaqte interes për të ndikuar në zhvillimet në Shqipëri, një vend me pozicion gjeopolitik

⁵² Shih Shtojcën 3 të Procesverbalit të bisedimeve të zhvilluara në Gjenevë, midis delegacionit të RPS të Shqipërisë dhe delegacionit të Britanisë së Madhe për çështjen e Arit Shqiptar dhe normalizimit të marrëdhënieve midis dy vendeve, 18-19 dhjetor 1990, në Arkivin e MPJ, Fondi Bisedimet me Anglinë për Arin Shqiptar, dosja e vitit 1990.

e gjeostrategjik kyç në pellgun e Adriatikut dhe të Mesdheut dhe i distancuar nga përkatësia dhe politika e Bllokut Lindor, që përbëhej nga vendet satelite të Bashkimit Sovjetik. Ai përpiqej të gjente pretekste për ta tërhequr atë në negociata, me qëllim që të “tatonte pulsin” dhe në se do të ishte e mundur të injektonte procese ndryshimesh. Pesë vjet më vonë rrethanat kishin ndryshuar tërësisht. Në fillimin e viteve '90, Shqipëria ishte përfshirë në proceset e hapjes dhe të ndryshimit të regjimit politik, që kishin përfshirë të gjithë Lindjen komuniste. Perëndimi dhe Londra, nuk kishin më motiv për të paguar kosto që të stimulonin futjen e saj në rrjedhën e tyre. Ajo kishte ndodhur tashmë dhe nuk kishte më kthim prapa.

Edhe në takimin e Tiranës të 22 korrikut 1991, delegacioni britanik mbajti pothuajse të njëjtin qëndrim si në Gjenevë. Përsëriti kërkesën për shumën e 6 milionë dollarëve si detyrim të palës shqiptare, për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në incidentin e Kanalit të Korfuzit. Sipas kryetarit të delegacionit britanik nuk mund të justifikoheshin dot në parlament për 44 viktimat, për të plagosurit dhe dëmet materiale të shkaktuara në atë incident. Shuma e 6 milionë dollarëve nuk mund të diskutohej.

Në këtë frymë negociatash të karakterizuar nga deformacione të paparashikuara, kryetari i delegacionit shqiptar duke deklaruar se filozofia e ndërtimit të marrëdhënieve shqiptaro-britanike duhet të orientohej nga e ardhmja dhe jo nga e kaluara, i rikujtoi homologut të vet britanik se “ju përmendet 44 vetë të vrarë në incidentin e Kanalit të Korfuzit, por mos harroni se gjatë viteve 1948-1953 në Shqipëri pati ndoshta 444 ose edhe me shumë shqiptarë të vrarë nga bandat e diversantëve të organizuar e të dërguar nga shërbime të caktuara anglo-amerikane. Prandaj duhet të hapim një faqe të re, të mos shohim prapa se nuk dalim dot.”⁵³

Negociatat e Tiranës u mbyllën gjithashtu pa asnjë rezultat, me dështim të plotë.

Përfundimi i bisedimeve dhe zgjidhja e çështjes

Negociatat rifilluan në Romë më 8 maj 1992. Pas ballafaqimesh të zgjata disaorëshe u pranua dhe u nënshkrua një *Memorandum mirëkuptimi*. Në të thuhej ndër të tjera se qeveritë e Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Bashkuar, pasi kishin rivendosur marrëdhëniet diplomatike, duke dëshiruar të zgjidhnin çështjet e mbetura pezull midis tyre, u morën vesh që qeveria e Mbretërisë së Bashkuar do të miratonte livrimin e rreth 1574.35 kg ar Shqipërisë, i identifikuar paraprakisht nga Komisioni Tripalësh i Arit Monetar, për t’iu dhënë Shqipërisë. Njëkohësisht me livrimin e arit qeveria e Shqipërisë do t’i paguante qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar një shumë prej 2 milionë dollarë amerikanë. Pagimin e shumës së mësipërme nga qeveria shqiptare qeveria britanike do ta konsideronte si zgjidhje të plotë dhe përfundimtare të pretendimeve të saj financiare. Të dyja qeveritë pranonin se livrimi i arit Shqipërisë kërkonte jo vetëm pëlqimin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, por edhe të qeverive të Francës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

⁵³ Po aty, fq. 7.

Nënshkrimi i *Memorandumit* shënoi përfundimin e bisedimeve shqiptaro-britanike për çështjen e Arit Monetar Shqiptar dhe odisenë gjysëmshekullore të negociatave e traktativave të shumta e të vështira, që konsumuan energji, përpjekje dhe një kohë shumë të gjatë, por shumë të vyer në marrëdhëniet shqiptaro-britanike.

Tre vjet më vonë, më 10 mars 1995, një marrëveshje e tillë u nënshkrua edhe midis Shqipërisë dhe SHBA, në bazë të së cilës u ra dakord që qeveria amerikane do të jepte pëlqimin e saj në Komisionin Tripalësh për Arin për kthimin e sasisë së arit prej 1 574,35 kg ar, të cilin Komisioni Tripalësh për Arin e kishte identifikuar për t'ia dhënë Shqipërisë. Shqipëria do t'i paguante SHBA një shumë prej 2 milionë USD për shlyerjen e plotë dhe përfundimtare të pretendimeve financiare amerikane.

Dy javë më vonë, më 22 shkurt 1996, u nënshkrua në Tiranë, një marrëveshje formale me 4 nene, ndërmjet qeverisë së Republikës Franceze dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë lidhur me rregullimin e çështjes së Arit Monetar dhe kredive të tjera publike ose private. Duhet të negociohej gjithashtu edhe me qeverinë angleze rreth formaliteteve dhe veprimeve që do të kryheshin nga pala shqiptare për pagimin e shumës prej 2 milionë dollarë amerikanë, si shlyerje e plotë dhe përfundimtare e pretendimeve të saj financiare dhe pasurore ndaj Shqipërisë. Në ato bisedime do të duhej të diskutohej edhe rreth veprimeve që do të kryente qeveria britanike për shprehjen e pëlqimit të saj pranë Komisionit Tripalësh për Arin, për kalimin e Arit Shqiptar në pronësinë e Shqipërisë.

Së fundi duhej biseduar me Komisionin Tripalësh për Arin rreth modaliteteve për kalimin e arit në pronësi të Shqipërisë.

Këto bisedime u zhvilluan më 29 tetor 1996, në vijim të të cilave u nënshkruan aktet e nevojshme dhe u përfunduan procedurat e duhura për rikthimin në Shqipëri të 1 574 kg ar. Ky veprim, nga pala shqiptare u krye në zbatim të ligjit Nr. 7913, datë 6.04.1995, "*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe SHBA për zgjidhjen e disa pretendimeve*", të ligjit Nr. 8141, datë 5.09.1996, "*Për ratifikimin e Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për problemin e arit të grabitur nga gjermanët*", të "*Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës franceze lidhur me çështjen e arit monetar dhe detyrimeve të tjera publike dhe private*", miratuar në parim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 667, datë 19.02.1996, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 668, datë 7.10. 1996, "*Për marrjen në dorëzim të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore*" si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 693, datë 23.10.1996, "*Për miratimin në parim të akteve "Mbi heqjen dorë nga të drejtat" dhe "Mbi marrjen në dorëzim të arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore"*".⁵⁴

Gjatë takimit të 29 tetorit u realizuan transaksionet financiare ndërmjet bankave qendrore të vendeve përkatëse për kalimin e arit në dispozicion të Shqipërisë si dhe për

⁵⁴ Sipas Informacionit Nr. 3462, datë 04.11.1996, "Mbi vizitën e kryer në Londër për marrjen e arit shqiptar të grabitur nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore", në Arkivin e Bankës së Shqipërisë, Fondi Guvernatori, Dosja Nr. 21, viti 1996.

likuidimin e pagesave në favor të Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shlyerjen e plotë dhe përfundimtar të pretendimeve të tyre financiare ndaj Republikës së Shqipërisë, siç ishte rënë dakord gjatë viteve 1984-1996.

Komisioni Tripalësh i Arit Monetar lëshoi menjëherë urdhërin për lëvrimin nga Banka e Anglisë të 77 lingotave, që përmbanin 31,168.508 once ar të pastër (fin) dhe të 49 qeseve të vulosura, që përmbanin 18,635.641 once ar të pastër (fin) në monedha. Kjo sasi kishte vlerën e 1 549, 0821 kg ar. Pra nuk ishte e barabartë me 1, 574. 35 sa ishte caktuar me vendimet e Komisionit Tripalësh për Arin. Diferenca prej rreth 25 kg do të dorëzohej më vonë, duke shkuar kështu në 64 % të sasisë së përgjithshme prej 2 454, 8745 kg, që ishte pretenduar nga qeveria shqiptare në vitin 1946.⁵⁵ Ato përfaqësonin sasi të alokuara paraprakisht, të cilat prej atij çasti do të konsideroheshin si alokimet pothuajse përfundimtare të kuotës së qeverisë së Republikës së Shqipërisë në shpërndarjen e masës së arit monetar, të kryer nga qeveritë e Francës, SHBA dhe të Britanisë së Madhe, në emër dhe për llogari të Komisionit Tripalësh për Arin, në zbatim të Marrëveshjes së Parisit, të 14 janarit 1946, për Reparacionet. Marrjen e urdhërit të mësipërm ato e konfirmuan nëpërmjet këtij akti, ndërsa Banka e Anglisë me një shkresë private dhe konfidenciale, të datës 19 tetor 1996, njoftonte Bankën e Shqipërisë se atë ditë kishte kryer transferimin e sasisë së mësipërme të arit në një llogari të veçantë ari në emër të Bankës së Shqipërisë.⁵⁶ Qeveria e Republikës së Shqipërisë, konfirmoi në atë çast, se marrja prej saj e sasisë së lartpërmendur të arit të atribuar, i korrespondonte kuotës së vet në masën e arit monetar aktualisht të disponueshëm.

Në "*Background note on Albanian gold*", që shoqëronte njoftimin e zëdhënësit të Foreign Officit britanik, të datës 29 tetor 1996, lidhur me pagesën e 2 milionë USD nga qeveria shqiptare në favor të qeverisë britanike, thuhej se ajo u krye për zgjidhjen e çështjes së incidentit të Kanalit të Korfuzit.⁵⁷ Ky formulim ishte krejt ndryshe nga sa ishte rënë dakord në bisedimet e Romës të majit 1992. Siç u përshkrua më sipër, në bisedimet e Romës, nuk u tha asnjëherë se pagesa e shumës 2 milionë dollarë, përbënte zgjidhjen e çështjes së incidentit të Kanalit të Korfuzit, por *zgjidhjen e plotë e përfundimtare të pretendimeve financiare të qeverisë britanike ndaj qeverisë shqiptare*, siç ishte rënë dakord që prej vitit 1984 e në vazhdim. Ishte e vërtetë, se kjo formulë nënkuptonte pikërisht çështjen e Kanalit të Korfuzit, por të dyja palët ishin marrë vesh që do të evitohej përmendja e saj shprehimisht.

Më 13 korrik 1998, përfaqësuesit e qeverive anëtare në Komisionin Tripalësh për Arin, firmosnën aktin e dorëzimit të një çeku prej 2, 106. 24 sterlina angleze dhe një urdhër livrimi lëshuar për Bankën e Anglisë për 1, 571. 543 once ar të pastër. Ishin pjesa e mbetur e kuotës së arit që i ishte caktuar Shqipërisë, që nuk u mor në vitin 1996 si dhe pjesa e interesave të prodhuara nga një sasi ari që Komisioni Tripalësh i Arit e kishte depozituar në bankë me kurs bankar, që i takonte qeverisë së Republikës së

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Sipas Shkresës së datës 29 tetor 1996, Nr. Bullion LAU 61, të Bank of England, që gjëndet në Arkivin e Bankës së Shqipërisë, Fondi Guvernatori, Dosja Nr. 21, viti 1996.

⁵⁷ Po aty.

Shqipërisë. Kjo sasi, së bashku me atë që ajo mori me aktet e 29 tetorit 1996, përbënte kuotën e saj të plotë dhe përfundimtare, të përcaktuar nga Komisioni Tripalësh i Arit.⁵⁸

Mund të thuhet se tashmë kishte ardhur momenti i *happy end-it*. Ishin zgjidhur dhe kapërcyer përfundimisht vështirësitë e karakterit politik dhe juridik. Me kryerjen e transaksioneve dhe marrjen e konfirmimit zyrtar nga bankat përkatëse, u konsiderua e mbyllur çështja e arit shqiptar të grabitur nga gjermanët dhe të bllokuar nga Mbretëria e Bashkuar në Bankën e Anglisë për shkak të incidentit të kanalit të Korfuzit.⁵⁹

Në këtë mënyrë, pas tratativash të vazhdueshme diplomatike, ndërhyrjesh e demarshesh, përballim procedurash të komplikuar e të tejzgjatura gjyqësore, negociatash formale e informale që përkshuan dekada të tëra, të karakterizuara nga ballafaqime interesante, nga diskutime e debate politike e profesionale, u mbyll një ndër kapitujt e rëndësishëm të historisë diplomatike shqiptare. Ari Shqiptar u çlirua nga statusi i pezullimit të ndërmjetëm, i adoptuar nga Komisioni Tripalësh për Arin, në dhjetor 1950 dhe iu kthye pronarit të ligjshëm, Shqipërisë. Restitucioni i tij, si shlyerje e një pjese të përgjegjësisë së madhe materiale e moralo-politike të pushtuesve nazi-fashistë për dëmet dhe humbjet e shkaktuara në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore përbënte vënien në vend të një padrejtësie të hapur dhe një satisfaksion të merituar edhe pse shumë të vonuar. Dosja e Arit Shqiptar, tani e tutje do të arkivohej, si kujtim i një kohe përpjekjesh të shumta politike, diplomatike e juridike.

Bashkë me të dhe e lidhur ngushtë, ishte çështja e incidentit të Kanalit të Korfuzit, e cila në fillimet e veta rrezikoi ta konfrontonte Shqipërinë e vogël me Britaninë e Madhe, një shtet me potenciale të fuqishme ushtarake dhe me shumë peshë në zhvillimet ndërkombëtare.

Nëpërmjet zgjidhjes së parashikuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të 8 majit 1992, u shtendosën përfundimisht marrëdhëniet shqiptaro-britanike dhe shqiptaro-amerikane nga një pengesë permanente. U hap rruga për zhvillime të përsheptuara në të ardhmen, për shkëmbime reciproke në dobinë e të gjitha palëve dhe i siguruan Shqipërisë mbështetjen dhe përkrahjen e dy prej fuqive më të mëdha e me peshë në jetën ndërkombëtare. Prej asaj kohe ato kanë njohur progres të vazhdueshëm. Tirana i ka identifikuar si marrëdhënie me rëndësi strategjike, me prioritet të veçantë në politikën e jashtme dhe tregon një kujdes të posaçëm për përparimin e tyre të pandalshëm.

⁵⁸ Sipas fotokopjes së dokumentit original në anglisht dhe frengjisht, që gjendet në Arkivin e Bankës së Shqipërisë, Fondi Guvernatori, viti 1998.

⁵⁹ Po aty.

“Revolucionet arabe” dhe Kina: Si duhen lexuar sot Marksi dhe Brzezinski

— Fatos Tarifa, PhD, UET —

ABSTRAKT. *“Revolucionet arabe” mund të thuhet se shënojnë prologun e një epoke të zgjimit dhe të radikalizimit politik masiv në vendet në zhvillim. Ky artikull shqyrton impaktin që eventualisht mund të kenë këto “revolucione” në Kinë. Në të analizohen, nga njëra anë, faktorët politikë dhe ekonomikë që e “imunizojnë” Kinën ndaj tronditjeve të mëdha revolucionare dhe, nga ana tjetër, implikimet praktike që mund të ketë teoria marksiste (të cilën udhëheqja e sotme e Pekinit e ka braktisur) për transformimin politik dhe shoqëror të këtij vendi. Teza e Marksit se kur një shoqëri orientohet nga tregu dhe modernizohet, ajo tenton gjithashtu të demokratizohet, ka rezultuar e vërtetë në shumë vende (në Korenë e Jugut, në Taiwan, në Spanjë, në Portugali, në Argjentinë, në Turqi etj), duke provuar një tendencë historike të pagabueshme: sa më shumë që regjimet autokratike kanë lejuar, ose lejojnë modernizimin e ekonomive të tyre dhe sa më shumë që një ekonomi e mbështetur në tregun e lirë ka qenë, ose është në gjendje të krijojë një shtresë popullsie, e cila, për nga të ardhurat, konsiderohet “klasë e mesme”, aq më i sigurt ka qenë dhe është transformimi dhe konsolidimi i shoqërisë si një demokraci liberale. Përfundimi në të cilin arrihet është se, Kina, sado kohë të marrë transformimi i saj politik, nuk ka pse të jetë një përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm. Trajektoret e zhvillimit ekonomik dhe të evolucionit politik të saj do të ndahen prej njëra-tjetres dhe, herët ose vonë, distanca midis tyre do të rritet në atë shkallë, sa që këto dy trajektore nuk do mund të qëndrojnë më së bashku dhe Kina do të njohë një krizë politike serioze.*

Fjalë kyçe: *Radikalizem politik, revolucionet arabe, zhvillimi ekonomik, evolucioni politik*

Nëse tronditjet e mëdha revolucionare të këtyre muajve të fundit në Tunizi, Egjipt, Jemen, Bahrein, Libi dhe në vende të tjera të botës arabe e zunë të papërgatitur Perëndimin, sa e mundur është që efekti domino i këtyre ngjarjeve të ndjehet në rajone të tjera të botës së tretë, në Afrikë dhe në Azi? A janë protestat e muajve të fundit në vende të tilla të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Veriore si Siria, Libani, Omani, Algjeria, Maroku, apo ato në Iran, në Bregun e Fildishtë, në Korenë e Veriut

dhe në Kinë, shenja të dobësimit apo të këputjes së hallkave të tjera në zinxhirin e vendeve që po përjetojnë një zgjim dhe radikalizim politik masiv të tillë që ndoshta do t'i japë një përmbajtje të re shekullit të 21-të? A shënojnë, pra, këto ngjarje, atë që tashmë rëndom kanë filluar ta quajnë “epoka e ngritjes së vendeve joperëndimore” (the era of the Rise of the Rest)?

Radikalizmi politik transnacional

Sot jetojmë në një botë politikisht më të populluar dhe më të ndërlidhur, në të cilën ndërthuren dhe përplasen interesat e rreth 200 shteteve nominalisht sovrane. Po kështu, *graviteti demografik* i planetit tonë është shmangur mjaft drejt Lindjes dhe Jugut. Për më tepër, popullsia e globit jo vetëm që po ndryshon disproporcionalisht në rajone dhe në kontinente të ndryshme të tij, por ajo po përjeton një *zgjim politik*, deri më sot të paparë, në shtrirje dhe në intensitet, çka ka bërë dhe po bën të mundur që *politika populiste* ta transformojë *politikën e pushtetit*. Nevoja për t'iu përgjigjur një fenomeni të tillë masiv përbën një sfidë historike, përgjigjja ndaj së cilës do të përcaktojë në një masë të madhe drejtimin e zhvillimeve në shekullin e 21-të. Siç ka theksuar me të drejtë Zbigniew Brzezinski, sfida globale më serioze në kohën tonë nuk është terrorizmi, por “tronditjet dhe destabiliteti në rritje që shkaktohen nga fenomeni i zgjimit politik në shkallë globale” (Brzezinski 2005: 40). Ky zgjim, argumenton ai, është “masiv nga pikëpamja sociale dhe radikalizues nga pikëpamja politike” (ibid).

Sot, në fillim të shekullit të 21-të, popullsia e shumë prej vendeve në zhvillim është politikisht e agravuar dhe aktive, e ndërgjegjësuar si rrallë herë më parë për padrejtësitë ekonomike dhe sociale dhe shumë herë e indinjuar dhe e zemëruar për mungesën e dinjitetit të vet politik dhe shoqëror. Pothuajse në të gjitha vendet e Botës së Tretë, arsimi masiv ka hapur horizonte të reja konjitive, të panjohura deri disa dekada më parë, për shtresa të gjera të popullsisë. Në kohën tonë, me përjashtim të skajeve më të largëta të planetit, nuk gjen thuajse asnjë vend që të ketë mbetur i pandikuar nga dinamika e *modernitetit pluralizues* që ka mundësuar përhapja masive e arsimit (sidomos e atij universitar) dhe teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit të kësaj epoke globalizimi. Aksesit thuajse universal ndaj radios dhe televizionit dhe gjithnjë e më shumë Interneti, me shtrirjen dhe rolin e tij të jashtëzakonshëm në shoqërinë moderne, që mundëson komunikimin e menjëhershëm ndërmjet masave potencialisht shumë të gjera (Cilluffo et al. 2007: 114-115), po krijon gjithnjë e më shumë një komunitet njerëzish që ndajnë mes tyre të njëjtat perceptime dhe besime dhe që mund të galvanizohen dhe të instrumentalizohen nga pasione politike demagogjike apo fetare. Këto energji transcendojnë përtej kufijve kombëtarë duke sfiduar si shtete të veçanta, ashtu edhe hierarkinë globale ekzistuese, në krye të së cilës vazhdon të qëndrojë e parivalizuar Amerika.

Sot është e pamundur të flasim për të ardhmen e Kinës, të Indisë, të Pakistanit, të Iranit, të Meksikës, të Sudanit apo të Egjiptit pa marrë në konsideratë sjelljen e mundshme të popullsisë të këtyre vendeve, aspiratat sociale dhe politike të të cilave

frymëzohen dhe nxiten nga impulse që nuk kanë më origjinë ekskluzivisht lokale. Mjafton të vësh re ngjashmëritë politike të lëvizjeve protestuese vitet e fundit në Kirgizstan, në Bolivi në Tailandë dhe, së fundi, në Tunizi, në Algjeri, në Jordani, në Egjipt, në Bahrein dhe në Siri. Në mënyra dhe shkallë të ndryshme intensiteti, këta popuj nuk e duan më *status quo*-në dhe shumë prej tyre mund të mobilizohen lehtësisht, jo vetëm kundër regjimeve autoritariste në vendet e tyre, por edhe kundër Amerikës, të cilën edhe e kanë zili, por edhe e shohin si fuqinë kryesore që kërkon ruajtjen e *status quo*-së në plan global.

Veçanërisht e indinjuar dhe aktive është rinia e vendeve në zhvillim. Revolucioni demografik në këto vende është një bombë me sahat. Shtimi i shpejtë i popullsisë në moshën nën 25 vjeç po krijon një masë të madhe njerëzish në moshë të re, të irrituar dhe lehtësisht të mobilizueshëm. Ngjarjet e Tunizisë në janar të këtij viti janë konsideruar si një “revolucion i rinisë” (*Youth Revolution*) (Diskey 2011), ashtu sikurse protestat masive për përmbysjen e regjimit të Mubarakut në Egjipt, në janar dhe shkurt 2011, nisën si një “revolucion i rinisë së Internetit” (*the revolution of the youth of the Internet*) dhe u shndërruan në një revolucion të të gjithë Egjiptit (*the revolution of all Egypt*) (Michael & Hendawi 2011).

Shumë shpejt, dy miliardë njerëz në moshë të re në mbarë globin do të jenë myslimanë (Bell 2005). Mendjet e tyre stimulohen dhe frymëzohen nga tinguj dhe imazhe që vijnë nga larg dhe që e intensifikojnë pakënaqësinë e tyre ndaj gjendjes në të cilën ata jetojnë. Potenciali i tyre revolucionar ka të ngjarë të shpërthejë në radhët e mbi 140 milionë studentëve të përqendruar në universitetet dhe kolegjet e vendeve në zhvillim. Kjo shtresë e arsimuar do të rritet shumë numerikisht në dekadat që do të vijnë. Një studim i UNESCO-s i kohëve të fundit parashikon se, gjatë 30 viteve të ardhshme, numri i të rinjve që do të marrin një diplomë universitare në të gjithë botën do të jetë më i madh se numri i të gjithë njerëzve që kanë studiuar në të gjitha universitetet e botës deri më sot. Të ardhur kryesisht nga radhët e shtresave më të ulëta dhe të pasigurta të klasës së mesme, si edhe të indinjuar nga ndjenja dhe eksperiencia të padrejtësive sociale, këta dhjetra milionë studentë janë potencialisht revolucionarë, gjysmë të mobilizuar në kampuset univeristare, të lidhur mes tyre përmes Internetit dhe të parapozicionuar për një *replay* në një shkallë më të gjerë se ajo që kemi parë të ndodhë vite më parë në Meksiko, në Xhakarta, në Sheshin Tiananmen, në Teheran dhe së fundmi në Aman, në Tunis, në Algjer dhe në Kairo. “Energjia fizike dhe frustrimi i tyre emocional”, shkruan Brzezinski, “thjesht presin të nxiten nga një kauzë, nga një besim apo nga një urrejtje” (Brzezinski 2005: 42).

Ç’mund të thuhet për të ardhmen? Zgjidhimi politik i masave popullore është bërë një fenomen (a) gjeografikisht *global*, pa lënë asnjë kontinent apo rajon të botës politikisht pasiv; (b) shoqërisht *gjithëpërfshirës*, me përjashtim të komuniteteve fshatare më të skajshme, të cilat ende mbeten politikisht të pamotivuara; (c) demografikisht *rinor* dhe, për këtë arsye, më i mundshëm për t’u mobilizuar politikisht brenda një kohe të shkurtër; dhe (d) *transnacional* nga pikëpamja e origjinës dhe e frymëzimit të tij, për shkak të impaktit kumulativ të përhapjes së gjerë të arsimit dhe të mjeteve të

informimit dhe të komunikimit masiv (Brzezinski 2005: 12). Si rezultat i të gjithë këtyre faktorëve, sentimentet dhe pasionet *politike populiste* në kohën tonë mund të drejtohen madje edhe kundër një “objekti” të largët, pavarësisht mungesës së një doktrine unifikuese (si Marksizmi), duke qenë, shpesh herë (apo gjithnjë e më shumë), Amerika ajo që bëhet “fokusi konfliktual i admirimit personal, i zilisë shoqërore, i zemërimit politik dhe i urrejtjes fetare” (ibid, 12).

Ngjarjet e koheve të fundit në Tunizi, në Algjeri, në Jordani, në Egjipt, në Jemen dhe në Siri nuk duhej të çudisnin askënd që ndjek sado pak me vëmendje zhvillimet ekonomike, sociale dhe politike në botën e sotme. Globi ynë është sot një vullkan në shpërthim. Popujt dhe, veçanërisht rinia e arsimuar e vendeve arabe, në Magreb apo në Lindjen e Mesme, masat e gjera të rinisë në vendet e Azisë Qendrore dhe të Azisë Juglindore dhe, sidomos në Kinë, janë në kërkim të një alternative që do të mund t’u japë fund varfërisë, padrejtësive sociale, korrupsionit endemik të elitave autokratike në pushtet, kushteve politike e sociale që i mbajnë ata në margjinat e shoqërisë dhe aspiratat e tyre të paplotësuar. Prirja e zhvillimeve të sotme i ngjan ndoshta periudhës së revolucioneve antikolonialiste dhe, si e tillë, ajo ka një përmasë dhe një karakter global. Nuk duhet të çuditemi nëse në muajt dhe në vitet që do të vijnë do të shohim që protestat e popullit dhe të studentëve tunizianë kundër regjimit autoritarist 23 vjeçar të “Çausheskëve” të tyre (Presidentit Ben Ali dhe gruas së tij Leila Trabelsi) dhe protestat e popullit dhe të studentëve egjiptianë kundër Presidentit Hosni Mubarak (njeriu që ka sunduar Egjiptin për kohën më të gjatë—30 vjet—pas Mehmet Ali Pashës, themeluesit të atij shteti), do të “përsëriten” në forma dhe intensitete të ndryshme në Burkina Faso, në Nigeri dhe në Kamerun, në Arabinë Saudite dhe në Iran, në Meinmar dhe në Kinë. Siç shkruante pak kohë më parë e përjavshmja amerikane *Nesweek*, “Nga Maroku në Egjipt në Jordani dhe më tej, përmes Internetit dhe telefonëve celularë, lajmi u përhap në këto shoqëri, që kanë qenë të shtypura për një kohë të gjatë, në atë mënyrë që ndikoi rënia e Murit të Berlinit në shembjen e diktaturave të Perandorisë Sovjetike më 1989” (Diskey 2011). Asnjë regjim autokratik nuk është i imunizuar nga revolta e popullit dhe e rinisë së vendit të vet që kërkojnë drejtësi sociale, dinjitet politik dhe kushte njerëzore jetese.

Trajtimi i kësaj çështjeje është shumë i komplikuar dhe kërkon më shumë hapësirë sesa kjo që më lejon ky artikull. Këtu, sidoqoftë, unë dëshiroj të trajtoj çështjen se ç’domethënie kanë për Kinën tronditjet e mëdha politike dhe sociale që po ndodhin në botën arabe dhe a do të mundet vala e tyre të sjellë ndryshime edhe në këtë vend?

“Pamundësia” e ndryshimeve demokratike në Kinë

Vëzhguesit dhe analistët e “revolucioneve arabe” janë, përgjithësisht, të mendimit se “Kina nuk është Egjipti” dhe se ngjarjet në vendet e Magrebit dhe në Lindjen e Mesme nuk do të rezonojnë fuqishëm përtej Murit të Madh kinez. Pa dyshim që regjimi i sotëm kinez dhe regjimi i Hosni Mubarakut në Egjipt (apo regjimet e tjera në vendet arabe) kanë disa karakteristika të ngjashme. Së pari, si njëri, ashtu edhe tjetri,

drejttoheshin apo drejtohen nga një grup oligarkik, i cili, për dekada me radhë, i ka shtypur masat e gjera të popullit dhe ka burgosur apo ka detyruar të heshtin elementët disidentë dhe opozitarë në shoqëritë e tyre. Së dyti, si njëri, ashtu edhe tjetri, kanë luajtur një lojë bizantine në marrëdhëniet me vendet e tjera, duke u angazhuar si me Shtetet e Bashkuara dhe me Perëndimin liberal, ashtu edhe me regjimet më autoritariste në kohën e sotme. Së treti, protestat e mëdha në të dyja vendet (sidomos ato në Sheshin Tiananmen dhe në Sheshin Tahrir) morën shkas dhe u energjizuan kryesisht nga rinia.

Pavarësisht ngjashmërive të tilla, arsyet apo faktorët që i dallojnë Egjiptin (apo vendet e tjera arabe) nga Kina janë të shumta dhe më të rëndësishme. Këto dallime, siç shprehet studiuesi Michael Auslin (2011), “janë kaq të mëdha, sa do ta bënin të padobishme çdo analizë” krahasuese midis tyre. Pse? Çfarë i dallon kaq shumë nga njëri-tjetri vende të tilla, si Egjipti dhe Kina, për të qenë të kujdesshëm në analizat dhe në prognozat tona? Dallimet janë të shumta, por më kryesoret mendojmë se janë:

Së pari, në ngjarjet e Sheshit Tiananmen, më 1989, Ushtria Çlirimtare Popullore (UÇP) e Kinës, ndryshe nga ushtria egjiptiane në Sheshin Tahrir, nuk hezitoi të zbatonte urdhrat e eprorëve të saj komunistë dhe t’i shpytë qytetarët e saj kryengritës, duke vrarë qindra, në mos mijëra studentë dhe përkrahës të tyre. Në këta 21 vjet që kanë kaluar nga ato ngjarje, nuk ka asnjë arsye të besojmë se UÇP-ja është bërë më pak luajale ndaj udhëheqjes komuniste të Kinës. Ndërsa në Egjipt, agravimi i situatës u la të kuptojnë krerëve të lartë të ushtrisë së atij vendi se pozitat e tyre do të forcoheshin nëse e nxirrnin jashtë loje Mubarakun, ushtrisë kineze do i duhej të merrej jo me një individ të vetëm, por me një parti komuniste të tërë, e cila s’mund të detyrohet të lërë pushtetin aq lehtë sa një njeri i vetëm. Një rrethanë e tillë, natyrisht, mund edhe të ndryshojë, por, aktualisht, ushtria kineze vazhdon të identifikohet më shumë se me çdo gjë tjetër me legjitimitetin e regjimit të sotëm të Pekinit, edhe pse elementë të rinj nacionalistë në strukturat e larta të ushtrisë kineze mund të duan t’i zgjerojnë kompetencat e tyre përtej autoritetit të Partisë Komuniste.

Së dyti, në vijim të argumentit të mësipërm, mund të thuhet se regjimi i Pekinit e ka bërë të qartë me ngjarjet e vitit 1989 se ai nuk do të lejojë të bjerë, ose të rrezikohet nga 100,000 apo më shumë protestues që mbushën Sheshin Tiananmen për shtatë javë me radhë, për një kohë, pra, tri herë më të gjatë se 18 ditët e protestave në Kajro, të cilat e detyruan Mubarakun të largohet. Presidenti aktual kinez, Hu Xhintao dhe oligarkia e tij nuk duket se kanë lëvizur nga pozitat e pararendësve të tyre, Ten Sjaopin dhe Li Pen. Fakti që Pekini ka censuruar, qysh nga muaji janar, thuajse çdo lajm nga Egjipti, dëshmon se udhëheqjes së sotme kineze i mungon madje edhe vullneti më i vogël për t’i lejuar qytetarët e vet të protestojnë qoftë edhe në mënyrë paqësore. Kjo, sigurisht, tregon edhe nervozizmin e saj, për shkak se informacioni që marrin çdo ditë mbi 420 milionë kinezë, përdorues të Internetit (*netizens*, siç kanë filluar të quhen sot qytetarët që kërkojnë informacion, ose komunikojnë online), mund të çojë eventualisht në mobilizim dhe radikalizim politik dhe në galvanizim të situatës në atë vend.

Së treti, Egjipti (edhe pse më i populluari ndër vendet arabe, me 83 milionë banorë) dhe Kina ndryshojnë shumë nga pikëpamja demografike. Ata dhjetramijëra

protestues që mbushën sheshet dhe rrugët e Kairos dhe të Aleksandrisë, edhe pse përfaqësonin vetëm një segment të vogël të popullsisë së Egjiptit, mjaftuan për ta detyruar Mubarakun të linte pushtetin, si edhe ushtrinë që të tregohej e përmbajtur. Por në një vend me një popullsi mbi 15 herë më të madhe, një numër i tillë protestuesish nuk do të përbënte një masë kritike. Në një vend me mbi 1.3 miliardë banorë, regjimi autoritarist kinez mund të izolojë dhe të shtypë relativisht lehtë masa qindramijëshe. Këtë, regjimi aktual i Pekinit e bën çdo ditë.

Së katërti, ndryshe nga regjimi i Mubarakut, udhëheqja kineze ka treguar se është e aftë t'i kanalizojë pakënaqësinë dhe zemërimin e rinisë dhe të masave popullore ndaj regjimit komunist në drejtim të një objekti të huaj, siç ndodhi, për shembull, më vitin 2005, kur protestat masive kundër Japonisë që u organizuan në Shanghai dhe në Hanxhou, në fakt, ishin të orkestruara nga vetë qeveria kineze. Fokusi i atyre protestave u bë një çështje thujse abstrakte për qytetarin kinez, siç është kundërshtimi për t'i dhënë Tokios një vend të përhershëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Kina e sotme ka mjaft arsye për t'i manipuluar qytetarët e saj dhe për ta orientuar zemërimin e tyre ndaj problemeve të brendshme në drejtime të tjera, që kanë të bëjnë sa me pretendimet territoriale të Kinës në Detin e Kinës së Jugut, aq edhe me mbështetjen që Amerika u jep Taivanit dhe Japonisë duke u shitur atyre armë të sofistikuar.

Së pesti, ndryshe nga Egjipti, ku fuqitë e mëdha dhe aktorët ndërkombëtarë mund të ushtronin influencën e tyre në punët e vendit, kjo nuk ka të ngjarë të ndodhë me Kinën. Edhe pse Mubaraku ishte një diktator, ai ishte, gjithashtu, një aleat i Uashingtonit dhe përfitonte prej tij një ndihmë rreth 2 miliardë USD në vit. Një rrethanë e tillë bënte që Uashingtoni të ishte në kontakt të vazhdueshëm dhe të kishte ndikim mbi Mubarakun, ashtu siç Pentagoni ishte në kontakt me krerët e ushtrisë egjiptiane. Ka analistë, të cilët mendojnë se fakti që ishte këshilli suprem i ushtrisë egjiptiane ai që vendosi fatin e Mubarakut mund të shpjegohet me presionin e Uashingtonit për t'i ndërprerë ushtrisë egjiptiane ndihmën amerikane, mbi të cilën ajo mbështetet. Një rrethanë e tillë nuk ekziston në marrëdhëniet kino-amerikane. Madje, edhe në kushte normale, Uashingtoni dhe Pekini komunikojnë me vështirësi, ndërsa dialogu politik midis tyre është tepër formal dhe larg çështjeve politike sensitive. Nëse do të imagjinonim në Kinë një krizë të ngjashme me atë në Egjipt, as Uashingtoni dhe as ndonjë fuqi tjetër e madhe nuk do të mund të luanin dot asnjë rol për të ndihmuar një zgjidhje paqësore apo demokratike të saj.

Së fundi, nuk duhet harruar se megjithë natyrën shtypëse, brutale dhe kontrollin e rreptë mbi çdo aspekt të jetës së qytetarëve të saj, udhëheqja e sotme kineze ka meritën se ka ndërmarrë një ndër projektet më të suksesshme modernizuese ekonomike në histori. Edhe pse zhvillimi ekonomik në Kinë është i pabarabartë dhe ndoshta nuk do të mund të ruajë ritmet e derisotme për një kohë të gjatë, ky zhvillim ka nxjerrë nga varfëria ekstreme mbi 400 milionë njerëz, duke i bërë ata pjesë të klasës së mesme dhe vetë Kinën një aktor shumë të rëndësishëm në skenën globale. Egjipti i Mubarakut nuk ishte dhe s'mund të ishte një vend i tillë, madje, nën Mubarakun, varfëria dhe mjerimi në këtë vend vetëm u shtuan, duke çuar në protesta të fuqishme si ato që e

rrëzuan atë nga fronti. Në Kinë, përkundrazi, megjithë pakënaqësinë dhe protestat në rritje të dhjetra e qindra miliona njerëzve që jetojnë në kushte të varfërisë së thellë, janë dhjetra e qindra milionë të tjerë që kanë përfituar nga politikat e qeverisë së sotme kineze dhe nuk duan, ose nuk janë gati, të mobilizohen për përmbysjen e saj.

Pavarësisht nga sa thamë më lart, në politikë asgjë nuk është e sigurt. Megjithë mungesën e stabilitetit në Egjipt gjatë viteve të fundit, askush nuk e kishte parashikuar përshkallëzimin e tillë të ngjarjeve që çuan në rrëzimin aq lehtë të Faraonit Mubarak. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kinën. Analistë të ndryshëm vënë në dukje dobësitë e sistemit politik në këtë vend dhe argumentojnë se ai është në rënie; të tjerë, përkundrazi, theksojnë se pozitat e Partisë Komuniste janë të forta dhe se në Kinë s'do të ndodhë politikisht asgjë edhe për disa gjenerata.

Sidoqoftë, ndoshta gjërat nuk janë fare kështu. Kina nuk është aq e qetë sa duket. Ajo pret një tranzicion tjetër autoritarist në udhëheqjen e saj vitin e ardhshëm, pra më 2012. Deri më sot, zëvendësimet në krye të udhëheqjes kineze kanë qenë relativisht të buta, por kjo s'do të thotë se tranzicionet e ardhshme të elitës në pushtet (për të cilën ne dimë shumë pak), do të jenë pa probleme (Blumenthal 2011). Nëse deri më sot elita kineze ka mundur të mbajë nën kontroll tranzicionin politik në krye të radhëve të saj, kjo mund të mos jetë e mundur edhe më tej. Kina mund të ndeshet me shumë të papritura. Një sfidë e minutave të fundit, një thirrje dhe një lëvizje reformiste për më shumë transparencë në vendimet që kanë të bëjnë me zëvendësimin e drejtuesve në pushtet, madje edhe një gabim nga drejtuesit e sotëm të Kinës mund të çojnë në divergjenca serioze brenda udhëheqjes kineze dhe të provokojnë një lëvizje të tillë politike, përballë së cilës, protestat e Egjiptit, të Tunizisë, të Libisë, të Jemenit, të Bahreinit apo të Sirisë do të dukeshin lehtësisht të menaxhueshme.

Mundësia e ndryshimeve demokratike në Kinë

Një analizë e vëmendshme e politikës së udhëheqjes së sotme kineze, evidenton faktin se ajo, para së gjithash, synon të *maksimalizojë stabilitetin e brendshëm në vend*. Edhe pse këtë synim e kanë të gjitha shtetet, në rastin e Kinës, stabiliteti i brendshëm merr një rëndësi të dorës së parë. Siç vë në dukje Brent Scowcroft, "Udhëheqjen kineze e tremb shumë prishja e stabilitetit...Kjo frikë është një ndër faktorët që motivon politikën e saj. Është pikërisht për shkak të saj që ata i tremben hapjes së sistemit të tyre politikisht" (shih Brzezinski & Scowcroft 2008: 118). Por sa e mundur është që udhëheqja e Pekinit të vazhdojë ta kontrollojë popullin kinez dhe t'i pengojë impulset apo përpjekjet e organizuara në radhët e tij, të cilat eventualisht mund t'u hapin rrugë reformave dhe transformimit demokratik të shoqërisë kineze?

Kontrolli mbi një popullsi, e cila po i afrohet shifrës 1.4 miliard, dhe mbi minoritetet e ndryshme etnike—mbi 40 minoritete të tilla, me rreth 100 milionë njerëz, të cilët popullojnë rreth 60 për qind të territorit të Republikës Popullore të Kinës—(Menon 2009: 355), nuk ka qenë kurrë diçka e lehtë për shtetin kinez, as pas vitit 1949, kur pushteti ra në duart e Partisë Komuniste, as në 150 vitet e trazuara nga

revolta të brendshme dhe nga presionet nga jashtë, të cilat çuan në rënien e dinastisë Çing. Edhe pse në periudhën pas Ten Hsiaopinit Kina nuk ka njohur ndonjë krizë të brendshme serioze politike ose ekonomike, e cila të ketë zgjatur, udhëheqja kineze e di mirë se tronditjet e brendshme nuk mund të përjashtohen. Ajo i ka të freskëta ngjarjet dramatike në Sheshin Tiananmen, më 1989, dhe bën shumë kujdes (sidomos pas ngjarjeve të fundit në Afrikën Veriore dhe në Lindjen e Mesme), që t'i mbajë nën kontroll tensionet social-politike në radhët e popullsisë, e cila po bëhet jo vetëm më e arsimuar, por edhe më e pasur dhe më e angazhuar me botën e jashtme, veçanërisht përmes tregtisë, udhëtimeve dhe Internetit.

Me hapjen e kufijve dhe me përdorimin e teknologjive moderne të informimit dhe të komunikimit, as qeveritë më të forta dhe më autoritariste nuk mund t'i kontrollojnë dot më qytetarët e tyre. Ne e pamë këtë në Bashkimin Sovjetik dhe në Europën Lindore. Po ashtu, e pamë dhe vazhdojmë ta shohim edhe më qartë këtë në vendet arabe. Kjo, pa dyshim, herët ose vonë do të ndodhë edhe në vende të tjera, pavarësisht formës së regjimit jodemokratik, madhësisë së territorit, vendndodhjes gjeografike apo numrit të popullsisë. Asnjë vend autoritarist nuk është i imunizuar ndaj tronditjeve sociale. Kina nuk bën përjashtim, madje, në këtë vend, tensionet sociale janë një dukuri e përhapur. Vetëm në vitin 2005, ushtria dhe forcat e policisë kineze shtypën me dhunë mbi 90,000 protesta, kryesisht në zonat rurale të vendit. Nga mënyra se si lidershpi kinez do të përpiqet t'i mbajë nën kontroll tensionet politike dhe sociale në vend, do të varet shumë stabiliteti ekonomik dhe politik i Kinës sot dhe në të ardhmen.

Një tjetër synim i rëndësishëm i politikës kineze (sidomos nëse marrim parasysh që ekonomia e këtij vendi, e dyta në botë pas ekonomisë amerikane, po bëhet gjithnjë e më shumë e varur nga importet e energjisë dhe të lëndëve të para, si edhe nga tregjet e huaja për shitjen e produkteve të saj), është që të *garantojë ruajtjen e ritmeve të larta të rritjes ekonomike* që ka arritur gjatë tri dekadave të fundit. Përmes kësaj, udhëheqja e sotme e Pekinit përpiqet të gjenerojë *legjitimitet* për politikën e saj dhe të vazhdojë të qëndrojë në pushtet (Terril 2005: 54; Zhao 2005: 76). Duke qenë se në Kinë ideologjia marksiste, si ideologji zyrtare e partisë-shtet, ka humbur rolin e saj të dikurshëm dhe asnjë filozofi tjetër zyrtare nuk e ka zëvendësuar atë, bazat e legjitimitetit të udhëheqjes së sotme kineze, e cila nuk është vënë kurrë përballë konkurrencës së alternativave të tjera politike dhe përpara testit të zgjedhjeve të lira demokratike, mbeten standardi i përmirësuar i jetesës dhe krenaria kombëtare. Sipas një raporti të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes të vitit 2007 (*Military Power of the People's Republic of China: A Report to Congress*), “për të zëvendësuar dështimin e ideologjisë komuniste, PKK e ka mbështetur legjitimitetin e saj në...arritjet ekonomike dhe në nacionalizmin” (USDD 2007: 6).

Alan Greenspan ka vënë në dukje se, “ndërkohë që Kina po hynte gjithnjë e më shumë në rrugën e kapitalizmit, progresi i saj ekonomik u bë një faktor kaq i rëndësishëm, sa që debati ideologjik i viteve të mëparshme duket se tashmë është thjesht një histori e së kaluarës” (Greenspan 2007: 295). Sidoqoftë, marrëdhëniet e shoqërisë së sotme kineze me Marksizmin nuk mund të konsiderohen krejt të papërfillshme. Edhe pse, në praktikë, udhëheqësit e sotëm teknokratë të Pekinit i kanë braktisur Marksizmin, Leninin

dhe Maon, duke krijuar një ekonomi, e cila mund të quhet “leninizëm i tregut”, vetë thelbi i teorisë sociale të Marksit mund të ketë implikime praktike për Kinën. Kjo teori parashikon se me ndryshimin e bazës ekonomike të shoqërisë, në mënyrë të paevitueshme ndryshon edhe sistemi politik. Marksi argumentoi se kur një shoqëri orientohet nga tregu dhe modernizohet, ajo tenton gjithashtu të demokratizohet. Historia dëshmon në mënyrë të qartë korrelacionin që ekziston midis ekonomisë së tregut dhe modernizimit të shoqërisë, nga njëra anë, dhe zhvillimit e konsolidimit të demokracisë, nga ana tjetër, edhe pse kjo ndonjëherë kërkon kohë.

Nëse u referohemi vendeve të tilla si, Korea e Jugut, Taivani, Spanja, Portugalia, Argjentina apo Turqia, tendenca historike ka qenë dhe mbetet e pagabueshme: sa më shumë që regjimet autokratike kanë lejuar, ose lejojnë modernizimin e ekonomive të tyre dhe sa më shumë që një ekonomi e mbështetur në tregun e lirë ka qenë, ose është në gjendje të krijojë një shtresë popullsie, e cila për nga të ardhurat, konsiderohet “klasë e mesme”, aq më i sigurt ka qenë dhe është transformimi dhe konsolidimi i shoqërisë si një demokraci liberale. Kina, sado kohë të marrë transformimi i saj politik, nuk ka pse të jetë një përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm. Siç ka argumentuar Brzezinski (2001: 5), trajektoret e *zhvillimit ekonomik* dhe të *evolucionit politik* të saj do të ndahen prej njëra-tjetrës dhe, herët ose vonë, distanca midis tyre do të rritet në atë shkallë, sa që këto dy trajektore nuk do mund të qëndrojnë më së bashku dhe Kina do të njohë një krizë politike serioze. Si rezultat, ndryshimet pozitive në Kinë do të vijnë kryesisht për shkak të presioneve social-ekonomike, të shkaktuara (pjesërisht në mënyrë të pandërgjegjshme) nga vetë reformat ekonomike racionale që ka ndërmarë elita sunduese e këtij vendi. Efekti i tyre akumulues është në mënyrë inherente i papajtueshëm me represionin politik dhe ushtron gjithnjë e më shumë presion për demokratizimin e këtij vendi. Udhëheqja e sotme kineze e kupton fare mirë këtë dhe, për të evituar daljen e kësaj situatë jashtë kontrollit të shtetit, ka nisur një diskutim publik se si të injektojë “më shumë demokraci”, pavarësisht se ç’kuptojnë ata me këtë, në sistemin e tyre jodemokratik.

Historikisht, faktorët demografikë, të kombinuar me pakënaqësinë ndaj kushteve ekonomike dhe sociale të një vendi, sidomos në radhët e shtresave të mesme të popullsisë, si edhe me mungesën e të drejtave dhe të dinjitetit politik, kanë çuar në konflikte sociale të dhunshme. Sociologu amerikan Jack Goldstone (1991) vlerëson se ishin pikërisht këta faktorë që çuan në Revolucionin Anglez dhe në Revolucionin Francez në shekujt e 17-të dhe 18-të. Will dhe Ariel Durant, nga ana e tyre, në librin *Mësimet e Historisë* (*The Lessons of History*), kanë vënë në dukje se “Revolucioni Francez u krye jo sepse Volteri shkroi satira brilante apo sepse Rusoi shkroi romanca sentimentale, por sepse klasat e mesme kishin marrë në dorë lidhësin ekonomik dhe kërkonin liri legjislative për ndërmarrjet dhe tregtinë e tyre, si edhe pushtet politik...” (Durant & Durant 1968: 52-55). Ndikimi i këtyre faktorëve mund të prodhojë zhvillime të ngjashme edhe në kohën tonë.

Unë mendoj se, herët ose vonë, Kina do të hyjë në rrugën e demokratizimit. Klasa e mesme qindramilionëshe e Kinës nuk mund të pranojë të mbetet për një kohë e gjatë e regjimentuar sipas diktumit të udhëheqjes së sotme të Pekinit “Ju rritni në rrjesht dhe unë ju bëj të pasur”. Siç vë në dukje Alan Greenspan (2007: 310), “Partia Komuniste e Kinës mund të ruajë për një farë kohe një regjim autoritarist, gjoja kapitalist dhe

relativisht të zhvilluar. Por, pa valvulat shkarkuese të procesit demokratik, unë dyshoj në suksesin afatgjatë të një regjimi të tillë”. Megjithatë, ka pak të ngjarë që Partia Komuniste në Kinë të heqë dorë vullnetarisht nga monopoli i saj politik, pra nga pushteti. Nëse kujtojmë masakrën e Tiananmenit, në qershor të vitit 1989, ose revoltën e Xinjangut, në korrik 2009, në të cilën forcat e rendit vranë qindra demonstrues, është vështirë të besohet se lidërshipi kinez nuk do të shtypte me dhunë (njëlloj, madje edhe më keq se Gadafi në Libi), çdo përpjekje për përmbysjen e regjimit të sotëm.

Sidoqoftë, nuk përjashtohet as mundësia që ngjarjet të marrin edhe një rrjedhë tjetër, dhe regjimi i sotëm i Pekinit të bjerë pa dhunë. Siç kam vënë në dukje edhe më parë (shih Tarifa 2006), kush munda ta kishte parashikuar se shembja e Bashkimit Sovjetik apo fundi i regjimit të apartheidit në Afrikën e Jugut do të ndodhnin kaq shpejt dhe në një mënyrë jo të dhunshme?

Referencat

- Auslin, Michael. 2011. “China is No Egypt”, *National Review*, February 22.
- Bell, Coral. 2005. “The Twilight of the Unipolar World.” *The American Interest*, Vol. 1, No. 2, ff. 18-29.
- Blumenthal, Dan. 2011. “What Does the Unrest in the Middle East Tell Us about China?” *Foreign Policy*, February 22.
- Brzezinski, Zbigniew. 2001. *The Geostategic Triad: Living with China, Europe, and Russia*. Washington, D.C.: The CSIS Press.
- Brzezinski, Zbigniew. 2005. “The Dilemma of the Last Sovereign”, *The American Interest*, Vol. 1, No. 1, ff. 37-46.
- Brzezinski, Zbigniew & Brent Scowcroft. 2008. *America and the World: Conversations on the Future of American Foreign Policy*. Moderated by David Ignatius. New York: Basic Books.
- Cilluffo, Frank J., Sharon L. Cardash, and Andrew J. Whitehead. 2007. “Radicalization: Behind Bars and Beyond Borders”, *The Brown Journal of World Affairs*, Vol. 13, No. 2, ff. 113-122.
- Dickey, Christopher. 2011. “Tunisia Riots: The Youth Revolution”, *Newseek*, January 14.
- Durant, Will & Ariel Durant. 1968. *The Lessons of History*. New York: MJF Books.
- Goldstone, Jack A. 1991. *Revolution and Rebellion in the Early Modern World*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Greenspan, Alan. 2007. *The Age of Turbulence: Adventures in a New World*. New York: The Penguin Press.
- Menon, Rajan. 2009. “Pax Americana and the Rising Powers”, *Current History*, Vol. 108, No. 721, ff. 353-360.
- Michael, Maggie & Hamza Hendawi. 2011. “Freed Young Leader Energizes Egyptian Protests”, Associated Press, February 8 (burimi online: http://www.forbes.com/feeds/ap/2011/02/08/general-broadcasting-amp-entertainment-ml-egypt_8298026.html).
- Tarifa, Fatos. 2006. “Facing Tomorrow’s Global Challenges: What Role for Social Science?”, *Journal of Applied Sociology*, Vol. 23, No. 2, ff. 1-19.
- Terril, Ross. 2005. “What Does China Want?”, *The Wilson Quarterly*, Vol. 39, No. 4, ff. 50-61.
- USDD (U.S. Department of Defense). 2007. *Military Power of the People’s Republic of China: A Report to Congress*. Washington, D.C.: Department of Defense.
- Zhao, Suisheng. 2005. “Nationalism’s Double Edge”, *The Wilson Quarterly*, Vol. 39, No. 4, ff. 76-82.

Reformat ekonomike dhe demokratizimi i rajonit Afrikano-Verior nën ndikimin European

— Dr. Nevila Xhindi, UET —

ABSTRAKT. Paqartësitë politike për zhvillimin rajonal, shqetësimi për rezervat energjetike dhe flukset e migracionit kulmuan me rënien e pushteteve autoritare në Tunizi dhe Egjipt në pranverën e 2011-tës dhe pasuan me trazirat në të gjithë botën arabe. Kjo tregoi se politika perëndimore për stabilitet të bregut jugor dhe lindor të Mesdheut ishte ndërtuar mbi rërë. Për Evropën, kjo situatë është gjithashtu një padi e rëndë e politikave evropiane të “fqinjësisë” me botën arabe. Bashkimi Evropian, për rreth gjysmë shekulli, është përpjekur të eksportojë zhvillim socio-ekonomik dhe politik në këtë rajon, por rezultatet kanë qenë, jashtëzakonisht modeste, veçanërisht kur krahasohen me transformimet mbresëlënëse të BE-së në Evropën Qendrore dhe Lindore, madje edhe në Ballkan.

Përse Mesdheu Afrikan pamvarësisht liberalizimit ekonomik ka vazhduar të ketë pak ose aspak liberalizim politik? Përgjigja e kësaj pyetje kërkon një analizë specifike të natyrës ekonomike të reformave të ndërmarra dhe të efekteve të tyre tek aktorët ekonomik.

Ky artikull, duke analizuar rastin e dy vendeve të rajonit Mesdhetar -Afrikan, atë të Tunizisë dhe Egjiptit, përmes argumenteve, sjell në vëmendje lidhjen e ngushtë që ekziston mes liberalizimit ekonomik dhe atij politik. Në 15 vitet e fundit reformat ekonomike në këto vende kanë qenë të lidhura dhe kanë mbështetur në një shkallë të lartë politikën autoritariste. Gjithashtu artikulli trajton ndihmën dhe mundësitë e rritjes që ekonomitë dhe tregu global, dhe veçanërisht Bashkimi Evropian, u ka dhënë këtyre vendeve. Aktualisht, në dekadën e fundit BE e ka orientuar politikën e saj të bashkëpunimit me vendet Mesdhetare drejt reformave ekonomike. Kjo është bërë e mundur duke përdorur instrumentat financiarë dhe duke mbështetur gjithashtu modernizimin e sistemit të prodhimit dhe kuadrin ligjor ekonomik.

Fjalë kyçe: Reforma ekonomike, demokratizim, demokraci e brishtë, modernizim sistemi

Demokracia e brishtë dhe reformat ekonomike në Afrikën Veriore

Në literaturën mbi demokratizimin e vendeve të Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Mesme është e vështirë të gesh një rrymë të qartë të mendimit mbi ndryshimet politike që duhet ose jo të ndodhin atje. Ky boshllëk në këtë rast ka ndodhur ndoshta për faktin se teoricienët e demokratizimit janë bazuar shumë në analizimin e një variabli të varur, e ndërkohë kanë neglizhuar të testojnë kuadrin e tyre logjik në vende që zgjidhjet demokratike i kishin dhe i kanë shumë të vështira (United Nation Development Program, 2005). Më së shumti, analizat për demokratizimin e këtyre vendeve mbështeten në variablin e brendshëm, i cili ishte shumë larg në aspektin e liberalizimit të politikave, si ato kulturore, fetare, socio-ekonomike dhe përfshirjen e shoqërisë civile. Faktorët e brendshëm, si p.sh elitat, të cilat ushtronin presion, apo mungesa e kredencialeve demokratike për opozitën dhe gjithashtu edhe mungesa e një klase të gjerë punëtore në industri, mundet të kenë ndaluar demokratizimin e këtyre vendeve. Në këtë analizë nuk mundet të anashkalojmë edhe variabëlën ndërkombëtar, i interesuar për një *status quo* demokratizimi dhe mbështetës i qeverive autoritare të këtyre vendeve (Chaudhry, 1998). Gjithashtu, këto vende, ashtu si dhe ato të Evropës Lindore e Juglindore, kanë qenë të ekspozuara ndaj forcave dhe ndikimeve ndërkombëtare si: reduktimi i mundësive për kredi; reduktimi i investimeve të huaja; vartësi e lartë ndaj tregtisë me vendet e zhvilluara kapitaliste; kushtet e borxhit të diktuar nga Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore; vartësia nga ndihma e huaj e SHBA-së dhe BE-së; të ekspozuar nëpërmjet valëve satelitore me mediat perëndimore; afërsia me Europën dhe eksperiencia në Europë nëpërmjet migrimit apo arsimimit të elitave; dhe reduktimi pas 1990-s i konflikteve rajonale ndërshtetërore (Hellman, 1998). Gjithsesi, literatura mbi demokratizimin e vendeve të Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Mesme ende nuk ka shpjeguar përse të gjithë këto variable kanë ndikuar pak ose aspak në liberalizimin politik, i cili kishte hyrë në ngërç të plotë dhe kërkonte zgjidhje.

Literatura e ekonomisë politike e adreson çështjen e demokratizimit duke shpjeguar impaktin e ushtruar në reformat ekonomike dhe ndryshimet politike nga ekonomia globale (Alissa, 2007). Shumë nga kjo literaturë fokusohet tek presioni i aktorëve të rinj ekonomik, zhvillimet në teknologji dhe tregëti, dhe kërkesat e reja për tregun me të cilin sot përballen këto shtete. Rezultati i sa më lart do të ishte politika e re, koalicionet politike dhe institucione të reja në politikën e brendshme. Kjo qasje i shikon politikat ekonomike dhe reformat të imponuara nga tendencat ndërkombëtare të ndryshimit të çmimeve, flukseve financiare, tendencave tregtare, të gjitha këto ushtrojnë presion mbi forcat sociale, që nga ana e tyre ushtrojnë presion për ndryshim ndaj elitave shtetërore. Shpesh kjo qasje është parë si pjesë e lobimit të sektorit privat dhe interesave të tyre (Dillman, 2002).

Për t'iu kthyer argumentit tonë, në Tunizi dhe Egjip sektori privat ka qenë realtivisht i dobët dhe jo i strukturuar. Biznesi privat historikisht nuk është llogaritur si pjesë e rëndësishme e GDP-së, dhe ka qenë i përjashtuar nga sektori strategjik i

ekonomisë. Në kontrast me këtë, sektori i ndërmarrjeve publike dhe punëtorët kanë qenë aktorët kryesore ekonomik të cilët mund të ndikonin në politikbërjen e shtetit. Në kushtet e mungesës të një sistemi multi partiak dhe partive me bazë të gjërë, që të mund të artikulonin politika ekonomike, veçanërisht politikat neo-liberale nuk kishin vend. (Bellin, 2004)

Bashkimi European e ka bazuar politikën e vet në Afrikën Mesdhetare në një numër hipotezash problematike, që janë shumë të dallueshme në literaturën e demokratizimit dhe ekonomisë politike. Një nga këto hipoteza është edhe që zhvillimi ekonomik do të çojë drejt liberalizimit politik, dhe kështu drejt demokratizimit. Siç Brynjar Lia thotë: “Kurioze të zbulosh, që ka doza Marksiste në këtë qëndrim të Europës ndaj sfidave përpara vendeve të Mesdheut në sensin që presupozohet liberalizimi politik do të ndodhë vetëm atëherë kur të jetë siguruar “baza” ekonomike” (Lia, 1999). Kështu, BE besonte që incentivat ekonomikë dhe presioni i moderuar ndaj qeverive për të mbështetur reformat ekonomike bazuar në Konsensusin e Uashingtonit, në mënyrë të ngadaltë, por të pakthyeshme do të reduktojë fuqinë e qeverisë, do të rrisë dhe shpërndajë influencën e sektorit privat dhe do të mundësojë zbatimin e ligjit. Kjo qasje do të ndikonte në këto 15 vitet e fundit në qeveritë autoritare të Tunizisë dhe Egjiptit, por risku i reformave të pjesshme do të ishte prezent.

Kohëve të fundit rritja e GDP në rajon ishte mbi 6 për qind (World Bank, 2007) më shumë se një dekadë më parë. Reformat ekonomike u kthyen në një sukses edhe pamvarësisht mungesës së reformave politike. Por ekonomitë e tregut nuk mund të ekzistojnë pa sistemet demokratike që mbrojnë pronën, të drejtat mbi të dhe mundëson pjesëmarrjen në ekonomi, e hapur për të gjithë në kushte të barabarta. Demokracia nuk mund të jetë e arritur në mungesë të tregut të lirë, sepse ekonomia e tregut dhe qeverisja demokratik plotësojnë njëra-tjetrën dhe ndajnë të njëjtat vlera kryesore: sundimin e ligjit, konkurrencën, pjesëmarrjen, transparencën, përgjegjësisë, lirinë, barazinë, dhe reagimin (John D. Sullivan and Anna Nadgrodkiewicz, 2008).

Bashkëpunimi i BE-së me vendet e Mesdheut Jugor (Afrika e Veriut)

Marrëveshjet për bashkëpunim të BE-së me vende të veçanta mesdhetare, në të ashtëquajturin “mare nostrum”, duke përfshirë këtu edhe Egjiptin, datojnë që nga fundi i viteve 1950, vazhdojnë me marrëveshjen “Politika Globale e Mesdheut” (1972-1991), e ringjallur me emrin Politika e Mesdheut në vitet 1991-1995, me Deklaratën e Barcelonës të vitit 1995 për themelimin e Partneritetit Euro-Mesdhetar, dhe pastaj me Politikën e Fqinjësisë Evropiane që janë në veprim që nga viti 2003. Ndërkohë që revoltat në vendet e Mesdheut janë përhapur me shumë shpejtësi, politika Evropiane për Mesdheun është futur në ngërç. Edhe instrumenti i ri politik i lançuar në 2008-ën “Unioni për Mesdheun” (UFM) përfundimisht është bërë irrelevant. Dokumenti Strategjik 2007-2013 i bashkëpunimit të BE-së me Egjiptin kishte identifikuar atë që nuk shkonte dhe ishte e gabuar me Egjiptin, dhe rekomandonte që të gjitha problemet

duheshin trajtuar duke punuar ngushtësisht me autoritetet egjiptiane, përfshirë këtu përmirësimin e të drejtave të njeriut, luftën ndaj korrupsionin, si dhe progresin e reformave demokratike dhe ekonomike, sundimin e ligjit dhe qeverisjes së mirë. Kundërthënia e kësaj qasje është ilustruar me fjali të tilla si kjo: “asistenca ekonomike e BE-së do të synojë forcimin e kulturës së respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, të kapaciteteve dhe efikasitetit të të gjitha institucioneve kompetente, duke përfshirë dhe jo vetëm policinë dhe aparatin e sigurisë kombëtare” (European Union, 2007). BE-ja gjithashtu shpresonte që përmes stabilitetit politik të nxiste mirëqenien e rajonit në vetvete, por edhe mirëqenien e vet, nëpërmjet hapjes së tregjeve të rajonit si dhe rritjes së sigurisë për furnizimin me naftë, dhe kjo e shprehur qartë në marrëveshjet e bashkëpunimit me Egjiptin.

Kështu Europa dhe rajoni Afrikanor-verior kanë bashkëpunuar në një pafundësi marrëveshjesh: të gjitha për të avancuar paqen, stabilitetin, prosperitetin dhe të drejtat e njeriut, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, dhe të demokracisë. Modeli për këtë bashkëpunim ka qenë ai i OSBE-së në procesin e mbështetjes për Evropën Lindore dhe Juglindore, me tre shtyllat e saj; atë të çështjeve politike dhe të sigurisë, ekonomisë, dhe atë të aspekteve socio-kulturore, duke përfshirë gjithkund të drejtat e njeriut. Megjithatë, ndërsa procesi i OSBE-së luajti një rol të rëndësishëm në transformimin e Evropës, përpjekjet e BE-së ndaj fqinjëve të saj jugorë nuk rezultuan frutdhënëse, pavarësisht shpenzimeve të konsiderueshme, përpjekjeve të herë pas herëshme, si dhe burimeve njerëzore dhe financiare të panumërta.

Megjithëse Europa nuk është e vetmja që ka mbështetur reformat ekonomike në këtë rajon, si BE ajo predominon me sasinë e kapitaleve të investuara dhe me tregtinë e bërë. Sigurisht, pamja e plotë e investimeve në rajon përfshin edhe Shtetet e Bashkuara, Japoninë dhe Shtetet Arabe. Egjipti dhe Tunizia kanë përfituar më shumë se vendet e tjera nga mundësia për të marrë grante dhe kredi në vlera të mëdha, nga investimet e huaja direkte, nga fatura turistike apo të ardhurat nga migracioni në Europë etj, pamvarësisht se asnjë nga këto mundësi nuk është shoqëruar me liberalizime të tregut nga ana e elitave qeverisëse të këtyre dy vendeve. Grantet nga BE mbështetur në programin për Partneritet Euro-Mesdhetar Faza parë për vitin 1995-1999 ishin shumë domethënëse dhe arrinin një total prej 1.9 bilion Euro (Commission of the European Communities, 2000). Këto vlera u dyfishuan gjatë implementimit të fazës së dytë në vitet 2000-2006. Kjo ndihmë e BE-së mbështeste projektet në fushën e administrimit publik, financave publike, reformat ekonomike dhe projektet e zhvillimit social. Pamvarësisht angazhimit të BE-së me fonde konkrete, disbursimi ishte në vlerat 25-30%, gjë që tregonte fuqinë thithëse dhe zbatuese të dobët të qeverive autoritare të Tunizisë dhe Egjiptit, të cilat nuk krijonin as mjedisin për të mbështetur me reforma të plota e jo pjesore keto investime të BE-së.

Analizë e reformave ekonomike pjesore dhe ndikimi në demokracinë e Tunizisë dhe Egjiptit

Gjatë vitit 2011, performanca ekonomike e Egjiptit dhe Tunizisë do të bjerë dukshëm. Në nivelin makroekonomik kjo do të duket në ngadalësimin e menjëhershëm të rritjes së GDP-së, rritjen e çmimeve për konsumatorin, zhveftësimin e monedhës vendase dhe

rritjen e fortë të deficitit buxhetor. Kjo rënie shpjegohet nga një sërë faktorësh të cilët ndikuan në prodhimin, konsumin dhe flukset e kapitalit. Për t'i analizuar shkurtimisht:

Ndërprerja e vazhdueshme e *aktiviteteve prodhuese* ka dëmtuar pothuaj çdo sektor: turizmi gjithashtu ka vuajtur nga rënia drastike e fluksit të turistëve të huaj, e gjithë kjo ka ndikuar rënien dukshëm të nivelit të punësimit në këtë sektor.

Konsumi është ndërprerë shpesh nga pamundësia e shpërndarjes në kohë të produkteve, si dhe nga zhdukja e menjëhershme nga tregu i disa produkteve esenciale, të frenuara nga pasiguria dhe objekt i spekulimeve.

Ngrirja e *Investimeve të huaja direkte* ndodhi në të njëjtën kohë me largimin e papritur të investimeve të huaja që vepronin dhe atyre të parashikuara për të ndodhur, si dhe me largimin nga vendi të vlerave kapitale të konsiderueshme.

Këtë vit deficitin buxhetor i Tunizisë dhe Egjiptit do të shënojë rritje. Rënia e menjëhershme e eksporteve, "fatura" e turizmit-maksimalisht e reduktuar dhe largimi i kapitaleve themelore, ndikuan ndjeshëm në balancën e pagesave për deficitin buxhetor. Në 10 vitet e fundit, ekonomia Tuniziane dhe ajo Egjiptiane, si shumë nga ekonomitë e tjera të Mesdheut, shënuan rritje, gjë që ka mundësuar bilancin pozitiv të pagesave dhe reduktim të deficitit buxhetor, reduktim i borxhit të huaj dhe rritje e pronësisë mbi asetet e huaja (Zallio, 2010). Kjo histori/bilanc pozitiv i deritanishëm, mund të ndihmojë që këto vende të mund të mbahen edhe për 2011, pa pësuar ndonjë goditje drastike financiare deri në krizë. Ndihma e huaj, afatshkurtër dhe afatgjatë, nga BE dhe SHBA duhet dhe janë shumë të nevojshme për të rimëkëmbur dhe rritur qëndrueshmërinë e reformave ekonomike të këtyre vendeve.

Në terma afatgjatë Egjipti dhe Tunizia tregojnë prosper ekonomik. Kjo mbështetet sot në të pasurit e një force të re pune, relativisht e aftësuar profesionalisht, shpirtit sipërmarrës të arabit sidomos në një kontekst të ri ekonomik, e mbështetur e gjitha mbi një platformë të re politike qeverisëse. Por realizimi i këtij skenari entuziast e pozitiv kërkon politika ekonomike adekuate ku bashkëpunimi European mund të luaj një rol të rëndësishëm dhe pse jo vendimtar.

Këtij skenari pozitiv ndërkohë i bashkëlidhen edhe shumë rrisqe. Qeveritë e Egjiptit dhe Tunizisë, në kërkim të një legjitimiteti popullor, do të joshen ndoshta dhe do ndërmarrin masa ekonomike populiste me efekte afatshkurtra, edhe nëse këto mund të kenë efekte negative në të ardhmen afatgjatë. Prioriteti i autoriteteve të reja, gjatë përcaktimit të axhendës ekonomike, sigurisht do të jetë punësimi në vlera maksimale, veçanërisht punësimi i të rinjve dhe rregullimi i çmimeve për produktet bazë. Kjo ka gjasë të çojë drejt ndërprerjes së privatizimeve dhe rritjes së punësimeve në sektorin publik dhe sektorët gjysëm publik si dhe mbajtjen nën kontroll të çmimeve të produkteve bazë, me qëllim të paktën mos rritjen e çmimit dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në vazhdim, këto masa kanë gjasa të çojnë drejt politikave proteksioniste për promovimin e produktit vendas ndaj atij të huaj. Bazuar në eksperiencën edhe të vendeve të tjera, ndërmarrjet e mësipërme sigurisht që do të kenë impakte të menjëhershme, por pa pretenduar në qëndrueshmërinë e tyre në të ardhmen, pasi jetëgjatësia e tyre çon drejt

krizës së borxhit. Po kështu, këto masa do të dekurajojnë investimet e huaja direkte dhe kështu do të ngadalësojnë integrimin e ekonomive Tuniziane e Egjiptiane në ekonominë ndërkombëtare, duke kthyer në të kundër edhe progresin dhe reformat e ndërmarra deri tani në këto vende dhe do të ketë ndikim të madh në rajon.

Tendencat populiste janë vënë re më së shumti në Egjipt. Ushtarakët dhe kundërshtarët e regjimit, janë shumë kritikë ndaj reformave ekonomike të ndërmarra në Egjipt gjatë dekadës së fundit. Gjatë viteve 2004-2011 reformat ekonomike në Egjipt janë zhvilluar dhe menaxhuar nga një grup teknokratësh dhe biznesmenësh të lidhur ngushtësisht me pushtetin autoritar, por këto reforma kanë rezultuar shumë efektive në nxitjen e rritjes ekonomike dhe përmirësimin e indikatorëve makroekonomikë. Për më shumë, perceptimi ndërkombëtar për ofertat dhe mundësitë ekonomike që ofronte vendi nxitën investimet e huaja direkte (Alissa, 2007). Gjithsesi, pamvarësisht impaktit pozitiv makroekonomik të reformave, papunësia qëndroi në vlera të larta, veçanërisht të rinjtë, inflacioni në rritje (pjesërisht i lidhur edhe me krizën botërore të ushqimit) gërreu xhepat e të varfërve. Nga reformat ekonomike përfituar kryesisht elitat e biznesmenëve dhe politikanëve. Për më shumë, zhvillimi ekonomik krijoi një shtresë të rinjsh të shkolluar mirë dhe zotërues të teknologjive të fundit të informacionit dhe dijes, zhgënjimi dhe revolta e të cilëve ndaj politikës vendase rritej çdo ditë. Sigurisht, të gjitha keto krijuan premiset e revoltës.

Paradoksisht, reformat ekonomike të dekadës së fundit në Egjipt po kritikohen ashpër nga opozita e kryesuar nga ushtarakët, e cila i shikon ato vetëm si favorizuese dhe mbështetëse të ish pushtetit autokrat dhe eletave përreth tij. Biznesmenët dhe teknokratët që drejtuan këto reforma janë përjashtuar tashmë nga qeveria aktuale egjiptiane. Shumë prej tyre janë nën investigim për korrupsion dhe nuk lejohen të lënë vendin, si dhe llogaritë e tyre bankare janë ngrirë. Duke pasur parasysh rolin e leadershipit aktual në ekonomi dhe vizionin e shpalosur prej tyre për të ardhmen, mbase reformat ekonomike do të kenë shumë shpresë.

Duke pasur parasysh këtë analizë të risqeve, BE mund të implementojë mekanizma të rinj të asistencës financiare për vendet e Afrikës Veriore, duke mbështetur objektivat bazë të reformave ekonomike të filluara gjatë dekadës së fundit, duke ndihmuar në riformulimin e tyre me qëllim një impakt social më të madh dhe duke siguruar transparencë. Në fakt, sfida më e madhe ekonomike gjatë këtij transformimi politik të këtyre vendeve, është rishikimi i reformave ekonomike nën një dritë transparente, duke evituar efektet negative sociale dhe pa hedhur poshtë progresin e arritur në vitet e kaluara. Transparenca do të kufizojë rolin e rrethëve të politikanëve, biznesmenëve dhe do të reduktojë klientelizmin, nepotizmin dhe korrupsionin. Adoptimi i politikave efektive për mbështetjen e SME-ve do të inkurajojë dhe shumëfishojë aktorët ekonomik, do të reduktojë ndërvartësinë e sektorit ekonomik nga ai politik, dhe do të mundësojë punësim (Zallio, 2010). Një sistem i ri pagash dhe politika fiskale që kanë në mendje edhe impaktin social të reformave ekonomike do të promovojë rishpërndarjen e fitimit nga prodhimi. Kjo duhet të pasohet nga reformat për mirëqenie, të cila nuk duhet të bazohen vetëm tek rregullimi apo kontrolli i çmimeve, dhe subvencioni nga

shteti, por duhet të targetojnë varfërinë dhe disavantazhet sociale. Së fundmi, arsimi dhe shëndetësia duhen reformuar nga themelet.

Konkluzione

Të gjitha sa më sipër janë çështje të njohura dhe të mbështetura nga BE dhe eksperiencia e saj me vendet në zhvillim, mbështetje institucionale, mbështetje e reformave ekonomike dhe deri në mbështetje të shoqërisë civile. Kjo lloj mbështetje e neglizhuar në të kaluarën, është shumë aktuale sot. Adresimi i problematikave të mësipërme mund të gjenerojë një platformë të re bashkëpunimi BE-Vendet Mesdhetare, duke rimodeluar instrumentat ekzistues të bashkëpunimit, dhe duke krijuar edhe të rinj, duke mbështetur institucionalisht transformimet politike në rajon dhe duke përmirësuar impaktin e tyre ekonomik. Asistenca financiare më frytdhënëse e BE-së ndaj Egjiptit dhe Tunizisë në stadin aktual është padyshim reformimi i reformave ekonomike. Sigurisht, në kushtet aktuale të një qeverisjeje tranzitore, aktorët në pushtet mund të kenë edhe interesa për ta mbajtur të centralizuar ekonominë, ky nuk duhet dhe s'mund të jetë edhe qëndrimi i opozitës. Nisur nga qëndrimi i deritanishëm European, për të ruajtur me çdo kusht stabilitetin e rajonit, duhet thënë që pretendimi për zgjidhje të shpejta dhe transformim pozitiv në vendet e Mesdheut, megjithëse zgjidhjet ndaj Tunizisë dhe Egjiptit dukeshin positive, është ende larg. Europa duhet të kërkojë zgjidhje tek adaptimi i politikave të saj ndaj këtyre çështjeve. Sigurisht, parë në këtë vështrim, të parat do të jenë ndryshimet në politikë, por absolutisht me vëmendje, në mos të mbështetura nga çështjet ekonomike. Bashkëpunimi ekonomik shumë shpejt do kthehet në prioritet rajonal për të siguruar qëndrueshmërinë politike. Ky bashkëpunim do të mbështetet mbi instrumentat aktuale Europiane, të cilat janë ekonomike.

Literatura

- Alissa, S. (2007). *'The challenge of economic reform in the Arab World'*. Carnegie Papers.
- Bellin, E. (2004). *'The political-economic reform in the Middle East and North Africa'*. Carnegie papers, *Midle East series*, No. 53, 13-14.
- Chaudhry, K. A. (1998). *'The price of Wealth: Econimies and institutions in the Middle East'*. Ithaca: Cornell University Press.
- Commision of the European Communities. (2000). *'Annual report of the MEDA program 1999'*. Brussels: <http://europa.eu.int>.
- Dillman, B. (2002). *'International Markets and partial economic reforms in North africa: What impact on democratization'*. EBSCO Publishing.
- European Union. (2007). *'Egypt: Country Strategy Paper 2007-2013 and National Indicative Programme 2007-2010'*. EU Commission.
- Hellman, J. (1998). *'Winners take all: The politics of partial reform in postcommunist transitions'*. *World Politics*, 203-34.

- John D. Sullivan and Anna Nadgrodkiewicz. (2008). 'Middle East and North Africa Reform: rooted in Economic and Political ground'. *Economic Reforms*, 8.
- Lia, B. (1999). 'Security challenges in Europe's Mediterranean periphery-Perspectives and policy dilemmas'. *European Security*, p. 33.
- United Nation Development Program. (2005). '*Arab human development report 2004: Towards freedom in teh Arab World*'. New York: UNDP.
- World Bank. (2007). '*Middle East and North Africa region 2007*'. Washinton D.C.: World Bank.
- Zallio, F. (2010). '*Reforming Economic Reforms:Europe and the Ongoing Transformation in Mediterranean countries*'. German Marshall Fund.

Cilat janë grupet e interesit që kanë më tepër influencë në vendimmarrjen e BE-së?

—— Besarta Vladi, UET ———

ABSTRAKT. *Diskutimet mbi mënyrën e vendimmarrjes brenda institucioneve të BE-së, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të shumta. Disa autorë mendojnë se vendimet e institucioneve të BE-së janë pothuajse plotësisht të izoluara, kështu që grupet e interesit nuk kanë influencë ndaj vendimeve të BE-së. Disa të tjerë janë të mendimit se ka shumë grupe interesi që influencojnë BE-në, dhe në këtë kuptim, vendimet janë produkt i interesave të shumëanëshme. Në fakt, nuk është e thjeshtë për këto grupe interesi, të jenë të suksesshme në rrugën e tyre për të influencur BE-në. Gjithashtu, nuk mund të thuhet që të gjitha grupet janë patjetër të suksesshme ose njësoj të suksesshme, sa i përket aspektit të influencimit. Cdo grup përdor një ose më shumë strategji për të influencuar vendimet e BE-së por rezultatet nuk janë të sigurta. Sidoqoftë, duke ju referuar një numri të madh autorësh dhe artikujsh, grupet e biznesit rezultojnë më të suksesshmet në aftësitë dhe mundësitë e tyre për të ndikuar në vendimmarrjet e BE-së. Kjo ese synon të shpjegojë disa nga arsyet kryesore që ndikojnë pozitivisht në suksesin e tyre influencues.*

Fjalë kyçe: *grupe interesi, akses, influencë, strategji influencimi*

Hyrje

Edhe pse studiuesit dëshirojnë të shkruajnë në lidhje me vendimmarrjen e BE-së dhe në lidhje me grupet e interesit që influencojnë këtë vendimmarrje, burimet e informacionit janë vërtetë të kufizuara. Tre burimet kryesore të informacionit janë: së pari, CONECCS, database-i i Komisionit European, ku regjistrimi i grupeve të interesit bëhet me bazë vullnetare. Këto grupe mund të marrin pjesë në takimet që organizon Komisioni, ato mund të kenë perfaqësuesit e tyre në

diskutime të ndryshme, ose të marrin pjesë thjesht si dëgjues. Burimi i dytë është Regjistri i Akreditimit i Parlamentit Europian. Në këtë regjister janë të regjistruar të gjitha grupet e interesit pasi vetëm duke qenë të regjistruar, kanë të drejtën të pajisen me fletë-hyrje të posaçme, të cilat u japin atyre akses pjesëmarrjeje në takimet dhe konferencat e institucioneve të BE-së. Burimi i tretë është Drejtoria e Punëve Publike Europiane. Ky është një regjistër komercial i grupeve të interesit, firmave, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, aktorëve rajonal etj. (Wonka et al, 2010).

Edhe pse është e vështirë të gesh informacion të saktë rreth grupeve të interesit që influencojnë vendimet e BE-së, ekziston një numer i konsiderueshëm artikujsh akademik rreth tyre. Bazuar në këta artikuj, kjo ese do të përqendrohet më tepër në grupet e interesit të biznesit dhe në influencën e tyre tek institucionet e BE-së. Keto grupe janë klasifikuar si grupet më me influencë në vendimarrjen e BE-së. Kjo ndodh për shume arsye që do të shpjegohen më poshtë. Ideja kryesore është se grupet e biznesit kanë më shumë akses dhe janë më të suksesshme në përpjekjen për të ndikuar vendimet e BE-së (Coen, 2007). Pyetja kryesore këtu është: pse grupet e biznesit janë më të suksesshme se grupet e tjera në lidhje me influencimin e BE-së? Metodologjia që do të përdoret gjatë përpjekjes për t'i kthyer një përgjigje kësaj pyetje, do të jetë një krahasim i vashdueshëm midis grupeve të biznesit dhe grupeve të tjera influencuese me karakter jo-fitimprurës.

Ky punim do të ndahet në dy pjesë: Pjesa e parë do të flasë për grupet e interesit në përgjithësi, brenda BE-së. Në këtë pjesë, diskutimet do të jenë të përqendruara në këto pyetje: Cfarë lloje grupesh interesi influencojnë vendimet e BE-së? A kanë qenë të gjitha këto grupe gjithmonë kaq aktive në këtë proces, apo influenza e tyre ka qënë e ndryshme në kohë të ndryshme? Cilat nga këto grupe interesi rezultojnë më të suksesshme? Cfarë mund të themi për origjinën e këtyre grupeve dhe çfarë është interesante lidhur me to? Sigurisht, nuk ka ndonjë përgjigje definitive për këto pyetje por gjithsesi mund të jepen disa përgjigje alternative. Gjithashtu, në këtë pjesë do të flitet lidhur me pengesat kryesore për të marrë informacion mbi grupet e interesit. Në mënyrë të përmbledhur, janë tre pengesa: 1) Si mund ta përcaktojmë dhe përkufizojmë konceptin e 'Fuqisë/Pushtetit' dhe atë të 'Influencës' dhe si mund ta bëjmë ndryshimin midis tyre? 2) Vështirësia për të matur rrugët e ndryshme të influencimit në BE. 3) Dhe e fundit është vështirësia për të matur influencën në vetëvete (Dur, 2008).

Pjesa e dytë dhe më e rëndësishme e kësaj eseje do të jetë diskutimi rreth grupeve të biznesit, si grupe interesi shumë influencuese në BE: Sa të suksesshem janë dhe pse? Cilat karakteristika i diferencojnë këto grupe nga grupet e tjera? Shkurtimisht, këto karakteristika janë: avantazhi krahasues, kapaciteti organizativ, burimet financiare, ekspertiza dhe informacioni, etj. (Coen, 2007). Kush janë strategjitë kryesore për të influencuar BE-në? Krahasimi ndërmjet grupeve të biznesit dhe atyre jo të biznesit na jep mundësinë për të marrë një lloj përgjigje. Në këtë mënyrë, lehtësisht mund të shohim diferencat midis tyre dhe mund të arrijmë në një ide se përse grupet e biznesit janë më të suksesshem se grupet e tjera në lidhje me influencën në BE.

BE dhe Grupet e Interesit

Shpesh BE konsiderohet si organizatë mbi- nacionale e cila, në shumicën e rasteve, është e ndarë dhe jo e influencuar nga grupet e interesit ose nga individët në përgjithësi. Në kundërshtim me këtë ide të përgjithshme, shumë studiues mendojnë se institucionet e BE-së nuk janë kaq të influencuara nga grupet e interesit. Gjithsesi, grupet e interesit kanë impaktin e tyre në vendimet e BE-së, pavarësisht nivelit të kësaj influence. Këto grupe janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri në termat e burimeve, karakteristikave, strategjive, por megjithatë kanë të njejtin qëllim: të kthejnë apo transformojnë zërin e tyre individual në një politikë konkrete dhe përfundimtare nga institucionet e BE-së.

Duke ju referuar Berkhout and Lowery (2010), ekzistojnë të paktën dy teori kryesore që tentojnë të shpjegojnë mënyrën se si influenca e grupeve të interesit në vendimmarrjen e BE-së ka ardhur duke u rritur. E para thotë se përfaqësimi i interesave në BE rritet përmes një procesi akumulimi të këtyre interesave. Shpjegimi tjetër thotë se është një proces vetë-rregullator në grumbullin total të interesave dhe ne mund të shohim të lindë një grup i ri interesi vetëm kur një grup i vjetër falimenton. Megjithatë, përtej këtyre dy shpjegimeve teorike, numri i grupeve lobuese brenda institucioneve të BE-së po rritet çdo ditë por numri i grupeve të interesit që me të vërtetë arrijnë të influencojnë vendimet e BE-së është absolutisht i limituar.

Disa hipoteza interesante janë sygjeruar nga Eising rreth mundësive institucionale të grupeve të interesit brenda BE-së. Sipas tij, grupet e interesit kanë më shumë mundësi për të kontaktuar me Komisionin e BE-së se sa me institucionet e tjera të BE-së. Një hipotezë tjetër pohon se këto grupe mund të kenë më shumë kontakte me Parlamentin e BE-së se sa me Këshillin e BE-së. Hipoteza e fundit mbron idenë se këto grupe mund të kenë më shumë kontakte me punonjës të nivelit mesatar brenda institucioneve të BE-së, se sa me udhëheqësit e lartë politik (Eising, 2007: 388-9). Është e nevojshme për tu theksuar se këto hipoteza janë më të vlefshme për grupet e interesit të biznesit dhe organizatave se sa për ato që nuk janë grupe biznesi, si NGO-të e ndryshme.

Grupet e Interesit: Tre pengesat kryesore për të marrë informacion

Kemi përmendur pak më sipër tre arsyt kryesore që shërbejnë si pengesë për të marrë informacion mbi grupet e interesit. Për t'i sqaruar më tej, e para është vështirësia për të përcaktuar dy koncepte të rëndësishme: influenca dhe pushteti. Shpesh herë, këto dy koncepte përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit. Në fakt, ato nuk mund t'a zëvendësojnë njëri-tjetrin devotshmërisht. Një grup interesi mund të ketë pushtet por jo influencë. Një tjetër mund të ketë influencë por jo pushtet. Dhe dy ekstremet janë kur njëri grup interesi mund t'i ketë të dyja dhe tjetri nuk mund të ketë asnjërin. Për shembull, grupet e biznesve i kanë të dyja, pushtetin dhe influencën. Pse ndodh kjo? Kjo pyetje do të jetë subjekt për pjesën tjetër të këtij punimi. Për tu rikthyer sërish tek

dy konceptet kryesore, pushteti dhe influenza, ka një numër të ndryshëm përcaktimesh për secilin prej tyre. Në shumë raste, konteksti përcakton domethënien apo kuptimin. Një përkufizim i përgjithshëm i pushtetit/fuqisë është ai i dhënë nga Hart (1976) sipas të cilit, pushteti mund të imagjinohet si pronë ose mundësi. Nga ana tjetër, koncepti i influencës bazohet në mundësinë e një grupi interesi për të ndryshuar politikën e BE-së në përshtatje me interesat e tij (DUR, 2008). Këto dy koncepte janë përdorur gabimisht disa herë në artikuj dhe tekste të ndryshme. Sidoqoftë, nuk është e lehtë për të bërë dallimin midis tyre por është e rëndësishme të theksohet se pushteti është një influencë potenciale por jo gjithmonë një influencë e vërtetë ndaj institucioneve të BE-së.

Pengesa e dytë është pamundësia për të marrë informacion rreth këtyre grupeve të interesit pasi këto grupe përdorin rrugë të ndryshme për të influencuar BE-në. Problemi i parë këtu është ai i ndryshimit midis aksesit dhe influencës në BE. Aksesit mund të përcaktohet si frekuencat e marrëdhënieve midis BE-së dhe grupeve të interesit (Eising, 2007). Shumë grupe interesi kanë akses në BE por nuk mund t'a përkthejnë atë në influencë. Pra, aksesit dhe influenza janë dy gjëra të ndryshme. Problemi tjetër është fakti se grupet e interesit mund të përdorin rrugë të ndryshme për të shprehur zërin ose interesat e tyre, si media, debatet publike, deklaratat, etj (Dur, 2008). Vështirësia këtu është se si mund të dimë në rrugët e ndryshme që këto grupe interesi kanë përdorur për të influencuar politikën e BE-së. U tha më sipër se këto grupe përdorin rrugë të ndryshme aksesit dhe influencë por kjo nuk do të thotë se i përkthejnë ato patjetër në influencë të vërtetë. Cilat nga këto rrugë përkthehen në influencë dhe cilat jo?

Pengesa e fundit është se si mund ta masim influencën në vetëvete? Cdo metodë ka problemet e veta dhe kjo e bën të vështirë për studiuesit të japin një rezultat të saktë për nivelin e influencës që grupet e interesit kanë në institucionet e BE-së. Për këto arsye, u propozua një arritje metodologjike për të matur influencën e grupeve të interesit. Kjo metodë thekson rëndësinë e analizave kuantitative të tekstit, për të matur influencën e grupeve të interesit. Metoda quhet Wordfish dhe është e bazuar në krahasimin e pozicionit politik të grupeve të interesit, me vendimet që merr BE. Avantazhet kryesore të kësaj metode janë: Është e thjeshtë për tu aplikuar, lejon analizat kuantitative të tekstit, është teknika më e dobishme për të matur influencën e grupeve të interesit etj.

Grupet e Interesit: Ndryshimet në Kohë dhe në Hapsirë

Dy mënyrat kryesore për të krahasuar dy gjëra (objekte, dukuri etj) janë: krahasimi në kohë dhe në hapsirë. Ky lloj krahasimi është gjithashtu i vlefshëm edhe kur flasim për influencën e grupeve të interesit në BE. Duke ju referuar ndryshimit në kohë, përpara vitit 1980, grupet e interesit nuk përbënin ndonjë interes të veçantë për studiuesit. Arsyeja për këtë ishte se këto grupe interesi nuk ishin aq aktive në lobim sa janë këto kohët e fundit. Një shpërthim i grupeve të interesit u vu re në hapsirën kohore 1986-1994. Vëmendja e studiuesve ndaj këtyre grupeve u rrit ndjeshëm në atë periudhë (Woll, 2006). Në kohën e sotme aktivitetet e grupeve të interesit janë rritur. Ato janë shtuar në madhësi dhe diversitet. Bazuar në rezultatet e statistikave, janë afërsisht

5039 grupe interesi, nga të cilët 70% janë grupe interesash të biznesit, 20% janë Organizata jo-qeveritare dhe 10% janë kategori të tjera grupesh interesi (Coen, 2007).

Ajo çfarë është më interesante rreth grupeve të interesit konsiston në ndryshimin e tyre në hapsirë. Janë shkruar shumë artikuj rreth grupeve të interesit në BE dhe në SHBA. Mënyra se si ato llobojnë është vërtetë e ndryshme. Diferencat midis tyre mund të përmbliken në pesë pika kryesore: a) Mënyra se si organizohen aktorët individual. b) Mundësia e metodave dhe burimeve. c) Vendimet: si dhe kur merren ato. d) Marrëdhëniet midis aktorëve publik dhe privat. e) Mënyra se si shprehen kërkesat e ndryshme. Grupet e interesit në SHBA janë ngurtësisht të fokusuar në elemente specifike dhe konkrete për të cilat janë të interesuara. Nga ana tjetër, në BE, grupet e interesit janë më konstruktive dhe të orientuara nga konsensusi. Lobimi në SHBA është më konfrontues dhe agresiv se në BE. Këto dallime ndërmjet tyre vijnë kryesisht për shkak të traditës së lobimit në secilin kontinent, instrumentet e përdorur dhe procesi politik. Në SHBA ka një traditë të konsoliduar lobimi, numri i lobuesve është i lartë dhe burimet financiare që mbështesin aktivitetin e tyre janë të shumta (Woll, 2006).

Është interesante për të analizuar origjinën e organizatave të regjistruara si pjesë lobuese e BE-së. Gjermania është dominuese me 7%. Pastaj vjen Franca dhe Britania me 13%, Belgjika me 7.8% dhe çfarë është më interesante, SHBA me 7.8%, njësoj si Belgjika që është një nga anëtarët më të rëndësishëm të BE-së. (Wanka et al 2010). Sigurisht, kjo përqindje lobuese nuk do të thotë se automatikisht mund të influencojë në politikë-bërjen e BE-së. Të gjitha vendet e tjera anëtare kanë një përqindje më të ulët se SHBA-ja. Ky është një rezultat surprizues pasi pritshmëritë janë që vendi origjinë i grupeve të interesit që llobojnë suksesshëm në BE të jetë nga kontinenti European dhe jo nga jashtë tij.

Një pyetje interesante është ajo se cilat nga keto grupe interesi janë më të suksesshem, grupet e interesit të shpërndara në hapsirë dhe në interesa (grupe të difuzuara) apo ato të koncentruar? Autorë të ndryshëm japin rezultate të ndryshme. Disa mendojnë se grupet e difuzuara janë më të suksesshme sepse kanë akses të thjeshtë në media dhe në institucionet e BE-së. Disa të tjerë mendojnë se grupet e interesit të koncentruara janë më të suksesshme. Arsyeja është se ato kanë një organizim më të mirë dhe janë më të konsoliduara se grupet e tjera. (Dur, 2008). Megjithatë, nuk mund të jemi të sigurt se cilët nga këto grupe janë më të suksesshme sepse varet nga shumë elemente si, strategjia, historia, përmbajtja, politikat në proces, etj. Në shumë raste, konteksti determinon suksesin apo mos-suksesin e këtyre grupeve.

Grupet e Interesit: Lobimi dhe Strategjitë

Janë katër faktorë përcaktues në shkallën e influencës së grupeve të interesit: a) Burimet e grupeve të interesit, si para, mbështetja politike, informacioni, ekspertiza. b) karakteristikat e çështjes për të cilën lobohet, kjo në varësi të çështjes politike që është në proces. c) Institucionet politike dhe aftësia e tyre për të formësuar aktorët social. d) Strategjia e grupeve të interesit (Dur 2008). Elementi i katërt do të shpjegohet në hollësi më poshtë.

Në qoftë se një grup interesi dëshiron të influencojë vendimet që merr BE, ai duhet të mendojë seriozisht rreth strategjisë/strategjive që do të përdorë. Strategjia është elementi kryesor që përcakton suksesin e një grupi interesi në destinacionin e tij final për të influencuar institucionet e BE-së. Janë shumë strategji që një grup interesi mund të përdorë dhe shpeshherë strategjia/strategjitë varen nga politika që është në proces.

Pesë strategji kryesore mund të përdoren nga grupet e interesit për të influencuar vendimet e BE-së. E para është përmes formimit të një organizate interesi, për shembull organizatat që llojnë në mbrojtje të mjedisit (Jeffrey, 2001). E dyta është duke kontaktuar direkt institucionet e BE-së. Kjo strategji vështirë se rezulton e suksesshme kur përdoret e vetme dhe kjo për shkak të burokracisë që karakterizon BE-në. E treta është duke përdorur institucionet nacionale për të influencuar vendimet e BE-së. Një shembull i mire për këtë janë shoqatat irlandeze (Dur, 2010). E katërta është duke llojuar në nivel nacional dhe atë të BE-së në të njëjtën kohë. Për shembull, grupet e interesit që llojnë në mbrojtje të të drejtave të njeriut, llojnë njëkohësisht në nivel nacional dhe mbinacional, pra në nivel europian. Dhe strategjia e fundit është duke përdorur konsulente profesionistë (Eising, 2004). Disa strategji të tjera janë për shembull duke llojuar në institucione të ndryshme të BE-së, në përshtatje me çështjen në diskutim. Gjithashtu, këto grupe mund të zgjedhin të llojnë para se vendimet e BE-së të jenë implementuar ose pas implementimit të tyre (Dur, 2008). Në shumicën e rasteve, grupet kombinojnë të gjitha strategjitë. Kjo i ndihmon ato për të qënë më me influencë në BE.

Bazuar në strategjitë që grupet e interesit përdorin, mund t'i klasifikojmë ato në pesë kategori: 1) Tradicionaliste, 2) Organizatat 'Niche', 3) Aktorët/lojtarët në nivel BE-je, 4) Aktorët/lojtarët e rastit, 5) Lojtarët në shumë nivele. Kategoria e fundit është ajo më aktivja dhe më me influencë në vendimet që merr BE. Ato shfrytëzojnë çdo mundësi që ta bëjnë çështjen e tyre publike dhe kështu të mundësojnë bërjen e politikave të BE-së në favorin e tyre. Në këtë kategori klasifikohen grupet e biznesit, si organizatat më predominante brenda politikës dhe vendimmarrjes së BE-së. Tradicionalistët dhe aktorët e rastit janë me më tepër sukses në nivel nacional sesa në nivel BE-je. Në kontrast me këto të dyja, organizatat 'niche' nuk janë grupe aktive dhe për këtë arsye është e vështirë që ato të kenë ndonjë influencë të vërtetë në institucionet nacionale ose ato të BE-së.

Grupet e Interesit të Biznesit dhe raporti i tyre me BE-në

U përmend më sipër se grupet e biznesit janë 70% e të gjitha grupeve që llojnë dhe influencojnë vendimet e BE-së. Një përkufizim interesant është dhënë nga Sadeh dhe Howarth, duke i konsideruar ato si 'shoqata përfaqësuese që ndjekin interesat materiale, ekonomike, të anëtarëve të tyre. Ato përfshijnë shoqata qendrore dhe sektoriale të biznesit, shoqata profesioniste, fermerët, sindikatat, shoqatat që përfaqësojnë bizneset e vogla si pronarë dyqanesh dhe tregtarë' (Sadeh dhe Howarth,

2008: 1). Për shumë arsye që do t'i shpjegojmë më poshtë, këto grupe interesi të biznesit janë më me influencë në BE.

Ekzistojnë shumë polemika rreth rolit që këto grupe biznesi luajnë në procesin e integritetit të BE-së. Disa studiues mendojnë se këto grupe luajnë një rol pozitiv në rrugën e integritetit në BE. Dhe disa të tjerë mendojnë se kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Në fakt, duke ju referuar Verdun "Grupet e interesit ekonomik nuk janë apriori në favor të integritetit Europian" (Verdun, 2008: 135). Roli i tyre varet nga kostoja dhe përfitimet personale në procesin e integritetit të BE-së.

Grupet e Interesit të Biznesit dhe strategjitë e tyre të lobimit

Grupet e biznesit konsiderohen si aktorë shumë-nivelesh në BE (Eising, 2004). Kjo do të thotë se ato llobojnë në nivel nacional dhe atë të BE-së në të njëjtën kohë. Kështu ato përdorin çdo mundësi për të përkthyer interesat e tyre në politika dhe vendime që merren nga institucionet e BE-së. Fillimisht, këto grupe llobojnë në nivel nacional. Për shembull, unionet tregtare në Angli dhe Suedi kanë një impakt të fortë në procesin e politikë-bërjes në nivel kombëtar (Verdun, 2008). Në këtë nivel, ato mundohen të influencojnë dhe të formësojnë politikën e autoriteteve të shtetit përkatës. Pas kësaj, anëtarët e shtetit që bën pjesë në BE, prezantojnë indirekt interesat e grupeve të biznesit në nivel BE-je.

Në të njëjtën kohë, këto grupe llobojnë direkt tek aktorët dhe institucionet e BE-së. "Një nga arsyet se pse grupet shkojnë dhe llobojnë në nivel europian është për shkak të fragmentarizimit që karakterizon sistemin politik të BE-së" (Verdun, 2008: 133). Në këtë nivel ata shfrytëzojnë aksesin që kanë në institucionet e BE-së, si Parlamenti Europian ose Komisioni Europian. Shume herë këto grupe krijojnë organizata të grupeve të biznesit dhe llobojnë në nivel BE-je si një forcë e vetme, shumë e organizuar dhe me të njëjtin qëllim. Kjo mënyrë është një avantazh i rëndësishëm i grupeve të biznesit, në ndryshim me ato grupe që nuk kanë lidhje me biznesin. Aftësia e tyre për të krijuar organizata të grupeve të interesit, i ndihmon ato të jenë më të suksesshme në procesin lobues.

Këto grupe përdorin gjithashtu konsulentë profesionist. Për shembull, gjatë krizës ekonomike globale, grupet e biznesit nuk ishin të përgatitura dhe po të mos kishin konsulentët profesionist, pasojat mund të kishin qenë edhe më të mëdha. Gjithashtu, në fushën e biznesit, situatat ndryshojnë me një shpejtësi të madhe ndaj për këtë arsye, grupet e biznesit duhet të parashikojnë rreziqet dhe jo t'i korrigjojnë pasojat e tyre. Si përmbledhje, grupet e biznesit janë aktorë shumë-nivelesh dhe kjo strategji i bën ato kaq të suksesshëm.

Grupet e Biznesit VS Grupet jo të Biznesit: Avantazhet krahasuese

Teorikisht, nëse duam të dimë avantazhet dhe disavantazhet e një fenomeni, një rrugë produktive se si ta realizojmë këtë është përmes krahasimit me një fenomen tjetër, nën prizmin e elementëve krahasues të vlefshëm për të dyja palët njëkohësisht. Ndër

arsyet kryesore se pse grupet e biznesit janë kaq të suksesshëm mund të konsiderohen: kapaciteti për organizim, ekspertiza, burime financiare dhe informacioni (Coen, 2007). Sidoqoftë, krahasimi do të jetë i përqëndruar në tre elemente kryesore: strategjia e grupeve të interesit, burimet e grupeve të interesit dhe institucionet politike (Dur, 2008).

Duke ju referuar elementit të parë, strategjitë e grupeve të interesit, ndryshimi midis tyre konsiston më tepër në mundësinë se sa në dëshirën e tyre për të përdorur një strategji apo një tjetër. Të dy llojet e grupeve mundohen të përdorin strategji multi-nivelore por sidoqoftë, ato nuk janë njësoj të suksesshme. Grupet e biznesit kanë një akses të jashtëzakonshëm në institucionet nacionale dhe ato Europiane. Ky akses i tyre në institucionet e BE-së është quajtur nga Pieter Bowen '*access goods*'. Access Goods janë të mirat ose shërbimet që grupet e biznesit ofrojnë ndaj institucioneve të BE-së, në mënyrë që të përfitojnë akses në këto institucione." (Bowen, 2002: 370)

Elementi i dytë që përbën avantazh krahasues janë burimet: paratë, legjitimiteti, ekspertiza, suporti politik, informacioni, njohuritë, etj. Pavarësia monetare e grupeve të biznesit i bën ato të pavarur edhe në politikat dhe strategjitë e tyre të lobimit. Nga ana tjetër, grupet sociale të interesit, për shembull, grupet e të drejtave të njeriut, kanë nevojë gjithnjë për donacione të huaja. Mbështetja politike është më e madhe për grupet e biznesit se sa për grupet sociale pasi gjithnjë ekziston një marrëdhënie e ngushtë midis biznesit dhe politikës.

Elementi i tretë dhe i fundit i avantazheve krahasuese lidhet me institucionet politike dhe me marrëdhënien e ngushtë që ekziston pra ndërmjet politikës dhe biznesit. Kjo marrëdhënie e ngushtë mes tyre i jep aq shumë përparësi grupeve të biznesit sa është e vështirë të kuptohet nëse janë institucionet politike ato që nxjerrin rregullat dhe ligjet përmes të cilave operojnë grupet e interesit apo janë këto të fundit që influencojnë në politikë-bërje gjatë fazës së hartimit të tyre, duke i kthyer ato në favor të vet (Dur, 2008). Si përfundim, grupet e biznesit kanë më shumë mundësi dhe avantazhe për të influencuar në vendimmarrjet e BE-së se sa grupet e tjera të interesit.

Konkluzione

Objektivi kryesor i këtij punimi është krijimi i një ideje të përgjithshme rreth grupeve të ndryshme të interesit që llojnë sot pranë institucioneve kryesore të BE-së dhe kryesisht identifikimi i atyre grupeve që kanë më tepër influencë se të tjerat në vendimmarrjen e BE-së. Një nga përfundimet më të rëndësishme që del në fund të kësaj analize është se grupet e biznesit janë grupet më të suksesshme që aktualisht llojnë në BE dhe arrijnë të influencojnë politikën me karakter europian, vendimet dhe outputet e tyre. Ka shumë vështirësi në procesin e gjetjes së informacionit të saktë rreth grupeve të interesit dhe kjo i bën studiuesit disi skeptik në nxjerrjen e përfundimeve afatgjata rreth grupeve të interesit që realisht influencojnë vendimmarrjen e BE-së. Gjithsesi, duke ju referuar Wonka (2010), janë të pakten tre burime ku mund të gjendet informacion rreth grupeve të interesit që llojnë në institucionet e BE-së:

database e Komisionit Europian CONESCO, Regjistri i Akreditimit i Parlamentit Europian dhe burimi i tretë është Drejtoria e Punëve Publike Europiane.

Duke dhënë një informacion të përgjithshëm rreth grupeve të interesit, bëhet i mundur identifikimi i ndryshimeve kohore dhe hapsinore ndërmjet tyre. Grupet e interesit janë vërtet aktive në vendimarrjen e BE-së, që prej vitit 1986. Krahasimi ndërmjet grupeve të interesit në USA dhe BE nënvizon faktin që të parat janë më tepër kompetitive dhe më agresive kurse të dytat janë më konstruktive dhe të orientuara drejt konsensusit. Strategjia e lobimit është një nga përcaktuesit kryesor të suksesit os mos-suksesit të grupeve të interesit, gjatë përpjekjeve të tyre për të influencuar vendimarrjen e BE-së. Duke ju referuar Dur (2008), strategjitë kryesore të lobimit janë: lobimi në nivel nacional, lobimi në nivel europian, lobimi në nivel nacional dhe europian (BE-je) në të njëjtën kohë, krijimi dhe pjesëmarrja në organizata të ndryshme grupesh interesi.

Si perfundim, grupet e biznesit, si grupe që luajnë në shumë nivele njekohësisht, konsiderohen si grupet me të suksesshme sa i përket aftësisë së tyre për të influencuar vendimarrjen e BE-së. Elementi i parë që ndikon pozitivisht në suksesin e tyre është strategjia multi-nivel e lobimit. Elementi i dytë janë burimet e këtyre grupeve, me theks të veçantë, burimet financiare. Grupet me karakter jo-fitimprurës e kanë të gjithë aktivitetin e tyre të varur nga mundësia për të gjetur donatorë dhe financime. Faktori i tretë ndikues është marrëdhënia e ngushtë që ekziston ndërmjet grupeve të biznesit dhe institucioneve politike. Bowen sygjeron konceptin “access goods” si konkretizues i kësaj marrëdhënie. Këto avantazhe dhe shumë të tjera me rëndësi dytësore, i klasifikojnë sot grupet e biznesit si grupet me të afta për të influencuar, në favor të tyre, vendimarrjen e BE-së.

Bibliografia

- Berckhout, J and Lowery, D (2010) “*The changing demography of the EU interest system since 1990*” European Union Politics. 11(3): 447-461
- Beyers, J (2002) “*Gaining and seeking access: The European adaption of domestic interest associations*” European Journal of Political Research. 41: 585-612
- Bouwen, P (2002) “*Corporate lobbying in the European Union: the logic of access*” Journal of European Public Policy. 9(3): 365-390
- Bouwen, P (2004) “*The logic of access to the EP*” Journal of Common Market Studies. 43(3): 473-496
- Bouwen, P (2004) “*Exchanging access goods for access: A comparative study of business lobbying in the EU institutions*” European Journal of Political Research. 43(3): 337-370
- Coen, D (2007) “*Empirical and theoretical studies in EU lobbying*” Journal of European Public Policy. 14(3): 333-345
- Dur, A (2008) “*Bringing Economic Interests Back into the Study of EU Trade Policy- Making*” Political Studies Association. 10: 27-45

- Dur, A (2008) "*Interest Groups in the European Union: How Powerful Are They?*" West European Politics. 31(6): 1212-1230
- Dur, A and Mateo, G (2010) "*Irish associations and Lobbying on EU legislation: Resources, Access, Points, and Strategies*" Irish Political Studies. 25 (1): 107-122
- Eising, R (2004) "*Multilevel Governance and Business Interests in the EU*" Governance: An International Journal of Policy, Administration and Institutions. 17(2): 211-245
- Eising, R (2007) "*The access of business interests to EU institutions: towards elite pluralism?*" Journal of European Public Policy. 14(3): 384-403
- Geyer, R (2001) "*Can European Union (EU) NGOs co-operate to promote EU social policy?*" Journal of Social policy. 30(3): 477-493
- Grigaliunaite, J (2010) "*Business Interest Associations in Lithuania: Status, Role and Prospects*" Social Science Studies. 1(5): 63-84
- Jeffrey, D (2001) "*The Roles of Environmental non-governmental organizations in the twenty-first century*" Royal Irish Academy. 101(1/2): 151-156
- Kluver, H (2009) "*Measuring Interest Group Influence Using Quantitative Text Analysis*" European Union Politics. 10/4: 535-549
- Molins, J and Casademunt, A (1998) "*Pressure groups and the articulation of interest*" West European Politics. 24(4): 124-146
- Sedah, T and Howarth, D (2008) "*Economic interests and the European Union: A catalyst for European Integration or a hindrance?*" Political Studies Association. 10: 1-8
- Smith, M (2008) "*All Access Points are Not Created Equal: Explaining the Fate of Diffuse Interests in the EU*" Political Studies Association. 10: 64-83
- Verdun, A (2008) "*Policy-Making and Integration in the European Union: Do Economic Interest Groups Matter?*" Political Studies Association. 10: 129-137
- Woll, C (2006) "*Lobbying in the European Union: From Sui Generis to a Comparative Perspective*" Journal of European Public Policy. 13(3): 456-469
- Wonka at al (2010) "*Measuring the size and scope of the EU interest group population*" European Union Politics. 11(3): 463-476

Roli i të ardhurave ekonomike për lëvizjen e lirë në Bashkimin European

Erjona Canaj, PhD, UET

ABSTRAKT. Disponibiliteti i të ardhurave ekonomike është ende një kriter i rëndësishëm në lëvizjen e lirë dhe qëndrimin e shtetasve komunitarë në një shtet tjetër anëtar të BE-së. Shtetasit komunitarë dhe familjarët e tyre gëzojnë të drejtën e qëndrimit aq kohë sa nuk bëhen barrë për sistemin asistencial në shtetin anëtar pritës. Ky kriter merr një domethënie akoma më të rëndësishme në kuadër të bashkimit familjar, e drejtë kjo që njihet titullarë, si shtetasit komunitarë, ashtu edhe ata jo komunitarë.

Në këtë artikull synohet të tregohet se kriteri i të ardhurave ekonomike për shtetasit komunitarë është zbehur ndjeshëm vitet e fundit, dhe pikërisht, që nga implementimi i direktivës 2004/38/KE mbi lëvizjen e lirë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Ndërkohë, disponibiliteti i të ardhurave ekonomike qëndron si një kusht i domosdoshëm për realizimin e bashkimit familjar për shtetasit jo komunitarë, i rregulluar në nivel europian nga direktiva 2003/86/KE mbi bashkimin familjar.

Fjalë kyçe: Të ardhurat ekonomike, lëvizje e lirë, bashkim familjar

Hyrje

Në Bashkimin European të ardhurat ekonomike janë ende një kriter i përgjithshëm dhe i rëndësishëm për ushtrimin e të drejtës së qarkullimit të lirë dhe në veçanti për qëndrimin afatgjatë të shtetasve komunitarë. Lëvizja e lirë është një nga të drejtat themelore që garantohen në Bashkimin European për të

gjithë shtetasit komunitarë¹. Këta të fundit përfitojnë nga legjislacioni europian vetëm nëse e ushtrojnë efektivisht këtë të drejtë, d.m.th. në qoftë se transferohen nga një shtet anëtar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Europian. Në lidhje me lëvizjen e lirë, direktiva e Këshillit dhe e Parlamentit Europian e 29 prill 2004 nr. 2004/38/KE² parashikon tre lloje qëndrimi për shtetasit komunitarë: e drejta e qëndrimit deri në tre muaj; e drejta e qëndrimit mbi tre muaj (deri në 5 vjet qëndrim afatgjatë) dhe e drejta e qëndrimit të përhershëm (mbi pesë vjet)³. Edhe pse direktiva 2004/38 ka bërë hapa përpara në unifikimin e legjislacionit europian për qarkullimin e lirë dhe në thjeshtësimin e formaliteteve me karakter administrativ, e drejta për qëndrim në BE *varet* nga të ardhurat ekonomike që posedon individ. Gjithsesi, këto të ardhura nuk janë më një kusht i ngurtë dhe penalizues për lëvizjen e lirë të shtetasve komunitarë.

Shtetasit komunitarë, gëzojnë gjithashtu të drejtën për t'u shoqëruar në qëndrimet e tyre edhe nga familjarët, si në qëndrime afatshkurtra, ashtu edhe në ato afatgjata.

¹ Për sa i përket bazës ligjore në të cilën mbështetet kjo liri themelore përmendim këtu në radhë të parë dispozitat e Traktatit të Bashkimit Europian si dhe aktet normative dytësore si rregulloret dhe direktivat. Adinolfi A., La libertà di circolazione delle persone, G.Strozzi, (a cura di) Diritto dell'Unione europea, Torino, 2005, fq. 69; Adinolfi A., L'art. 39, në Il Codice della famiglia, M.Sesta, 2007 fq. 370; L.S.Rossi, I beneficiari della libera circolazione delle persone, në Foro italiano, 1994, fq. 98; K. Hailbronner, Free movement of EU nationals and Union citizenship, në R.Cholewinski, R.Perruchoud-E. MacDonald, International migration law, The Hague, 2007, fq. 320; Giubboni S.-G. Orlandini, La libera circolazione dei lavoratori nell'Unione europea, Torino, 2007, fq. 64; Villani U., Istituzioni di diritto dell'Unione europea, Bari, 2008, fq. 87; Ferrari Bravo L.-E.Moavero Milanese, Lezioni di diritto comunitario, Editoriale scientifica, 2000, fq. 275.

² Direktiva në fjalë amendoi rregulloren n.1612 e 15 tetor 1968 e cila shënoi liberalizimin e plotë në qarkullimin e punëtorëve me pagesë dhe shfuqizoi direktivën n. 360 e 15 tetor 1968; rregulloren n. 1048/71 e 14 qershorit 1971 mbi sigurimet e cila synonte një harmonizim të të gjitha legjislacioneve të Shteteve Anëtare; direktivën 98/49/CE e 29 qershorit 1998, me anë të së cilës disiplina komunitare u aplikua edhe për regjimet e pensione; direktivën 73/148/KEE që kishte të bënte me heqjen e pengesave në transferimin dhe të drejtën e leje-qëndrimit e shtetasve të një shteti anëtar të BE-së në fushën e vetë-punësimit dhe të shërbimeve; rregulloren n.1251/70 dhe direktivën 75/34 të cilat parashikonin kushtet që duhen plotësuar nga punëtorët me pagesë dhe familjarët e tyre për të drejtën e qëndrimit të përhershëm kur nuk punojnë më për arsye të ndryshme si mosha, arsye shëndetësore etj.; direktivën 75/34/KEE e 17 dhjetorit 1974, e cila parashikonte që t'u aplikohen edhe punëtorëve që vetë-punësohen, pasi kanë përfunduar punën për arsye të moshës ose invaliditetit (dhe familjarëve të tyre) të drejtën për leje qëndrim ashtu sikurse parashikohet për punëtorët në përgjithësi si dhe direktivat 90/364, 90/365, 93/96, të vitit 1990 lidhur me lëvizjen e lirë të personave jo aktivë ekonomikisht, të studentëve dhe të pensionistëve. C.Sanna, La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri, në Rivista di diritto internazionale privato e processuale, 42/2006, fq. 1167; M.Missorici-C.Romano, Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni, në Rivista internazionale dei diritti dell'uomo, n. 11/98, fq. 44.

³ C.Sanna, La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri, në Rivista di diritto internazionale privato e processuale, 42/2006, fq. 1167; Mattera A., "Civis europaeus sum". La libertà di circolazione e di soggiorno dei cittadini europei e la diretta applicabilità dell'art. 18 (ex art. 8 A) del trattato CE, në Il Diritto dell'Unione europea, 1990; Guild E., The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law, Kluwer Law International, 2004.

Ndaj, për këtë arsye, burimet financiare janë një kusht i rëndësishëm jo vetëm për lëvizjen e lirë në BE por edhe për bashkimin familjar, e drejtë kjo që mund të ushtrohet si nga shtetasit komunitarë ashtu edhe ata jo komunitarë.

Të ardhurat ekonomike – kusht i rëndësishëm për lëvizjen e lirë të shtetasve komunitarë në BE

Kriteri i posedimit të të ardhurave ekonomike për lëvizjen e lirë për shtetasit komunitarë, që me miratimin e direktivës 2004/38 është zbehur ndjeshëm. Treguesit e qartë të kësaj zbehje apo tolerance lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me llojet e qëndrimeve të shtetasve komunitarë në një shtet tjetër anëtar të BE-së; me kategoritë e individëve që e ushtrojnë këtë të drejtë; me vetë konceptin e shtetësisë europiane i cili, së fundmi po kthehet në statusin kryesor që gëzon qytetari europian në BE. Ashtu si do të pasqyrohet edhe në vijim, këta tregues janë padyshim, të ndërthurur njëri me tjetrin dhe nuk mund të analizohen të veçuar.

a) Të ardhurat ekonomike nuk janë kusht i domosdoshëm për shtetasit komunitarë që lëvizin lirshëm brenda tre muajve në çdo shtet tjetër anëtar të Bashkimit Europian. Në lidhje me qëndrimin afatshkurtër, kushti kryesor dhe i vetëm që duhet të plotësojnë shtetasit komunitarë është pajisja me një dokument identifikimi të vlefshëm, për të vërtetuar se ata janë shtetas komunitarë. Pra, e drejta për të dalë, për të hyrë dhe për të qëndruar në një Shtet të BE-së, i garantohet çdo personi që gëzon statusin e shtetasit europian⁴. Ky regjim aplikohet edhe për familjarët që dëshirojnë të shoqërojnë ose i bashkohen shtetasve komunitarë kur ushtrojnë të drejtën e lëvizjes së lirë. Pra, edhe për familjarët – shtetas komunitarë ose jo, për qëndrime afatshkurtër, legjislacioni europian aktual nuk parashikon kushte që lidhen me burimet financiare. Për familjarët që nuk janë shtetas komunitarë parashikohet vetëm pajisja me një pasaportë të vlefshme si dhe vizë hyrje. Disponibiliteti i burimeve financiare merret si i mirëqenë derisa subjektet nuk bëhen barrë për sistemin kombëtar të asistencës sociale. Shtetasit komunitarë mund të “rrezikojnë” të bëhen barrë nëse ata kanë hyrë në një shtet tjetër anëtar për të kërkuar një punë dhe janë ende në pritje të një pune edhe pse mund të kenë kaluar tre muaj nga momenti i hyrjes në atë Shtet. Siç dihet tashmë, një nga arsyet e transferimit të shtetasve komunitarë në një Shtet tjetër Anëtar është për të kërkuar një punë. E drejta për të kërkuar një punë është parashikuar në nenin 45 (ish neni 39) të Traktatit të Bashkimit Europian (TBE), i modifikuar nga Traktati i Lisbonës, si dhe aktet ligjore dytësore, të miratuara ndër vite. Sipas akteve ligjore në fjalë individët kanë tre muaj kohë për të gjetur një punë në shtetin tjetër. Problemet lidhur me këtë çështje lindin pikërisht atëherë kur personat nuk e kanë gjetur akoma një punë brenda kësaj kohe dhe janë të detyruar të largohen për të mos iu rënduar

⁴ Giubboni S.-G.Orlandini, La libera circolazione dei lavoratori nell'Unione europea, Torino, 2007, fq. 64.

sistemit asistencial të Shtetit pritës. Praktika e Shteteve të BE-së para miratimit të direktivës në fjalë, në lidhje me këtë çështje, ka qenë e kufizuar në mënyrë strikte në një hapësirë kohore deri në tre muaj. Gjykata europiane e Drejtësisë në vendimet e saj është treguar më liberale⁵. Ndaj, falë interpretimit të Gjykatës, u zgjat deri në gjashtë muaj koha në të cilën shtetasit europianë mund të qëndrojnë në një shtet tjetër anëtar për të kërkuar një punë. Shtetet anëtare nuk mund t'i detyrojnë shtetasit e tjerë komunitarë të largohen menjëherë pas mbarimit të afatit kohor tre mujor por pas gjashtë muajve nëse ata nuk e kanë gjetur një punë për të justifikuar qëndrimin e tyre në Shtetin pritës. Vlen të përmendim këtu dhe nenin 24 të direktivës 2004/38/KE i cili parashikon që shtetasit europianë që e ushtrojnë këtë të drejtë si dhe familjarët e tyre gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit e shtetit pritës sipas rregullave të parashikuara në Traktatin e Bashkimit Europian⁶.

b) Shtetasit komunitarë transferohen në një Shtet tjetër edhe për periudha më të gjata se tre muaj. E drejta për qëndrim për më tepër se tre muaj sanksionohet shprehimisht në nenin 7 të direktivës 2004/38, në të cilin përcaktohen qartë kategoritë e personave që përfitojnë nga kjo e drejtë. Ata janë të punësuarit, të vetëpunësuarit, studentët, pensionistët dhe të gjithë personat që edhe pse nuk janë në marrëdhënie pune, disponojnë të ardhura të mjaftueshme (të quajtur ndryshe persona jo aktivë ekonomikisht). Për qëndrimin afatgjatë, këta të fundit janë të vetmit që duhet të tregojnë se disponojnë të ardhura të mjaftueshme. Kjo ndodh për shkak se kushtet mbi të ardhurat ekonomike që të gjitha këto kategori duhet të plotësojnë për të përfituar të drejtën e qëndrimit, janë ato të përcaktuara në nenin 8 të direktivës 2004/38 ku parashikohet se: të punësuarit duhet të tregojnë tek autoritet kompetente vendase kontratën e punës dhe sigurimet shëndetësore vjetore të paguara për vete dhe për familjarët që i shoqërojnë; të vetë-punësuarit duhet të tregojnë fillimin e një aktiviteti privat; studentët duhet të tregojnë se disponojnë të ardhura të mjaftueshme për vete dhe për familjarët. Për këtë kategori nuk është e detyrueshme që të tregojnë se si i kanë përfituar këto të ardhura, mjafton fakti që të ardhurat të jenë në emrin e tyre. Të ardhurat duhet të jenë të mjaftueshme për jetesën në atë Shtet dhe shpeshherë kjo kategori e tregon disponibilitetin e të ardhurave nëpërmjet vetëdeklarimit.

⁵ Shih vendimin e 20 shkurtit 1997, Komisioni kundër Belgjikës në të cilën Gjykata deklaroi shkelje të nenit 39 të Traktatit nga ana e Belgjikës pasi ajo mbante akoma në fuqi legjislacionin sipas të cilit parashikohej detyrimi i shtetasve të Shteteve të tjera anëtare të BE të cilët shkonin në Belgjikë me qëllim kërkim punësimi, të largoheshin menjëherë nga territori kombëtar pas skadencës së tre muajve. Shih për këtë çështje A. Adinolfi, *Il diritto al ricongiungimento familiare ed il trattamento dei familiari*, në Trattati dell'Unione Europea e della Comunità Europea, A.Tizzano, Giuffrè, 2004, fq. 39.

⁶ K.Hailbronner, *Free movement of EU nationals and Union citizenship*, në R.Cholewinski - R.Perruchoud-E. MacDonald, *International migration law*, The Hague, 2007, fq. 320; Villani U., *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari, 2008, fq. 87; C.Sanna, *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, vepër e cit., fq. 1167.

Të gjithë shtetasit e tjerë komunitarë (kategoria e fundit në renditje) që qarkullojnë lirshëm në BE por që nuk janë në marrëdhënie pune duhet të tregojnë se i disponojnë të ardhurat e mjaftueshme për qëndrimin e tyre në shtetin anëtar pritës. Pra, në lidhje me këtë qëndrim afatgjatë kategoria e vetme që duhet të tregojë disponibilitetin e të ardhurave janë pikërisht personat që nuk janë në marrëdhënie pune por që disponojnë burime financiare të mjaftueshme.

c) Për personat që qëndrojnë prej më shumë se pesë vjet në territorin e një shteti tjetër anëtar (qëndrim i përhershëm) nuk kërkohet të tregohen të ardhurat ekonomike. Kjo e drejtë u garantohet shtetasve europianë pas pesë viteve rezidence të pandërprerë dhe të rregullt në shtetin pritës. Pas një qëndrimi pesëvjeçar, në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje, shtetasit përfitojnë të drejtën e qëndrimit të përhershëm (rezidencën) e cila parashikohet nga neni 16 i direktivës 2004/38. Në këtë nen sanksionohet pikërisht se kur kjo e drejtë përfitohet, atëherë këta shtetas nuk janë të detyruar të plotësojnë më kushtet e të ardhurave ekonomike për qëndrimin afatgjatë⁷. Kjo kategori përjashtohet nga detyrimi për të treguar disponibilitetin e të ardhurave ekonomike tek autoritetet kompetente vendase pasi këta individë për pesë vite me radhë e kanë përmbushur këtë kriter, konform rregullave të shtetit pritës, në përputhje me legjislacionin europian në fjalë. Për këtë kategori personash posedimi i burimeve financiare merret i mirëqenë. Ky rregull vlen edhe për familjarët e shtetasit komunitar. Nëse familjarët janë shtetas komunitarë, përfitojnë nga kjo e drejtë pa asnjë lloj kushtëzimi ndërsa familjarët shtetas jo komunitarë përfitojnë vetëm nëse kanë jetuar për pesë vjet me radhë dhe pa ndërprerje me shtetasin europian⁸.

d) Shtetasit komunitarë janë të detyruar të tregojnë disponibilitetin e të ardhurave ekonomike vetëm në momentin fillestar dhe jo gjatë gjithë periudhës së qëndrimit të tyre në Shtetin anëtar ku ata transferohen. Vlen të përmendet këtu vendimi i Gjykatës së Drejtësisë në çështjen *Trojani*⁹ ku është përcaktuar se të ardhurat e mjaftueshme të sanksionuara nga legjislacioni europian janë kusht i domosdoshëm vetëm në fillim, pra në momentin e prezantimit të kërkesës së lejes së qëndrimit¹⁰. Duhet theksuar se që nga viti 2007, në përputhje me direktivën 2004/38, shtetet anëtare të Bashkimit Europian, nuk i pajisin me shtetasit komunitarë me kartë/leje qëndrimi por vetëm i regjistrojnë ata në regjistra të posaçëm. Kjo procedurë e thjeshtësuar është parashikuar

⁷ Neni 17 i direktivës 2004/38.

⁸ Shih nenin 16 paragrafin 2 të direktivës 2004/38. Libre circulation des personnes et des capitaux. Rapprochement des législations, Commentaire J.Mègret, Paris, fq. 77.

⁹ Vendim i 7 shtatorit 2004, çështja C-456/02, në Përmbledhje 2004, fq. I-7573.

¹⁰ K.Hailbronner, Union citizenship and access to social benefits, vep. cit., fq. 1248. E. Bergamini, Il difficile equilibrio fra riconoscimento del diritto alla libera circolazione, rispetto della vita familiare e abuso del diritto në Il Diritto dell'Unione europea, n. 11/2006, fq. 352; X.Groussot, "Principled citizenship" and the process of european constitutionalization-From a pie in the sky to a sky with diamonds, në U.Bernitz-Nergelius J.-Cardner, General Principles of EC Law in a Process of Development, Oxford, fq. 324; K.Hailbronner, Union citizenship and access to social benefits, vep. cit., fq. 1248.

në nenin 8 të direktives në fjalë dhe është lënë në diskrecion të vetë shteteve anëtare. Me kartë ose leje qëndrimi pajisen vetëm familjarët shtetas komunitarë ose jo, që shoqërojnë ose i bashkohen më vonë shtetasit komunitar.

d) Vlen të theksohet gjithashtu se nuk është e detyrueshme që personat jo aktivë ekonomikisht t'i kenë posaçërisht në emrin e tyre burimet financiare¹¹. Përmendim këtu vendimin e dt. 19 tetor 2004, *Chen*, çështja C-200/02, ku Gjykata e Drejtësisë përcakton se është e vërtetë që shtetasit europianë jo aktivë ekonomikisht duhet të disponojnë të ardhura ekonomike të mjaftueshme nëse dëshirojnë të qëndrojnë në një shtet tjetër të BE-së, por kjo nuk do të thotë që ato duhet të jenë të fituara prej tyre personalisht (pra, mund të jenë në emrin e shtetasit komunitar po jo domosdoshmërisht t'i ketë fituar vetë). Rasti konkret ka të bëjë me të ardhurat e një foshnje gjashtë muajshe lindur në Irlandë, ku kishte fituar shtetësinë me lindjen, e cila çohet në Angli nga prindërit e saj kinezë. Shtetasja në fjalë e dispononte shumën e vendosur si kriter falë të ardhurave të prindërve të saj. Duhet theksuar gjithashtu se Gjykata bazohet edhe në faktin se në legjislacionin europian nuk është parashikuar në asnjë dispozitë burimi i të ardhurave ekonomike për të qëndruar në një Shtet tjetër. Ky interpretim liberal i Gjykatës së Drejtësisë vjen edhe si pasojë e përforcimit të konceptit të shtetësisë europiane e cila në këtë rast mbizotëroi ndaj çdo pretendimi tjetër.

dh) Shprehje e interpretimit liberal është edhe fakti se në përcaktimin e shumës se të ardhurave të mjaftueshme llogariten jo vetëm të ardhurat e individit por edhe ato të familjarëve, pra edhe nëse nuk janë fituar prej tyre ose nuk janë në emrin e tyre: rëndësi ka fakti që familja në tërësi i posedon këto burime financiare. Ky parim sanksionohet në direktivën mbi lëvizjen e lirë në nenin 14. Po ashtu edhe në direktivën 2003/86 mbi bashkimin familjar, në nenin 7 par. 1, pika c, saktësohet se Shteti Anëtar duhet të mbajë parasysh kontributin e të gjithë familjarëve në përlllogaritjen e të ardhurave financiare, me qëllim bashkimin familjar.

e) Zbehja e “kontrollit” ndaj të ardhurave ekonomike për ushtrimin e lëvizjes së lirë duket qartë edhe nga fakti se direktiva 2004/38 sanksionon shprehimisht që shtetasit komunitarë nuk mund të dëbohen nga territori i Shtetit pritës vetëm për arsye të mungesës apo pamjaftueshmërisë së burimeve financiare. Neni 14 par. 1 i direktivës 2004/38 sanksionon shprehimisht që këto burime financiare duhet të posedohen nga individ. Por, nga ana tjetër, në paragrafin e tretë të po këtij neni thuhet qartë që kërkesa nga ana e shtetasit komunitar ose e familjarëve të tij për asistencë sociale apo përfitimi i asistencës nuk çon automatikisht në një masë dëbimi nga autoritetet

¹¹ E.Bergamini, *Il difficile equilibrio fra riconoscimento del diritto alla libera circolazione, rispetto della vita familiare e abuso del diritto*, në *Codice della famiglia*, M.Sesta, 2007, p. 4074; G.Perin, *In margine alla sentenza Chen: il diritto di circolazione dei familiari di cittadini comunitari*, në *Diritto, immigrazione e cittadinanza*, 4/2004, fq. 89; L. Fadiga, *Genitori extracomunitari di cittadino dell'U.E.: la Cina è vicina*, në *Famiglia e Diritto*, n. 1/2006, fq. 19; B.Kunoy, *A Union of national citizens: the origins of the Court's lack of avant-gardisme in the Chen case*, në *Common market law review*, 2006, fq. 179; X.Groussot, *“Principled citizenship” and the process of european constitutionalization-From a pie in the sky to a sky with diamonds*, vep. cit., fq. 333; E.Guild, *Citizenship and fundamental rights*, vep. cit., fq. 52.

kompetente vendase. Po në nenin 14, në paragrafin 4 specifikohet se nuk mund të ndërmerret një masë dëbimi ndaj shtetasit komunitar ose familjarëve të tyre “...a) nëse shtetasit komunitarë janë punëtorë ose të vetëpunësuar ose b) shtetasit komunitarë kanë hyrë në territorin e një Shteti Anëtar pritës me qëllim që të kërkojë një punë. Në këto raste shtetasit komunitarë dhe familjarët e tyre nuk mund të dëbohen për aq kohë sa shtetasit komunitarë mund të provojnë që ata janë duke kërkuar një punë dhe kanë mundësinë që ta fitojnë atë.” Kjo kategori mbrohet njësoj si kategoria e punëtorëve dhe e të vetëpunësuarve. Pra, duket interesant fakti që direktiva mbi lëvizjen e lirë kërkon të mbrojë me çdo kusht shtetasit komunitarë që shkojnë në një shtet tjetër për të kërkuar një punë. Edhe kjo qasje është, pa dyshim, shprehje e përforsimit dhe konsolidimit të shtetësisë europiane.

Vlen të përmendet këtu dhe parimi i përgjithshëm i sanksionuar në preambulën e direktivës në të cilën specifikohet se shteti pritës duhet të mbajë parasysh situatën personale të të interesuarit para se ta konsiderojë personin që merr asistencë “barrë” për sistemin e vet asistencial. Në këtë preambul saktësohet se përfituesit e të drejtës së qëndrimit nuk duhet të dëbohen pa u bërë barrë për sistemin asistencial të Shtetit Anëtar pritës¹². Ndërkohë, një masë dëbimi nuk duhet të jetë rrjedhoja e menjëhershme ndaj kërkesës apo përfitimit të ndihmës asistencialë. Shteti anëtar pritës duhet të vlerësojë nëse bëhet fjalë për vështirësi financiare të përkohshme (të momentit) dhe duhet të mbajë parasysh kohëzgjatjen e qëndrimit të këtyre shtetasve. Duhet të mbahet parasysh gjithashtu situata personale e individit, shuma e të ardhurave si dhe fakti nëse ky shtetas është ndihmuar më parë nga shteti në fjalë me asistencë ose ndihma të tjera ekonomike. Në përputhje me këtë preambul, dhe me të njëjtën frymë me nenin 14 paraqitet dhe neni 27 i direktivës ku sanksionohen kufizimet e të drejtës së lëvizjes së lirë për arsye të rendit publik, sigurisë publike dhe shëndetit publik. Ky nen është shprehje e konsolidimit të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe praktikës së Shteteve anëtare që të mos dëbojnë nga territori i tyre shtetasit e tjerë komunitarë vetëm për arsyen e pamjaftueshmërisë së të ardhurave ekonomike¹³. Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet qartë që të ardhurat ekonomike nuk mund të përbëjnë motiv të rendit publik dhe për këtë arsye shtetasit nuk mund të dëbohen. Kjo tregon qartë që vullneti i Shteteve anëtare duhet të udhëhiqet nga fryma pozitive dhe nga statusi që gëzojnë shtetasit europianë në kuadër të shtetësisë europiane.

¹² Pika 16 e Preambulës thotë shprehimisht: “As long as the beneficiaries of the right of the residence do not become an unreasonable burden on the social assistance system of the host Member State they should not be expelled. Therefore, an expulsion measure should not be the automatic consequence of recourse to the social assistance system. The host Member State should examine whether it is a case of temporary difficulties and take into account the duration of residence, the personal circumstances and the amount of aid granted in order to consider whether the beneficiary has become an unreasonable burden on its social assistance system and to proceed to his expulsion. In no case should an expulsion measure be adopted against workers, self-employed persons or job-seekers as defined by the Court of Justice save on grounds of public policy or public security.”

¹³ Adinolfi A. “Pacchetto sicurezza” e violazioni (...sicure) di obblighi comunitari në Rivista di diritto internazionale, 2008, fq. 1090.

Përcaktimi i kufijve të të ardhurave ekonomike të mjaftueshme

Pas analizës së kriterëve të burimeve financiare, në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit dhe të kategorive të individëve që ushtrojnë këtë të drejtë, lind nevoja e përcaktimit të kufijve të të ardhurave që kërkohen për ushtrimin e të drejtës së lëvizjes së lirë. Vështirësia qëndron pikërisht në përcaktimin e të ardhurave ekonomike minimale që konsiderohen të mjaftueshme për një qëndrim “dinjitoz” në shtetin pritës.

Rregulli kryesor që përcakton direktiva mbi qarkullimin e lirë dhe që mbizotëron në praktikën e shteteve anëtare është që këto të fundit në mënyrë kategorike nuk duhet të përcaktojnë një shifër ekzakte. Kjo evidentohet qartë në nenin 8 të direktivës 2004/38. Pra, shteteve anëtare në detyrimin e mospërcaktimit të një shifre ekzakte, u është lënë një hapësirë lirie dhe veprimi. Në direktivë sanksionohet që vetë shtetet anëtare, kur bëhet fjalë për përcaktimin e të ardhurave, duhet të jenë elastikë dhe duhet të vlerësojnë rast pas rasti situatën e çdo individit që mund të ndodhet në vështirësi ekonomike në mënyrë që të mos arrihet në dëbimin e tij nga territori vetëm për këtë shkak. Pra, fleksibiliteti kërkon që vlerësimi i autoriteteve kompetente të jetë gjithmonë në varësi të personit dhe të bëhet rast pas rasti¹⁴.

Nga ana tjetër, thuhet se niveli i të ardhurave ekonomike që përcaktohen nga secili shtet anëtar në mënyrë të pavarur gjithsesi nuk mund të zbrësë poshtë kufirit të përcaktuar për përfitimin e asistencës sociale ose të pensionit social. Secili shtet anëtar e përcakton në mënyrë autonome kufirin e të ardhurave poshtë së cilës jepet asistencë sociale. Duke konsideruar faktin që shtetasi komunitar që nuk është në marrëdhënie pune duhet të ketë të ardhura të mjaftueshme vjetore, ai mund të qëndrojë në secilin shtet anëtar, mjaft që në llogarinë e tij bankare të jetë e depozituar minimalisht shuma e përcaktuar si kufi për asistencë. Le të sjellim një shembull konkret: në Itali shuma e vendosur si kufi për përfitimin e asistencës sociale për vitin 2010 ishte 5.349,89 Euro ndaj shtetasi komunitar që qëndron në Itali duhet të posedojë në llogarinë e tij bankare minimalisht 5.349,89 Euro. Shtetasi në fjalë mund të qëndrojë në këtë Shtet për një periudhë kohore të pakufizuar, asnjëherë nuk do të detyrohet të tregojë përsëri të ardhurat ekonomike dhe asnjëherë nuk do të dëbohet, për arsye të kësaj natyre nga ky shtet.

Në lidhje me fleksibilitetin duhet theksuar gjithashtu që kufiri i përcaktuar për të përfituar asistencën sociale apo pensionin është i ndryshëm nga një Shtet Anëtar në tjetrin. Fleksibiliteti në fjalë kërkohet edhe për arsyen se i njëjti Shtet mund të ndryshojë ndër vite shumën (kufirin) e të ardhurave ekonomike, në varësi të të cilës jepet asistencë sociale.

Praktikisht, të gjitha shtetet anëtare kërkojnë respektimin në parim të kriterëve ekonomike, edhe pse me modalitete të ndryshme. Problemi kryesor në lidhje me verifikimin e tyre është delegimi i kompetencave Zyrës së Gjendjes Civile,

¹⁴ Libre circulation des personnes et des capitaux. Rapprochement des législations, Commentaire J.Mègret, Paris, fq. 74; E.Bergamini, Il difficile equilibrio fra riconoscimento del diritto alla libera circolazione, rispetto della vita familiare e abuso del diritto, në Codice della famiglia, M.Sesta, 2007, p. 4074.

kompetente këto të fundit për regjistrimin e prezencës së shtetasit komunitar për qëndrimin afatgjatë¹⁵.

Të ardhurat ekonomike – kusht i domosdoshëm për bashkimin familjar në BE

Disponibiliteti i të ardhurave ekonomike të mjaftueshme merr vlerë dhe rëndësi të veçantë edhe në kuadër të bashkimit familjar në BE. E drejta për bashkim familjar është një e drejtë shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi. Nëpërmjet të drejtës për bashkim familjar, familjarët e një personi kanë të drejtë të shoqërojnë ose t'i bashkohen këtij të fundit nëse transferohet në një shtet tjetër anëtar, i ndryshëm nga ai i origjinës. Në përgjithësi, bashkimi familjar njihet si titullar aktiv (personi që transferohet dhe që kërkon bashkimin me familjen e tij që ndodhen në shtet tjetër) si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar.

a) Bashkimi familjar i shtetasve komunitarë

Regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë me familjarët (qofshin këta shtetas komunitarë ose jo) bie nën regjimin e përgjithshëm të lëvizjes së lirë, e cila rregullohet nga legjislacioni i brendshëm në përputhje me aktet ligjore europiane dhe me interpretimin evolues dhe shpeshherë revolucionar të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

E drejta për bashkim familjar për shtetasit komunitarë merr rëndësi për të drejtën komunitare vetëm atëherë kur personat që shoqërojnë familjarin e tyre qëndrojnë në një shtet tjetër anëtar për një periudhë më të gjatë se tre muaj: pra, bashkimi familjar për një familje të përbërë vetëm nga shtetas komunitarë mund të realizohet *de facto* për një periudhë kohe deri tre muaj pasi për këta individë aplikohet regjimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë afatshkurtër. Në këto raste nuk ka kritere për t'u përmbyshur lidhur me të ardhurat ekonomike. Në qoftë se familja qëndron për më shumë se tre muaj atëherë duhet të tregohen burimet financiare për të gjithë familjen. Siç u përmend edhe më lart, këto të ardhura tregohen vetëm në momentin e paraqitjes pranë autoriteteve kompetente gjatë procesit të regjistrimit të shtetasve komunitarë, në ato shtete ku kërkohet regjistrimi. Këto të ardhura nuk duhet të tregohen më në të ardhmen¹⁶.

¹⁵ Kjo kompetencë është kundërshtuar së tepërmi, pasi funksionarët e Zyrave të Gjendjes Civile nuk mund të bëjnë njëkohësisht dhe regjistrimin e shtetasve komunitarë dhe familjarëve të tyre dhe verifikimin e disponibilitetit të të ardhurave ekonomike ose të dokumentacionit përkatës të nevojshëm për këtë regjistrim. Në lidhje me këto problematika shih Liberati A., *La disciplina dell'immigrazione e i diritti degli stranieri*, Cedam, 2009, fq. 196; Minardi R.- Palmieri L., *La nuova disciplina dei cittadini comunitari*, Maggioli Editore, 2008, fq. 53.

¹⁶ C.Sanna, *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167; Lang A.-B.Nascimbene, *L'attuazione in Italia della direttiva 2004/38/CE sulla libera circolazione dei cittadini dell'Unione europea*, në *Diritto, immigrazione, cittadinanza*, 2/2007, fq. 3; Adinolfi A. "Pacchetto sicurezza" e violazioni (...sicure) di obblighi comunitari në *Rivista di diritto internazionale*, 2008, fq. 1090; Foglia R., *La libertà di circolazione dei lavoratori*, në *Il diritto privato dell'Unione europea*, A Tizzano (a cura di), Milano 2005, fq. 833.

b) Bashkimi familjar i shtetasve jo komunitarë

Bashkimi familjar ku titullar aktiv është shtetasi jo komunitar që jeton (dhe punon) në një Shtet Anëtar të BE-së, rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i shteteve anëtare në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian 2003/86/KE¹⁷.

Bashkimi familjar i shtetasve jo komunitarë i është nënshtruar gjithmonë legjislacionit të brendshëm i painfluencuar nga e drejta komunitare pasi në legjislacionin europian mungonin akte ligjore që rregullonin institutin e bashkimit familjar. Vetëm në vitin 2003 në Bashkimin Europian miratohet direktiva e parë e cila rregullon bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë. Në fakt, direktiva 2003/86 është frut i negociatave të vështira në Këshill (në ndryshim nga Komisioni dhe Parlamenti Europian) pikërisht pasi Shtetet Anëtare ishin kundër cedimit të sovranitetit të tyre në lidhje me këtë çështje dhe në përgjithësi për çështje të emigracionit.

Një nga kushtet e rëndësishme për të përfituar nga kjo e drejtë, përveç disponibilitetit të një banese të përshtatshme dhe sigurimeve shëndetësore, është pikërisht disponibiliteti i të ardhurave ekonomike të mjaftueshme. Kriteri i të ardhurave ekonomike është sanksionuar në nenin 7 të direktivës 2003/86. Në këtë nen saktësohet shprehimisht se të ardhurat ekonomike duhet të jenë të qëndrueshme dhe të mjaftueshme, që kalojnë ose janë baraz me nivelin e të ardhurave që vendoset si kriter-kufi, nën të cilin përfitohet asistencë sociale. Pra, këto të ardhura duhet të jenë të vazhdueshme dhe të mjaftueshme për individin dhe familjen në mënyrë të tillë që të mos kërkojnë asistencë sociale. Shtetet anëtare kanë diskrecion në vlerësimin e të ardhurave të shtetasve jo komunitarë, të familjarëve që përfitojnë bashkim familjar, të natyrës së të ardhurave dhe të raportit ndërmjet të ardhurave dhe numrit të familjarëve që përfitojnë bashkimin familjar.

Në lidhje me kriterin e të ardhurave ekonomike, të gjitha Shtetet Anëtare, përveç Suedise dhe Belgjikës, kërkojnë respektimin e kriterëve ekonomike, edhe pse me modalitete të ndryshme. Disa nga shtetet anëtare kërkojnë në mënyrë të përgjithshme respektimin e kriterëve ekonomike, pa bërë specifikime të mëtejshme (Qipro, Finlanda, Gjermania, Spanja dhe Anglia); disa të tjera i përcaktojnë kriteret duke iu referuar të ardhurave vjetore minimale (Franca, Greqia, Hungaria, Letonia, Lituania, Luksemburgu dhe Sllovakia) dhe disa të tjera vendosin kufi të ardhurat minimale, nën të cilin jepet asistencë sociale (Austri, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Italia dhe Portugalia)¹⁸.

c) Kriteri i të ardhurave ekonomike – kriteri që diferencon

Kriteri i të ardhurave financiare kërkohet më me rreptësi ndaj shtetasve jo komunitarë. Ky kriter është penalizues i mirëfilltë në (mos) ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar.

¹⁷ Colacino N., Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE në Saulle M.R., L'Europa tra costituzione, asilo e immigrazione, Napoli, 2004.

¹⁸ Groenendijk K.- Fernhout R.- Van Dam D.- Van Oers R.- Strik T., The family Reunification Directive in EU Member States, Nijmegen, 2007, fq. 19.

Treguesi kryesor në lidhje me rreptësinë e kërkesave për të ardhura ekonomike ndaj shtetasve jo komunitarë, ndryshe nga shtetasit komunitarë, lidhet me faktin se disponibiliteti i të ardhurave duhet të jetë jo vetëm në momentin e paraqitjes së kërkesës por edhe në vazhdimësi. Pra, shtetasit jo komunitarë, për të përfituar bashkim familjar duhet të tregojë disponibilitetin e të ardhurave ekonomike jo vetëm në momentin e prezantimit të kërkesës, por edhe gjatë procedurave të bashkimit familjar, në momentin e realizimit *de facto* të tij si dhe çdo herë që shtetasi jo komunitar ose familjarët e tij paraqiten pranë autoriteteve kompetente për rinovimin e lejeve të qëndrimit. Ky “kontroll” sanksionohet shprehimisht jo vetëm në nenin 7 të direktivës 2003/86 por edhe në nenin 16 të saj ku thuhet shprehimisht: “Shtetet anëtare mund ta refuzojnë kërkesën për hyrje dhe qëndrim për bashkim familjar, ose mund të tërheqin ose të refuzojnë rinovimin e lejes së qëndrimit për arsye bashkimit familjar në rastet e mëposhtme: a) *kur kushtet e përcaktuar në këtë direktivë nuk përmbushen ose kur nuk përmbushen më...*”.

Në draftin e parë dhe të dytë të kësaj direktive Komisioni ka propozuar modelin e parashikuar për shtetasit komunitarë, pra që kriteret në lidhje me të ardhurat ekonomike, ashtu si dhe me kushtet e tjera të verifikoheshin vetëm në momentin e parë, d.m.th. në atë të prezantimit të kërkesës për bashkim familjar por këto propozime nuk u pranuan pikërisht për shkak të refuzimit të Shteteve anëtare në Këshill. Në këtë drejtim këto kritere duhet të përmbushen në vazhdimësi. Por, duke patur parasysh që procedurat e bashkimit familjar, nga momenti i prezantimit të kërkesës e deri në realizimin e tij, mund të zgjasin (nga 90 ditë) deri në tre vjet, këto kërkesa bëhen vërtet të rënda për shtetasit jo komunitarë që kërkojnë të përfitojnë nga kjo e drejtë: shto këtu kriteret e tjera që duhet të përmbushen (si disponibiliteti i banesës, i sigurimeve dhe kriteret e integritetit) dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm si kriza financiare apo papunësia e përkohshme.

Përfundime

Të ardhurat ekonomike nuk mund të konsiderohen më “barrë” e rëndë për shtetasit komunitarë në funksion të lëvizjes së lirë në BE. Këto të ardhura, për personat që lëvizin lirshëm në BE brenda tre muajve nuk janë më kusht i domosdoshëm. Pra, për qëndrime afatshkurtra asnjë shtet nuk mund t’i detyrojë shtetasit komunitarë të disponojnë dhe të tregojnë se posedojnë të ardhura ekonomike. Burimet financiare nuk tregohen më nëse shtetasi komunitar jeton për më shumë se 5 vjet në Shtetin pritës. Kategoria e punëtorëve me kontratë nuk tregon se disponon të ardhura ekonomike por tregon kontratën e punës e cila mund të ketë kohëzgjatje variabël (gjathtë muaj - një vjeçare-e deri në pesë-vjeçare). Fakti që personi tregon kontratën e punës për një periudhë kohe më të shkurtër se pesë vjet (kufiri maksimal i qëndrimit për të treguar të ardhurat) tregon që legjislacioni europian dhe praktika e shteteve anëtare nuk i japin këtij kushti atë rëndësi thelbësore që më parë e karakterizonte lëvizjen e lirë. Kjo do

të thotë që autoritetet vendase i japin më tepër rëndësi koherencës dhe rregullsisë së të ardhurave, stabilitetit dhe mbi të gjitha rendit publik, sigurisë publike dhe shëndetit publik. Duke konsideruar të gjitha këto kategori rezultojnë se burimet financiare si shumë të hollash (në llogari bankare apo nëpërmjet vetëdeklarimit) duhet të tregohen vetëm nga shtetasit që nuk janë në marrëdhënie pune.

Burimet financiare për shtetasit komunitarë tregohen vetëm në fillim, pra, në momentin fillestar dhe nuk kërkohen më gjatë qëndrimit të tyre në shtetin pritës. Probleme në lidhje me këta shtetas mund të lindin vetëm nëse ata përfitojnë asistencë sociale, për shkak të të ardhurave dhe rëndojnë në asistencën sociale të shtetit pritës. Por, edhe në këto raste shtetasit nuk mund të dëbohen menjëherë.

Kjo “tolerance” lidhet në mënyrë të pashmangshme me vetë konceptin e shtetësisë europiane. Shtetësia europiane po kthehet në statusin kryesor që karakterizon shtetasit komunitarë qoftë në përfitimin e të drejtave ashtu edhe në kufizimin e ndalimeve për ushtrimin e këtyre të drejtave.

Situata ndryshon ndjeshëm në lidhje me bashkimin familjar. Shtetet duhet të tregohen më tolerante me shtetasit jo komunitarë që kërkojnë bashkimin familjar. Detyrimi i vijueshmërisë së disponibilitetit të të ardhurave financiare të mjaftueshme gjatë realizimit të bashkimit familjar e vështirëson shumë ushtrimin e kësaj të drejte. Të ardhurat familjare nuk duhet të jenë më shkak kryesor për refuzimin e bashkimit familjar.

Literatura

- Adinolfi A., La libertà di circolazione delle persone, në G.Strozzi, (a cura di) Diritto dell'Unione europea, Torino, 2005, fq. 69
- Adinolfi A., Il diritto al ricongiungimento familiare ed il trattamento dei familiari, në Trattati dell'Unione Europea e della Comunità Europea, A.Tizzano, Giuffrè, 2004 fq. 39
- Adinolfi A. “Pacchetto sicurezza” e violazioni (...sicure) di obblighi comunitari në Rivista di diritto internazionale, 2008, fq. 1090
- Adinolfi A., L'art. 39, në Il Codice della famiglia, M.Sesta, 2007 fq. 370
- Blumann B., L'Europe des citoyens, in Revue du Marché Commun, 1991, p. 283
- J.Carlier-E.Guild, L'avenir de la libre circulation des personnes dans l'UE. Analyse de la directive 2004/38 du 29 avril 2004 relative au droit des citoyens de circuler et de séjourner librement, Bryulant-Bruxelles, 2006
- Chalmers D.-E.Szysczczak, European Union Law. Volume two: Towards a European Policy, Great Britain, 1998, fq. 101
- Colacino N., Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE in L'Europa tra costituzione asilo e immigrazione (a cura) di Saulle M.R., Napoli, 2004
- Diritto dell'Unione europea. Aspetti istituzionali e politiche comuni, VXI ed. a cura di Edizioni giuridiche Simone, Napoli, 2008, fq. 303

- Ferrari Bravo L.-E.Moavero Milanesi, *Lezioni di diritto comunitario*, Editoriale scientifica, 2000, fq. 275
- Foglia R., *La libertà di circolazione dei lavoratori, në Il diritto privato dell'Unione europea*, A Tizzano (a cura di), Milano 2005, fq. 833
- Giubboni S.-G.Orlandini, *La libera circolazione dei lavoratori nell'Unione europea*, Torino, 2007, fq. 64
- Groenendijk K.- Fernhout R.- Van Dam D.- Van Oers R.- Strik T., *The family Reunification Directive in EU Member States*, Nijmegen, 2007
- X.Groussot, "Principled citizenship" and the process of European constitutionalization-From a pie in the sky to a sky with diamonds, në U.Bernitz-Nergelius J.-Cardner, *General Principles of EC Law in a Process of Development*, Oxford, 2004
- Guild E., *The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law*, Kluwer Law International, 2004
- K. Hailbronner, *Free movement of EU nationals and Union citizenship*, në R.Cholewinski, R.Perruchoud-E. MacDonald, *International migration law*, The Hague, 2007, fq. 320
- Lang A.-B.Nascimbene, *L'attuazione in Italia della direttiva 2004/38/CE sulla libera circolazione dei cittadini dell'Unione europea*, në *Diritto, immigrazione, cittadinanza*, 2/2007, fq. 3
- Liberati A., *La disciplina dell'immigrazione e i diritti degli stranieri*, Cedam, 2009
- Libre circulation des personnes et des capitaux. Rapprochement des législations*, Commentaire J.Mègret, Paris, fq. 77
- Mattera A., "Civis europaeus sum". *La libertà di circolazione e di soggiorno dei cittadini europei e la diretta applicabilità dell'art. 18 (ex art. 8 A) del trattato CE*, në *Il Diritto dell'Unione europea*, 1990
- M.Missorici-C.Romano, *Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni*, në *Rivista internazionale dei diritti dell'uomo*, n. 11/98, fq. 44
- L.S.Rossi, *I beneficiari della libera circolazione delle persone*, në *Foro italiano*, 1994, fq. 98
- C.Sanna, *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167
- G.Tesauro, *Diritto comunitario*, 4° ed. Cedam, 2005
- L. Trifone, *L'ammissibilità di limiti parziali alla libera circolazione delle persone*, në *Diritti comunitari e degli scambi internazionali*, 42/2003, fq. 755
- Villani U., *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari, 2008, fq. 87

Kriza greke dhe solidariteti European

Arlinda Hoti, Doktorante, UET

ABSTRAKT. Ky artikull përpiket të analizojë krizen e borxhit grek shkaqet dhe efektet e tij, si dhe përgjigjen e BE-së për këtë çështje. Aktualisht vazhdon debati mbi rrugët e zgjidhje së problemit të krizës greke dhe impakti që ka ajo mbi vendet e zonës së Euro-s. Ne theksojmë se qasja kryesore për zgjidhjen e këtij problemi është solidariteti i BE-së ndaj Greqisë pikërisht bazuar në parimin bazë mbi të cilin është krijuar vetë BE-ja që është solidariteti. Natyrisht solidariteti ka cmimin e saj financiar dhe do të varet pikërisht nga ajo se sa vendet anëtare të BE-së do të mbështesin parimin bazë të solidariteti që është parim bazë i vetë BE-së.

Fjalë kyçe: Solidariteti european, kriza ekonomike, vlerësim financiar afatgjatë

Hyrje

Në janar të vitit 2011 bëhen përafërsisht rreth 12 vjet nga krijimi monedhës së përbashkët Euro. Kjo monedhë e re e Bashkimit Evropian, ka arritur tashmë të krijojë reputacionin e vet si valutë e qëndrueshme dhe e besueshme. Megjithatë, gjatë krizës financiare globale, në vitet 2007–2009 ku nivelet e riskut pësuan rritje dhe fenomeni i rrjedhjes së kapitalit preku mbi të gjitha vendet në zhvillim, Euro-ja u ndikua menjëherë dhe u luhat besueshmëria e saj, gjë që nxiti masat për mbrojtjen e saj.

Krijimi i monedhës së përbashkët integroi tregun evropian, lehtësoi në mënyrë të konsiderueshme tregtinë ndërkombëtare, kjo midis të tjerash, falë transparencës së çmimeve ose eliminimit të kostove të shkëmbimit të valutës, pra duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta nga qenia vend anëtar i zonës së Euros. Po kështu, Euro ka garantuar stabilitetin ekonomik duke ulur pasigurinë, gjë e cila ka nxitur investimet afatgjata. Përfitimet nga integrimi rajonal janë fuqizuar gjithashtu në kushtet e bashkimit monetar.

Në këtë artikull kemi si qëllim të prezantojmë krizën, me të cilën duhet të ballafaqohet BE-ja në lidhje me problemet e borxheve kryesisht në Greqi por kjo parë edhe në këndvështrimin nga lajmet e fundit shqetësuese që vijnë nga Portugalia apo Irlanda.

Fillimisht përshkruhen shkaqet e fillimit të krizes dhe ndikimin e saj në zonën e Euro-s. Në kontekstin e kësaj analize kthejmë vëmendjen në domosdoshmërinë e *solidaritetit* evropian, që është një nga parimet e rëndësishme mbi të cilat është krijuar vetë BE-ja.

Greqia në zonën e Euro-s

Sot zona Euro përfshin 16 vende. Kjo do të thote që sot kemi një politikë të vetme monetare, por strategji të ndryshme fiskale (buxhetore). Shtetet anëtare që janë pjesë e BE-së (Bashkimit Ekonomik e Monetar) kanë deleguar pavarësinë e tyre në fushën e krijimit të parasë, rregullimin e normave të interesit si dhe të kursit valutor për llogari të Bankës Evropiane Qendrore. Politika buxhetore ndërkohë ka qëndruar në kopetencat e nivelit kombëtar, por vetëm se i nënshtrohet kontrollit dhe koordinimit të përbashkët.

Greqia si anëtare e BE-së dhe zonës së Euro-s, zgjodhi një strategji të sajën në politikat buxhetore që shkonte drejt akumulimit të borxhit publik. Kjo politikë, që lehtësohej nga besueshmëria që vinte si rrjedhojë e faktit që Greqia ishte pjesë e zonës së Euro-s, bëri që borxhi të ishte më i lirë dhe më lehtë i aksesueshëm.

Qeveria përfitoi elasticitet më të madh në termat e emetimit të borxhit, kurse vlera financiare e obligacioneve pësonte lëkundje thuajse të vogla e të pandjeshme. Si efekt i kësaj politike, në Greqi lulëzoi një sistem i përfitimeve sociale i tejfryrë, gjë e cila nuk pasqyrohej dhe mbështetej në mundësitë reale të ekonomisë greke.

Deri në momentet kur ekonomia po zhvillohej, shteti grek ishte në gjendje të paguante borxhet, por në momentin e rritjes së rrezikut, shkaktuar nga kriza në tregjet ndërkombëtarë financiarë, borxhi publik i akumuluar prej vitesh u bë më i shtrenjtë në shërbimin e tij. Përveç kësaj, për shkak të recesionit ekonomik, u ulën dhe të ardhurat fiskale nga taksat, çfarë shkaktoi rritje të deficitit buxhetor.

Heqja dorë nga monedha kombëtare, bëri që Greqia ta kishte të pamundur përmirësimin e konkurrencës përmes devaluimit të monedhës dhe duke qënë se tregu grek i punës karakterizohej nga një ngurtësi e madhe, kjo vështirësonte përshtatjen e thellë në sektorin e ekonomisë reale.

Duke pasur në vëmendje mungesën e mundësive për një vend anëtar të zonës së Euro-s, për të shfrytëzuar instrumentat që të lejon politika monetare apo e kurseve të këmbimit, atëherë mbetet që vështirësitë të kapërcehen me ndihmën e mekanizmave fiskalë e buxhetorë, por edhe këtu me kufizimet e përgjithshme për vendet anëtare të BE-së. Në këtë aspekt Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes, dokument i nënshkruar nga vendet anëtare të BE-së, vendos kushte për financa publike të sigurta, nëpërmjet forcimit të disiplinës buxhetore në vendet e zonës Euro si dhe në vendet e tjera të Bashkimit Evropian. Ky Pakt plotëson politikën monetare, duke mbajtur në nivele të ulta dhe të qëndrueshme inflacionin e pritshëm¹. Kjo gjithashtu lejon të ruhen normat e interesit në nivele, që krijojnë kushte favorizuese për rritje ekonomike dhe

¹ Pacheco L.M., Fiscal Federalism, EMU and Shock Absorption Mechanism: a Guide to Literature, European Integration Online Papers, 2000, vol. 4.

punësim. Në përputhje me kriteret e Paktit, vendet e zonës Euro, janë të detyruara që të mbajnë buxhetin të balancuar, në një periudhë afatmesme. Në rast të kapërcimit të deficitit buxhetor publik, përmbi nivelin referues të 3% PBB-së, atëhere mbi këtë vend anëtar të BE-së, ndërmerren sanksione të cilat lidhen me detyrimin për të krijuar një depozitë financiare sigurie, e cila kthehet në gjorbë financiare në rast se deficiti tejkalon nivelet e lejuara përgjatë 2 viteve.

Në mënyrë që t'i shpëtonte sanksioneve nga ana e Komisionit Evropian, i cili e ka detyrë monitorimin e situatës buxhetore të vendeve të Bashkimit Evropian², qeveria greke vendosi të fshihnte nëpërmjet manipulimit, nivelin e borxhit të saj publik. Në këtë drejtim Greqia manipuloi statistikën, për cilësinë e të cilave vetë Eurostat-i shumë herë ka patur kundërshtime dhe rezervat e tij.

Manipulimi bazohej në përdorimin e instrumenteve të komplikuar financiare të tilla si swap-et valutore me obligacionet qeveritare që emetoheshin fillimisht të denominura në valutë USD ose YEN dhe më tej këmbeshin në Euro, kjo nëpërmjet marrëveshjes me bankën Goldman Sachs. Marrëveshja parashikonte që borxhi të këmbhej sërish në monedhën e emetuar fillimisht, pra në USD ose YEN. Ndërkohë që kursi i këmbimit të Euros, në të tilla transaksione ndryshonte nga kursi real i tregut, falë të cilës borxhi zyrtar i Greqisë prezantohej si shume me i ulët se në të vërtetë.

Transaksione të tjera lidheshin me mekanizmat e interceptimit të të hyrave të ardhshme publike (me natyrë jo tatimore) kundrejt parave cash të inkasuara paraprakisht. Këto flukse parash për nga definicioni, nuk llogariteshin në borxhin publik.

Në tetor të vitit 2009, qeveria e re e Greqisë prezantoi parashikimet e deficitit buxhetor në nivelin e 12,7% PBB-së³, në të njëjtën kohë kur qeveria e mëparshme e kishte parashikuar nivelin e deficitit buxhetor në rreth 6% të PBB-së. Kjo gjë shkaktoi shqetësim në tregjet financiare. Rishikimi i statistikave financiare të Greqisë, në mënyrë të dukshme e uli besimin ndaj saj, gjë e cila shkaktoi uljen e rentabilitetit dhe rritjen e riskut për obligacionet greke. Sigurimi ndaj pamundësisë eventuale për pagesën e obligacioneve greke kapi shifrën marramendëse të 407 570 EURO në vit për çdo 10 milion EURO borxh të emetuar.

Problemet e Bashkimit Ekonomik e Monetar (BEM)

Problemet e Greqisë tregojnë se, Bashkimit Ekonomik e Monetar, i nevojitet një kontroll më i dobishëm i vendimeve fiskale për të 16 vendet anëtare të saj. Kur u mor vendimi për krijimin e monedhës së përbashkët Euro, u diskutua edhe unifikimi i rregullave fiskale (buxhetore), por kjo gjë megjithë insistimin e Gjermanisë përfundimisht nuk u miratua. Sot idea për të shpëtuar Greqinë nga kriza e borxheve ka

² Pacheco L.M., Fiscal Federalism, EMU and Shock Absorption Mechanism: a Guide to Literature, European Integration Online Papers, 2000, vol. 4


³ Me fjalën „junk bonds” kuptohen letrat me vlerë që vlerësohen me një risk të lartë kreditimi dhe karakterizohen me një vlerësim të ulët financiar „rating” në nivelin BBB (sipas terminologjisë së Standard&Poor's dhe Fitch) ose Baa3 (sipas terminologjisë së Moody).

hasur pikërisht në kundërshtimin më të madh nga ana e taksapaguesve gjermanë, ku duhet thënë se vetë Gjermania vitet e fundit është përballur me kufizime të përfitimeve sociale dhe rritje të moshës së daljes në pension. Kundërshtimet patën si bazë frikën për të mos krijuar një precedent të rrezikshëm sepse ndihma e ofruar Greqisë mund të mos i nxiste grekët për ndërmarrjen e reformave të nevojshme buxhetore (si psh. rritjes së taksave, uljes së pagave e pensione) si dhe nga ana tjetër mund të ishte një sinjal negativ për vendet e tjera që mund të vazhdojnë të mos respektojnë disiplinën buxhetore si Portugalia apo Irlanda.

Megjithatë edhe mosveprimi në këtë rast do të kushtonte shumë. Pamvarësisht se PBB-ja e Greqisë është vetëm 2% e asaj të BE-së, ekspozimi i bankave evropiane ndaj aktivave të Greqisë është i lartë dhe nëse Greqia nuk gjente rrugë për pagimin e borxheve atëherë kjo do të ndikonte gjithë BE-në e më tej tregjet ndërkombëtare financiare. Më të goditurat do të ishin në këtë aspekt bankat dhe institucionet financiare franceze dhe gjermane, ndërkohë që vetë monedha Euro e ka ndjerë në kurriz krizën greke. Ulja e ratingut të Greqisë në fund të viti 2009 nga agjensitë e tilla financiare si Fitch, Standard & Poor's dhe Moody, kanë ndikuar në dobësimin e Euro-s.

Në nëntor të vitit 2009 agjencia financiare Fitch ishte e para që e uli nivelin e vlerësimit të Greqisë në nivelin A-, dhe më pas shembullin e saj e ndoqën dhe agjencitë e tjera financiare (grafiku.1). Si pasojë e këtyre vlerësimeve të ulura letrat me vlerë, morën statusin negativ të quajtur në anglisht "junk bonds"⁴ kjo automatikisht i skualifikon ato nga mundësia për tu investuar nga ana e institucioneve financiare.


Grafiku 1. Vlerësimi financiar afatgjatë i Greqisë



Burimi: Bloomberg

⁴ P. Jacquet, J. Pisani-Ferry, Economic policy co-ordination in the euro-zone, CER, January 2001, s. 4-9.

**Grafiku 2. Lulatja e kursit të këmbimit EURO/USD
në periudhën 1.10.2009–28.02.2010.**



Burimi: grafik i përpiluar mbi të dhënat statistikore nga tregjet financiare.

Nëse kjo tendencë vlerësimi nga ana e agjensive të mësipërme do të vazhdonte me uljen e besueshmërisë së Greqisë atëherë edhe kostoja e borxhit për Greqinë do vazhdonte të rritej dhe do të ishte më e vështirë pagesa e tyre. Po kështu, bankat greke do ta kenë më të vështirë të marrin hua nga Banka Qëndrore Evropiane, bazuar në garancinë e obligacioneve të emetuara greke. Kjo padyshim do të përkeqësonte situatën e tyre financiare dhe do të ulte penetrimin e kredive në tregun grek. Nga ana tjetër, zonës së vendeve të Euro-s, i mungon struktura unike ekonomike, mobiliteti i madh i resurseve të punësimit dhe elasticiteti i pagave. Mungesa e një politike të përbashkët fiskale shkakton asimetri ekonomike, pra shfaqjen e fenomeneve të recesionit ekonomik vetëm në disa prej vendeve të zonës Euro. Diferencat strukturore midis vendeve të zonës Euro dhe në bazë të kësaj – faza të ndryshme të cikleve konjunkturale në ekonominë përkatëse, shkaktojnë reagime të ndryshme ndaj kushteve të jashtme dhe pritshmëri të ndryshme ndaj nivelit të normave të interesit. Nevoja për të nxitur rritjen ekonomike në njërin nga vendet anëtare të zonës së Euro-s, mund të jetë në kundërshtim me presionin inflacionist në një vend tjetër të zonës Euro. Mungesa e mundësisë për të përshtatur normat e interesit ndaj kushteve lokale mund të thellojë vështirësitë në rast recesioni ekonomik.

E ardhmja e zonës euro

Problemet e sipërpërmendura nuk përbëjnë krizën e një shteti të vetëm, por të gjithë zonës euro. E rëndësishme është që të gjenden zgjidhjet e duhura në të ardhmen për probleme të ngjashme. Ndër propozimet e prezantuara nga politikanët, gjendet midis të tjerash, ideja e formimit të qeverisë ekonomike evropiane me qëllim koordinimin më të mirë të qeverive kombëtare. Më pas, ngrihet ideja gjithashtu për

një sistem të ri të ekzekutimit të politikës së duhur fiskale, që vendet anëtare mos të thellonin së tepërmi huamarrjen dhe të mbanin defçitin buxhetor në kufij jo të lartë. Pakti i Stabilitetit dhe i Rritjes që ishte i detyrueshëm deri tani, doli zhgënjyes. Objekt i kritikave është jo vetëm stabiliteti ekonomik dhe struktura e saj, e cila nuk mundëson hyrjen e politikës anticiklike që nxit rritjen ekonomike si dhe kufizon veprimin e të ashtuquajturve stabilizatorëve automatik të koniukturës në periudhën e dobësimit të saj⁵. Joseph E. Stiglitz ka thënë që, kur jemi në periudhën e ngadalësimit ekonomik dhe bien të ardhurat e buxhetit, politika fiskale duhet të jetë më ekspansive. Në këtë rast, borxhi publik duhet të rritet. Ai pra sugjeron që "Bashkimi Evropian duhet të formulojë nga e para paktin e vet të stabilitetit, duke marrë parasysh madhësinë e defçitit buxhetor në kushtet e punësimit të plotë"⁶. Mendim tjetër është krijimi i mekanizmit antikrizë⁷, për shembull, në modelin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili është kreu i institucioneve monetare në botë, e krijuar me qëllim krijimin e një sistemi monetar, i cili do të jetë përgjegjës për sigurimin e stabilitetit ndërkombëtar të sistemit financiar, përmes dhënies së kredive në momentet e rreziqeve, që përmirësojnë likuiditetin. FMN-ja siguron klimen e besimit të ndërsjellë në marrëdhëniet kreditor-debitor si dhe forcon qëndrueshmërinë e kurseve të këmbimit të valutave⁸. Ndiurma për vendet që ndeshin probleme jepet nga përdorimi i mjeteve që vijnë nga kuotat e vendeve anëtare. Megjithatë, ideja se qenia pjesë e strukturës së FMN-së nënkupton garancinë për zgjidhjen e problemeve financiare nga ana e këtyre institucioneve, mund të çojë në shkujdesjen ndaj respektimit të disiplinës financiare⁹. Në lidhje me sa më sipër, fondi i stabilitetit, duke qënë subjekti evropian i Fondit Monetar Ndërkombëtar, mund të financohet në fazën e parë nga emetimi i obligacioneve të garantuara nga qeveritë e zonës euro dhe më pas – nga kuotat e shteteve anëtare, të cilat nuk i përmbushin kriteret e Traktatit të Maastrichtit. Në të njëjtën kohë, do të ishte kjo për ta një nxitje për të rregulluar financat e tyre publike.

Në lidhje me zgjidhjet e debatuar në nivelet më të larta të vendimmarrësve dhe ekonomistëve më të shquar evropianë ideja e cila duket se ka triumfuar deri më tani është respektimi i parimit të solidaritetit, që nënkupton ndihmën për vendet në rrezik si Greqia apo Portugalia. Megjithatë duhet theksuar se çmimi i këtij solidariteti evropian do ta ketë çmimin shumë të lartë dhe jo gjithmonë do të ekzistojë dëshira për ta paguar atë. Taksapaguesit gjermanë dhe së fundmi dhe ndryshimet politike në Finlandë tregojnë për një rritje të euroskepticizmit në Bashkimin Evropian.

⁵ European Commission (2010f), Proposal for a Regulation amending Regulation (EC) No 1466/97 on the strengthening of the surveillance of budgetary positions and the surveillance and coordination of economic policies, COM(2010) 526.

⁶ Jacquet P, Pisani-Ferry J., Economic policy co-ordination in the euro-zone, Centre for European Reform, London 2001,pg.32

⁷ Arghyrou M., Kontonikas A. (2010), The EMU sovereign-debt crisis: Fundamentals, expectations and contagion, Cardi_ Economics Working Papers,pg.11

⁸ Arghyrou M., Kontonikas A. (2010), The EMU sovereign-debt crisis: Fundamentals, expectations and contagion, Cardi_ Economics Working Papers /5–6, pg. 2.

⁹ Në shtator të vitit 2010 në Greqi hyri në fuqi ligji që parashikon deri në 10 vjet burg për mashtruesit e taksave.

Përfundim

Integrimi evropian duhet të shoqërohet me solidaritetin, duke u bërë pjesë e pandarë e vlerave evropiane, ky ka qënë dhe qëllimi i krijuesve të Bashkimit Evropian. Mungesa e tij, sidomos në periudha krize, mund të kthehet në kërcënim për gjithë zonën euro. Tregjet janë të bindur se, Greqia nuk ia del dot mbanë vetë dhe i gjithë bashkimi monetar duhet të ndihmojë Greqinë, që të shpëtojë besimin e saj. Taksapaguesit dhe zgjedhësit e të gjithë vendeve të eurozonës janë të bindur që, ndërvarësia e fateve të tyre është më e madhe se sa politikanët e kishin parashikuar, duke krijuar valutën e përbashkët.

Në maj dhe qershor të vitit 2010 Greqia mori transhin e parë të parashikuar në shumën e rreth 110 mld EUR të paketës së ndihmës, në të cilën bëjnë pjesë huatë e shteteve të zonës euro si dhe kredia nga FMN. Transferta e mjeteve financiare e përcaktuar nga Bashkimi Evropian si dhe Fondi Ndërkombëtar Valutor jepet me kushtin e hyrjes së reformave strukturale. Qeveria Greke filloi reformën e tregut të punës si dhe realizimin e planit të kursimit – ka ulur pagat në sektorin buxhetor dhe ka rritur taksat, si dhe ka përmirësuar pagesën e taksave¹⁰. Muajt dhe vitet e ardhshme do të tregojnë se sa i lartë është çmimi i solidaritetit të Evropës.

Bibliografia

- Argyrou M., Kontonikas A. (2010), The EMU sovereign-debt crisis: Fundamentals, expectations and contagion, Cardi_ Economics Working Papers.
- Barrios S., Iversen P., Lewandowska M. and Setze R. (2009), Determinants of intra-euro area government bond spreads during the financial crisis, European Commission Economic Papers 388.
- European Commission (2010f), Proposal for a Regulation amending Regulation (EC) No 1466/97 on the strengthening of the surveillance of budgetary positions and the surveillance and coordination of economic policies, COM(2010) 526.
- Filipek A.K., Schreiber T. (2010), The Stability and Growth Pact: Past Performance and Future Reforms, College of William and Mary, Working Paper Nr 97.
- Goodhart C., Persaud A. (2008), A proposal for how to avoid the next crash, Financial Times, 31.01.2008.
- Jacquet P, Pisani-Ferry J., *Economic policy co-ordination in the euro-zone*, Centre for European Reform, London 2001
- Pacheco L.M., *Fiscal Federalism, EMU and Shock Absorption Mechanism: a Guide to Literature*, European Integration Online Papers, 2000, vol. 4.
- World Economic Outlook Database*, International Monetary Fund, October 2009.
- <http://www.cmadatavision.com> [05.02.2010].

¹⁰ Në shtator të vitit 2010 në Greqi hyri në fuqi ligji që parashikon deri në 10 vjet burg për mashtruesit e taksave.

Fugia e shtetit dhe Krizat e globalizmit _____

_____ **Dr. Lavdosh Ahmetaj** _____

*Drejtor i Institutit "Aleks Buda"
Universiteti "Kristal"*

ABSTRAKT. *Në këtë punim, shteti është konceptuar në tre teoritë perspektive. Duke e përqëndruar vëmendjen brenda shtetit, për të përshkruar format e ndryshme të fuqisë së shtetit. Kemi argumentuar mënyrat e ndryshme me të cilat shtetet janë në gjendje të përdorin instrumentet politike dhe ekonomike. Është arritur të identifikohen grupet dhe aktorët brenda shtetit për të përcaktuar vendimmarrjen në lidhje me politikën e jashtme. Gjithashtu shqyrtojmë edhe mënyrën në të cilën globalizmi, ideologjitë ndërkombëtare dhe lëvizjet etnonacionaliste kërcënojnë sovranitetin e shtetit, dhe si rrjedhojë, fusin në krizë stabilitetin e sistemit ndërkombëtar (Puto 2004: 498). Të gjitha këto lëvizje, janë studjuar në mënyrë komplekse, për të arritur në përfundimin se, kriza ekonomike gjithësesi mund të menaxhohet dhe të orientohet përmes elitave politike, të cilat janë faktorë të rëndësishëm, të ndërthurur me interesat ekonomike dhe politike (Smith 2005: 233).*

Fjalë kyçe: *Fugia e shtetit, kriza, globalizimi*

Hyrje

Potencialiteti i një shteti varet nga rezervat e tij natyrore të territorit të tij, që janë kritike, në raportet me shtetet e tjerë, në këtë potencialitet përfshihen burimet principiale të fuqisë, të cilt janë:

- a. masa dhe pozita gjeografike,
- b. rezervat natyrore
- c. popullsia.

Në analizën e burimeve principiale të fuqisë, konsiderohen si burimet e para , Masa dhe pozita gjeografike, të cilat njihen në marrëdhëniet ndërkombëtare nga teoristët, por njëherash nuk mund të mos vlerësohen edhe popullsia, e cila i jep një peshë të rëndësishme fuqisë së shtetit, në kushtet e të drejtës publike e strukturuar, në

bazë të institucioneve dhe modeleve moderne, pra nga pikpamja e fuqisë së shtetit, burimet konsiderohen në raport me njëra tjetrën, por pa nënvleftësuar asnjërin. Kjo ka rëndësi në kushtet e një krize globale edhe për faktin se kriza ekonomike kombëtare përballohen përmes formesimit të një shoqërie individuale, e cila është e pregatitur për kriza dhe riciklim të tyre. Duke e parë shtetin në përballjen e krizave globale, është me interes edukimi përmes historisë së krizave, në kontekstin e mekanizmave të tyre, por edhe në rrjedhojat përkatëse, sepse shteti në thelb ka karakter natyror, ai është ajo që përbënë fondamentin e rregullimit të shoqërisë, por gjithnjë duke i konsideruar institucionet politike të shtetit, në harmonizimin e së drejtës natyrore të shoqërisë me të drejtën pozitive, për shka, se kështu mundësohet evitimi i tronditjeve sociale dhe politike. Kjo do të thotë se në kushtet e një krize globale, shteti kombëtar e ka me të thjeshtë për kapërximin e krizës dhe ndërtimin e institucioneve.

Potenciali i fuqisë

Me anë të ushtrimit të fuqisë, shtete të ndryshme kanë influencë mbi shtete të tjerë dhe mund të kontrollojnë drejtimin e ligjeve dhe ngjarjeve të ndryshme. Në qoftë se fuqia është efektive në influencimin e rezultateve, kjo varet nga *potenciali i fuqisë* së çdo pale pjesëmarrëse. Potenciali i fuqisë së një shteti varet nga rezervat e tij natyrore të fuqisë, që është kritike në lidhje me perspektivat realiste dhe radikale. Tre burimet kryesore të fuqisë janë: masa dhe pozita gjeografike, rezervat natyrore dhe popullsia. Masa dhe pozita gjeografike janë burimet e para natyrore që njihen në marrëdhëniet ndërkombëtare nga teoristët (Montesquieu 2001: 39). Një përhapje e madhe gjeografike i jep një shteti fuqi automatike (kur dikush mendon për fuqi, zakonisht ai ka në mendje shtete të mëdha si Rusia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina, Kanadaja, India, ose Britania e Madhe). Megjithatë, kufijtë e gjatë mund të jenë edhe një dobësi; ata duhet të mbrohen në mënyrë të përhershme, gjë që përbën një detyrë problematike.

Dy vizione rreth rëndësisë së gjeografisë në marrëdhëniet ndërkombëtare dolën në pah në fillim të shekullit 20, brenda traditës realiste (Berzhezinski 1999: 149). Në fund të vitit 1890, historiani Alfred Mahan (1840-1914) shkroi rreth rëndësisë së kontrollit të detit. Ai argumentoi se shteti që kontrollonte rrugët oqeanike, kontrollonte botën. Për Mahanin, sovraniteti i tokës nuk ishte aq i rëndësishëm se sa aksesit i rrugëve oqeanike. Në vitin 1904, gjeografi britanik Halford Makinder (1861-1947) ishte kundër këtij qëndrimi. Për Makinderin, shteti që ka më shumë fuqi është ai që kontrollon gjeografinë e Euroazisë; kush sundon Europën Lindore, sundon zemrën gjeografike të Euroazisë; kush sundon zemrën e Euroazisë, sundon të gjithë ishullin e Europës, Azisë dhe Afrikës, dhe kush sundon ishullin e Botës, sundon gjithë botën.

Të dy qëndrimet kanë vlerë empirike. Fuqia britanike në shekullin 18 dhe 19 u përcaktua nga sundimi i saj mbi detet, një fuqi që e lejoi Britaninë të kolonizonte vende të largëta, duke përfshirë edhe Indinë, pjesën më të madhe të Afrikës, si dhe Amerikën Veriore dhe Qendrore (Marks 1974: 125). Pamundësia e Rusisë për akses

në det dhe pamundësia e ndërtimit të një flote të fuqishme detare janë parë si një dobësi e vazhdueshme në potencialin e fuqisë së këtij shteti. Kontrolli i pikave strategjike oqeanike, siç janë Ngushtica e Gjibraltarit ose Kanali i Panamasë, shihen si tregues pozitivë të potencialit të fuqisë. Megjithatë, pozicioni gjeografik i zemrës së Euroazisë që paraqiti Malkinderi, është provuar të jetë një burim domethënës i potencialit të fuqisë.

Më shumë se çdo shtet tjetër, Gjermania ka vepruar për të siguruar fuqi me anë të kontrollit të zemrës së Euroazisë, duke vepruar shumë qartë në bazë të diktumit të Malkinderit, ashtu siç u interpretua edhe nga gjeografi gjerman Karl Haushofer (1869-1946). Haushoferi, i cili shërbeu në ushtrinë e Bavarisë dhe Gjermanisë, ishte i zhgënjyer nga humbja e Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore. Ai argumentoi se Gjermania mund të ishte një shtet i fuqishëm në qoftë se do të sundonte zemrën e Euroazisë; ai ishte i vendosur që ta bënte gjeopolitikën një kërkim akademik legjitim. Ai themeloi një institut dhe një gazetë, duke u bërë në vetvete mbështetësi kryesor dhe ithtar i ekspansionit nazist.

Por, potenciali i fuqisë gjeografike zmadhohet ose përmbahet në rezervat natyrore, që është një burim i dytë i fuqisë natyrore. Të kontrollosh një përhapje të gjerë gjeografike, nuk është një element pozitiv i rritjes në qoftë se kjo rritje nuk ka rezerva natyrore. Shtetet kanë nevojë për naftë dhe ata janë në gjendje të paguajnë shtrenjtë për të, dhe madje ata shkojnë në luftë në qoftë se nuk i lejohet aksesit tek kjo rezervë natyrore. Shtetet që kanë këto rezerva natyrore kaq të domosdoshme, edhe pse kanë përmasë gjeografike të vogël, kanë mundësi që të ushtrojnë fuqi mbi shtete që nuk i kanë këto rezerva natyrore (Montesquieu 2001).

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia dhe Afrika e Jugut kanë më shumë potencial fuqie, sepse ato kanë rezerva të ndryshme natyrore, siç janë: nafta, bakri, floriri, argjendi etj. Sigurisht, po të shkosh gjithmonë pas rezervave natyrore, kjo mund të jetë një pengesë, duke i bërë shtetet shënjestër për aksione agresive ndaj tyre, ashtu siç e pësoi Kuvajti në vitin 1990. Mungesa e rezervave natyrore nuk do të thotë se shteti nuk ka potencial fuqie; Japonia nuk është e pasur në rezervat natyrore, por i ka dhënë vetes elementë të tjerë ekonomikë dhe teknologjikë, duke e kthyer veten në një nga shtetet më të zhvilluar në botë.

Popullsia është burimi i tretë i fuqisë natyrore. Popullata të mëdha si ajo e Kinës, me 1.2 miliardë njerëz, ose India me 975 milionë njerëz, apo Shtetet e Bashkuara me 300 milionë njerëz dhe Rusia me 147 milionë njerëz, automatikisht i japin një shteti potencial fuqie shumë të madh. Megjithatë një popullatë e madhe prodhon një larmi produktesh dhe shërbimesh, karakteristikat e këtyre popullatave (siç janë niveli i ulët i edukimit ose niveli i ulët i shërbimeve sociale) mund të shërbejë si një pengesë në potencialin e fuqisë së shtetit. Shtetet me popullata të vogla, por të edukuar, dhe me aftësi shumë të zhvilluara, si Zvicra ose Norvegjia, Austria, Danimarka dhe Singapori, kanë përparuar dhe gëzojnë një nivel jetese shumë të lartë. Këta elementë të fuqisë natyrore modifikohen nga përdorimi dhe organizimi i fuqisë në burime të prekshme dhe të paprekshme. Këto burime përdoren për të zgjeruar, modifikuar, ose për të mbajtur potencialin e fuqisë.

Burimet e përkohshme të fuqisë

Midis elementëve të preکشëm, zhvillimi industrial është një nga më kryesorët. Me një kapacitet industrial të përparuar, avantazhet dhe disavantazhet e gjeografisë zvogëlohen (Rezenberg 1999: 129). Udhëtimi ajror, për shembull, e bën zgjerimin gjeografik një barrierë joekzistente, por në të njëjtën kohë, bën edhe shtete të mëdhenj që të jenë të ndjeshëm nga aksionet agresive ndaj kësaj industrie. Me industrializmin, rëndësia e popullsisë gjithashtu modifikohet. Ushtri të mëdha, por me armatime të vjetra, nuk mund të luftojnë dot ushtri të vogla, por me mjete të sofistikuara (Akademia e Shkencave 1987). Shtetet e industrializuara zakonisht kanë nivele më të larta edukimi, teknologji më të përparuar dhe përdorin kapitalin e tyre në mënyrë më të efektshme; të gjitha këto i shtojnë potencialin fuqisë së tyre. Si realistët, ashtu dhe radikalët, e vlerësojnë rëndësinë e elementëve të fuqisë dhe potencialit të fuqisë. Por, realistët organizojnë fuqinë rreth shtetit, ndërsa radikalët e shohin elementin e fuqisë në terma të klasave. Në bazë të radikalëve, dallimet mes atyre që kanë elementët e fuqisë, çojnë në krijimin e klasave, disa më të fuqishme (kapitalistët që zotërojnë mënyrat e prodhimit) dhe klasa punëtore. Këto klasa kapërcejnë shtetet dhe kufijtë kombëtarë.

Burimet e paprekshme të fuqisë

Elementët e fuqisë së paprekshme - imazhi kombëtar, mbështetja e publikut, lidhshipi - mund të jenë aq të rëndësishëm sa dhe elementët e preکشëm. Njerëzit brenda shteteve kanë imazhe të potencialit të fuqisë së shteteve të tyre - imazhe që përkthehen në një element të paprekshëm të fuqisë. Kanadezët shihen tipikisht si të përgjegjshëm ndërkombëtarisht dhe të gatshëm të marrin pjesë në misione paqeruajtëse ndërkombëtare, gjithashtu ata japin ndihma të ndryshme humanitare dhe gjithmonë i përgjigjen emergjencave ndërkombëtare. Shteti ka vepruar dhe ka ndihmuar të formojë imazhin, duke e bërë Kanadanë një aktor më të fuqishëm, edhe pse popullata e tyre përbëhet vetëm nga 35 milionë njerëz (Ruso 2008: 192).

Perceptimi i mbështetjes publike është një tjetër element i paprekshëm i fuqisë. Për shembull, fuqia e Kinës u rrit shumë gjatë lidhshipit të Mao Ce Dunit (1893-1976), ku dukej se kishte mbështetje publike për lidhshipin komunist. Fushatat e suksesshme ushtarake të Izraelit në vitet 1967 dhe 1973 mund t'i atribuohen mbështetjes së fortë publike në Izrael, duke përfshirë dëshirën e çdo qytetari izraelit që të shërbejë për ushtrinë e vendit të tij kur të ishte nevoja. Kur kjo mbështetje nga publiku mungon, sidomos në shtetet demokratike, mundësia e potencialit të fuqisë së shtetit zvogëlohet. Kështu dëshmon fakti i Luftës së Vietnamit, ku sfidat kundër dhe mosrënia dakord me luftën e hodhi poshtë vlerën e efektivitetit ushtarak. Humbja e mbështetjes publike, gjithashtu, mund të krijojë sisteme autoritare (Montesquieu 2000: 254). Një rast tjetër është dorëzimi i ushtrisë së Sadam Huseinit përkundër ushtrisë amerikane. Ushtarët irakenë nuk ishin të gatshëm të vdisnin për regjimin e Sadam Huseinit.

Lidershipi është një tjetër element i fuqisë së paprekshme. Liderë të ndryshëm, siç ishin Gandhi në Indi, De Goli në Francë ose Frenklin Ruzvelti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ishin në gjendje të merrnin në dorë potencialin e fuqisë së shteteve të tyre, duke marrë përsipër veprime shumë të guximshme. Liderët e shteteve të varfër, siç ishin Muamer Kadafi në Libi apo Mobutu në Zaire, Fidel Kastro në Kubë, ose siç ishte edhe Sadam Huseini në Irak, i ulin vlerat e potencialit të fuqisë me anë të veprimeve të tyre që dëmtojnë këtë fuqi me kalimin e kohës. Liberalët në mënyrë të veçantë i venë rëndësi lidërsipit; liderët e mirë mund të shmangin alternativën e luftës, kurse liderët e këqinj nuk mund të jenë në gjendje të bëjnë një gjë të tillë (Gazeta Shekulli 1999).

Qartësisht, kur kemi të bëjmë me elementët e prekshëm dhe të paprekshëm të potencialit të fuqisë, atëherë ne kuptojmë se mund të kemi një zmadhim ose zvogëlim të këtij potenciali bazuar në këta elementë. Liberalët, të cilët kanë një kuptim më ekspansiv të fuqisë, mundet që t'i vënë më shumë rëndësi këtyre elementëve të paprekshëm, meqë shumë nga këta janë karakteristika të procesit vendor. Megjithatë, kombinime të ndryshme të burimit të fuqisë mund të sjellin rezultate të ndryshme. Fitorja e aleancës së NATO-s kundër forcave jugosllave të Milosheviçit mund të shpjegohet me madhësinë e burimeve të fuqisë së NATO-s. Por si mund të shpjegojmë atëherë fitoret e Afganistanit kundër Bashkimit Sovjetik në vitet '80 dhe fitoren e Vietnamit ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vitet '70, ose fitoren e Algjerisë ndaj Francës në vitet '50? Në këto raste, shtete me rezerva natyrore të kufizuara ishin në gjendje të fitonin ndaj shteteve me më shumë kapital dhe me më shumë rezerva natyrore. Në këto raste, burimet e paprekshme të fuqisë, duke përfshirë edhe dëshirën e popujve të ndryshëm që të vazhdojnë luftën edhe pse janë në disavantazh, shpjegon fitoren për palën e dobët. Suksesi, duke përdorur forma të ndryshme të fuqisë së shtetit, varet qartësisht nga kontekste specifike.

Në të kundërt, konstruktivistët ofrojnë një perspektivë unike mbi fuqinë. Ata argumentojnë se fuqia përfshin burime të prekshme dhe të paprekshme. Gjithashtu, fuqia përfshin fuqinë e ideve dhe të gjuhës, e cila ndryshon nga ideologjia dhe furnizon me energji palën e dobët. Me anë të fuqisë së ideve dhe gjuhës krijohet identiteti i një kombi.

Përdorimi i fuqisë së shtetit

Në të gjitha perspektivat teorike, fuqia nuk mund vetëm të zotërohet, ajo gjithashtu duhet të përdoret. Përdorimi i fuqisë së shtetit është një detyrë shumë e vështirë. Shtetet përdorin një larmi teknikash për të kthyer potencialin e fuqisë në fuqi efektive. Të gjithë shtetet përdorin teknikat diplomatike, ekonomike dhe fuqinë ushtarake. Në një situatë të veçantë, një shtet duhet të niset me një strategji dhe pastaj të ndryshojë në strategji të ndryshme për të ndikuar mbi shtete të tjerë. Në raste të tjera, teknika të ndryshme mund të përdoren në të njëjtën kohë. Se cilat janë teknikat që shkencëtarët politikë theksojnë më shumë, varet nga perspektiva teorike të ndryshme.

Arti i diplomacisë

Diplomacia tradicionale detyron shtetet që përpiqen të ndikojnë mbi sjelljen e të tjerëve me anë të negociatave, duke ndërmarrë një aksion specifik ose duke u frenuar për të ndërmarrë një aksion specifik, ose duke përdorur diplomacinë publike. Në përdorimin e diplomacisë për të projektuar pushtet, një shtet mund të angazhohet në këto aktivitete (Kissinger 1999: 703):

- Shprehja e shtetit shënjestër, ose publikisht ose privatisht, dhe pakënaqësi me zgjidhjen e veprimeve të tij.

- Sugjeron se një marrëdhënie e mirë do të realizohet në qoftë se veprimet e shtetit shënjestër ndryshojnë në mënyrë specifike.

- Kërcënimi se do të ketë pasoja negative në qoftë se shteti shënjestër vazhdon të lëvizë në një drejtim specifik.

- Kërkesa në një institucion ndërkombëtar për të marrë mbështetje dhe për të legjitimuar këtë kërkesë dhe për të arritur mbështetjen e shteteve të tjerë (Anastasi 2001: 345).

- Mosplotësimi i kërkesave të shtetit shënjestër (siç janë heqja e ndihmave humanitare, tërheqja e përfaqësuesve diplomatikë, prishja e raporteve diplomatike) kur ndërmerr veprime të padëshirueshme.

Diplomacia zakonisht fillon me marrëveshje, me anë të komunikimit direkt dhe indirekt, me synim që të arrihet një marrëveshje për ndonjë çështje. Kjo marrëveshje mund të bëhet në mënyrë taktike nga ana e palëve pjesëmarrëse, sepse ata e dinë se lëvizja në një lloj mënyre, ndikon në lëvizjen e palës tjetër. Marrëveshja mund të zhvillohet haptazi në negociata formale, kur njëra palë ofron një ofertë formale dhe pala tjetër i përgjigjet me dashamirësi; kjo përsëritet disa herë derisa të arrihet një kompromis. Këto janë marrëdhënie reciproke dhe çdo palë është dashamirëse. Shtetet, kur hyjnë në marrëveshje diplomatike, e dinë shumë mirë fuqinë e vet dhe fuqinë e shteteve të tjerë, dhe kështu, edhe pse marrëveshjet zakonisht janë të dobishme për të dyja palët, kjo nuk do të thotë se palët janë gjithmonë të kënaqura nga këto rezultate.

Marrëveshjet dhe negociatat janë proçese komplekse, që ndërlikohen të paktën nga dy faktorë.

Së pari, shumica e shteteve zbatojnë dy nivele marrëveshjesh në mënyrë të njëkohshme; marrëveshje të njëkohshme midis shteteve dhe marrëveshje që duhet të zhvillohen midis përfaqësuesve të shteteve, dhe kështu të dy të arrijnë në pozicion negociimi për të ratifikuar traktatin e marrëveshjes. Shkencëtari politik Robert Putnam i referohet këtij rasti si “loja e dy niveleve”. Negociatat e tregtisë ndërkombëtare në Organizatën Botërore të Tregëtisë (WTO) janë një lojë me dy nivele (Civici 2007: 254). Për shembull, Japonia dhe Koreja e Jugut bënë marrëveshje me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të liberalizuar çmimin e orizit në tregun botëror. Shtetet e Bashkuara mbështesin liberalizmin në mënyrë që të kenë mundësi për të përmirësuar balancën mes saj dhe fuqive respektive aziatike (Klinton 2005). Duke mbajtur këtë qëndrim, Shtetet e Bashkuara mbështesin prodhuesit e orizit në vendin e tyre, të cilët

ndodhen në vende kyç, siç janë shtetet e Kalifornisë dhe Teksasit, kur është koha për zgjedhjet elektorale të vendit, ndërkohë që në Japoni dhe Korenë e Jugut kanë interesat e brendshme të tyre që janë kundër liberalizmit (Hobhaus 2000: 144). Kështu, në të dy rastet, Shtetet e Bashkuara dhe Japonia e Koreja e Jugut janë duke zhvilluar dy palë negociatash, një me shtete të huaja dhe një tjetër në arenën e brendshme politike. Çfarë e bën lojën shumë komplekse është se “lëvizjet që janë racionale për një lojtar në njërën anë, mund të jenë krejtësisht ndryshe nga çfarë është racionale nga ana tjetër”. Negociatori është lidhësi formal midis dy niveleve të negocimit. Realistët e shohin sistemin e dy niveleve si të parandaluar nga sistemi ndërkombëtar, ndërsa liberalët i venë më shumë rëndësi presioneve dhe stimujve të brendshëm.

Së dyti, marrëveshjet dhe negocimet janë një aktivitet për lidhje kulturore. Mënyrat se si arrihen marrëveshjet, ndryshojnë midis kulturave dhe ky është një vizion që pranohet më shumë nga liberalët, të cilët i vënë rëndësi dallimit të shteteve. Deri tani janë dy mënyra që janë identifikuar për negocim. Dy stile të ndryshme mund të japin rezultate që kontrastojnë njëri-tjetrit. Në negociatat e viteve '70 për Rendin e Ri Ndërkombëtar Botëror (NEIO), për shembull, kultura ndikoi mbi stilin e negocimit të adoptuar nga Jugu. Veçanërisht gjatë marrëveshjeve në çështje specifike, Jugu argumentoi një stil deduktiv - nga parimet e përgjithshme deri në aplikimet e veçanta. Detyra që jugu pa për veten e tij, ishte që të bënte shtetet e tij të binin dakord për parimet bazë (NEIO) dhe t'i linin detajet e tjera të zgjidheshin në një datë të mëvonshme. Kjo lloj metode maskoi në mënyrë të favorshme detajet deri në një fazë tjetër të bisedimeve. Mënyra e Jugut ishte në kundërshti të thellë me mënyrën se si bëheshin negociatat në Veri, ku më shumë favorizohej diskutimi i detajeve konkrete, duke iu larguar debateve filozofike. Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe ishin aktorët kryesorë në veri, dhe që të dyja favorizonin pragmatizmin e adresimin e problemeve konkrete dhe zgjidhjen e çështjeve specifike përpara se parime më të gjera të mund të kristalizoheshin (Kissinger 1999: 24). Këto diferenca në mënyrën e negocimit çuan në shumë raste në një ngrirje të bisedimeve dhe eventualisht në dështim për arritjen e ndonjë lëshimi domethënës.

Përdorimi i diplomacisë publike është një teknikë më popullore në një botë të lidhur me mjete të ndryshme komunikimi. Diplomacia publike përfshin edhe përpjekjet për të krijuar një imazh të përgjithshëm që e rrit mundësinë e një shteti për të arritur objektivat e tij diplomatikë. Për shembull, Zonja e Parë, Hilari Klinton, në udhëtimet e saj i vuri shumë rëndësi emancipimit të gruas në shoqëri në të gjithë botën dhe, në këtë mënyrë, i jepej një imazh humanitar edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sidomos rreth kujdesit për njerëzit, duke përfshirë gratë dhe fëmijët dhe duke i dhënë shtytje vlerave, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Ekonomia e shtetit

Shtetet përdorin ekonominë e shtetit - me sanksione pozitive apo negative - dhe përpiqen të ndikojnë edhe mbi shtete të tjerë. Sanksionet pozitive përfshijnë edhe ofertat që e nxisin shtetin shënjestër të veprave në mënyrën e dëshiruar. Nga ana

tjetër, sanksionet negative mund të jenë edhe norma: duke kërcënuar që të veprojë për të ndëshkuar shtetin shënjestër për lëvizje në drejtimin jo të dëshiruar. Synimi për përdorimin e sanksioneve negative është të ndëshkojë ose të qortojë shtetin shënjestër për aksionet e ndërmarra, për të ndryshuar sjelljen e ardhshme të shtetit shënjestër. Tabela e mëposhtme na jep shembuj të sanksioneve pozitive dhe negative të përdorura nga ekonomia e shtetit:

Tipet e sanksioneve të ekonomisë së shtetit

Tipi	Sanksioni	Shembulli
Pozitiv	I jep shtetit shënjestër të njëjtat privilegje tregtare, ashtu siç i jepen shteteve partnerë më të dëshiruar.	Shtetet e Bashkuara i dhanë titullin e shtetit më të favorizuar për tregti Kinës, edhe pse ky shtet ka një histori të keqe në lidhje me të drejtat e njeriut.
Pozitiv	Lejon tregti sensitive me shtetin shënjestër, duke përfshirë mjetet ushtarake, me anë të liçensimit të importit dhe eksportit të mallrave kryesore.	Franca dhe Gjermania i eksportojnë mjete të ndryshme Iranit, edhe pse qeveria iraniane është në pozitën e kundërshtarit ndaj Perëndimit.
Pozitiv	I jep korporatave garanci në lidhje me investimet e tyre dhe stimuj në taksa për të investuar në shtetin shënjestër, të cilat mund të shihen si shumë të rrezikshme.	Shtetet e Bashkuara i ofrojnë siguri kompanive amerikane që kanë dëshirën të investojnë në Afrikën e Jugut në periudhën e postaparteidit.
Pozitiv	Lejon importimin e produkteve nga shteti shënjestër në vendin tuaj me sistemin e tarifave të rezervuara për shtetet e preferuar.	Shtetet e industrializuara lejojnë importimet nga shtetet në zhvillim me tarifa më të ulëta.
Negative	Ngrirja e fondeve të shtetit shënjestër në bankat tuaja.	Shtetet e Bashkuara ngrinë depozitat e Bankës Iraniane gjatë krizës së pengjeve në vitin 1979.
Negative	Vendosja në listën e zezë të shtetit shënjestër.	Shtetet arabe vunë në listën e zezë kompanitë që bënin biznes me Izraelin.
Negative	Bojkotimi i produkteve dhe shërbimeve që vijnë nga shteti shënjestër.	Afrika e Jugut u bojkotua në vitet '70 dhe '80, në përgjigje ndaj politikës së saj raciste të aparteidit.
Negative	Sanksionimi i një ose i të gjitha produkteve të shtetit shënjestër.	Iraku u ndalua të shiste naftë në tregun botëror, si ndëshkim për Luftën e Gjirit Persik të vitit 1991.

Mundësia e shtetit për të përdorur instrumentët e ekonomisë së shtetit varen nga potenciali i fuqisë. Shtetet me një larmi burimesh për fuqinë kanë më shumë instrumente në dispozicion. Qartësisht, vetëm shtete në gjendje të mirë ekonomike mund të japin liçensa ose të ofrojnë investime të sigurta, ose t'i japin preferenca një shteti të veçantë, të mbajnë pasuri të huaja, ose të bojkotojnë në mënyrë efektive. Radikalët shpesh venë në dukje këtë fakt për të ilustruar homogenitetin e sistemit kapitalist ndërkombëtar. Edhe pse radikalët refuzojnë ta pranojnë, liberalët argumentojnë se shtetet në zhvillim kanë një lloj ndikimi në ekonominë e shtetit

në rrethana të veçanta. Nëqoftëse një shtet ose një grup shtetesh kontrollojnë një rezervë natyrore kryesore për të cilën ka një prodhim të kufizuar, fuqia e tyre rritet. Midis produkteve primare, vetëm nafta ka këto karakteristika dhe i dha vendeve arabe anëtare të Organizatës së Kombeve Eksportuese të Naftës (OPEC) mundësinë për të diktuar sanksione mbi Shtetet e Bashkuara dhe Hollandën, kur këta dy shtete mbështetën Izraelin në luftën arabo-izraelite të vitit 1973.

Shtetet e dobët mund të përdorin edhe metoda më pak shtrënguese, duke u përpjekur të ndikojnë mbi procesin e ligjvënies në vend të një shteti më të fortë, që të lëvizë në drejtimin e dëshiruar. Shtetet e dobët përpiqen të tërheqin vendimmarrësit me anë të ndërmjetësisë, duke përdorur kontakte personale dhe taktika ndikuese dhe, shpeshherë, duke mbikaluar kanalet zyrtare. Për shembull, në fund të viteve '80, qeveria e Koresë së Jugut punësoi Majkëll Deverin, që më parë kishte qenë drejtori i staftit të Shtëpisë së Bardhë, për të prezantuar negociatorët nga Koreja e Jugut me zyrtarë të lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, individë nga një shtet i dobët mund të përdorin njohuritë e tyre të mekanizmit procedural ose sistemin legal në shtetin e fortë, për të ndërhyrë administrativisht, në mënyrë që të reklamojnë axhendën e shtetit të tyre. Kështu, Koreja e Jugut paguan më shumë se njëqind avokatë amerikanë për të krijuar një sistem prirjesh rregulluese, për të gjetur shtigje të ndryshme në sistem për të avancuar interesat tregtare të Koresë së Jugut.

Shtetet e dobët mund të përdorin edhe mënyra më të gjera bashkëpunimi, siç është lidhja e çështjeve të ndryshme me njëra-tjetrën, dhe duke u përpjekur të depërtojnë në rrjetet sociale të shoqërisë, duke lidhur grupe përtej kufijve kombëtarë. Tajvani ishte në gjendje të shmangte sanksionet pas hetimeve të bëra në lidhje me praktikën e padrejtë të Tajvanit në fund të viteve '80, duke blerë me kujdes prodhime të eksportuara në Tajvan nga korporata amerikane që ndodheshin në zonat kryesore elektorale në zgjedhjet amerikane. Kongresmenët nga këto distrikte, pasi u zgjodhën në kongres, ishin më pak të interesuar për të hetuar praktikën e tregtisë të Tajvanit. Në një numër të kufizuar rastesh, shtetet e dobët mund të përdorin mobilizmin "grassroot" - siç është shkruajta e letrave, duke dhënë kontribute financiare për fushata elektorale dhe duke u mbështetur në rrjetet sociale. Izraeli dhe lobi pro-izraelit e përdor këtë teknikë në mënyrë të shkëlqyer në Amerikë, duke kaluar fonde me anë të këtyre mënyrave për politikanët që mbështesin Izraelin. Të njëjtat strategji janë gjithashtu të rëndësishme për shtete më të fortë; shtetet e fortë kanë më shumë mundësi. Teoristët liberalë (Civici 2007: 164) e vendosin theksin në fuqinë ekonomike, diplomatike dhe më pak shtrënguese, meqë ata e vizionojnë fuqinë si një marrëdhënie shumëpërmasore. Teoristët realistë besojnë se është i nevojshëm përdorimi i forcës në një bazë më të rregullt.

Si përfundim: së pari, tendencat e krizave globale çojnë gjithnjë e më shumë në përgjegjësitë e zhvillimit të brendshëm ekonomik; dhe së dyti, sovraniteti i shteteve kombëtarë ndërjegjëson për lënien e elementëve sovranë.

Bibliografia

- Puto, A., (2008) "Shqipëria politike", Tiranë
- Puto, A., (2002) "Historia e diplomacisë 1914- 1918", Tiranë
- Kissinger, H., (2000) "Diplomacia", Tiranë
- Bachouse, R., "Historia e Teorive Ekonomike", Tiranë
- Unioni i Ekonomisë Shqiptare (1999), "Zhvillimet Ekonomiko – Shoqërore", Tiranë
- Hobbsi, Th., (2000) "Leviatani", Tiranë
- Omari, L., (2004) "Shteti i së Drejtës", Tiranë
- Rosnou, XH., (1990) "Turbulencat në botën politike", New Jersey
- Dibra, P., (2005) "Shqipëria dhe Diplomacia Angleze", Tiranë
- Hegel (2000), "Shkrime Politike", Tiranë
- Montesquieu, (2000) "*Mbi Frymën e Ligjit*", Tiranë
- Instituti i Financave Kosovë (2008) "*Konferenca e Nëntë Ndërkombëtare*", Prishtinë
- Ferguson, Y dhe Manbah, R (1988) "Kërkimi i pakapshëm; teoria e politikës ndërkombëtare"
- Kasner, S., (1978) "Mbrotjtja e interesave kombëtare", Universiteti i Prinstonit, New Jersey
- Mahan, A., (1897) "Influenca e fuqisë detare në histori nga vitet 1660-1773", Boston
- Mek, A., (1975) "Përse shtete të mëdhenj humbasin luftëra të vogla. Politika e konfliktit asimetrik"

Eksperienca europiane në përcaktimin e zonave malore më pak të avantazhuara: aplikimi në kushtet e Shqipërisë

Dr. Shkelzen Marku

Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore

Abstrakt. Zonat malore kanë një rëndësi të madhe sociale, ekonomike, kulturore dhe mjedisore për vendin. Në këto kushte, politika Shqiptare përballet sot me një sërë sfidash lidhur me rritjen e kohezionit social si dhe të konkureshmërisë së këtyre zonave. Për arritjen e këtij qëllimi, duhet të ndërmerren politika konkrete dhe të përdoren sa më shpejt të gjitha instrumentat politike dhe mekanizmat e mbështetjes për futjen në shfrytëzim të burimeve dhe përshtetimin e ritmeve të zhvillimit të zonave malore dhe atyre më pak të favorizuara. Në këtë fushë kemi shumë për të mësuar nga komuniteti i vendeve europiane, drejt të cilave deshirojmë të shkojmë sa më shpejt. Pothuajse të gjitha vendet europiane kanë politika dhe instrumente teknike dhe financiare specifike për mbështetjen e zonave malore dhe më pak të favorizuara dhe rritjen e kohezionit social.

1. Hyrje: rëndësia e përcaktimit të zonave malore në Shqipëri

Shqipëria është një vend i vogël, me një sipërfaqe prej 28,748 kilometër katrorë, me një popullsi prej 3,2 milion banorë, një densitet prej rreth 110.3 banorë/km² (INSTAT, 2009) dhe me një lartësi mesatare rreth 708 metra mbi nivelin e detit. Shqipëria është një nga vendet më malore të mesdheut, ku hapsirat malore zënë rreth dy të tretat e territorit të vendit dhe në të cilat jetojnë më shumë se gjysma e popullsisë. Popullsia që jeton në këto zona është përballur historikisht me një sërë vështirësish natyrore, fizike, ekonomike dhe strukturore. Ndryshimet e mëdha ekonomike dhe politike të këtyre 20 viteve të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut kanë patur ndikime të ndjeshme në jetën ekonomike dhe sociale të këtyre zonave. Si rezultat, një numër i madh familjesh janë larguar drejt zonave fushore dhe sub-urbane për një jetë më të mirë dhe për më shumë mundësi për të ardhmen e fëmijëve të tyre. Pavarësisht progresit të bërë në disa aspekte gjatë viteve, bujqësia në shkallë të vogël mbetet sot aktiviteti kryesor ekonomik i

këtyre zonave edhe pse me një produktivitet mjaft të ulët. Nga ana tjetër, mjaft burime dhe mundësi të tjera mbeten të pa shfrytëzuara sa duhet.

Një nga këto instrumenta, që mund të përdoret së shpejti edhe nga Shqipëria, është IPA e cila lejon tavane më të larta mbështetje nga fondet publike për investime në zonat malore dhe ato më pak të favorizuara. Por, përdorimi i këtyre mundësive kërkon që vendi të ketë një përcaktim të qartë dhe sipas kriterëve të pranueshme për BE-në se cilat janë konkretisht zonat malore në Shqipëri. Një përcaktim i qartë i këtyre zonave përben gjithashtu një mundësi të mirë për futjen e masave kompensuese në kuadër të financimeve publike në nivel kombëtar dhe një mundësi për praktikimin dhe zhvillimin e pagesave kompensuese të ngashme me ato të Bashkimit Europian.

Në mbështetje të këtij procesi, MADA realizoi gjatë vitit 2010 një studim i cili kishte tre objektiva komplementare: (i) të analizonte eksperiencën dhe legjislacionin e vendeve europiane mbi përcaktimin e zonave malore dhe më pak të favorizuara; (ii) të Zhvillonte një metodologji për përkufizimin dhe përcaktimin e zonave malore në Shqipëri, dhe (iii) të grumbullonte dhe analizonte të dhënat e nevojshme për përcaktimin e zonave malore të Shqipërisë. Grupi i ekspertëve të MADA u mbështet edhe nga ekspertë të huaj të ofruar nga GTZ në kuadër të projektit EU-IPA-2008 si dhe ekspertë të IFAD.

2. Shqyrtimi i eksperiencës së vendeve europiane

Faza e parë e studimi konsistoi në grumbullimin dhe shqyrtimin e eksperiencës së vendeve të ndryshme europiane si dhe të legjislacionit të Bashkimit Europian dhe të vendeve të ndryshme mbi përcaktimin e zonave të tyre malore.

Politika e BE i konsideron zonat malore si një nga kategoritë e zonave më pak të favorizuara, kryesisht si pasojë e “handikapit natyror” që ato kanë. Në terma socio-ekonomik, “handikapi natyror” i zonave malore konsiston në dy elemente;

(I) ***Lartësinë mbi nivelin e detit***: sepse me rritjen e lartësisë temperaturat dimrore bien shumë dhe kontrastet e temperaturave bëhen më të mëdha (gjë që kufizon përdorimin e tokës për prodhim bujqësor, shkurton sezonin e rritjes së bimëve, e bën transportin rrugor më të vështirë, rrit kostot, etj.);

(II) ***Topografinë (pjerrësisë)***: sepse terrenet e ashpra vështirësojnë aksesin rajonal, e bën komunikimin dhe investimet e tjera në infrastrukturë më të shtrenjtë, kufizon apo pengon mekanizimin në bujqësi, dhe bën modernizimin e bujqësisë dhe industrive të tjera më të vështirë;

(III) Apo ***kombinime të lartësisë dhe pjerrësisë***, ku handikapi nga secili i marrë veçmas është më i vogël, por kombinimi i të dy faktorëve jep të njëjtin efekt handikapi si më sipër.

Shqyrtimi i eksperiencës së vendeve europiane tregon se, në vende të ndryshme, janë zhvilluar dhe aplikohen përkufizime të ndryshme për politikat kombëtare dhe ato europiane. Edhe pse ka një konsensus të gjërë mbi përcaktimin e maleve të larta, ka opinione të ndryshme mbi diferencat mes maleve dhe kodrave dhe, veçanërisht, pjesën e poshtme topografike të peisazheve.

Në 2001, Komiteti i Bujqësisë i Parlamentit European vendosi një pikëpamje të përgjithshme mbi rajonet malore brenda vendeve të BE-së, si “rajone administrative të përcaktuara me mbi 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore të përdorur mbi të paktën 600 metra dhe me një sezon të shkurtër të rritjes së bimëve... dhe rajonet ku mesatarja e gradëve të pjerrësisë është mbi 20%” (Parlamenti European, 2001). Megjithatë, Neni 50 (paragrafi 2) i Rregullores (EC) No 1698/2005, mbi mbështetjen për zhvillimin rural nga EFRD, përfshin përkufizimin e zonave malore si vijon “Për të përfituar nga pagesat të ofruara nga Neni 36(a)(i) zonat malore [*që përfshijnë pagesat për masat që targetojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, përmes pagesave për fermerët në zonat me handikap natyror*] duhet të karakterizohet nga kufizime të konsiderueshme të mundësive të përdorimit të tokës dhe një rritje e dukshme e kostove të punimit të saj si pasojë e: (a) ekzistencës, për shkak të lartësisë, e kushteve klimaterike shumë të vështira, që kanë si rezultat një shkurtim të ndjeshëm të sezonit të rritjes së bimëve; (b) në lartësitë më të vogla, prezenca në një pjesë të madhe të territorit e pjerrësive shumë të larta që pengon shfrytëzimin e mekanikës bujqësore ose që kërkon përdorimin e mjeteve speciale, ose një kombinim i të dy faktorëve...” Zonat në veri të paralelit të 62-të si dhe zonat e bashkëngjitura me to, duhet të konsiderohen si zona malore.

Pavarësisht debateve mbi përcaktimet e ndryshme në kuadër të politikave kombëtare, vendet anëtare të BE-ë i kanë përcaktuar zonat e tyre malore për efekt të aplikimit të politikës europiane në linjë me parimet e kësaj rregullorje. Tabela e mëposhtme prezanton një përmbledhje të kriterëve kryesore të përdorura nga disa vende të BE-së në përcaktimin e zonave të tyre malore.

Tabela 1. Kriteret për përcaktimin e zonave malore në vendet e BE-së

Vendet	Lartësia minimale	Kritere të tjera
Austria	700 m	Edhe > 500 m, nëse pjerrësia > 20 %
Belgjika	300 m	
Bullgaria	600m	Edhe > 200 m diferencë lartësie/km ² ; ose pjerrësi > 12 °
Kroacia	650 m	
Qipro	800 m	Edhe > 500 m nëse mesatarja e pjerrësisë >15 %
Republika Çeke	700 m	
Franca	700 m (në përgjithësi) 600 m (zona e Vosges) 800 m (zona mesdhetare)	Pjerrësia > 20 % në > 80 % të sipërfaqes
Gjermania	700 m	Kushte klimaterike të vështira
Greqia	800 m	Edhe 600 m nëse pjerrësia > 16 %; Nën 600 m nëse pjerrësia > 20 %
Hungaria	600 m	Edhe > 400 m nëse pjerrësia mesatare > 10 %; ose pjerrësia mesatare >20 %
Italia	600 m	Ndryshim i lartësisë > 600 m

Norvegjia	600 m	
Polonia	350 m	Ose > 12 ° për të paktën 50 % të sip.bujqësore në komunë
Rumania	600 m	Edhe në pjerrësi > 20 °
Slovakia	600 m	Edhe >500 m në pjerrësi > 7 °; ose pjerrësi mesatare > 12 °
Slovenia	700 m	Edhe > 500 m nëse > 50% e tokës së fermës në pjerrësi > 15 %; ose pjerrësi > 20 %
Portugalia	700 m (veriu i lumit Tejo) 800 m (jugu i lumit Tejo)	Pjerrësi > 25 %
Spanja	1 000 m	Pjerrësi > 20 %, ngritje e lartësisë me 400 m
Ukraina	400 m	

Burimi: Agjencia Europiane e Mjedisit, 2010 [Castelein et al. (2006); raportet kombëtare për Komisionin European (2004b); Observatori European i Pyjeve Malore (2000); Price (2000)].

3. Metodologjia e përdorur për përcaktimin e zonave malore në Shqipëri

Për përzgjedhjen e kritereve të përcaktimit të zonave malore të Shqipërisë dhe vendosjen e niveleve të secilit kriter (lartësi dhe pjerrësi) janë përdorur dy përjasje: (i) analiza e të dhënave (statistikore dhe GIS) për të parë se në cilat nivele rezulton më i dallueshëm faktori “handikap natyror”, si pasojë e ndikimit të lartësisë dhe pjerrësisë, dhe demarkimi i këtyre niveleve, dhe; (ii) krahasimi i rezultateve të përpunimit statistikore dhe GIS me eksperiencën e vendeve europiane.

Zbatimi i këtij studimi kërkonte përdorimin e një game të madhe të dhënash nga burime të ndryshme, përfshirë statistika nga institucione të ndryshme si të dhëna të zhvilluara dhe grumbulluara në mënyrë specifike për këtë studim. Treguesit e përdorur përfshinin: tregues gjeografik, topografik, demografik, ekonomik, tregues të prodhimit dhe produktiviteti bujqësor, tregues të infrastrukturës, etj. Informacione të vlefshme cilësore dhe staistikore u siguruan pranë institucioneve të ndryshme (INSTAT, zyrat e statistikave të ministrive të ndryshme, etj.). Gjithashtu, një sasi e konsiderueshme të dhënash u grumbulluan në mënyrë specifike për këtë studim nga ekspertë të MADA në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë. Të dhënat GIS për të gjithë territorin e vendit u siguruan kryesisht nga Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA).

Analiza e të dhënave për përcaktimin e faktorit të “handikapit natyror” mbi përdorimin e tokës bujqësore dhe sezonin e rritjes së kulturave janë kryer në nivel njësie të qeverisjes vendore (niveli NUTS-5)¹. Të dhënat statistikore mbi sipërfaqet e mbjella, rendimentet, kostot, aksesin në treg janë krahasuar mes njërive të konsideruara si të favorizuara/avantazhuara dhe atyre të konsideruara si të pa avantazhuara.

Analiza e lartësisë mbi nivelin e detit si dhe pjerrësisë është bërë me anë të përpunimit të të dhënave në GIS, të dhëna këto të siguruar kryesisht nga Agjencia Europiane e

¹ Nëse krahasohet me sistemin NUTS të BE, Qarqet në Shqipëri korrespondojnë me nivelin NUT-3, rrethet korrespondojnë me NUTS-4 dhe komunat dhe bashkitë me nivelin NUTS-5.

Mjedisit. Analiza e të dhënave në GIS është kryer për çdo pjesë të sipërfaqes së vendit në madhësinë 25m² (gjë që është shumë më e detajuar se sa minimumi i aplikuar në raste të tilla nga vendet e BE-së, që zakonisht është 1 km²). Mbi këtë bazë janë përcaktuar lartësitë e tokës bujqësore mbi nivelin e detit si dhe nivelet e pjerrësive të tyre për çdo njësi të qeverisjes vendore të vendit.

Të dy analizat (statistikore dhe GIS) janë kryqëzuar dhe janë krahasuar mes tyre si dhe me rezultatet e analizave të ngjashme në vendet europiane, dhe mbi këtë bazë janë përcaktuar nivelet e kriterëve për Shqipërinë.

4. Rezultatet: përkufizimi dhe përcaktimi i zonave malore të Shqipërisë


Bazuar në rezultatet e analizës së të dhënave dhe duke i krahasuar ato me eksperiencat e vendeve të ndryshme të BE, grupi u konkludua se për tu konsideruar “zonë më pak e avantazhuar malore”, një njësi e qeverisjes vendore duhet të përmbushë të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- Të ketë të paktën 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore në lartësinë mbi 600 metra mbi nivelin e detit;
- Të ketë të paktën 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore me pjerrësi mbi 20%;
- Të ketë të paktën 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore në lartësinë mbi 300 metra mbi nivelin e detit dhe të ketë njëkohësisht mbi 50% të sipërfaqes së tokës bujqësore me pjerrësi mbi 15%;
- Të ketë një reliev shumë të thyer, i përcaktuar me deviacion standart të lartësisë mbi nivelin e detit mbi 200 metra;
- Të jetë e rrethuara në mbi 50% të territorit të saj, nga: (i) njësi të tjera të qeverisjes vendore të klasifikuara “më pak të favorizuara malore” me të paktën një nga kriteret e mësipërme; ose (ii) të rrethuara pjesërisht nga njësi të qeverisjes vendore të klasifikuara “më pak të favorizuara malore” dhe pjesërisht nga kufinj të kombëtar.

Nga aplikimi i këtyre kriterëve në bazën e të dhënave për secilën njësi të qeverisjes vendore të vendit, rezulton se:

- 240 njësi vendore (komuna/bashki) rezultojnë si “zona më pak të avantazhuara malore” sipas të paktën njërit prej 5 kriterëve të mësipërme (ose 64% e njësive vendore në të cilat jetojnë rreth 37.3% e totalit të familjeve të vendit);
- 133 Njësi Vendore rezultojnë jo-malore (ose 36% e njësive vendore, ku jetojnë rreth 62.7 e totalit të familjeve të vendit);

Grafik 1. Përqindja e njësive vendore të klasifikuara si “zonë më pak e avantazhuar malore” sipas nënprefekturave.



Bibliografia

- Castelein et al. 2006.** Raportet Kombëtare për Komisionin European.
- Castelein, et al, 2006.** Mountains and the law: Emerging trends. Legislative study 75, Rev.1. FAO, Rome.
- EC, 2009a.** Sixth progress report on economic and social cohesion. European Commission, Brussels.
- EC, 2006.** Council Document No10917/06: Review of the EU Sustainable Development Strategy (EU SDS). European Commission, Brussels.

- EC, 2006.** Commission Regulation (EC) No 718/2007 of 12 June 2007 implementing Council Regulation (EC) No 1085/2006 of 17 July 2006 establishing an Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA). Commission Regulation. s.l. : EC, 2006.
- EC, 2005.** Council regulation (EC) No 1698/2005 on support for rural development by the European Agricultural Fund for Rural Development (EAFRD). Council regulation. s.l. : European Agricultural Fund for Rural Development (EAFRD), EC, 2005.
- EC, 2004.** Mountain areas in Europe: Analysis of mountain areas in EU Member states, Acceding and other European countries. Directorate-General for Regional Policy, European Commission, Brussels.
- EC, 2000b.** Structural policies and European territory: The mountains. Office for Official Publications of the European Communities, Luxembourg
- EC, 1999.** Council Regulation (EC) No. 1257/1999 establishing an Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA). Council Regulation. s.l. : EC, 1999.
- EEA, 2010.** Europe's ecological backbone: recognizing the true value of our mountains (Report No 6/2010). s.l. : Office for Official Publications of the European Union, 2010.
- EEA, 2010.** GIS data representation for Albanian. [Online] <http://www.eea.europa.eu/data-and-maps>.
- EOMF, 2000.** Raport i Observatorit Europian të Pyjeve Malore;
- NORDREGIO, 2004.** Mountain Areas in Europe: Analysis of mountain areas in EU member states, acceding and other European countries.
- INSTAT, 2009a.** Albania in Figures 2008. Tirana, Albania : INSTAT, 2009 (a).
- Krutaj, F. et al., 1991.** Gjeografia fizike e Shqipërisë. s.l. : Kombinati Poligrafik Tirane.
- Ministry of Agriculture of Slovenia, 2007.** Rural Development Programme of the Republic of Slovenia 2007 – 2013. 2007.
- Price, M.F., 2003.** Sustainable mountain development in Europe. In: Mather, A. and Bryden, J. (eds.) Regional Sustainable Development Review: Europe, Encyclopedia of Life-Support Systems. EOLSS, Oxford
- Price, M.F. (ed.), 2000.** Mountain regions east and south of the Adriatic Sea. SAB-Verlag, Brugg.

Cila është vlera e tokës? Informacione nga krijimi i tregut në zonën bregdetare shqiptare

_____ Dr. Fatmir Guri _____

_____ M.Sc. Elena Kokthi _____

Abstrakt. Kur sjellim ndërmend konkurrencën që ekziston midis bujqësisë dhe sektorëve të tjerë ekonomikë, ne i referohemi pothuaj gjithmonë konkurrencës së përdorimit të tokës midis bujqësisë dhe turizmit, ose midis bujqësisë dhe urbanizimit. Këto tre aktivitete janë konsumatorë të mëdhenj të tokës. Është e vërtetë se bujqësia është përdoruesja më e madhe e tokës por edhe aktivitetet e tjera kanë nevojë për hapësira të gjëra për tu zhvilluar. Në ballafaqimin midis bujqësisë dhe turizmit, ka edhe dy faktorë të tjerë të cilët janë në disfavor të bujqësisë: së pari, niveli i të ardhurave të nxjerra nga aktiviteti bujqësor është më i ulët se sa ai i siguruar nga turizmi. Së dyti, aktivitetet bujqësor dhe turistik kanë nevojë për krah pune të rëndësishëm, faktor që është bërë problematik në zonat rurale të mesdheut verior, ku është gjithmonë e më i pranishëm procesi i dezertifikimit të zonave rurale, i shoqëruar me eksode rurale drejt qyteteve, duke rrënuar kështu ekonomitë rurale, probleme të cilat nuk janë akoma verifikuar në vendet e Jugut. Këto raste përfundojnë me praktika në të cilat «turizmi «zbon» bujqësinë».

Artikulli tenton të analizojë organizimin e tregut të tokës si elementi më shpjegues i kësaj konkurrence midis aktorëve, arsyet e shitjes, çmimi dhe rrjedhimet e kësaj konkurrence në hapësirën bujqësore të zonës Rreth-Greth dhe Spillej në rrethin e Kavajës.

Hyrje

Midis bujqësisë dhe turizmit ka edhe situata bashkëpunimi, megjithëse ekuilibri është shumë herë i dobët dhe që thyhet nga çmimet e tokës që disa herë janë edhe dhjetë herë më të lartë se çmimet e zakonshme të tokës për përdorim bujqësor, që shtyjnë fermerët të lënë strategjitë patrimoniale dhe të vendosin për të shitur tokën. Ky fenomen i cili është bërë prezent në shumë vende

të mesdheut të Jugut, është duke kërcënuar gjithashtu bujqësinë e zonës bregdetare shqiptare në favor të turizmit, në kontekstin e lindjes së tregu tokë të autorizuar vetëm që prej vitit 1995.

Shqipëria me më shumë se 350 km bregdet, përfaqëson mundësi turistike të jashtëzakonshme dhe ka nevojë për të zhvilluar këtë sektor. Megjithatë, zona bregdetare shqiptare është gjithashtu zona më bujqësore e vendit së bashku me fushën e Korçës. Në këto kushte konkurrenca për tokën midis bujqësisë dhe turizmit është shumë e fortë dhe kjo e fundit është një element thelbësor për jetën ekonomike të vendit, por që nuk është akoma e studiuar thellësisht.

Ky artikull synon të analizojë organizimin e tregut të tokës si elementi më shpjegues i kësaj konkurrence midis aktorëve, arsyet e shitjes, çmimi dhe rrjedhimet e kësaj konkurrence në hapësirën bujqësore të zonës. Duhet të theksojmë se ndarja e tokës e bërë nga ligji i vitit 1991 i ka dhënë çdo fermeri një sipërfaqe të kufizuar toke (midis 1,4 dhe 3 ha), që i vendos fermerët në rangun e aktorëve më të rëndësishëm të zonës. Zona e studimit ndodhet në zonën bregdetare pranë qyteteve Tiranë dhe Durrës¹, ku kjo problematikë konkurrence mbi tokën ndërmjet bujqësisë dhe turizmit është më e mprehtë.

Metodologjia

Për hartimin e këtij artikulli janë zhvilluar më shumë se 130 anketa në zonën e Rreth-Greth dhe Spillej në rrethin e Kavajës. Anketat kanë qenë të rastësishme dhe përfshijnë më shumë se 10% të familjeve në zonë.

Pyetësorët kanë qenë gjysëm të mbyllur dhe individualë.


Formimi i tregut të tokës në zonën e studimit

Është evidente se toka bujqësore është një ndër elementët më të rëndësishëm të ndërhyrjes së turizmit në jetën bujqësore të disa zonave. Pasi kemi diskutuar lidhur me elementë të ndryshëm të tregut të tokës, na mbetet për të analizuar çmimin e tokës i cili është elementi më shpjegues, që mund të na japë pista për të analizuar më mirë situatën.

Teorikisht, sistemi i çmimeve të tokës bujqësore është e lidhur me nivelin e kursimeve të fermave bujqësore të cilët janë edhe blerësit potencialë të këtyre tokave, mundësisë për kreditime dhe politikave shtetërore lidhur me tokat bujqësore (Coulomb 1986). Kjo logjikë është e vërtetë për çmime tokash të cilat do të përdoren edhe pas transaksionit për qellime bujqësore, por në zonën e studimit ne kemi parë që tokat bujqësore që dalin në tregun e shitjes, dalin nga përdorimi bujqësor. Sipas anketave të realizuara në zonën tonë të studimit, vetëm 3% e fermerëve kanë blerë toka, të cilat kryesisht mbesin në fushën bujqësore në krahasim me pothuaj 20% të fermave bujqësore të zonës që kanë shitur toka.

¹ Zona e studimit është përzgjedhur në dy pika të ndryshme në Shkallnuri i cili ndodhet pranë rrugës automobilistike në vendin e quajtur shkëmbi i Kavajës dhe në zonën Rreth- Greth, Spillej 20 km në jug të qytetit të Kavajës.

Perqindja e tokes se shitur dhe te blere ne zone




Burimi :Anketa personale

Tokat bujqësore të përdorura për bujqësinë kanë çmime shumë më të ulta se sa tokat të cilat shiten për të ndërtuar. Ky nivel çmimesh vjen si pasojë e dy faktorëve të cilët janë përfitimi i ulët që merret nga produktet bujqësore përveç rasteve kur mbi tokën janë bërë investime (ambjente të mbrojtura, dru frutorë etj.) dhe një kërkesë e ulët nga ana e fermerëve për të rritur sipërfaqe të fermës (mungesë financimesh, interesi për bujqësinë). Niveli i ulët i kërkesës për tokë bujqësore është rrjedhojë gjithashtu e një mungese garancie që duhet të kenë pronarët e ardhshëm përse i përket problemeve që mund të lindin me ish pronarët. Për shembull tokat e shitura për qellime bujqësore kanë çmime të cilat janë të nivelit 1/32 të çmimeve të tokave të cilat përdoren për qellime jo bujqësore. Ky krahasim nuk jep gjithë realitetin, sepse nga pikepamja agronomike tokat të cilat do të përdoren për qellime bujqësore kanë një cilësi shumë më të mirë se sa tokat që përdoren për qellime jo bujqësore të cilat janë kryesisht toka ranore dhe jo shumë produktive. Kjo do të thotë se produktiviteti i tokave nuk është një faktor i cili përcakton çmimin e tokave, për pjesën më të madhe të transaksioneve të kryera në zonë, por vetëm për tokat të cilat do të vazhdojnë të përdoren për qellime bujqësore. E njëjta ide është e vërtetë edhe për tregun e qeradhënies i cili është shumë i kufizuar dhe ku qeraja paguhet kryesisht me pjesë prodhimi, pjesë e cila është variabël midis 10 dhe 20% e prodhimit. Tokat e marra me qera janë kryesisht të mbjella me pemë frutore të cilat nënkuptojnë produkte bujqësore me vlerë ekonomike të lartë.

Në këto kushte, duhen kërkuar dhe gjetur elementët të cilët përcaktojnë çmimin e tokave bujqësore të cilat dalin nga prodhimi bujqësor.

Sipas anketave tona, çmimet e tokave bujqësore për qellime jo bujqësore ndërtohen në bazë të çmimeve të tokës së përdorur për qellime bujqësore dhe të cilat shërbejnë si nivele çmimesh bazë. Ne kemi kërkuar që të vlerësojmë nivelin e çmimeve të cilat duke ju shtuar çmimit bujqësor, i cili është shumë më i ulët, formojnë nivelet e çmimeve për tipe të ndryshme tokash bujqësore. Është interesante të shihet se niveli i çmimit të tokave për përdorimet bujqësore dhe jo bujqësore nuk ndjekin të njëjtën trajektore, që është shumë e shpjegueshme sepse kriteret e përcaktimit të çmimit nuk janë të njëjta në të dy rastet, të cilët bien ndesh me njeri- tjetrin (tokat pranë detit, shumë produktive nga pikëpamja bujqësore, janë më të shtrenjta nga pikëpamja turistike).

Formimi i çmimit të tokës në zonën e studimit



Burimi: Anketa personale

Është interesant shpjegimi i elementeve të cilët marrin pjesë në krijimin e çmimit të tokave bujqësore. Distanca nga deti është një faktor shumë i rëndësishëm në krijimin e çmimit të tokës por nuk është i vetmi. Ne kemi mundur të vëzhgojmë se në zonat ku egziston një treg toke i vazhduar, ka një nivel më të lartë çmimi midis tokave të cilat janë në rreshtin e parë në krahasim me bregun me ato të cilat janë në rreshtin e dytë. Kjo lidhje me bregun është në traditën e turizmit shqiptar, traditë e cila preferon lokalizime sa më pranë bregut të jetë e mundur. Për këtë arsye, distanca me detin mbetet një element thelbësor për krijimin e çmimit të tokës.

Akset e komunikimit përbëjnë një faktor tjetër në përcaktimin e çmimit. Infrastruktura e zonës është akoma e pazhvilluar; kështu zonat të cilat preken nga këto akse janë shumë më të favorizuara se sa zonat e tjera të cilat janë më të izoluar. Akset e komunikimit kanë favorizuar më shumë zonën e parë Shkallnur se sa të dytën (Rreth-Greth, Spillej), që do të thotë një nivel çmimesh më të lartë rreth 35%; rrjeti i komunikimit lejon një njohje më të mirë të zonës dhe zhvillimin e turizmit.

Mundësia për të ndërtuar apo jo në tokën e blerë në një të ardhme të afërt ose më të largët, i jep nivelit të çmimeve një tjetër diferencë. Prezenca e shtetit mbetet akoma e ulet, megjithë disa iniciativa për të bërë prezent rolin e tij veçanërisht në qytetet e mëdha, ndërtimet e paligjshme mbeten të përhapura në të gjithë zonën bregdetare të vendit. Forcimi i rolit të shtetit përgjatë viteve të fundit përbën një nga karakteristikat më diskriminuese në procesin e formimit të çmimit të tokave. Është natyrale që tokat të cilat kanë mundësi që të klasifikohen në të ardhmen si troje ndërtimi kanë një çmim edhe tre herë më të lartë se sa tokat të cilat nuk e kanë këtë «mundësi», çmim i cili rritet edhe me 25% po qe se tokat e kanë tashmë lejen për të ndërtuar. Ne shohim gjithashtu se formimi i çmimit për përdorime turistike nuk është frut i kërkesës dhe ofertës midis fermerëve ose një funksion ekonomik i lidhur në mënyrë strikte me të adhurat ose me nivelin e kursimeve, por është funksion i një grupi faktorësh spacial (siç është distanca nga deti ose niveli i izolimit) politikë (mundësia për të legalizuar ose jo ndërtimet e bëra në këto toka), të cilët janë elementë shumë të vështirë për tu marrë në konsideratë, analizuar dhe mbi të gjitha për të përcaktuar rolin dhe rëndësinë e tyre.

Efektet mbi strukturat e tokës në zonën bregdetare shqiptare

Këto transformime kanë provokuar modifikime të rëndësishme të strukturave të tokës së zonës, por edhe një ndryshim të fortë social. Ne nuk mund të neglizhojmë faktin se përbërja sociale e zonës ka ndryshuar shumë me mbërritjen e turistëve dhe emigracionit i cili mbetet gjithmonë i rëndësishëm drejt Italisë dhe Greqisë (duke ndikuar në plakjen e popullsisë dhe në mungesën e krahut të punës). Gjithashtu, edhe perceptimi i fermerëve për prodhimet bujqësore në përgjithësi por edhe për rolin e bujqësisë si aktivitet ekonomik në zonë ka ndryshuar shumë. Aktualisht bujqësia nuk përbën më mjetin e vetëm të përdorimit të tokës dhe as aktivitetin e vetëm ekonomik në zonë; ajo mbetet sektori më i privilegjuar por ka humbur shumë rëndësinë e saj në favor të turizmit. Strategjitë e fermave bujqësore janë bërë shumë më të lidhura me tregun dhe rationale në përdorimin e krahut të punës. Prodhimet bujqësore janë të lidhura me tregun dhe paraqesin nivelin e lidhjes së fermës me turizmin, i cili mbetet tregu kryesor i zonës. Emigracioni dhe puna në sektorin turistik të zonës krijojnë një konkurrencë në krah pune me punët bujqësore (i cili mbetet i rëndësishëm si pasojë e një niveli të ulët mekanizimi në zonë) dhe në fushat e tjera ekonomike. Si pasojë e këtyre ndryshimeve mund të përmendim:

- *Copëzimi i skajshëm i tokës bujqësore dhe ulja e sipërfaqeve të fermave bujqësore.*

Fermat bujqësore të cilat u krijuan pas aplikimit të ligjit «Për tokën» i vitit 1991 vuajnë shumë nga parcelizimi i tokave, në zona të ndryshme. Parcelat e tyre gjenden ndonjëherë edhe 3-4 kilometra larg shtëpisë së fermerit, që e bën shumë të vështirë kultivimin e tyre me efektivitet. Zakonisht, në zonën tonë të studimit, fermat bujqësore kanë një numër parcelash që variojnë nga pesë deri në shtatë. Duke patur parasysh se sipërfaqja e fermave bujqësore është e kufizuar, fakt të cilin ne e

kemi shpjeguar tashme, kultivimi i këtyre tokave bëhet edhe më i vështirë nga fakti i shitjes së tokave ose i rritjes së pjesës së tokave të cilat përdoren për arsye jo bujqësore. Këto faktorë ndikojnë në uljen e mundësive të mbijetesës së fermave bujqësore vetëm nga të ardhurat që sigurohen nga bujqësia. Shitjet çojnë në një ulje të sipërfaqes së kultivueshme të fermës me 17% mesatarisht (sipërfaqe e cila varion nga një mungesë totale e tokave të shitura deri në 80% të sipërfaqes); duke ulur tokat bujqësore dhe duke bërë të pamundur sigurimin e të ardhmes së familjes. Gjithashtu, pesha e bujqësisë në të ardhurat totale të familjes ulet në mënyrë të konsiderueshme. Kjo dinamike çon në një ndryshim të ngadaltë por të rregullt dhe të pastër për nga tendenca e statusit të fermerit i cili nuk mundet më të quhet «bujqësor».

Struktura e të ardhurave në fermat bujqësore të zonës




□ E ardhura Bujqësore ■ E ardhura jo Bujqësore □ E ardhura turistike

Burimi: Anketa personale

Siç e tregon qartë edhe grafiku, rëndësia ekonomike e bujqësisë është ulur shumë në favor të aktiviteteve të tjera siç është puna në qytet ose turizmi në familjet fermere.

Braktisja e tokave bujqësore të cilat nuk janë produktive dhe zgjerimi i sipërfaqeve të tokave djerrë.

Të ardhurat të cilat janë të larta nga sektori turistik apo puna jashtë sektorit bujqësor çojnë në një rritje të sipërfaqeve të tokave djerrë. Kjo mund të shpjegohet nga mundësia e një punë alternative me fitimprurëse në qytet ose në sektorin turistik dhe nga mungesa e krahut të punës i cili në zonë mungon edhe si rrjedhojë e nivelit të lartë të emigracionit. Për rrjedhojë, tokat e pjerrëta nuk punohen dhe tendenca e përgjithëshme është për të kultivuar tokat të cilat janë shumë produktive ose të cilat janë pranë shtëpisë, që çon në një rritje të sipërfaqeve të tokave djerrë për fermë.



Burimi: Anketa personale

Përfundime

Pas atomizimit të tokave bujqësore të provokuara nga ligji «Për Tokën» i vitit 1991, hapja e tregut të tokës në Shqipëri në vitin 1995, ka çuar në një riorganizim të rëndësishëm të aktiviteteve dhe të strukturave të tokës. Tregu i tokës shqiptare është i vonë dhe zhvillohet kryesisht në zonat ku presioni mbi tokën është shumë më i fortë, qoftë nga zhvillimi i urbanizimit qoftë nga turizmi.

Në zonat bregdetare të studiuara të cilat ndodhen në një presion urban dhe turistik të fortë, tregu i tokës është në formim e sipër. Megjithatë ky treg toke është akoma i kufizuar dhe numri i transaksioneve të regjistruara është i vogël, ne kemi vëzhguar që efektet e tij janë të rëndësishme në nivelin e të ardhurave të familjes, transformimet territoriale dhe në ndryshimin e mentalitetit.

Katër janë rezultatet të cilët janë më të rëndësishëm për tu theksuar :

Nuk ka një treg toke për toka bujqësore sepse transaksionet e tokës midis fermerëve pothuaj nuk ekzistojnë; tregu i tokës prek transaksione jo bujqësore (toka të shitura për arsye rezidencë dhe turizmi).

Elemente të cilët përbëjnë çmimin janë ekzogjenë për bujqësinë dhe për zonën; ato përcaktohen nga kërkesa për tokë e qytetarëve dhe e promotorëve turistikë.

Tregu i tokës luan një rol qendror në transformimet territoriale të bregdetit (copëzim, lënia djerre) dhe në riorganizimin e aktiviteteve (bujqësi, agroturizëm, turizëm).

Rritja e konsiderueshme e çmimit të tokës në një thyerje në strategjitë dhe sjelljet e fermerëve bujqësor. Lidhja e tyre me tokën preket nga shtysat e forta për ta shitur atë, shtysa që vijnë nga niveli i lartë i çmimeve.

Bibliografia

- Cavaillès J., (1992). « Marche foncier et prix des terres agricoles », Problèmes économiques, N° 2302.
- Civici A. (1999). « La réforme foncière en Albanie durant la période de transition. Comparaison avec les autres pays de l'Europe centrale et orientale », Cahiers Options Méditerranéennes, Vol 36, CIHEAM.
- Civici A. Laçi S. (2000). « Albanie », in Abaab A. et al (ed.) « Agricultures familiales et développement rural en Méditerranée », Karthala- CIHEAM, Paris.
- Civici A. (2001). « Evolution des Politiques foncières et dynamiques des espaces ruraux en Albanie », in Jouve A-M, (ed.) « Terres Méditerranéennes. Le morcellement, richesse ou danger ? », Karthala- CIHEAM, Paris.
- Civici A. et Lerin F. (ed) (2001). « L'agriculture albanaise. Contraintes globales et dynamiques locales », Options Méditerranéennes, Vol 28, CIHEAM.
- Coulomb P., (1986). Préface « Le tourisme contre l'agriculture », ADEF, Paris.
- Coulomb P., (1999). « De la terre à l'Etat. Droit de propriété, théories économiques, politiques foncières », Cahiers Options Méditerranéennes, Vol 36, CIHEAM.
- Guigou J.L. (1982). « La rente foncière : Les théories et leurs évolutions depuis 1650 », Economica, Paris.
- Guri F. (2002). « Transformation des exploitations agricoles et réorganisation foncière sur la côte albanaise. Cas des districts de Durres et Kavaja », Master of Science, CIHEAM-IAMM, Montpellier.

Analizë e disa problematikave të legjislacionit për falimentimin ndërkufitar në Shqipëri

— Erion Manohasa, Doktorant, UET —

— Nina Radulovic, PhD —

'La Sapienza', Romë

ABSTRAKT. *Një sistem efikas i zbatimit të ekzekutimit individual dhe kolektiv është një kusht i domosdoshëm i ekzistencës së mundësisë të kreditimit dhe si rrjedhojë të investimit. Mobiliteti ndërkombëtar, dhe sidomos ai evropian, i shoqërive tregtare apo i sipërmarrjeve dhe kapitaleve sjell që procedurat ekzekutive të ndikojnë më shumë në debitorët që kanë organizime të qëndrueshme biznesi dhe pasurish të tjera, të tilla si pasuritë e paluajtshme, investimet e kapitalit apo pjesëmarrjet në shoqëri dhe llogaritë bankare në Shtete të ndryshme nga ai i selisë apo vendbanimit. Si rrjedhojë duket se ka ardhur momenti që të zhvillohet praktika e kërkesave për hapjen e procedurave dytësore të falimentimit pasi ka filluar procedura kryesore e falimentimit në Shqipëri dhe anasjelltas. Në këtë artikull do të tentohet të përcaktohen disa nga problemet kryesore legjislative të cilat mund të pengojnë një zhvillim të falimentimeve ndërkufitare duke vënë në dukje disa aspekte të rëndësishme të Ligjit model të UNCITRAL, Rregullores së BE "Për falimentimin", legjislacionin malazez dhe atë shqiptar.*

Fjalë kyçe: *Falimentimi ndërkufitar, Ligji shqiptar për falimentimin, Rregullorja e BE-së për falimentimin, Ligji model i UNCITRAL për falimentimin*

Hyrje

Ky artikull synon të analizojë falimentimin ndërkufitar, i kuptuar si falimentimi i një subjekti që zotëron aktivitete dhe pasuri në më shumë se një shtet. Falimentimi ndërkufitar është një pjesë shumë e kufizuar e *international litigation*¹ dhe

¹ Proçese gjyqësore ndërkombëtare.

rregullohet nga legjislacionet e vendeve të përfshira në falimentim, dhe për sa i përket vendeve të Bashkimit European, nga Rregullorja 1346/2000/KE "Për falimentimin". Disa vende, në përgatitjen e legjislacionit mbi falimentimin, i janë përmbajtur Ligjit model për falimentimin ndërkufitar të predispozuar nga UNCITRAL-i². Shqipëria e rregullon falimentimin ndërkufitar në Pjesën e njëmbëdhjetë të Ligjit për falimentimin, Nr. 8901, datë 23.05.2002 i ndryshuar me ligjin nr 9919, datë 19.05.2008. Legjislacioni për falimentimin dhe zbatimi i tij në praktikë është i rëndësishëm për subjektet vendase apo investitorët e huaj, duke qenë se një sistem efikas i zbatimit të ekzekutimeve individuale dhe kolektive është një kusht i domosdoshëm në rritjen e sigurisë së investimit. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh dhe rëndësinë që duhet të ketë për Shqipërinë mbrojtja e të drejtave financiare të kreditorëve dhe në veçanti të punëtorëve³. Një aspekt tjetër që duhet vënë në dukje është që globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i shoqërive tregtare i ka kthyer falimentimet ndërkufitare në rregull dhe jo në përjashtim. Duket se ka ardhur momenti që të zhvillohet praktika e kërkesave për hapjen e procedurave dytësore të falimentimit pasi ka filluar procedura kryesore e falimentimit në Shqipëri dhe anasjelltas⁴.

Rëndësia e një procedure falimentimi të organizuar mirë

Falimentimi i sipërmarrjeve që veprojnë në disa shtete njëherësh kërkon një menaxhim të drejtë dhe efikas dhe që të mbrojë interesat e të gjithë kreditorëve dhe të gjithë subjektet e tjerë. Menaxhimi i drejtë dhe efikas maksimizon vlerën e asetëve të debitorit, lehtëson kthimin në aktivitet të bizneseve në vështirësi financiare, mbron investimet dhe punësimin. Ky nivel menaxhimi arrihet duke nxitur rritjen e bashkëpunimit midis gjykatave dhe organeve të tjera të shteteve në të cilat këto procedura janë hapur⁵.

Një sistem efikas i zbatimit të ekzekutimit individual dhe kolektiv është një kusht i domosdoshëm i ekzistencës së mundësisë të kreditimit dhe si rrjedhojë të investimit. Mobiliteti ndërkombëtar, dhe sidomos ai evropian, i shoqërive tregtare apo i sipërmarrjeve dhe kapitaleve sjell që procedurat ekzekutive të ndikojnë më shumë në debitorët që kanë organizime të qëndrueshme biznesi dhe pasurish të tjera, të tilla si pasuritë e paluajtshme, investimet e kapitalit apo pjesëmarrjet në shoqëri

² www.uncitral.org

³ Duke qenë se ka miratuar edhe Konventën nr. 173 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Mbrojtja e pretendimeve të punëtorëve në rast falimentimi të punëdhënësit" të 1992 me ligjin nr. 9278, date 23.9.2004.

⁴ Në këtë artikull nuk do të konsiderohen ato çështje komplekse si për shembull aspektet ndërkufitare të falimentimit të Firmave Piramidale në vitin 1997 në Shqipëri. Këto Firma rregullohen në mënyrë të veçantë dhe jo sipas procedurave të përgjithshme të Ligjit për falimentimin, Nr. 8901, datë 23.05.2002 i ndryshuar me ligjin nr 9919, datë 19.05.2008.

⁵ Berends, I., Ligji model i Ucitral-it "Për falimentimin ndërkufitar". Vështrim i përgjithshëm. 1998. faq. 6.

dhe llogaritë bankare në Shtete të ndryshme nga ai i selisë apo vendbanimit⁶.

Këto Shtete të ndryshme kanë legjislacione dhe gjykata apo autoritete të tjera të ndryshme të cilat do kërkojnë të trajtojnë aspektet që janë në juridiksionin dhe kompetencën e tyre⁷. Kjo do të çonte në mosmarrëveshje për sa i përket implikimeve ndërkufitare. Ky aspekt ngre problemin e përshtatjes për këtë qëllim të procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, të ligjit procedural dhe të legjislacionit mbi falimentimin, për të arritur një koordinim midis këtyre autoriteteve.

Për sa i përket procedurave individuale të ekzekutimit, brenda Bashkimit Evropian është në fuqi, që nga viti 1968, Konventa e Brukselit dhe e Bruksel II⁸ mbi juridiksionin dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare, e cila ka dhënë rezultate të kënaqshme. Konventa parashikoi “lëvizjen e lirë” në nivel evropian të vendimeve të dhëna në çështjet civile dhe tregtare.

Për rastin e falimentimit, praktika ka treguar që situata e deri tanishme nuk rezulton e kënaqshme⁹. Për këtë qëllim, përcaktohet si falimentim ndërkufitar ai në të cilin subjekti në krizë zotëron aktivitete dhe pasuri në më shumë se një shtet. Atëherë shtrohet pyetja nëse aktivitetet e ndryshme dhe pasuritë që ndodhen në shtete të ndryshme mund t’i nënshtrohen të njëjtës procedurë falimentimi.

Në diskutimin e rregullimit ligjor të falimentimit ndërkufitar duhen përmendur teoritë e kundërta të Universalitetit dhe Territorialitetit të falimentimit¹⁰. Universaliteti karakterizon një procedurë falimentimi, për të cilën nuk ka asnjë rëndësi vendi ku janë vendosur pasuritë e debitorit dhe synon të godasë të gjitha pasuritë në përgjithësi të këtij të fundit. Kjo i korrespondon parimit themelor që rregullon çdo procedurë falimentimi, e cila ndjek riorganizimin e përgjithshëm të situatës pasurore të debitorit.¹¹ Territorialiteti, nga ana tjetër, sjell që procedura e falimentimit në zhvillim e sipër në një shtet të caktuar ndikon vetëm në pasuritë e vendosura në atë shtet, dhe si rrjedhojë, që të zbulohet masa e falimentimit, e përbërë nga të gjithë pasuritë e debitorit, duhet

⁶ S.M. Carbone, Il Regolamento UE nr. 1346/2000 relativo alle procedure di insolvenza, në S.M. Carbone, M. Frigo dhe L. Fumagalli, Diritto processuale civile e commerciale comunitario, Milano, 2004, faq. 109.

⁷ Do të trajtohen në vijim parimet e territorialitetit dhe universalitetit.

⁸ Me tekst të njëjtë me Rregulloren 1347/2000/KE “Në lidhje me kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me çështje martesore dhe caktimin e fëmijëve të të dy prindërve”

⁹ Shiko Gourdain v. Nadler; SCT Industry v. Alpenblume; German Graphics v. Alice van der Schee.

¹⁰ ENRIQUES, Universalità e territorialità del fallimento nel diritto internazionale privato, Roma, 1934, faq. 7, L. Daniele, Le procedure concorsuali nel diritto internazionale privato e processuale, Padova, 1987, faq. 22 dhe në vijim.

¹¹ Po aty faq. 41.

të fillojë një procedurë e veçantë falimentimi kudo që ndodhen pasuritë e debitorit¹².

Këto teori janë tejkaluar me teorinë e Universalitetit të “kufizuar” ose të “zbutur”¹³ nga Ligji model i UNCITRAL-it “Për falimentimin ndërkufitar” dhe me Rregulloren 1346/2000/KE “Për falimentimin”. Universaliteti është i “kufizuar” sepse lejon mundësinë e fillimit të procedurave “dytësore” në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin ndodhet *qendra kryesore e interesit* të debitorit dhe që është hapur procedura “kryesore”. Procedurat “dytësore” mund të hapen pa pasur nevojë të kontrollohen nga autoritetet e këtij shteti të ndryshëm nëse ekzistojnë kushtet subjektive dhe objektive për fillimin e procedurës së falimentimit.

Rregullorja e Bashkimit European Nr. 1346/2000/KE “Për falimentimin”.

Nga pikëpamja kronologjike do të duhej të fillonim me Ligjin model të UNCITRAL na intereson nga pikëpamja praktike të fillojmë me Rregulloren BE “Për falimentimin”. Një nga veçoritë kryesore të Rregullores së BE-së nr. 1346-2000¹⁴ për procedurën e falimentimit është fakti që zbatohet vetëm në Bashkimin Evropian, duke qenë se është një mjet i cili rregullon funksionimin tregut të përbashkët¹⁵.

Në Rregulloren e mësipërme, pika e nisjes së raportit midis procedurës kryesore dhe asaj dytësore është neni 3 i cili parashikon atribuimin e juridiksionit. Kriteri thelbësor i juridiksionit është *qendra kryesore e interesave të debitorit*, e cila në rastin e shoqërive tregtare prezumohet se është selia. Vetëm gjyqtarët e shtetit ku ndodhet *qendra kryesore e interesave* kanë të drejtë të hapin procedura kryesore falimentimi ndërsa gjyqtarët e një shteti tjetër mund të hapin procedura dytësore të cilat kanë efekte të kufizuara territoriale vetëm mbi pasuritë e debitorit që ndodhen në atë shtet¹⁶. Këto kritere juridiksioni nuk parashikojnë përjashtime dhe nuk mund të ketë asnjë ndikim vullneti i palëve të interesuara. Për sa i përket juridiksionit, nuk ndikon

¹² L. Daniele, Le procedure concorsuali nel diritto internazionale privato e processuale, Padova, 1987, faq. 22 dhe në vijim, GALLESIO-PIUMA, Aspetti sostanziali del progetto di convenzione sul fallimento e sulle altre procedure concorsuali, in L'influenza del diritto europeo sul diritto italiano a cura di Cappelletti e Pizzorusso, Milano, 1982, faq. 319 e në vijim.; COLESAANTI, Aspetti processuali del progetto di convenzione sul fallimento e sua incidenza nel diritto italiano, faq. 433 e DANIELE, Il fallimento nel diritto internazionale privato e processuale, Padova, 1987, faq. 232; PROTO, Le procedure concorsuali nella Comunità europea, in Il fall., 1995, faq. 1169.

¹³ FUMAGALLI, Il regolamento comunitario sulle procedure di insolvenza, në Riv. dir. proc., 2001, faq. 687.

¹⁴ Për një përmbledhje të ngjarjeve që çuan në miratimin e Rregullores, shih për të gjithë, L. Fumagalli, Il Regolamento dell'Unione Europea sulle procedure concorsuali, në Riv.dir.proc., 2001, 677. Rregullorja (KE) Nr 1346/2000 e Këshillit të Bashkimit Evropian e datës 29 maj 2000 për aspekte të caktuara të procedurës së falimentimit, e cila ka hyrë në fuqi 29 maj 2002.

¹⁵ P. De Cesari dhe G. Montella, Le procedure di insolvenza nella nuova disciplina dell'Unione Europea, Milano, 2004, faq. 127 Vë në dukje se si dispozitat e ligjit material uniform përfaqësojnë një embrion të parë të një ligji të njëtrajshëm falimentimi në Evropë.

¹⁶ Shiko dhe nenin 18 mbi kompetencat e administratorit të falimentimit.

as vendi ku ndodhen pasuritë e debitorit¹⁷. Kriteret e juridiksionit të rregulluara në nenin 3 janë të detyrueshme por vlejnë vetëm për të përcaktuar shtetin anëtar në të cilin gjyqtarët mund të hapin procedurën e falimentimit. Ndarja e brendshme e kompetencave përcaktohet nga ligji kombëtar¹⁸.

Në praktikë, kjo do të thotë se rregullat e hollësishme për trajtimin e rasteve të falimentimeve ndërkufitare do të zbatohen vetëm në qoftë se debitori e ka *qendrën kryesore të interesave* të tij në një shtet anëtar, për sa ka të bëjë me procedurën kryesore të falimentimit. Çdo procedure dytësore ose e pavarur, por e kufizuar territorialisht, mund të fillohet vetëm në qoftë se debitori ka një aktivitet ekonomik në shtetin anëtar përkatës.

Kjo lë të hapur problemin sesi do të trajtohen procedurat e falimentimeve ndërkufitar në ato raste kur debitori e ka *qendrën kryesore të interesave* të tij ose aktivitetin apo pasurinë¹⁹ jashtë territorit të Bashkimit Evropian²⁰. Për të përmbushur kërkesat e përmendura më sipër, në shumë vende²¹, u krye një harmonizim në rritje i rregullave të falimentimit ndërkufitar.

Për arsyen e mësipërme, si dhe për mungesë hapësire, Rregullorja 1346/2000/KE “Për falimentimin” nuk mund të analizohet më gjerësisht²².

Ligji model i UNCITRAL-it “Për falimentimin ndërkufitar”.

Ligji model²³ i UNCITRAL “Për falimentimin ndërkufitar” plotëson hapësirën e lënë nga Rregullorja e BE-së e cila nuk mbulon shtetet jo-anëtare. Qëllimi kryesor i ligjit model është që të ndihmojë shtetet në hartimin e legjislacionit të tyre të falimentimit, me rezultatin përfundimtar që këto ligje të ndërtohen mbi një bazë të përbashkët. Ligji model shërben si shtesë ndaj ligjeve materiale të falimentimit të atyre shteteve që do ta zbatojnë atë dhe synon të trajtojë disa vështirësi që dalin gjatë

¹⁷ FUMAGALLI, Il regolamento comunitario sulle procedure di insolvenza, në Riv. dir. proc., 2001, faq. 689.

¹⁸ Pika 15 e preambulës.

¹⁹ Për të cilën mund të hapet procedura dytësore.

²⁰ Paul Torremans et al, Falimentimi në aspektin krahasues, Tiranë 2005 faq. 372.

²¹ Ndryshe nga sa ndodhi në vende si Spanja, Holanda dhe veçanërisht Gjermania, vend të cilin ne kemi marrë si shembull për përpilimin qoftë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ashtu dhe të Ligjit nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin”. Duhet pasur parasysh edhe se në këto vende gjen zbatim të drejtpërdrejtë Rregullorja e KE 1346/2000 e Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 29 maj 2000 për aspekte të caktuara të procedurës së falimentimit, e cila ka hyrë në fuqi 29 maj 2002.

²² Për një analizë të plotë shih Paul Torremans et al, Falimentimi në aspektin krahasues, Tiranë 2005 faq. 234.

²³ Aspektet pozitive të ligjeve model të Uncitral janë:

Mund të miratohen individualisht nga shtetet dhe mund të hyjnë në fuqi menjëherë.

I ofrojnë shtetit miratues një liri më të madhe.

Disa nga dispozitat mund të ndryshohen ose edhe të fshihen.

Teksti i ligjit model të UNCITRAL-it “Për falimentimin ndërkufitar” është i disponueshëm në faqen e internetit të UNCITRAL-it ee.uncitral.org

falimentimve ndërkufitare²⁴. Ligj model është i bazuar në parimin e universalitetit të kufizuar. Ky ligj model është marrë si bazë për përgatitjen e legjislacionit për falimentimin në Mbretërinë e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Japoni, Poloni, Rumani, Serbi, Mali i Zi²⁵, të cilin do ta trajtojmë në vijim, etj.

Është e qartë se ligji model, duke qenë se i drejtohet shteteve në përgjithësi, do të përballlet me sisteme shumë të ndryshme ligjore. Ligji nuk ka për qëllim të realizojë unifikimin e ligjeve mbi procedurat e falimentimit, por të promovojë përafrimin e tyre që të arrijë rezultatin praktik për të lejuar një bashkëpunim më të lehtë midis autoriteteve të shteteve të ndryshme të cilët janë të përfshirë në një falimentim ndërkufitar. Kjo shpjegohet edhe nga “Udhëzuesi për zbatimin” që e përkufizon “një mjet për harmonizimin e ligjeve”. Tipari kryesor i ligjit model është fleksibiliteti, në kuptimin që shteti që mendon ta pranojë si model mund t’i bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme tekstit standard, që të rezultojë në përputhje me sistemin e tij ligjor. “Udhëzuesi për zbatimin” përmban rekomandimin që shtetet t’i bëjnë sa më pak ndryshime që të jetë e mundur gjatë inkuadrimin të ligjit model në legjislacionin e tyre, në mënyrë që të arrihet një shkallë e mjaftueshme harmonizimi e falimentimit ndërkufitar.

Ligji model trajton në dy kapitujt e parë parime dhe përcaktime të një natyre të përgjithshme. Fusha e zbatimit është përcaktuar në nenin 1, i cili përjashton nga zbatimi subjektet që i nënshtrohen regjimeve të veçanta të falimentimit, të tilla si bankat apo shoqëritë e sigurimeve. Neni në vijim nxjerr në pah kuptimin e përkufizimeve të termave të përdorura, veçanërisht me përcaktimin se çfarë nënkuptohet me procedurë të huaj dhe identifikimin e kërkesave që një procedurë të kualifikohet si procedurë falimentimi²⁶. Neni 2 përcakton gjithashtu konceptet e procedurës kryesore (e hapur në qendrën kryesore të interesave të debitorit) dhe dytësore (e hapur aty ku ka një aktivitet ekonomik apo pasuri të debitorit). Parashikohet gjithashtu përparësia e konventave ndërkombëtare²⁷, dhe kufiri i rendit publik²⁸. Kapitulli i dytë i ligjit model trajton organet e procedurave dhe kreditorët, duke parashikuar që t’i lejojë organeve të procedurës së huaj një akses të drejtpërdrejtë në gjykatat e vendit, pa ndonjë formalitet të veçantë²⁹. Në vijim parashikohet dhe që kreditorët e huaj të kenë të drejta të njëjta me kreditorët e brendshëm, si për sa i përket kërkesës për të hapur procedurat ashtu dhe për sa i përket pjesëmarrjes në marrëveshje³⁰.

Ligji model është i ndarë në tre kapituj shtesë të cilët i janë kushtuar njohjes së vendimeve të huaja në falimentim, bashkëpunimin ndërkufitar të autoriteteve dhe

²⁴ Paul Torremans et al, Falimentimi në aspektin krahasues, Tiranë 2005 faq. 373.

²⁵ www.uncitral.org

²⁶ Neni 2, pika a.

²⁷ Neni 3.

²⁸ Neni 6.

²⁹ Neni 9

³⁰ Neni 13.

³¹ Në Rregulloren përcaktohen në mënyrë të hollësishme raportet midis procedurës kryesore dhe asaj dytësore.

organeve si dhe koordinimit të procedurave kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë pikë të ligjit model gjejmë njohjen e procedurës së huaja të falimentimit, në sajë të së cilës bëhet i mundur zbatimi i normave mbi bashkëpunimin dhe koordinimin e procedurave, dhe në veçanti, bëhet e mundur hapja e procedurës dytësore. Udhëzuesi në numrin 184 të tij, thekson se neni 28 i ligjit model parashikon, së bashku me nenin 29, se njohja e një procedure të huaj kryesore nuk pengon hapjen e një procedure dytësore nëse debitori ka pasuri në atë shtet. Nuk parashikohet një varësi e procedurës dytësore ndaj procedurës së huaj kryesore³¹, edhe pse njohja e një procedure të huaj çon në një prezumim të paaftësisë paguese³². Në këtë rast parashikohet që marrëdhëniet midis këtyre procedurave të vlerësohen nga Gjykata e brendshme, kryesisht në pikëpamjen e përputhshmërisë së efekteve³³. Në parim, njohja e procedurave të huaja kryesore përfshin pezullimin e zbatimit të ekzekutimeve individuale kundrejt pasurisë dhe të drejtave të debitorit si dhe ndalimin e disponimit të pronës nga ky i fundit³⁴. Nëse pas njohjes së procedurës së huaj fillohet një procedurë vendase, mund të bëhet një rishikim i masave të marra³⁵.

Falimentimi ndërkufitar në Malin e Zi

Pas paraqitjes së shkurtër të Ligjit model të UNICITRAL le të shohim Ligjin për falimentimin në Malin e Zi dhe se sa është marrë për bazë në përpilimin tij ligji model. Kemi paraqitur Ligjin për falimentimin të Malit të Zi pasi është një vend që paraqet shumë elementë të përbashkët me Shqipërinë si dhe është një nga vendet që kanë marrë si bazë për përgatitjen e legjislacionit mbi falimentimin Ligjin model të UNICITRAL³⁶.

Falimentimi ndërkombëtar në Malin e Zi është rregulluar me një kapitull të veçantë të Ligjit të Falimentimit³⁷. Dispozitat përkatëse gjejnë aplikim nëse një gjykatë e huaj ose një autoritet tjetër kompetent i cili kryen kontrollin ose monitorimin mbi pronën apo veprimtarinë e biznesit të debitorit të kërkojë ndihmë ligjore në lidhje me procedurat e huaja të falimentimit. Gjithashtu këto dispozita zbatohen nëse gjykata vendase ose një administrator falimentimi vendas kërkojnë ndihmë nga një autoritet kompetent i huaj në lidhje me procedurat e falimentimit të ndërmarra në Mal të Zi. Dhe rasti i tretë kur zbatohen këto dispozita është ai i procedurave të falimentimit të huaja dhe vendase që zhvillohen në të njëjtën kohë³⁸. Gjatë procedurave të falimentimit

³² Neni 31.

³³ Neni 29.

³⁴ Neni 20.

³⁵ www.uncitral.org

³⁶ Është e verifikueshme në websitin e UNCITRAL www.uncitral.org.

³⁷ Kapitulli IX i Ligjit të Falimentimit në Malin e Zi, nenet 178-207, shpallur më 22 dhjetor, 2010, botuar në Gazetën zyrtare, nr. 01/11.

³⁸ Po aty, Neni 178, paragrafi 1.

³⁹ Po aty, Neni 178, paragrafi 2.

supozohet zakonisht ose riorganizimi ose falimentimi dhe likuidimi i subjektit³⁹, por gjithçka vështirësohet ose bëhet e pamundur kur debitori është një shoqëri e huaj tregtare me vendin e themelimit dhe selinë jashtë Malit të Zi ose një person fizik me vendbanim në një vend të huaj⁴⁰. Megjithatë, nëse vendimi për falimentimin i një autoriteti të huaj njihet, kjo nuk e ndryshon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, për titujt e siguruar mbi pronën apo të drejtat e vendosura brenda Malit të Zi vazhdojnë të zbatohen normat e brendshme⁴¹, ndërsa kontratat e punës mbeten gjithmonë në kompetencë të ligjit për të cilin është rënë fillimisht dakord⁴². Pasi është emëruar administratori vendas i falimentimit, ky ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha veprimet në emër të debitorit ose për pasurinë që përbën masën e falimentimit brenda juridiksionit të huaj dhe brenda kufijve që ky lejon⁴³. Në mënyrë të ngjashme, gjykatat vendase mund të mohojnë veprimet ligjore që kërkojnë me iniciativë të autoritetit të huaj, në qoftë se këto veprime janë në kundërshtim me rendin juridik vendas⁴⁴. Në rast njohje të një përfaqësuesi të huaj, mbetet fakti që ai, edhe pse gëzon të drejtën për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në procedurën e brendshme të falimentimit⁴⁵, mund të fillojë këto procedura vetëm nëse janë përmbushur kushtet e përgjithshme të ligjit kombëtar⁴⁶.

Përfaqësuesi i huaj mund t'i drejtohet gjykatës malazeze kompetente me kërkesë për njohjen e procedurës së falimentimit të huaj për të cilën ai është emëruar⁴⁷. Gjykata kombëtare është e detyruar të njohë procedurën e huaj të falimentimit, nëse parashihet që janë plotësuar formalitetet ligjore⁴⁸. Procedurat e huaja do të njihen si procedura kryesore nëse i përkasin juridiksionit brenda të cilit debitori ka përqendruar interesat e tij kryesore, ndërsa do të njihen si procedura dytësore nëse i përkasin juridiksionit brenda të cilit debitori ka një njësi të përhershme biznesi⁴⁹. Ka një prezumim, nëse nuk provohet e kundërta, që vendi i regjistrimit të themelimit të debitorit ose vendi i tij i banimit është qendra kryesore e interesave të tij⁵⁰. Megjithatë, pas fillimit të procedurës së falimentimit vendase, procedura e huaj e falimentimit mund të njihet vetëm si dytësore⁵¹.

Njohja e procedurave kryesore të falimentimit të huaja prodhon pasoja të rëndësishme ligjore, të tilla si ndalimi i inicimit të procedurave të reja ose pezullimin e procedurave ekzistuese ligjore lidhur me pronën e debitorit dhe të drejtat dhe detyrimet e tij, ndalimin e ekzekutimeve kundër pasurisë së debitorit, si dhe, ndalimin

⁴⁰ Po aty, paragrafi 3.

⁴⁰ Ligji Falimentimit i Malit të Zi, neni 179, paragrafi 2.

⁴¹ Po aty, paragrafi 3.

⁴³ Ligji Falimentimit i Malit të Zi, neni 182.

⁴⁴ Po aty, Neni 183.

⁴⁵ Po aty, nenet 186 dhe 189.

⁴⁶ Po aty, Neni 188.

⁴⁷ Po aty, Neni 190.

⁴⁸ Po aty, Neni 192, paragrafi 1.

⁴⁹ Po aty, paragrafi 2.

⁵⁰ Ligji Falimentimi i Malit të Zi, Neni 191, paragrafi 3.

⁵¹ Po aty, Neni 192, paragrafi 8.

⁵² Po aty, Neni 195, paragrafi 1.

e caktimit të formave të tjera të disponimit mbi pronën⁵². Në përgjithësi, njohjen e shoqërojnë detyrime për ndihmë juridike si detyrimin e gjykatës që të miratojë masa për mbrojtjen e pasurisë së debitorit dhe kreditorët e tij⁵³. Edhe para njohjes, pas paraqitjes së kërkesës, gjykata është e detyruar dhe e autorizuar të ndërmarrë masa të përkohshme urgjente të nevojshme për të njëjtat arsye mbrojtje⁵⁴.

Gjykatat e Malit të Zi dhe administratorët e caktuar për procedurat e falimentimit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efikase me autoritetet e huaja kompetente, njëkohësisht kanë të drejtë të plotë për të adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë këto autoritete në rastet e falimentimit ndërkombëtar⁵⁵. Bashkëpunimet mund të ndërmerren në të gjitha mënyrat e mundshme, sidomos dhe duke përfshirë caktimin e personave të posaçëm për veprime të veçanta juridike, shkëmbimin e të dhënave dhe koordinimin e menaxhimit të pasurisë së debitorit⁵⁶.

Pas njohjes së procedurave kryesore të falimentimit të huaja, procedurat e falimentimit në Malin e Zi mund të fillohen vetëm nëse debitori ka pasuri në Malin e Zi dhe për qëllime bashkëpunimi me autoritetet e huaja kompetente⁵⁷. Në një rast të tillë në të cilin ka procedurat paralele falimentimi të brendshme dhe të jashtme kundër të njëjtit debitor të falimentuar, gjykatat kombëtare marrin pjesë në mekanizmat e bashkëpunimit dhe koordinimit⁵⁸. Nëse supozohet se procedurat e falimentimit paralele përfshijnë më shumë se një masë koordinimi me juridiksionin e huaj këto duhet të përshtaten me nevojat e procedurave të falimentimit kryesore⁵⁹. Megjithatë, edhe pse njohja e procedurave të falimentimit kryesore të huaja paraqet prezumimin e një arsye të vlefshme për fillimin e procedurës së falimentimit vendase, procedurat e brendshme të falimentimit nuk do të iniciohen në qoftë se debitori provon se nuk ka arsye të mjaftueshme për fillimin e këtyre procedurave sipas kushteve të përgjithshme të Ligjit për Falimentimin të Malit të Zi⁶⁰.

Së fundi, e përshtatshme për përfundimin e kësaj përmbledhje të zgjidhjeve ligjore në Malin e Zi në lidhje me falimentimin ndërkombëtar është dispozita mbyllëse e kapitullit në fjalë numër IX të Ligjit për Falimentimin e cila, në rast shlyerje të pjesshme të kreditorëve që janë pjesë e procedurës kryesore të falimentimit të huaj, ndalon shlyerjen e tyre të plotë për aq kohë sa në procedurat e brendshme të falimentit nuk janë paguar kreditorët të së njëjtës klasë që kishin pretendime dhe që nuk janë paguar në mënyrë proporcionale me kreditorët e procedurës kryesore⁶¹.

⁵³ Po aty, Neni 196, paragrafi 1, këto, janë kryesisht standarde në praktikën ndërkombëtare si dhe janë në përputhje me pasojat e përgjithshme të njohjes.

⁵⁴ Po aty, Neni 194.

⁵⁵ Po aty, nenet 200 dhe 201.

⁵⁶ Po aty, Neni 202.

⁵⁷ Po aty, Neni 203.

⁵⁸ Po aty, Neni 204.

⁵⁹ Po aty, Neni 205.

⁶⁰ Po aty, Neni 206.

⁶¹ Po aty, Neni 207.

Siç u evidentua më lart, zgjidhjet ligjore të Malit të Zi janë pak a shumë tipike ndërkombëtare. Nga ana tjetër është pothuajse e pamundur të flasim për praktikë ligjore, pasi nuk ka praktikisht asnjë jurisprudencë apo vendim gjyqësor që të trajtojë këto aspekte deri më sot. Dispozitat e Ligjit të falimentimit të fundit të 2010⁶² në lidhje me falimentimin ndërkombëtar nuk kanë gjetur ende ndonjë aplikim, ndërsa dispozitat e Ligjit të mëparshëm për falimentimin e shoqërive tregtare⁶³ kanë gjetur zbatim vetëm në një rast. Në 2009 një administrator falimentimi i një debitori nga Serbia ka dorëzuar një kërkesë në Seksionin tregtar të Gjykatës së Podgoricës për njohjen e procedurës së falimentimit të filluar paraprakisht në Seksionin tregtar të një Gjykate në Serbi, si procedurë falimentimi kryesore. Seksioni tregtar i Gjykatës së Podgoricës, pas kontrollit nëse kushtet ligjore ishin plotësuar arriti në një vendim pozitiv⁶⁴. Si pasojë, pasuritë e paluajtshme të vendosura në Mal të Zi dhe në pronësi të debitorit të procedurës së falimentimit serb hynë në masën e falimentimit dhe u shitën në përputhje me procedurat e falimentimit kryesore bashkë me pjesën tjetër të pronës së debitorit.

Legjislacioni shqiptar

Dispozitat ligjore të falimentimit ndërkombëtar në Shqipëri janë rregulluar me një kapitull të veçantë të Ligjit për Falimentimin Nr. 8901, datë 23.05.2002 i ndryshuar me ligjin nr 9919, datë 19.05.2008⁶⁵. Ky kapitull fillon duke përcaktuar se procedura e falimentimit e hapur në Shqipëri përfshin të gjitha pasuritë e debitorit në çdo shtet që ndodhen dhe vazhdon me përcaktimin e rasteve kur hapet një procedurë e veçantë nëse debitori nuk ka seli ose vendbanim në Shqipëri. Në asnjë moment, as në këtë nen dhe as në nenet në vijim, nuk përmendet koncepti ndërkombëtar i *qendrës kryesore të interesit*. Në vazhdim përcaktohen kushtet e njohjes së një procedure të huaj falimentimi; debitori duhet të ketë vendbanim ose seli në shtetin e huaj dhe të mos shkelë parimet themelore të legjislacionit shqiptar⁶⁶. Në vazhdim trajtohen pasojat e njohjes ku përcaktohen rastet përjashtuese të përdorimit të një ligji të huaj. Këto raste janë kur; nuk është pezulluar padia e ngritur në territorin e Republikës së Shqipërisë⁶⁷, nuk cenohen të drejtat e pronësisë mbi pasuri të luajtshme e të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kur kemi të bëjmë me kontrata për pasuri të paluajtshme brenda Shqipërisë ose çdo kontratë punësimi. Këto raste i nënshtrohen vetëm legjislacionit shqiptar⁶⁸. Duket me vend që këto dy raste të mos trajtohen në këtë shkrim.

⁶² "Sl. list CG", Nr. 01/11.

⁶³ "Sl. list RCG", Nr. 06/02, 01/06 dhe 02/07.

⁶⁴ Business Court of Podgorica, Case Rs-3/09, related to Commercial Court of Niš (Serbia), Case St-23/2006.

⁶⁵ Pjesa e Njëmbëdhjetë.

⁶⁶ Po aty, Neni 279.

⁶⁷ Po aty, Neni 280, paragrafi 1.

⁶⁸ Po aty, Neni 281, paragrafi 1.

Paragrafi i dytë i nenit 280 trajton rastin e shmangieve të huaja të cilat duhet të kenë një korrespondencë në legjislacionin shqiptar. Në vijim trajtohen procedurat dytësore ku përcaktohet aspekti një procedurë të hapur tashmë në një shtet të huaj nuk parandalon hapjen e procedurës dytësore në Shqipëri⁶⁹. Në vazhdim gjejmë dhe përcaktimin se subjekteve të legjitimuar për të kërkuar hapjen e procedurës së falimentimit i shtohet dhe administratori i procedurës së huaj ose përfaqësuesi i tij dhe në përfundim hiqet si detyrim tregimi i shkakut të fillimit të procedurës së falimentimit⁷⁰. Në mbyllje të pjesës së njëmbëdhjetë për procedurat e falimentimit lidhur me shtetet e tjera kemi bashkëpunimin i cili duhet të jetë i shkallës më të lartë me gjykatësin e huaj ose përfaqësuesin e huaj. Kjo dispozitë nuk është funksionale sepse përdor termin bashkëpunim, term i cili nuk përcakton një raport koordinimi. Siç ka treguar eksperiencia, çdo gjyqtar dhe administrator falimentimi do të donte të koordinonte trajtimin e të gjitha pasurive të debitorit, qofshin këto në shtetin e tyre ose në shtetin e huaj⁷¹. Këtu mbetet e pazgjidhur problematika e mos rënies dakord midis administratorit të një vendi me autoritetet e vendit të huaj. Sipas Ligjit model të UNICITRAL duhet që koordinimin e të gjitha procedurave ta kryejë administratori i procedurës kryesore. Në mbyllje të kapitullit gjejmë një dispozitë e cila përcakton komunikimin e drejtpërdrejtë midis gjykatave. Me këtë rregullim ligjor mundësohet përfaqësimi dhe mungesa e përdorimit të mjeteve të ngarkuara dhe që kërkojnë kohë si letërporositë dhe forma të tjera të komunikimeve konsullore dhe diplomatike.

Në përfundim mund të themi se në ndryshimet e legjislacionit të falimentimit janë “harruar” disa dispozita dhe përcaktime të dobishme në pjesën e njëmbëdhjetë të ligjit nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin” e cila trajton procedurat e falimentimit të lidhura me shtetet e tjera.

Përfundime

Në mungesë të një legjislacioni specifik shumë pyetje mbeten të hapura si për shembull ajo se si do të vendoset se cila është procedura kryesore e falimentimit dhe ajo dytësore kur ne jo vetëm nuk kemi një përcaktim ligjor të qendrës kryesore të interesit por as nuk e përmendim në ligj ndryshe nga Ligji i Malit të Zi për falimentimin. Nuk mund të zgjidhet kjo “mangësi” me përdorimin i terminologjisë seli apo vendbanim pasi është vetëm një prezumim ai që këto të dyja përkohjnë me qendrën kryesore të interesit. Një aspekt tjetër problematik është ai që nuk ka një parashikim ligjor nëse një shoqëri tregtare shqiptare lëviz selinë e saj jashtë vendit për të shmangur falimentimin në Shqipëri. Nuk kemi parashikim ligjor dhe nëse ndodh e kundërta që një shoqëri e huaj të lëvizë selinë e saj në Shqipëri për të shmangur falimentimin në vendin e origjinës.

Legjislacioni për falimentimin i Malit të Zi nuk i jep përgjigje të gjitha

⁶⁹ Po aty, Neni 281, paragrafi 2 dhe 3.

⁷⁰ The Eurofood ISFC Case.

⁷¹ Me Ligjin 9919 datë 19.05.2008 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin”.

problematikave që nxjerr praktika por është shumë më i avancuar se legjislacioni shqiptar për falimentimin, nëse nuk përmendim disa aspekte kuazi proteksioniste si për shembull neni 182 paragrafi 8 të trajtuar më lart. Por gjithsesi mund të merret si shembull pasi përmbush përafrimin e dëshiruar me Ligjin model të UNCITRAL dhe paraqet pak a shumë të njëjtat problematika me vendin tonë.

Në të kundërt, një qëndrim pasiv, dhe një mbështetje vetëm në zhvillimin e jurisprudencës dhe praktikës gjyqësore, duket se shkon kundër nevojës për siguri ligjore dhe mbrojtjes e pritshmërive legjitime të kreditorëve, të cilat janë gjithashtu elementë kyç të menaxhimit të mirë të falimentimeve, qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare.

Bibliografia

- Carbone S.M., *Il Regolamento UE nr. 1346/2000 relativo alle procedure di insolvenza*, në S.M. Carbone, M. Frigo dhe L. Fumagalli, *Diritto processuale civile e commerciale comunitario*, Milano, 2004, faq. 109.
- COLESANTI, *Aspetti processuali del progetto di convenzione sul fallimento e sua incidenza nel diritto italiano*, faq. 433
- Daniele L., *Le procedure concorsuali nel diritto internazionale privato e processuale*, Padova, 1987.
- DANIELE, *Il fallimento nel diritto internazionale privato e processuale*, Padova, 1987, faq. 232;
- De Cesari P. dhe Montella G., *Le procedure di insolvenza nella nuova disciplina dell'Unione Europea*, Milano, 2004.
- ENRIQUES, *Universalità e territorialità del fallimento nel diritto internazionale privato*, Roma, 1934, faq.
- Fumagalli L., *Il Regolamento dell'Unione Europea sulle procedure concorsuali*, në Riv.dir.proc., 2001.
- GALLESIO-PIUMA, *Aspetti sostanziali del progetto di convenzione sul fallimento e sulle altre procedure concorsuali*, in *L'influenza del diritto europeo sul diritto italiano* a cura di Cappelletti e Pizzorusso, Milano, 1982, faq. 319 e në vijim.
- Lascari P., *Breve commento sulle procedure concorsuali internazionali n.1346/2000*, në Dir.fall., 2004, I.
- PROTO, *Le procedure concorsuali nella Comunità europea*, in *Il fall.*, 1995, faq. 1169.
- Torremans P. et al, *Falimentimi në aspektin krabasues*, Tiranë 2005.
- Ligji model i UNCITRAL për falimentimin
- Rregullorja e KE 1346/2000 për falimentimin.
- Ligji Falimentimit i Shqipërisë i ndryshuar.
- Ligji Falimentimit i Malit të Zi.
- The Eurofood IFSC case.
- Gourdain v. Nadler case.
- SCT Industry v. Alpenblume case.
- German Graphics v. Alice van der Schee case.
- Business Court of Podgorica, Case Rs-3/09, related to Commercial Court of Niš (Serbia), Case St-23/2006
- www.uncitral.org

Pastrimi i parave dhe efektet negative në ekonomi

— Av. Ma. Naim MËÇALLA, Doktorant —

Lektor i të Drejtës Penale në Universitetin Wisdom, Tiranë.

Pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë të UT.

Abstrakt. Objekti i këtij punimi është kërcënimi ekonomik dhe financiar i veprimtarisë kriminale të pastrimit të parave. Historia e pastrimit të parave është, në radhë të parë, historia e fshehjes së parave ose pasurive nga konfiskimi ose nga taksimi. Pastrimi i parave prodhon pasojë negative dhe shtrembërime të thella në zhvillimin real të ekonomisë. Ai denatyrton konkurrencën e lirë dhe të ndershme, cënon rëndë rregullat e lojës së tregut, bile, i trondit ato duke sjellë me vete çrregullime serioze në treg. Hyrja e parave të pista në ekonominë legale, mund të çojë në marjen në zotërim të ekonomisë legale dhe financiare nga grupimet kriminale.

Pastrimi i parave është një krim financiar, pavarësisht nga përkufizimet ajo përfshin përpjekjet për t'ju shmangur konfiskimit të të ardhurave të krimit. FATF (Financial Action Task Force) e përcakton pastrimit të parave si “përpunimi i të ardhurave kriminale, me qëllim fshehjen e origjinës së tyre të paligjshme”¹.

Historia e pastrimit të parave

Historia e pastrimit të parave është, në radhë të parë, historia e fshehjes së pasurive nga konfiskimi ose nga taksimi. Është provuar se në Kinë, tregtarët para 4000 vjetësh fshihnin pasurinë e tyre nga sundimtarët. Koncepti modern i pastrimit të parave fillon me historinë e babait të mafias, Al Kapone, i cili hapi lavatriçet për të fituar legjitimitetin e parave që kishte hedhur në dorë në rrugë të paligjshme. Nëpërmjet kësaj mënyre, ai synonte të vërtetonte sikur paratë e fituara nga kontrabanda dhe bixhozi i kishte të ligjshme. Ai, arriti që në dhjetë vjet të kishte një pasuri prej 200 milion dollaresh dhe kur u denua me 11 vjet burg me 1931 akuza ndaj tij ishte vetëm për

¹ FATF, 1996, Dyzet Rekomandimet, shih www.oecd.org/fatf/40Recs_en.htm.

*shmangie tatimore (evasion fiskal)*². Dënimi i Al Kapones i dha anëtarëve të organizatave të tjera kriminale një leksion të rëndësishëm, se paraja që nuk deklarohet me një raport formal në institucionet tatimore është para e pistë dhe me rrisht të vazhdueshëm, e cila nuk mund të shpenzohet ose të investohet pa u shoqëruar nga ankthi dhe rreziku potencial i zbulimit dhe i ndjekjes penale. Në Sh.B.A., që nga viti 1920, shuma të konsiderueshme parash vinin nga kontrabanda e pijeve alkoolike. Madje, u krijua përshtypja se ndalimi me ligj i kësaj kontrabande, u dha shansin organizatave kriminale të pasurohen me fonde në të holla, të aftësohen si dhe të kualifikohen për të vepruar me sipërmarrje deri miliona dollarëshe.

Pastrimi i parave si krim ka tërhequr vëmendjen në vitin 1980, brenda kontekstit të trafikut të drogës. “Amerika e Veriut është vendi më i madh, jo vetëm i konsumit të drogave, por dhe pastrimit të parave që burojnë nga trafiku i tyre”.³ Pastrimi i parave si krim ka tërhequr vëmendjen në vitin 1980, brenda kontekstit të trafikut të drogës, ndërsa për shumicën e vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore, përfshirë edhe Shqipërinë termat “pastrim parash” dhe “lufta kundër pastrimit të parave” u njohën dhe u bënë më të përdorshëm pas viteve ’90. Gjenerimi i fitimeve të mëdha nga ky aktivitet kriminal dhe rritja e përmasave të abuzimit me drogën, nxitën qeveritë perëndimore për të vepruar, duke krijuar legjislacionin e nevojshëm për konfiskimin e të ardhurave të paligjshme.

Marrëveshje e parë ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave u arrit në vitin 1988 (Konventa e Vjenës). Kjo Konventë vendosi parimin e konfiskimit të produkteve të krimit të drogës dhe përmirësimin e ndihmës së ndërsjellë ligjore, duke përfshirë mbledhjen e provave dhe ekstradimin ndërkombëtar. Nga vitet 1990, përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave morën një zgjerim të shpejtë dhe masiv, u krijua FATF⁴ si institucioni më i rëndësishëm ndërkombëtar për të miratuar dhe shpërndarë standartet e luftës kundër pastrimit të parave. Këshilli i Evropës përfundoi Konventën “Mbi pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit” Strasburg XI 1990. Përveç të qenit i pari që përdori termin “pastrimin e parave,” ky traktat zhvendosi vëmendjen nga droga për të gjitha krimet.

Për shkak se pjesa dërrmuese e parave të mbledhura nga organizatat kriminale vijnë prej burimeve të paligjshme, si fajdetë, prostitucioni, bixhozi, drogat; etj., kriminelët jo vetëm që nuk janë të gatshëm të deklarojnë të ardhurat ose burimet e tyre në institucionet tatimore, por i fshehin ato. Përpara se të shpenzojnë ose të përdorin këto fonde, ata përpiqen t’i japin këtyre parave një koperturë të ligjshme. Ky shndërrim është i njohur me termat *pastrim parash*.

² [Http://www.laundryman.u_net.com/pag.1hist.html](http://www.laundryman.u_net.com/pag.1hist.html).

³ Vasilika Hysi – Kriminallogjia, Tiranë 2005, fq.163.

⁴ Financial Action Task Force, shih http://www.fatf-gafi.org/pages/0,3417,en_32250379_32236920_1_1_1_1_1,00.html

Çfarë kuptojmë me pastrim parash?

Pastrimi i parave është përkufizuar si “... transferimi i të hollave të nxjerra në rrugë të paligjshme ose investimi për të fshehur burimin e vërtetë.”⁵ Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e përkufizon pastrimin e parave si “një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe proceseve me qëllim errësimin e burimit të të hollave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të krijuar pamjen se ato e kanë origjinën nga një burim legjitim”.⁶ Një zyrtar i Rezervës Federale të ShBA-së e përcakton pastrimin e parave “...si kthimin e të ardhurave të realizuara me mjete të paligjshme në pasuri të cilave është e vështirë t’u gjendet origjina e krimit. Disa nga veprimet kriminale që shoqërohen me pastrim parash janë trafiku i drogës, financimi i terrorizmit dhe përvetësimi i fondeve publike”.⁷ Një përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, Paul Byron, shprehet se, “...pastrimi i parave ka të bëjë me përfitimin e pasurisë nga aktivitetet ilegale dhe përpjekjet që këto përfitime të vendosen në sistemet bankare, në atë mënyrë që të fshehet origjina e parave apo edhe të vazhdohet aktiviteti kriminal, duke përdorur sistemin financiar”.⁸

Nuk ka dallime të rëndësishme në përkufizimin e pastrimit të parave. Në thelb kjo veprimtari kriminale përfshin përpjekjet për t’ju shmangur konfiskimit të të ardhurave të krimit, të cilat mund të përdoren si “të ligjshme”. Pastrimi i parave në përgjithësi përfshin transaksione të shumta të përdorura për të fshehur burimin e aseteve kriminale. Paraja pastrohen nëpërmjet agjencive të këmbimit valutor, kazinove, shitblerjes së makinave të shtrenjta, të bizhuterive, kompanive të sigurimeve dhe kompanive tregtare. Ajo pastrohet nëpërmjet “of-shorë”, parajsave financiare dhe bankare, korporatave të karburantëve, zonave të tregtisë së lirë, etj..

Metodat e pastrimit të parave mund të klasifikohen në tre faza të dallueshme :

a) Vendosja është procesi i lëvizjes fizike të parave nga vendi i krimit, nëpërmjet depozitave, SWIFT /transfertave bankare, ose instrumenteve të tjera financiare. Në këtë fazë kryhet shndërrimi i shumave të parasë fizike me origjinë kriminale (si nga trafiqet e ndryshme, korrupsioni, etj..) në një formë tjetër, si përshembull, në para elektronike, ose duke i përdorur në tregtinë me pakicë ose transferuar jashtë vendit;

b) Pastrimi i referohet procesit të ndarjes së të ardhurave nga origjina e tyre kriminale, nëpërmjet përdorimit të transaksioneve financiare. Kjo fazë përfaqëson sasinë më të madhe të parave dhe synon humbjen e gjurmave, mbulimin dhe maskimin e origjinës së tyre, nëpërmjet:

⁵ Përkufizimet e pastrimit të parave janë miratuar në fjalor të përbashkët, shih Oksford anglisht Fjalor, Edicioni i dytë, 1989, fq. 702.

⁶ Shih IOSCO Komiteti Teknik, Tetor 1992, Raporti mbi pastrimin e parave.

⁷ Ted Truman (ish zyrtar i Rezervës Federale Sh.B.A) dhe Peter Reuter, bashkëautorë të studimit të Institutit të Ekonomisë Ndërkombëtare, Uashington. Pastrimi i parave - 2004-12-15 <http://www1.voanews.com/albanian/neës/a-30-a-2004-12-15-3-1-85540192.html?moddate=2004-12-15>

⁸ Albana Isufi, Prishtinë.Seminari “Pastrimi i parave përbën kërcënim global” 21.09.2004 <http://www.evropaelire.org/content/Article/1020095.html>. Cituar Paul Byron, përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.

- futjes së parave në sistem financiar,
- kryerjes së investimeve të tjera,
- konvertimit të parave të pista fillestare në para të tjera,
- kryerjes së transaksioneve tregtare.

Në këtë fazë synohet copëzimi i kapitaleve të paligjshme me qëllim fshirjen e çdo mundësie për t'u ngjitur në origjinën e paligjshme të fondeve. Ky process realizohet nëpërmjet një sistemi kompleks transfertash financiare, me ndihmën e shoqërive fantazëm ose nëpërmjet përdorimit të të ashtuquajtura "parajsave fiskale".

c) Integrimi përfaqëson investimin e fondeve me origjinë të dyshimtë në një veprimtari ekonomike ligjore, me qëllim legjitimimin e tyre. Investimi, konsiston në përdorimin e parave të pista, pasi ato kanë dalë nga sistemi bankar. Pra, ndodh përdorimi i kësaj paraje "të pastër" në operacione investimesh të ligjshme. Në këtë fazë thuajse nuk mund të identifikohet më personi që kryen pastrimin e parave.

Dimensionet ndërkombëtare të pastrimit të parave

Ngjarjet e mëdha që kanë ndryshuar koperturën botërore, si përfundimi i Luftës së Ftohtë, lëvizja e lirë e njerëzve, zhvillimet ekonomike dhe arritjet teknologjike si informatika dhe telematika, kanë sjellë me vetë globalizimin e ekonomisë. *"Tashmë të gjithë janë të bindur se globalizmi përfaqëson dukurinë më tërësore ndikuese në planetin tonë.... me shumë ndikime të ndryshme të natyrës ekonomiko-financiare..."*⁹. Fluksi i parave nuk njeh kufij, ato mund të investohen në çdo skaj të botës, aty ku ka kushte më të mira.

FATF vlerëson se pastrimi i parave mund të arrijë në rreth 2 % të GDP-së globale. *"Askush nuk e di se sa para pastrohen çdo vit në botë përmes bankave, kjo shifër mund të arrijë në shtatëqind miliard dollarë"*.¹⁰ Në një studim për pastrimin e parave në Australi për vitin 1995 është vlerësuar se *"...sasia e parave të pastruara ishte rreth 3 miliard USD ose 3.4 % të PBB-së"*.¹¹ Sipas një studimi të përgatitur për Komisioni Europian, *"pastrimi i parave është vlerësuar midis 0.2 dhe 2 për qind të PBB-së"*.¹²

Globalizmi i ekonomisë ka favorizuar riciklimin financiar të krimit në ekonomi. Pra, sasi të mëdha kapitalesh transferohen lehtë pa u kontrolluar nga procedurat kombëtare të kontrollit. Globalizmi dhe integrimi në tregut financiar ndërkombëtar lehtëson në veçanti pastrimin e parave. Kriminelët paguajnë asistencën ekonomike për të realizuar riciklimin e kapitaleve. Sistemet telematike i japin shumë mundësi dhe siguri krimit të organizuar, të bëjë riciklimin e parave në një kohë shumë të shkurtër.

⁹ Adrian CIVICI, "Globalizmi ...ante portas", botim i pare nga UET-Pres, Tiranë 2009, fq.192.

¹⁰ Raport i përgatitur nga eksperti ndërkombëtar për financimi i terrorizmit, Jean-Charles Brisandrd për presidentin e Këshillit të Sigurimit, Dhjetor 2002.

¹¹ FATF, 1996-97 Report on Money Laundering Typologies, available on the ëbsite at: www.oecd.org/fatf/pdf/TY97_en.pdf

¹² Fraud without frontiers, 1997 study by Deloitte Touche for the European Commission.

Kalimi i shpejtë në ekonominë e tregut nga një ekonomi e planifikuar, provokoi edhe në Shqipëri, si dhe në vendet e ish sistemit socialist, dukuri të tilla si, privatizime të menjëhershme, shembje të sistemit të prodhimit, rritje të varfërisë, shtim të korrupsionit, që krijuan situatë të përshtatshme për krimin ekonomik, *ku thelbi është pastrimi i parave*. Qëllimi i subjektit të krimit në pastrimit e parave është të krijojë veprimtari ekonomike ku të maskohet transferimi i kapitaleve. Pastrimi i parave, si një krim ekonomik, që të ekzistojë, kërkon veprimin në ekonomi, zbatimin e rregullave të sistemit ekonomiko - financiar.

Pastrimi i parave është një dukuri me përmasa ndërkombëtare, e cila është gjallëruar në kushtet e hapjes dhe integritit të tregjeve. Transferimi i flukseve financiare është sot i mundur drejt çdo cepi të botës. Nuk ka vende të përjashtuara nga rreziku i pastrimit të parave. Por, sistemet e kontrollit dhe këndvështrimi mbi pastrimin e parave, janë ende në nivele të ndryshme. Dimensioni ndërkombëtar i pastrimit të parave del qartë edhe nga një studim kanades i pastrimit të parave. Nga punimi rezultoi se mbi 80 përqind e të gjitha skemave të pastrimit të parave kishin dimension ndërkombëtar. "*Operacioni Green Ice*"¹³ tregoi se pastrimi i parave ka natyrë transnacionale.

Transaksionet e përdorura për pastrimin e parave janë bërë gjithnjë e më komplekse, shpesh duke përfshirë institucione të shumta dhe të ndryshme financiare nga shumë vende, si zyrë këmbimi, agjensi sigurimi, agjensi shërbimi, agjentët, tregtarët, etj. Gjithashtu, përdorimi i bizneseve të ndryshme dhe tregjeve për pastrimin e parave është në rritje, duke përfshirë jo vetëm institucionet e paligjshme të tilla si kompani guaska të krijuara si instrumente të pastrimit, por edhe kompanitë e ligjshme, ku fondet e paligjshme janë intergruar me fonde të ligjshme.

Ndikimi dhe pasojat e pastrimit të parave në ekonomi

Pastrimi i parave mund të ketë pasoja shkatërruese sociale e ekonomike dhe paraqet një kërcënim për sigurinë e çdo vendi, të madh apo të vogël, të zhvilluar apo në zhvillim. Ai garanton dhe nxit trafikantët e drogës, të armëve, terroristët, zyrtarët e korruptuar dhe të gjitha llojet e kriminelëve për të vepruar dhe për të zgjeruar aktivitetet e tyre kriminale.

Procesi i globalizmit dhe revolucionit i komunikimit i kanë bërë krimet gjithnjë e më ndërkombëtare dhe më komplekse nga ana financiare. Sistemet ndërkombëtare të bankave e kanë lehtësuar transferimet dhe fshehjen e origjinës së fondeve të paligjshme. Ky proces ndihmohet edhe nga "rëmbimi" i institucioneve financiare nga kriminelët të pasur që përdorin institucionet për të futur fondet e tyre të paligjshme në botën financiare. Sistemet moderne financiare, përveç lehtësimin të tregtisë së ligjshme, mundësojnë kriminelët të urdhërojnë transferimin e miliona parave menjëherë, duke përdorur kompjuterat personale dhe artin e sistemeve të komunikimit.

¹³ Shih www.laundryman.u-net.com/.../operation_green_ice.html

Pastrimi i parave mund të dëmtojë integritetin e institucioneve financiare të vendit duke krijuar konkurrencë të pandershme midis bizneseve legjitime dhe jo legjitime. Studimet nga FMN, sugjerojnë se vendet e vogla janë më të ndjeshëm ndaj shkallës së lartë të operacioneve të pastrimit të parave duke shkaktuar *destabilitet të rëndë makroekonomike*¹⁴. Për shkak të marrëdhënieve tejet të ngushtë me tregjet e kapitalit, pastrimi i parave mund të ndikojë negativisht në monedhat dhe normat e interesit, pasi *“pastruesit”* i riinvestojmë fondet ku skemat e tyre janë më pak të rrezikuara për t’u zbuluar, pavarësisht nga norma e interesit.

“Pastruesit” e parave nuk kërkojnë normë të larta interesi, por mënyra më të lehta për të pastruar paratë e tyre të pista. Konkurrenca e pandershme e krijuar nga pastrimi i parave, në fund të fundit, ndikon negativisht në të ardhurat tatimore, rrit taksat për tatimpaguesit e ndershmë, dhe dëmton zhvillimi ekonomik. Pasojat janë proporcionalisht më të mëdha për vendet e vogla. Paratë e pista, në fazën përfundimtare, futen në sistemet financiare globale, duke përbërë një kërcënim serioz për stabilitetin ekonomik në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Cilët janë efektet negative të pastrimit të parave për ekonominë?

Pastrimi i parave prodhon pasoja negative dhe shtrembërime të thella në zhvillimin real të ekonomisë. Ai denatyrton konkurrencën e lirë dhe të ndershme, cënon rëndë rregullat e lojës së tregut, bile, i trondit ato duke sjellë me vete çrregullime serioze në treg. Pastrimi i parave shtrembëron kushtet e konkurrencës në treg, duke shkaktuar vështirësi për veprimtari të ndershme të biznesit, mund të ketë pasoja të tjera negative makroekonomike. Shoqërohet me krijimin e monopoleve në sektore të rëndësishëm të ekonomisë.

Ai e bën mbledhjen e taksave kombëtare dhe zbatimit e ligjit më të vështirë, mund të shtrembërojnë caktimin e burimeve dhe shpërndarjen e pasurisë. *“Pastrimi parave deformon statistikën dhe çorienton autoritetet në marrjen e masave të përshtatshme. Në raste ekstreme, mund të ketë vendime të gabuara në parashikime të natyrës fiskale dhe monetare (norma interesi dhe kurs kembimi)”*.¹⁵ *“Në qoftë se, krimi i pastrimit të parave dhe informaliteti zhvillohet në një shkallë mjaft të madhe, atëherë politikëbërësit makroekonomik duhet të marrin ato në konsideratë.”*¹⁶

Dëmet ekonomike mund të lindin jo vetëm drejtpërdrejt nga pastrimi i parave, por edhe nga akuzat që ndikojnë në reputacionin e një vendi. Akuza të tilla ndikojnë në vullnetin e agjentëve ekonomikë, veçanërisht ato jashtë vendit, për të bërë investime në një vend të caktuar. Kohët e fundit, publikimi i listave nga FATF dhe OECD¹⁷ kanë një ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim.

¹⁴ https://www.bov.com/filebank/.../BR28%2018-32Frank_Caruana.pdf.

¹⁵ <http://google.com>. Titulli “Pastrimi i parave dhe rreziku i parave cash” nga A. Ndoja.

¹⁶ Quirk, P. Charles, Macroeconomic Implications of Money Laundering IMF Working Paper, EP/96/66.

¹⁷ Organisation for Economic Cooperation and Development (OECD). Shih <http://www.environment.gov.au/about/international/oecd/index.html>

Fluksi i kapitalëve të paligjshme në ekonominë e një vendi sjell në dukje një rritje të mirëqenjes, por për një periudhë më të gjatë shoqëritë private kanë shumë vështirësi, derisa ngrenë duart lart dhe falimentojnë përpara grupeve kriminale. Hyrja e parave të pista në ekonominë legale, çon në marjen në zotërim të ekonomisë legale dhe financiare nga grupimet kriminale. Sistemi ekonomiko-financiar mund të bjerë në duart e grupeve kriminale.

Pastrimi i parave është i lidhur me krimet e tjera financiare, si me korrupsionin, mashtrimin, apo me krimin e organizuar¹⁸. Pas marrjes së të ardhurave të paligjshme, kriminelët mund të kërkojë pastrimin e tyre nëpërmjet sistemit financiar. Kjo, nga ana tjetër, mund të kërkojë një seri aktiviteteve kriminale, si p.sh. mashtrim, falsifikimin, korrupsion, etj.. Pra, një zinxhir i tërë aktiviteteve kriminale mund të rezultojë në rrjedhjen e parave kriminale përmes sistemit financiar.

Pastrimi i parave dhe ekonomia informale

Pastrimi i parave është i lidhur me ekonominë informale, pasi origjina e parave të rrjedhura nga krimi nuk kontrollohet dhe as kërkohet për fillimin dhe realizmin e veprimtarive të ndryshme ekonomike. Në këtë aspekt, ekonomia e nëndheshme përbën një kërcënim të mirëfilltë për stabilitetin ekonomik. *“Humbja e të ardhurave nga ekonomia informale, nxit qeverinë të rrisë taksat. Prania e ekonomisë së fshehtë mund të çojë në një “hiperbolizim” të efekteve inflacioniste të nxitësve fiskalë apo monetarë”*.¹⁹ Në përgjithësi, ekonomia informale çon në një ulje të rritjes ekonomike, pasi jo vetëm ulen të ardhurat në buxhet, por qeveritë shpesh janë të detyruara t’i drejtohen financimit nëpërmjet emisionit të bonove të thesarit, që mund ta destabilizojë ekonominë.

Një ekonomi e lartë informale krijon agregatë ekonomikë zyrtarë jo të saktë, si norma e papunësisë dhe niveli i të ardhurave. Ekonomia e nëndheshme krijon kushtet për konkurrencë të padrejtë mes firmave. Firmat që operojnë në këtë ekonomi nuk kanë rregulla ligjore dhe mund të vendosin çmime më konkurruese se firmat e regjistruara. Firmat në ekonominë e fshehtë mund t’i shesin produktet dhe shërbimet e tyre në çmime më të ulëta se çmimi i përgjithshëm i tregut dhe mund të rrisin vëllimin e tyre të shitjeve dhe fitimeve. *“Ekonomia e fshehtë mund të përkeqësojë pozicionin financiar të institucioneve të sigurimeve shoqërore apo të ul të ardhurat nga taksat dhe kjo ulje mund të shkaktojë kufizimin e ndihmës sociale tek njerëzit me të ardhura të pakëta dhe mund të rritin tensionet sociale në komunitet”*.²⁰

Veprimet në *cash* përbëjnë një prej dukurive negative më të cilin përballet aktualisht ekonomia dhe financat shqiptare duke patur një impakt jo vetëm mbi të ardhurat buxhetore të shtetit shqiptar, por edhe mbi vetë biznesin e rregullt që operon konform

¹⁸ Shih Naim Mëçalla, “Pastrimi i parave kërcënim për sigurinë kombëtare”, “Dita 200”, Tiranë 2007.

¹⁹ <http://google.com.www.bankofalbania.org>. Titulli “Pastrimi i parave dhe rreziku i parave cash” nga Alma Ndoja.

²⁰ Po aty.

ligjeve. Veprimet në *cash* pengojnë krijimin e një imazhi të qartë e të plotë të zhvillimeve ekonomike brenda vendit. Mungesa e një informacioni të detajuar mbi sasinë e parave në qarkullim e veprim, vështirëson në të njëjtën kohë edhe ruajtjen e parametrave makrofikale brenda normave e objektivave të përcaktuara në programin e qeverisë dhe është bërë një nga pengesat kryesore për të parashikuar e programuar saktësisht zhvillimet ekonomike. Ka burime që shprehen se, *“ekonomia shqiptare është e pushtuar nga informaliteti. Madje, arrihet deri në atë pikë sa në raport thuhet se informaliteti, ka arritur nivele sa gjysma e GDP-së”*.²¹

Pastrimi i parave gjejnë teren të përshtatshëm në vendet ku ekonomia *cash* është në nivel të lartë. Në vendin tonë ekonomia informale akoma është në shifra të larta krahasuar me vendet e Europës Perendimore. Ky fenomen shtron sfida domethënëse për luftën kundër pastrimit të parave dhe asaj kundër financimit të terrorizmit, *“..mbasi vetëm 25-30 % e transaksioneve kalojnë në sitemin bankar, dhe mbi 30 % e ekonomisë në vend vlerësohet të jetë informale”*.²²

Përfundime

Si përfundim, provat mbi përmasat e pastrimit të parave, janë të kufizuara, matjet në bazë të krimeve të raportuara nënvlerësojnë madhësinë aktuale të abuzimit të sistemit financiar, ndërsa vlerësimet bazuar në ekonominë e nëndheshme teprojnë në mënyrë të qartë atë, por duhet pranuar se ndikimi i pastrimit të parave në ekonominë e një vendi nuk mund të përjashtohet.

Fenomeni i pastrimit të parave ka një shtrirje jo vetëm tek ata persona të cilët ne shikojmë se janë marrë me trafikë të paligjshme, si drogë, prostitucionë, apo krime të tjera, por edhe në biznesmenë të fuqishëm. Detyra e specialistëve të fushave përkatëse është të investigojnë ata persona që shfaqin një shtesë të menjëhershme të parave. Ky shtim i menjëhershëm i kapitalëve duhet të vëjë në lëvizje institucionet përkatëse për zbulimin e aktiviteteve të tyre kriminale.

Pastrimi i parave është një dukuri globale, prandaj bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet i domosdoshëm duke patur parasysh lehtësinë me të cilën organizatat kriminale akumulojnë dhe transferojnë vlera të mëdha monetare nëpërmjet sistemit financiar.

Lufta kundër pastrimit të parave redukton krimit financiar, por edhe privon kriminelët për të kryer krime të tjera. Për arritjen e suksesit të kësaj lufte kërkohet një bashkëpunim punësh e procedurash ndërmjet bankave, agjencive të udhëtimit, hipotekës dhe institucioneve të tjera financiare nga njëra anë dhe Drejtorisë së Përgjithshme Parandalimit Pastrimit Parave, Policisë, Shërbimit Informativ Shtetëror, Prokurorisë dhe Gjykatës, nga ana tjetër.

21 Raporti i shërbimeve sekrete të inteligjencës amerikane, i publikuar ditët e fundit. Marrë nga gazeta “Sot”, datë 03 Gusht 2006, titulli “Gjysma e ekonomisë shqiptare, informale”.

22 Drejtoria e Përgjithshme PPP. Raport vjetor 2006, mbajtur nga ish Drejtori i Përgjithshëm A. Islami.

Literatura :

- Adrian CIVICI, "Globalizmi ...ante portas", botim i pare nga UET-Pres, Tiranë 2009.
- Vasilika HYSI – Kriminallogjia, Tiranë 2005.
- Naim Mëçalla, "Pastrimi i parave kërcënim për sigurinë kombëtare", "Dita 200", Tiranë 2007.
- FATF, www.oecd.org/fatf/40Recs_en.htm.
- [Http://www.laundryman.u-net.com/pag.1hist.html](http://www.laundryman.u-net.com/pag.1hist.html).
- http://www.fatf-gafi.org/pages/0,3417,en_32250379_32236920_1_1_1_1_1,00.html
- Fjalor Oksford anglisht, Edicioni i dytë, 1989.
- IOSCO. http://en.wikipedia.org/wiki/International_Organization_of_Securities_Commissions
- <http://www1.voanews.com/albanian/neës/a-30-a-2004-12-15-3-1-85540192.html?moddate=2004-12-15>
- <http://www.evropaelire.org/content/Article/1020095.html>. Albana Isufi, Prishtinë. Seminari "Pastrimi i parave për bën kërcënim global" 21.09.2004 Cituar Paul Byron., përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara.
- Raport i përgatitur nga eksperti ndërkombëtar për financimi i terrorizmit, Jean-Charles Brisard për presidentin e Këshillit të Sigurimit, Dhjetor 2002. en.wikipedia.org/wiki/Jean-Charles_Brisard.
- Report FATF, 1996-97 on Money Laundering Typologies, available on the website at: www.oecd.org/fatf/pdf/TY97_en.pdf
- Fraud without frontiers, 1997 study by Deloitte Touche for the European Commission. www.laundryman.u-net.com/.../operation_green_ice.html
- https://www.bov.com/filebank/.../BR28%2018-32Frank_Caruana.pdf.
- Quirk, P. Charles, Macroeconomic Implications of Money Laundering IMF Working Paper, WP/96/66.
- OECD. <http://www.environment.gov.au/about/international/oecd/index.html>
- <http://google.com.www.bankofalbania.org>. Titulli "Pastrimi i parave dhe rreziku i parave cash" nga Alma Ndoja.
- Raportet vjetore të Drejtorisë e Përgjithshme PPP.

Partneriteti Publik-Privat: PRO DHE KUNDRA

Dr. Ali Turhani

Fakulteti Ekonomik

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

ABSTRAKT. Ky punim ka si synim të trajtojë dhe evidentojë avantazhet dhe disavantazhet e PPP-ve (Partneriteti Publik-Privat) si dhe treguesit, të cilët duhet të përdoren, për vlerësimin e përfitimeve që vijnë nga PPP-të në projektet e ndryshme të infrastrukturës së shërbimeve publike. Duke elaboruar eksperiencën e vendeve të tjera në lidhje me PPP, do të mund të sigurohet një bazë teorike e vlefshme për institucionet publike të Shqipërisë, me qëllim që të arrihet një vendimmarrje sa më efektive e tyre në ndërtimin e infrastrukturës së shërbimeve publike ose nëpërmjet financimit të tyre nga buxheti ose nga PPP.

Duke ndërtuar këtë infrastrukturë nëpërmjet PPP-së, është e paevitueshme që ato të mos përfshihen në debatin politik. Po të mos ekzistojë një vullnet i plotë nga ana e sektorit publik si dhe po të mos garantohet aftësia për të komunikuar hapur dhe qartë nga ky i fundit, ndryshimet politike mund të mos lejojnë që të hartohet dhe të zbatohet me sukses një program i PPP-së. Të kuptuarit e këtij argumenti nga ana e institucioneve publike të Shqipërisë është i domosdoshëm për ndërtimin e formave të ndryshme të PPP-së.

Hyrje

N atyrshëm lind pyetja: Pse ka pasur një interes në rritje në të gjithë botën për PPP në vitet e fundit? Lëvizja për reforma në sektorin publik, e njohur si "Menaxhimi i ri publik", jep bazën teorike të pranisë në rritje të këtij interesi për PPP, por arsyeja kryesore në realitet është se PPP-të shmangin kufizimet që të imponon buxheti i sektorit publik. Sidoqoftë ka një debat të gjërë sot për avantazhet dhe disavantazhet e PPP, i cili duhet pranuar se është një debat kompleks. Një shumëllojshmëri argumentash është përdorur nga qeveritë për të promovuar projekte

të PPP, por disa prej tyre janë të natyrës pas-veprimit (janë përdorur për të justifikuar vendimet të cilat janë marrë për arsye të buxhetit). Elementet rreth të cilëve sillet ky debat janë:

- 1) Nëse PPP siguron një shtesë të investimeve në infrastrukturën publike
- 2) Kostoja më e lartë e financimit në projektet e PPP.
- 3) Nëse transferimi i riskut dhe kostoja e parasë së PPP mund të kompensohet përkundrejt koston më të lartë të financimit të projektit.
- 4) Së fundmi, konteksti politik ku zhvillohet ky debat

Manaxhimi i Ri Publik, Privatizimet dhe PPP

PPP duhet të shihet brenda kontekstit të përgjithshëm të lëvizjes për reforma në sektorin publik të njohur si “Manaxhimi i ri publik”, i cili inkurajon:

- a) Decentralizimi i qeverisjes.
- b) Ndarja e përgjegjësisë për blerjen e shërbimit publik nga ato, të cilët e garantojnë atë.
- c) Output ose matje të bazuara në performancën e realizimit të shërbimit publik.
- d) Kontraktimi me sektorin privat për realizimin e shërbimit publik
- e) Privatizimi i shërbimeve publike.

Të gjitha këto mjugullojnë kufirin midis sektorit publik dhe sektorit privat. Kështu ndërsa kontrata e tipit BOT dhe variantet e saj krijuan bazën teknike në vitet 1990 për një gjeneratë të re të PPP, baza teorike dhe politike ishte krijuar prej “Manaxhimit të ri publik”. Privatizimi i shërbimit publik – një tjetër iniciativë publike – filloi nën qeverisjen e Margaret Thatcher në 1980, e cila u përhap gjithashtu në shumë vende të tjera. Incentivat kryesore për privatizimin krijoheshin nga besimi i bazuar në “Manaxhimin e ri publik”, sipas të cilit duhej që shteti të shndërrohej në rolin e tij dhe të bashkëpunonte me sektorin privat për të garantuar shërbime të cilat ishin më shumë efçente, si dhe realizimin e një konkurrence e cila do të çonte në një nivel më të mirë shërbimi si dhe kosto më të ulët për qytetarët, po ashtu si dhe një përdorim me ekonomik të burimeve (veçanërisht nëse shërbimet janë dhënë pa pagesë ose me një tarifë nën kosto). Kjo prapësoi tendencën e shekullit të 20-të për sigurimin e shërbimeve publike vetëm nga shteti. Programi vijues anglez i PFI, kishte si qëllim shtrirjen e këtyre përfitimeve nga privatizimi për të mbuluar shërbimet publike të cilat nuk do të privatizohen, koston e parasë si dhe argumentat e tjera që do të diskutohen më poshtë si frenuese për mënyrën e të menduarit sipas “Manaxhimit të ri publik”.

Megjithatë, ka diferenca të rëndësishme midis privatizimit dhe PPP, disa prej të cilave e vështirësojnë mundësinë që PPP të arrijë të njëjtat rezultate si dhe privatizimi:

1. Autoriteti publik mbetet në mënyrë direkte politikisht i llogaritur për një shërbim të garantuar nga PPP, por jo në rastin e privatizimit.
2. Qytetarët nuk mund të jenë normalisht të ndërgjegjshëm se një shërbim me bazë PPP duhet të sigurohet nga një kompani private dhe jo nga sektori publik, ndërsa kjo është e dyshimtë për shërbimet e privatizuara.

3. Në një PPP, pronësia e asetëve publike normalisht i mbetet sektorit publik, ndërsa në privatizime ato ngelin përjetësisht në pronësi të privatëve.

4. Një PPP normalisht përfshin garantimin e shërbimeve publike që janë monopol, ndërsa privatizim normalisht do të thotë futja e konkurrencës për të ofruar shërbimin.

5. Në një PPP, korniza dhe kosto e shërbimit është e fiksuar prej një kontrate specifike midis sektorit publik dhe atij privat, ndërsa në privatizim ato janë të kontrolluara prej disa mënyrave të liçensimit ose rregullatorëve të cilët lejojnë ndryshime të rregullta të koston, ose i janë nënshtruar thjesht konkurrencës ose forcave të tregut.

Përfitimet Buxhetore

Ndërsa “Manaxhimi i ri Publik” krijoi një bazë teorike për PPP-të, arsyeja kryesore për rritjen e kohëve të fundit të PPP-ve, qëndron në moskërkesën e fondeve nga sektori publik. Një PPP lejon që kostoja e kapitalit të një fasiliteti të sektorit publik të shtrihet në të gjithë jetën e tij, më shumë se sa të kërkohet që t’i jetë ngarkuar menjëherë për pagesë buxhetit publik. Kjo kosto është atëherë (për modelin e konçesionit) paguar prej përdoruesve në vend që të paguhet taksa, dhe (për modelin e PFI) i ngarkohet buxhetit të sektorit publik për të gjithë kohështrirjen e kontratës së PPP, me anë të pagesës së tarifës së shërbimit. Një program kështu i PPP-ve i mundëson sektorit publik të çlirohet në terma afatshkurtra nga kufizimet që i imponohen në investimet e infrastrukturës publike nga pamjaftueshmëria e të ardhurave nga taksat dhe limitet e huave të sektorit publik. Disa prej emrave që u janë dhënë programeve të PPP, të tillë siç janë në Britani “Inisiativa e financimit privat, PFI”, ose termi “Financimi Inovativ” i përdorur tashmë shpesh nga agjensitë e qeverisë Amerikane për të përshkruar PPP-të, konfirmojnë pikpamjen se PPP-të janë së pari për financimin e sektorit privat të investimeve në sektorin publik.

Kjo ngre pyetjen nëse kufizimet buxhetore në investimet e infrastrukturës të cilat krijojnë një nevojë për të pranuar itinerarin e PPP, janë të përafërta, veçanërisht në rastet kur këto kufizime janë krijuar në mënyrë artificiale nga rregulla të tilla si limitet e vendosura nga Traktati i Mastrihtit për deficitin buxhetor në Komunitetin Europian. Përdorimi i PPP-ve në raste të tilla shkakton një kundërshtim për t’i përshkruar ato aspak më shumë se një hua për mbylljen e deficitit të bilancit të qeverisë, megjithëse ato kanë të tjera merita, siç i kemi diskutuar më lart. Kështu mund të ketë një argument për të ndryshuar rregullat në favor të publikut në të tilla raste, më shumë se sa të shkatërrohen këto modele.

Duhet të theksohet se megjithëse PPP-ve shpesh u referohen si burime për të mbyllur deficitet e bilancit të sektorit publik, sektori publik nuk ka një bilanc të krahasueshëm me atë të kompanive private. Ky pohim nënkupton se PPP-të nuk mund të trajtohen si një huadhënie për sektorin publik e as që kosto e kapitalit të trajtohet si shpenzim në buxhetin publik. Sidoqoftë, në rastin e modelit të PFI-së, tarifat e shërbimeve janë një kosto vjetore e ardhshme, dhe në këtë mënyrë ka një impakt në buxhetin e sektorit publik në të njëjtën mënyrë si huamarrja. Kjo mund

të përkeqësorë përfundimisht kufizimet të cilat mund të çojnë adoptimin e itinerarit të PPP-ve në vend të parë, të cilat janë rreziqe të veçanta për vendet që hyjnë në programe të mëdha të PFI. Ky problem ka qenë evident në Portugali, ku pagesat për një program të madh dhe të shpejtë për zhvillimin e modeleve të PFI-së, kanë patur një efekt të rëndësishëm në buxhetin publik.

Nëse investimi fillestar në një PPP nuk realizohet nga buxheti, kjo mundëson sektorin publik të bëjë investime në infrastrukturë, të cilat nuk do mund të realizoheshin me mjetet financiare të buxhetit (ose do të realizoheshin shumë më vonë). Në këtë mënyrë zgjidhja reale në kushtet e kufizimeve të buxhetit, nuk duhet parë si raport zgjedhjeje midis PPP dhe Prokurimit të sektorit publik për fasilitetin, por midis PPP dhe ekzistencës së investimit. Ky "Plotësim" është një argument i përdorur shpesh në favor të programit të PPP – nga i cili qeveritë japin të tilla shprehje "PPP-të na lejojnë ne të investojmë më shpejt në shërbimin publik", si dhe pasojat e atraksioneve politike të PPP.

Është e debatueshme nga pikpamja makroekonomike se nëse investimet publike rriten, investimet private ulen. Kështu, rezultati neto është i njëjtë nëse është investimi publik ose privat, por duket se ka njëfarë qartësie në atë se PPP ngjeshin investimet e sektorit privat diku tjetër (ndonëse ato mund të ndikojnë në industrinë e ndërtimit siç do të diskutohet edhe më poshtë). Në mënyrë të ngjashme, është pothuajse e qartë se PPP-të janë ndërmarrë në të vërtetë si shtesë e formave të tjera të investimeve të sektorit publik dhe jo për ti zëvendësuar këto forma.

Kosto e financimit dhe transferimi i riskut

Financimi i sektorit privat për një PPP ka një kosto më të madhe nëse projekti do të prokurohet nga sektori publik dhe të financohesh nga huatë e sektorit publik. Kostoja e kapitalit për një PPP është normalisht 2-3% më e lartë kur financohet nga sektori privat se sa kur financohet nga fondet publike, madje edhe për modelin e PPP kur të ardhurat nga pagesat e bëra rrjedhin nga sektori publik.

Huamarrja e sektorit publik është më e lirë sepse huadhënësit e qeverisë nuk kanë marrë përsipër ndonjë risk me paratë e tyre, ndërsa huadhënësit tek PPP-të janë në mënyrë të qartë duke marrë përsipër risk. Por risku i projekteve nuk zhduket pikërisht sepse sektori publik është duke i financuar ato – por mund të jetë një argument se risqet e mbetura tek sektori publik formojnë një kosto të fshehur të projektit, e cila duhet ti shtohet koston së ulët të financimit të sektorit publik që të bëhet e krahasueshme me koston e financimit të një PPP.

Mund të jetë një alternativë tjetër pamja se sektori publik është më i aftë të shpërndajë riskun se sa sektori privat – nga kjo del se ka një ndryshim real midis marrjes së riskut nga sektori publik dhe nga sektori privat, edhe kështu kostoja reale e një projekti të financuar nga sektori publik, madje duke marrë parasysh riskun, është aktualisht më e ulët se sa financimi dhe manaxhimi i projektit nga sektori privat. Por nëse kjo pamje do të realizohej në ekstrem, ajo do të thoshte se qeveria duhej të financonte çdo gjë. Pra është njësoj si të thuash se kompanitë në sektorin privat janë

në pronësinë e shumë aksionerëve individualë të cilët, diversifikojnë riskun e tyre duke patur në pronësi një diapazon të gjërë të aksioneve. Kjo nuk është qartësisht një rast i pastër për të sugjeruar se ka diferenca themelore në mundësitë e sektorit publik dhe sektorit privat për të absorbuar riskun.

Por, vlerësimi nga pikëpamja sasiore e transferimit të riskut në një PPP (ose risku korespondues i cili do të mbetet në një prokurim të sektorit publik) është një proces i vështirë, siç është dhe rasti i përfitimeve të tjera nga një PPP, të cilat do të diskutohen me poshtë. Drejtimi realist i zhvillimit të debatit për koston krahasuese të financimit presupozon një zgjedhje të lirë midis fondeve të sektorit publik dhe një PPP, presupozim i cili për shkak të kufizimeve të buxhetit në të shumtën e rasteve nuk ekziston, në këtë mënyrë zgjedhja qëndron midis një PPP dhe asnjë projekti. Çështja atëherë fokusohet nëse fasiliteti është prokuruar me një kosto efektive si në një PPP, pavarësisht se çfarë mund të kenë qenë të ardhurat teorikisht nga prokurimi i sektorit publik.

Transferimi i riskut dhe kosto e parasë

Pavarësisht vështirësisë së vlerësimit sasior, sidoqoftë, transferimi i riskut mbetet një element kryesor i koston së parasë, i cili është një argument në favor të PPP – sipas këtij argumenti risku i cili mund të transferohet mund të menaxhohet më mirë nga sektori privat, kështu që kosto e realizimit do të jetë më e ulët se sa risku që ngelet tek sektori publik. Nga këtu mund të themi se transferimi i riskut ul koston e parasë. Në këtë kontekst, kosto e parasë nuk është e bazuar në atë se çfarë është fillimisht më e lirë, por merr parasysh kombinimin e transferimit të riskut, koston e të gjithë jetës së projektit dhe të shërbimit të fasilitetit, si një bazë për të vendosur se kush ofron vlerën më të mirë. Argumentat e koston së parasë nga pikëpamja politike kanë një rëndësi të konsiderueshme për të siguruar mbështetje për një program të PPP-ve. Elementët e transferimit të riskut, për koston e parasë janë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me faktin se projektet nuk mund të aprovohen në bilancin e sektorit publik po të mos transferohet risku tek sektori privat në mënyrë demonstrative (të hapur).

Nuk ka dyshim se PPP-të inkurajojnë sektorin publik të identifikojë riskun e projekteve dhe të mendojë për transferimin e riskut në një mënyrë e cila nuk ka qenë konvencionale në prokurimet e sektorit publik. Mënyra sipas së cilës transferimi i riskut realizohet në një kontratë të PPP-së do të duhet të vrojtohet si një proces kompleks, por një PPP e transferon si riskun e ndërtimit, ashtu edhe atë të përdorimit\ tregut dhe riskun e shpërndarjes së shërbimit\disponibilitetit tek sektori privat. Secila prej këtyre kategorive të riskut do të diskutohet shkurtimisht më poshtë.

Risku i ndërtimit

Prokurimi i projekteve madhore prej sektorit publik mund të rezultojë në një tejkalim të konsiderueshëm të koston së ndërtimit, ndërsa pagesat e Autoritetit Publik për një PPP janë fikse në kontratë, prandaj të tilla tejkalime të koston nuk duhet të

ndodhin. Në këtë mënyrë është e qartë se risqet e ndërtimit janë transferuar tek sektori privat në një PPP.

Por arsyeja për këtë nuk është vetë struktura e PPP-ve në vetvete, pasi është një fakt i pamohueshëm se kostot e ndërtimit janë të fiksuara në një kontratë projektim-ndërtimi, në të cilën kompanitë projektuese (nëpërmjet nënkontraktorëve të ndërtimit) gjithashtu marrin një risk qysh në projektim, risku i ndonjë gabimi apo harrese në projektim, ose mosparashikimi i saktë i punimeve. Kontratat e projektim-ndërtimit nuk eliminonin plotësisht riskun e tejkalimit të koston ose të dështimit të kësaj faciliteti, por shmangin problemin e ofertimit të projektim-ndërtimit në një prokurim në sektorin publik, të ofertes fillestare më të ulët nga kontraktorët të cilët janë nën influencën e ndryshimit të rregullave ndërsa Autoriteti Publik ndryshon dhe zhvillon projektin. Sidoqoftë, në një kontratë projektim-ndërtimi, kosto fillestare është qenësish më e lartë se në një kontratë të përzgjedhjes së ofertuesit të projektim-ndërtimit, sepse kjo e dyta le mundësinë për të marrë parasysh tejkalimet e koston që mund të dalin më vonë. Në këtë mënyrë mund të ketë rritje të kostove të projekteve të PPP (të cilat mund të fshihen duke reduktuar përmasat e projektit), në kohën midis pranimit të ofertave dhe momentit të vlerësimit dhe nënshkrimit të kontratës së PPP.

Në çdo rast pothuajse, kontratat e projektim-ndërtimit mund të përdoren në prokurimet në sektorin publik, kryesisht për të eliminuar tejkalimet e koston, për të garantuar se Autoriteti Publik mund të specifikojë, negociojë dhe supervizojë këto kontrata në mënyrë efektive. Në mënyrë të ngjashme, kombinimi i projektimit dhe ndërtimit brenda një kontrate të PPP-së duhet të sigurojë një kompletim të ndërtimit, ndërsa këto aktivitete mund të realizohen pjesërisht paralel, në vend që të presin mbarimin e njërit për të filluar tjetri, por përsëri ky përfitim mund të sigurohet prej Autoritetit Publik duke u futur në një kontratë të tipit projektim-ndërtim, se sa të futet në një kontratë të tipit projekto-oferto-nderto.

Risku i përdorimit

Në modelin e konçensionit, risku i përdorimit transferohet tek konçesionari (por ky i fundit mund edhe të mbështetet nga Autoriteti Publik), gjithashtu, ky model mund të shndërrohet në modelin e PFI, por kjo nuk mund të jetë efektive nga pikpamja e koston nëse sektori privat duhet të ngarkohet rëndë për marrjen përsipër të riskut të përdorimit. Në fakt, trenda e përgjithshme në projektet e modelit të PFI është që risku i përdorimit t'i ngelet Autoritetit Publik.

RISKU I DISPONIBILITETIT DHE PERFORMANCËS

Megjithëse këto risqe mund të jenë transferuar tek kompania projektuese, niveli real i tyre është shumë i ulët pas ndërtimit të facilitetit.

KOSTOT E OPERIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES

Risku i tejkalimit të koston së operimit në përgjithësi transferohet tek kompania projektuese, siç do të trajtohet edhe më poshtë. Ky sens drejtimi për të gjithë jetën

e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së fasilitetit, i cili është fundamental për procesin e PPP-ve, është një prej pikave më të forta të argumentave të kostos së parash për PPP-të. Sidoqoftë, këto risqe nuk janë transferuar gjithmonë plotësisht.

REALITETI I TRANSFERIMIT TË RISKUT

Por sa real është transferimi i riskut? Një PPP, sipas përcaktimit, siguron një shërbim publik të rëndësishëm. Nëse investitorët e sektorit privat investojnë gabim në një PPP, ato mund të humbasin investimet e tyre, por ato nuk mund të vazhdojnë më tej të financojnë me paratë e tyre për të shpëtuar projektin. Nëse një PPP dështon, është e sigurtë se Autoriteti Publik do të sigurojë financime të mëtejshme mbi koston për të siguruar mirëfunksionimin e shërbimit publik, kështu që koncepti i transferimit të riskut nuk mund të jetë prezent në këto raste.

Për më shumë, ndërsa interesi kryesor i Autoritetit Publik është që PPP-të të vazhdojnë të garantojnë shërbimin, rruga më e lehtë për të arritur këtë qëllim mund të jetë sigurimi i një suporti shtesë për projektin, se sa përfundimi i kontrates së PPP-së dhe pastaj të përpiqesh për të gjetur argumenta justifikues. Një proces i tillë mbështetës mund të thotë se Autoriteti Publik merr përsipër përgjegjësinë për riskun i cili ka qenë transferuar tek investitorët e sektorit privat, duke mohuar në këtë mënyrë përfitimet nga transferimi i paramenduar i riskut për PPP. Ky proces është karakterizuar si “Përfitimet e privatizimit dhe humbjet shoqërore”. Megjithatë, duhet thënë se nuk do të ishte korrekte të pretendohet se kjo ndodh gjithmonë nëse një projekt i tipit PPP nuk ecën mirë, për sa kohë që ka incentiva të mira financuese për pjesën tjetër të sektorit privat që mund të përfundonin me sukses.

Mund të jetë e debatueshme që një tarifë-shërbimi, e cila është llogaritur saktësisht t’i japë sektorit privat një normë fitimi me realizimin e tij, me një pagesë të strukturuar në mënyrë të kujdesshme që të sigurojë se neto cash flow nuk është seriozisht e rishikuar, në fakt nuk është kjo larg nga rreziku i një kostoje plus. Nëse ky është një pohim i drejtë, atëherë duhet të pranohet se transferimi i riskut është shumë i limituar.

PPP-të dhe politikat

Duke i dhënë PPP-së natyrën e shërbimeve publike, është e paevitueshme që ato të mos jenë subjekte të debateve të forta politike. Po të mos ekzistojë një vullnet i fortë politik nga ana e sektorit publik në tavolinë, dhe aftësia për të negociuar një PPP në mënyrë të ndershme dhe të drejtë, rrymat politike mund të hedhin lehtë procesin jashtë kursit, kështu që programit të PPP-ve do t’i duhet shumë luftë dhe përpjekje për të arritur suksesin.

Një aspekt i këtij debati është se pavarësisht të qenit në mënyrë evidente ndryshe, PPP-të vështrohen akoma si një formë privatizimi, e cila i jep shans nxjerrjes së arsyeve të ndryshme për një opozitë politike të tyre :

“Shpenzime të publikut dhe fitimi i privatit”. Mund të pretendohet se PPP-të i japin investitorëve të sektorit privat mundësinë të fitojnë duke dhënë shërbime të

cilat mund të ishin dhënë nga sektori publik me një kosto më të ulët. Por shumë prej elementeve individuale të një strukture PPP-je, të tillë si ndërtimi i një fasiliteti, duhet të jenë garantuar prej sektorit privat në ndonjë mënyrë. Fitimi shtesë marxhinal, të cilin sektori privat e realizon nga investimi në një projekt të PPP-së, i krahasuar me fitimin e drejtpërdrejtë në prokurorimet e sektorit publik, nuk është ndoshta shumë i madh për të mbështetur këtë argument. Në çdo rast, nëse sektori publik nuk ka kapacitetin buxhetor të nisë projekte, ky argument është i bazuar, pikërisht në krahasimin e koston së prokurimit të sektorit publik me atë privat, duke u nisur nga një premisë jo e saktë se gjithmonë ka një zgjedhje midis prokurimit të sektorit publik dhe një PPP-je.

Sidoqoftë, nëse investitorët e sektorit privat janë të përgatitur për fitime të shpejta, për shembull nëpërmjet interesave të larta fillestare të kthimit të investimit, rifinancimit të borxheve, ose shitjeve të aksioneve të tyre në asete, atëherë ky është një dobësim i programit të PPP-ve nga pikpamja politike.

“Standarte të ulëta operimi”: Është e debatueshme se nëse një fasilitet do të operohet nga një kompani private, kjo e fundit do të “sakrifikojë sigurinë për hir të fitimit”. Por një PPP është nën një supervizion të rreptë të Autoritetit Publik, dhe standartet e sigurisë do të jenë specifikuar qartë në kontratën e PPP-së : ns këtë aspekt një Autoritet Publik ndoshta ka më shumë aftësi të kontrollojë dhe supervizoje sigurinë se sa një kompani private.

“Nivel më i ulët i konditave të punës”: Mund të pretendohet se një PPP ul konditat e punës të punëtorëve të sektorit publik në rastet kur kjo punë – në pastrimin dhe shërbimet e tjera ndihmëse – është marrë përsipër si një pjesë e PPP. Ky është një aspekt i një PPP-je ku pozita është e njëjtë me atë të një privatizimi – në të dy rastet punëtorët e sektorit publik mund të jenë marrë përsipër nga një kompani private, dhe varet nga Autoriteti Publik që të garantojë se investitorët privatë në një PPP nuk janë të stimuluar të trajtojnë punëtorët padrejtësisht, duke u përqëndruar në “përfitimet e efikasës” të cilat janë arritur vetëm duke u fokusuar në shkurtimet e pagave dhe numrit të stafit.

Opozita politike në një PPP është shpesh e keqkuptuar. Për shembull, specifikimet (numri i shtretërve në një spital) janë një problem për Autoritetin Publik për të vendosur se kur do të prokurohet kontrata e PPP, por kundërshtuesit e PPP-ve mund të pretendojnë se janë investitorët privatë ato të cilët e kanë vendosur atë. PPP-të mund ta kenë si disavantazh shkallën e lartë të transparencës së tyre. Kështu, kostoja e një PPP, duke përfshirë operimin në terma afatgjatë, mund të krahasohet gabimisht vetëm me koston fillestare kapitale të prokurimit të sektorit publik. Në mënyrë të ngjashme, transparenca më e madhe e PPP-ve do të thotë se gabimet janë më të dukshme.

Në anën tjetër, rasti i bërë nga një Autoritet Publik për një PPP mund të jetë i njëanshëm, me pretendimin për kursime të mëdha në kosto krahasuar me prokurimet e sektorit publik, të cilat nuk mund të provohen në mënyrë objektive, dhe PPP-të mund të jenë promovuar për avantazhe politike afatshkurtra.

Në këtë mënyrë, mund të jetë e vështirë të mbash një balancë të debatit pro dhe kundra një programi PPP-je, veçanërisht siç është bërë e qartë në këtë punim, sepse argumentat pro dhe kundra PPP-se, nuk janë domosdoshmërisht të bardha dhe të zeza.

Bibliografia

- Mathias Dewatripont dhe Patrick Legros (2005), "*Public-private partnership: contract design and risk transfer*" EIB papers, vol. 10, Numer 1, European Investment Bank, Luksemburg, faqe 120.
- Patrick Boeuf (2003), "*Public – privat partnerships for transport infrastructure projects*", paper at Transport Infrastructure Development for a wider Europe, European Union/UNECE/ European Investment Bank joint seminar.
- Darrin Grimsey dhe Mervyn K. Lewis, (2005) "*The Economics of Public Private Partnerships*", Edward Elgar, Cheltenham.
- Paul A. Groot, (2005) "*Value-for-money measurement in public-privat partnership*", EIB papers, vol. 10, Numer 2, European Investment Bank, Luksemburg, p. 32.
- Michael Klein, (1996) "*Risk Taxpaper and the role of government in Project Finance*", Policy research working paper 1688, Washington DC.
- James Leighland, (2006) "*Is the public sector comparator right for developing countries?*", Gridlines note N.4, Public-Privat Infrastructure Advisory Facility, Washington DC.
- Jarkko Murtaoro (2006) "*Public-Privat Partnership*", A study on the Economics and Financing of Technology Laboratory of Industrial Management, Espoo.
- Armin Riess, (2005) "Is the PPP model applicable across sectors?", EIB papers, Vol. 10, N.2, European Investment Bank, Luksemburg, p 10.
- Marco Sorge, (2004) "*The natyre of Credit Risk in Project Finance*", BIS Quarterly Review Bank for International Settlements, Basel, p. 91.
- Timo Väilä, (2005) "*How expensive are cost savings? On the economics of public-private partnerships*", EIB papers, vol. 10, N. 1 (European Investment Bank, Luxemburg 2005), p. 94.

Implementimi i Standardeve të Kontabilitetit në Analizën e Pasqyrave Financiare

Lirola Këri, Msc

Inspektore për SNK, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit

Prof. Dr. Flutura Kalemi

Universiteti Bujqësor i Tiranës

ABSTRAKT. *Analiza financiare është qëllimi final dhe kurorëzimi me sukses i ndërtimit të pasqyrave financiare. Implementimi i standardeve të kontabilitetit synon në paraqitjen e një informacioni të drejtë dhe të sigurtë për përdoruesit e jashtëm. Për vendimmarrësit interpretimi i rezultateve është jetik mbi frytshmërinë e investimeve të tyre. Analiza financiare bën të mundur leximin në mënyre shumë të kuptueshme të transaksioneve të ndodhura dhe parashikimin me besueshmëri të ngjarjeve të pritura në të ardhmen. Ky parashikim mund të bëhet jo vetëm për nivelin mikro, por edhe për nivelin makroekonomik. Sa kanë ndikuar standardet e reja në përmirësimin e cilësisë së analizës financiare? Sa e kanë lehtësuar interpretimin e treguesve financiarë? A kanë ndikuar standardet e reja në rritjen e përdorimit të analizës edhe në nivel makroekonomik? A janë të besueshme rezultate e analizës? Qëllimi i kësaj teme është tu japë përgjigje pyetjeve të mësipërme duke dashur të nxjerrë në pah efektivitetin ose jo të implementimit të standardeve të kontabilitetit.*

Fjalë kyçe: *Standarde të Kontabilitetit, Analizë e Pasqyrave Financiare, Makroekonomi*

Qëllimi i Analizës Financiare

Analiza financiare është një nga disiplinat e shkencës së financës e cila bazohet në pasqyrat e hartuara nga kontabiliteti financiar. Pasqyrat financiare janë një regjistrim i gjithë aktivitetit të një njësie, informacion relevant financiar i paraqitur në një mënyrë të strukturuar dhe i lehtë për tu kuptuar nga përdoruesit.

Qëllimi i analizës financiare është jo vetëm përcaktimi i normave të fitimit të kompanisë, por edhe parashikimi i pozicionit financiar për të ardhmen. Mund të ketë disa raporte specifike ose raporte të kombinuara me anë të të cilave mund të vëzhgohen prirjet dhe të parashikohet suksesi apo dështimi.

Sidomos në vitet e fundit pas krizave të njëpasnjëshme financiare, ka patur një shqetësim të përgjithshëm për saktësinë e pasqyrave financiare. Qëllimi është që ato të mos përmbajnë ndonjë informacion të pasaktë ose të gabuar apo të mos lënë jashtë fakte materiale të nevojshme për marrjen e vendimeve duke mos i lënë vendimmarrësit të marrin vendime të gabuara.

Me anë të këtyre raporteve krijohen modele të cilat i ndihmojnë drejtuesit për të ndërmarrë masa parandaluese. Të tilla modele mund të ndihmojnë edhe investitorët për të zgjedhur apo ndryshuar investimet e tyre. Bankat mund ta përdorin një model të tillë për të vendosur mbi kredidhënien dhe monitorimin e arkëtimeve. Në përgjithësi, të gjithë përdoruesit e informacionit kontabël duhet të përdorin modele të parashikimit financiar me anë të treguesve të analizës financiare për të përmirësuar dhe siguruar efektivitet maksimal në shpërndarjen dhe kontrollin e burimeve të financimit.

Megjithatë përdorues të ndryshëm mund të përdorin tregues të ndryshëm për të analizuar pozicionin financiar të njësisë. Analiza e prirjeve të pasqyrave financiare ndihmon në studimin e historikut të njësisë për qëllime krahasimi, nëse treguesit kanë rënë, janë përmirësuar apo kanë mbetur të njëjtë, duke zbuluar në këtë mënyrë problemet. Analiza me përmasa të njëjta e cila shpreh krahasimet me përqindje, përdoret kryesisht për krahasimin midis njësive me madhësi të ndryshme, dhe krahasimin në kushtet e periudhave inflacioniste. Treguesit me raporte përdoren për të vlerësuar përfitueshmërinë, efizienzën, qëndrueshmërinë dhe rritjen.

Implementimi i SNK dhe SKK

Vende të ndryshme kanë vendosur parimet e tyre kontabël duke e vështirësuar krahasimin ndërkombëtar midis njësive në vende të ndryshme. Për të lehtësuar krahasueshmërinë midis pasqyrave financiare të njësive të ndryshme, janë vendosur një komplet udhëzimesh dhe rregullash.

Këto vitet e fundit janë bërë ndryshime duke vendosur rregulla ndërkombëtare të kontabilitetit nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, i cili ka hartuar Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, rregulla të cilat janë adoptuar në Australi, Kanada dhe në Bashkimin Europian. Midis dy bordeve të raportimit financiar në Londër dhe në USA janë ndërmarrë angazhime për të konverguar SNK dhe GAAP në vitet në vijim.

Aktualisht në Shqipëri sipas Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, për të gjitha njësitë ekonomike, ka lindur detyrimi për raportimin financiar duke implementuar SNK dhe SKK qysh në 1 janar të vitit 2008, përkatësisht sipas degës së industrisë ku operojnë dhe potencialeve ekonomike që zotërojnë njësitë. Si për ironi të fatit, pavarësisht se titullohen standard, këto rregullime përcaktojnë se ka dy metoda vlerësimi, metoda standarde e lejuar dhe metoda alternative e sugjeruar.

Avantazhet e ndërtimit të raporteve financiare pas implementimit të SNK dhe SKK

Në vijim do të analizojmë lehtësinë që ofrojnë PF të ndërtuara sipas formatit të SKK dhe SNK, në krijimin e raporteve dhe interpretimin e tyre.

Përfitueshmëria

Norma e fitimit bruto = marzhi bruto nga shitjet / shitje

Sipas SKK dhe SNK, formati sipas natyrës i PASH, zëvendësimi i zërave do të ishte (1-3-4)/(1); në formatin sipas funksionit ky tregues është i shprehur direkt.

Kthimi nga shitjet = fitim neto / shitje

Pavarësisht nga formati i përdorur këta tregues gjenden lehtësisht si zëra të veçantë në PASH.

Kthimi nga aktivet = fitim neto / aktive totale

Ky raport kërkon vënien në raport të një treguesi të marrë nga PASH dhe tjetri nga BK.

Kthimi nga kapitali i vet = fitim neto / kapitalin aksioner

Si më sipër, por këtë herë kërkon vënien në raport ndaj një zëri të burimeve të financimit.

Eficensa

Qarkullimi i kapitalit = shitje / kapitalin aksioner

Zëri i parë i PASH, pavarësisht formatit të saj, në raport me një zë të anës së djathtë të bilancit.

Qarkullimi i aktiveve = shitje / aktive totale

Zëri i parë i PASH në raport me totalin e bilancit.

Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme = shitje / llogari të arkëtueshme

Zëri i parë i PASH në raport me një zë të aktiveve afatshkurtra

Qarkullimi i inventarit = kosto e mallrave të shitura / inventar

Sipas formatit të natyrës të PASH, vlera e KMSH merret nga zëri (4) i tij; ndërkohë që sipas formatit të funksionit kjo vlerë merret nga zëri (2); duke i vënë në raport për secilin rast me një nga zërat më kryesorë të aktiveve afatshkurtra.

Shitje për punonjës = Të ardhura nga shitja / numrin e punonjësve

Ky tregues është shumë i veçantë sepse tregon se sa të ardhura nga shitja gjeneron puna e secilit punonjës. Specifikë tjetër është se numri i punonjësve është një tregues sasior, jofinanciar, i cili nuk është i shprehur në PF. Ky tregues mund të gjendet vetëm tek shënimet shpjeguese, prandaj dhe kjo pasqyrë përbën një nga pikat kryesore të referimit për

përdoruesit e jashtëm të informacionit sepse përmban të dhëna lehtësisht të lexueshme.

Qëndrueshmëria

Raporti korrent = aktive afatshkurtra / detyrime afatshkurtra

Këto vlera gjenden lehtësisht në pasqyrën e BK.

Testi acid = (aktive afatshkurtra – inventar) / detyrime afatshkurtra

Raport i cili kërkon krahasimin e vlerave brenda përbrenda aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra.

Raporti i kapitalit të vet = kapitali aksioner / aktive totale

Krahasohen zëra të BK me totalin e tij.

Interesi neto nga shitjet = (shpenzime interesi – te ardhura nga interesi) / shitje

Secili prej këtyre zërave është i specifikuar në PASH, madje të ardhurat/shpenzimet neto të interesit, sipas parimit të kompesimit i cili lejon vetëm kompesim të disa zërave të ardhurave dhe shpenzimeve të PASH, është zë më vetë në këtë pasqyrë.

Rritja

Norma e rritjes së shitjeve = rritje në shitje / shitje

Norma e rritjes së fitimit = rritjen në fitim / fitim

Këto raporte kërkojnë përpunimin e vlerave të marra nga pasqyra e PASH për dy vite të njëpasnjëshme.

Për të informuar investitorët, shumë njësi i paraqesin pasqyrat e tyre financiare në publikime të përditshme duke i paraqitur edhe me grafikë dhe foto për të qenë më të kuptueshme për përdoruesit e informacionit kontabël.

Për më shumë se qindra vjet pasqyrat financiare janë hartuar në letër. Rritja dhe masivizimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit bëri të mundur hartimin e pasqyrave në format elektronik, format i cili bën të mundur shkëmbimin e informacionit duke i ndërtuar pasqyrat sipas një formati të lexueshëm elektronik.

Metoda të ndryshme kontabël

Përdorimi i metodave të ndryshme kontabël e bën të vështirë krahasimin e pasqyrave financiare midis njësive. Diferencat më të mëdha ndodhin në: vlerësimin e inventarit (metoda FIFO ose mesatare e ponderuar); amortizimi (linear, mbi vlerën e mbetur); kapitalizimi apo njohja si shpenzim periudhe të disa zërave të shpenzimeve; vlerësimi në investimet në aksione (me kosto apo vlerën e tregut); përkufizimi i operacioneve jo të vijueshme. Emri i mirë është një tjetër aktiv i cili është i vështirë që të vlerësohet.

Secili prej këtyre treguesve ka efekt në më shumë se një raport. Konkretisht, metoda e vlerësimit të inventarit ndikon tek raportet e perfitueshmërisë, kthimi nga aktivet; te efikasësinë, qarkullimi i inventarëve; dhe raportet e qëndrueshmërisë. Metoda e amortizimit të aktiveve ndikon në raportet e kthimit nga aktivet, qarkullimin e

aktiveve, raportet e borxhit dhe të gjitha raportet e tjera në të cilat bën pjesë zëri i aktiveve afatgjata. Në të njëjtat raporte ndikon edhe vlerësimi dhe rivlerësimi i emrit të mirë, kapitalizimi ose jo i shpenzimeve. Mënyra e vlerësimit të aksioneve ka një efekt shumë të madh në treguesit financiarë sepse edhe vetë qëllimi i njësishë është maksimizimi i vlerës së aksionerëve.

Edhe pse pasqyrat financiare sigurojnë informacion të nevojshëm për vendimmarrësit, ka shumë informacion të cilin ato nuk e përfshijnë të tillë si, kushtet e tregut, zhvillimi i teknologjisë, burimet njerëzore, tarifat, regullatorët shtetërorë, konkurentët, efektet natyrore etj., mund të kenë një efekt të rëndësishëm në prespektivën e njësishë.

Ky informacion, edhe pse nuk përfshihet në raportet financiare, bën dallimin nga një kompani në tjetrën. Mund të ndodhë që njësitet të kenë raporte financiare të njëjta, por informacionin jofinanciar ta kenë të ndryshëm. Në këto kushte kanë dallime që nuk i zbulon analiza financiare. Anasjelltas, njësitet mund të kenë raporte të ndryshme por të njëjtat kushte, dhe të keqinformohen përdoruesit e informacionit financiar.

Përfundime dhe Rekomandime

Implementimi i SNK dhe SKK lehtëson ndjeshëm ndërtimin e raporteve dhe interpretimin e tyre duke e bërë më tërheqëse përdorimin e analizës financiare. Duke qenë se për vlerat e marra mund të përdoren metoda të ndryshme vlerësimi, këto raporte nuk mund të jenë më standarde. Analistët financiarë duhet jo vetëm të ndërtojnë raporte dhe të bëjnë analiza krahasuese, por pas implementimit të standardeve të kontabilitetit duhet të shtojnë dhe të këmbëngulin më shumë në interpretimin e tyre. Puna lehtësuese në gjetjen e vlerave duhet të kompletohet me metoda shtesë dhe më të lexueshme të rezultateve.

Jo rastësisht, zbatimi i SNK dhe SKK kërkon detyrimisht edhe hartimin e pasqyrës së shënimeve shpjeguese, duke parë se sa i rëndësishëm është ky informacion në marrjen e vendimeve, do të ishte shumë mirë që tregues të kësaj pasqyre të përfshihen në ndërtimin e raporteve financiare. Përdorimi në nivelin e duhur të analizës financiare jo vetëm për qëllime të vetë njësi, por edhe për qëllime makroekonomike, i rrit akoma më shumë vlerën implementimit të SNK dhe SKK. Standardet e reja të kontabiliteti përmirësojnë efikasitetin e analizës financiare, kurse analiza e saktë dhe e plotë do të rritë efektivitetin e tyre.

Disa teknologji moderne për implementimin e një aplikimi në web

____ Prof. Asoc. Dr. Tamara Luarasi (UET) ____

Abstrakt. Qëllimi i këtij artikulli është të paraqesë një material të plotë në pak faqe që paraqet në detaje përdorimin e disa teknologjive moderne së bashku për realizimin e një aplikimi në Web, siç janë përdorimi i një software-i ku zhvillohet aplikimi, në rastin tonë është Eclipse, përdorimi i një serveri që menaxhon elementin kërkesë-përgjigje nëpërmjet një browser-i në një servlet, që në rastin tonë është Apache Tomcat, të një software-i që ndihmon në konfigurimin e një aplikimi në Web, që në rastin tonë është Maven, përdorimi teknologjisë Hibernate që realizon lehtësimin e punës së programuesit për sa i përket lidhjes dhe komunikimit me një bazë të dhënash, përdorimi i një sistemi menaxhimi të një baze të dhënash, në rastin tonë është SQL Serveri. Aplikimi realizon futjen dhe modifikimin e informacionit në një Bazë të Dhënash nëpërmjet Web-it. Gjuha e përdorur është Java dhe teknologjia e komunikimit nëpërmjet Web-it janë Servlet-et.

Fjalëkyçe: Aplikim, Eclipse, Maven, Hibernate, Servlet.

Hyrje

Për të realizuar një aplikim në Web janë disa software që duhet të sigurohen. Së pari duhet të ngarkohet një software që luan rolin e një server-i, që interpreton elementin kërkesë-përgjigje në një servlet, duhet të ngarkohet gjuha e programimit në të cilën do të zhvillohet aplikimi, në rastin tonë gjuha Java. Por që të bëhet interpretimi i kodit Java, serveri Tomcat kërkon një konfigurim specifik të direktorive të punës, pra të direktorive ku vendosen kodet të kthiera në objekte pas përkthimit të tyre si dhe file të ndryshme .html dhe .xml që janë pjesë e aplikimit. Për ata që nuk kanë eksperiencë në aplikimet në Web si dhe për qëllim mësimdhënje, sygjerohet të përdoret Eclipse që është një software shumë komod dhe i plotë për

këtë qëllim si dhe për realizimin e përkthimeve të programeve në Java dhe lidhjen e elementëve të një aplikimi (me fjalë të tjera ndërtimin e një projekti). Konfigurimi i përmëndur realizohet automatikisht nga Eclipse kur krijohet një projekt Web-i në Java. Komponentët e zakonshëm të një aplikimi Java në Web do të ishin disa klasa në Java, servlet-e, file JSP, file .html dhe file .xml. Në servlet ne realizojmë marrjen e vlerave (parametrave) nga një kërkesë dhe i përcjellim këto vlera në një klasë Java ose në një bean. Në një klasë të tillë bëhet komunikimi me një bazë të dhënash ku këto vlera regjistrohen ose modifikojnë vlerat ekzistuese. I mbetet pra klasës Java të realizojë komunikimin me bazën e të dhënave dhe ky komunikim realizohet në mënyrë të veçantë për çdo lloj veprimi që bëjmë me bazën e të dhënave, regjistrim, modifikim, fshirje. Kuptohet përsëritja disa herë e rreshtave të kodit Java në një klasë të tillë rrit numrin e rreshtave të kodit. Ekzistojnë sot teknologji të reja që eliminojnë këtë përsëritje. Hibernate është një teknologji e tillë. Në bazën e saj qëndrojnë dy file .xml. Nëpërmjet njërit prej tyre realizohet lidhja me bazën e të dhënave dhe në nëpërmjet tjetrit bëhet korrespondenca midis të dhënave të klasave dhe fushave të tabelave të bazës së të dhënave. Në këtë mënyrë në programim mjaftohemi vetëm me krijimin e një objekti korrespondues të një table dhe pasurimin e të dhënave të tij me vlera dhe automatikisht realizohet futja e këtyre të dhënave në bazën e të dhënave.

Por përdorimi i Hibernate kërkon një konfigurim specifik të aplikimit, që ka të bëjë me direktoritë e punës, si dhe file-t .jar që duhet të përfshihen në classpath-in e një projekti. Nëse nuk kemi një experience të mëparshme të këtij konfigurimi, programisti mund të ndeshë në vështirësi që kanë të bëjnë me versione të ndryshme të elementëve të përfshira në projekt dhe kombinimin e tyre. Për zgjidhjen e këtij momenti na ndihmon Software-i Maven. Maven duhet të ngarkohet dhe të përfshihet në Eclipse. Ky software ofron konfigurime për tipe të ndryshme projektesh duke krijuar strukturat e përshtatëshme të direktorive të punës. Në listën e projekteve përfshihen projektet që përdorin Hibernate. Ne mund të bëjmë kombinime konfigurimesh për aplikime në Web dhe aplikime që përdorin Hibernate. Së fundi sistemi SQL Server është përdorur si sistem menaxhimi bazash të dhënash. Kombinimi i gjithë këtyre elementëve është implementuar në materialin e mëposhtëm duke i dhënë lexuesit një metodologji të plotë pune që përdorin gjithë teknologjitë e sipërpërmëndura.

Teknologjia Maven (<http://maven.apache.org/>)

Maven është një software që ndihmon në konfigurimin dhe menaxhimin e një projekti. Bazohet në konceptin e një modeli objekt të një projekti (project object model (POM)), ku sigurohen të gjitha konfigurimet për një projekt të vetëm. Konfigurimi bëhet duke u bazuar në një file të quajtur pom.xml ku konkretisht vendosen të gjitha elementët që i duhen një projekti për të funksionuar. Elementët kryesorë të POM janë repozitorët (lokalë apo në distancë) që janë koleksione artifac-tesh të ndryshëm dhe dependencat që përcaktojnë artifact-et e nevojshëm për projektin.

(http://maven.apache.org/pom.html#Plugin_Repositories).

Për shembull:

```
<repositories>
<repository>
<id>JBoss repository</id>
<url>http://repository.jboss.org/nexus/content/groups/public/</url>
</repository>
</repositories>
```

përfaqëson përdorimin e një repozitori në distancë në file-in e konfigurimit pom.xml që është një nga file-t e konfigurimit të këtij software. Në këtë mënyrë Maven eviton referencat e sistemit. Në rastin ku nuk përdorim tagun <repository> do të thotë se përdoren repozitorët lokale, si në rastin e shembullit të këtij aplikimi.

Ndërsa

```
<dependencies>
<dependency>
<groupId>junit</groupId>
<artifactId>junit</artifactId>
<version>3.8.1</version>
<scope>test</scope>
</dependency>
</dependencies>
```

paraqet si mund të përfshihet në projekt artifact-i me identifikatorin junit dhe me versionin përkatës që ndodhet në URL e repository-it JBoss repository në projekt.

Për nga qëllimi i tij Maven krahasohet me Ant, por avantazhi i tij, e veçanërisht i përdorur në kuadrin e Eclipse-it është automatizimi i procesit të konfigurimit të projekteve të tipeve të ndryshme duke pasur mundësinë e zgjedhjes së këtij tipi dhe plotësimit të konfigurimit të tij në mënyrë shumë komode.

Së pari Maven duhet të ngarkohet dhe instalohet. Më poshtë jepen disa detaje të këtij procesi në sistemin Windows. Për të ngarkuar këtë software mund të përdorni adresën <http://maven.apache.org/download.html>. për momentin (gusht 2011) version i fundit i Maven mban numrin 3.0.3 dhe konsiderohet i liçenzës [Apache License 2.0](#). Duhet të zgjidhet formati .zip për sistemin Windows.

Instalimi i Maven në Microsoft Windows

Në këtë material kemi supozuar se instalimi i Maven në Windows bëhet nën direktorinë C:\Program Files\apache maven-3.0.3, por nuk do të kishte ndonjë ndryshim nëse instalimi do të bëhej në një direktori tjetër nëse do të bëhej një konfigurim i variablave të ambientit (environment variables). Sapo paketa e Maven të

jetë instaluar është e nevojshme të përcaktohen variablat —PATH dhe M2_HOME. Këto dy variabla mund të konfigurohen nga Control Panel

M2_HOME → C:\Program Files\apache-maven-3.0.3

PATH → %PATH%;%M2_HOME%\bin

(http://en.wikipedia.org/wiki/Apache_Maven#Project_Object_Model)

Për ta përfshirë Maven si një komponent të Eclipse-it ka disa mënyra. Manualisht kjo gjë realizohet me komandën:

mvn -Declipse.workspace=<path-i i ambientit të punës së Eclipse-it> eclipse: add-maven-repo

Kjo komandë bën që Eclipse të njohë repozitorin lokal të Maven nëpërmjet variablit classpath M2_REPO. E njëjta gjë mund të bëhet manualisht nga Eclipse me vargun e komandave:

nga menu bar, selekton Window > Preferences, zgjidhniJava > Build Path > faqja Classpath Variables

Pasi Maven të jetë bërë një komponent i Eclipse, çdo projekt në Eclipse mund ta realizojmë në kuadrin e një projekti Maven. Një projekt Maven është i shoqëruar në procesin e krijimit të tij me një listë tipesh projektesh “archetype”. Ju mund të zgjidhni një nga tipet dhe ambienti i punës përkatës krijohet automatikisht.

Përdorimi i software Maven krijon automatikisht një ambient pune që i përgjigjet kërkesave të një projekti: le të shohim disa nivele projekti dhe ambientet e punës që Maven krijon për secilin prej tyre:

1. Një projekt i thjeshtë Java:
2. Një projekt Java që përdor teknologjinë hibernate
3. Një projekt Java që përdor Web-in si një interface
4. Një projekt Java që përdor Web-in si ndërfaqës dhe teknologjinë hibernate

Një projekt i thjeshtë Java i krijuar manualisht nga niveli komandë

Për rastin e një projekti të thjeshtë Java le të punojmë manualisht për ta krijuar atë në kuadrin e një projekti Maven dhe më pas e përfshijmë në Eclipse.

Kalojmë në një direktori, në rastin tonë c:\eclipse\projekte ku mendojmë të krijojmë projekte të tipeve të ndryshëm duke përdorur Maven. Japim komandat e mëposhtme në nivel komande:

**mvn archetype:generate -DgroupId=maven.simpleJava
-DartifactId=simpleJava -Dpackage=maven -Dversion=1.0**

-SNAPSHOT

krijohet në këtë mënyrë një projekt Java që mundet lehtësisht të importohet në Eclipse. Për këtë duhet se pari të futet një variabël në hapësirën e punës në Eclipse; për këtë duhet të shkojnë në hapësirën e punës që në rastint tonë është simpleJava dhe të shkruajmë komandën e mësipërme.

mvn -Declipse.workspace=simpleJava eclipse:add-maven-repo

E më pas komandën:

mvn eclipse:eclipse

që bën të mundur importimin e këtij projekti në Eclipse.

Importimi bëhet në Eclipse duke zbatuar vargun e komandave nga menu-të e Eclipse-it

File > Import > Existing Projects into Workspace dhe zgjedhim projektin tashme të ndërtuar

Krijimi i një pakete .jar nga projekti dhe kthimi i tij në një artifact të vendosur në directorinë target bëhet me komandën:

mvn package

kjo komandë kompilon, gjithë filet Java, ekzekuton çdo test, dhe krijon paketën që livrohet .jar si në Figurën 1.

Struktura e krijuar
simpleJava/ pom.xml src/ src/main/java/ maven src/test/java/ maven
pom.xml
<pre><project xmlns="http://maven.apache.org/POM/4.0.0" xmlns:xsi="http://www.w3.org/2001/XMLSchema-instance" xsi:schemaLocation="http://maven.apache.org/POM/4.0.0 http://maven.apache.org/xsd/maven-4.0.0.xsd"> <modelVersion>4.0.0</modelVersion> <groupId>maven.simple</groupId> <artifactId>simple</artifactId> <version>1.0-SNAPSHOT</version> <packaging>jar</packaging> <name>simple</name> <url>http://maven.apache.org</url> <properties> <project.build.sourceEncoding>UTF- 8</project.build.sourceEncoding> </properties> <dependencies> <dependency> <groupId>junit</groupId> <artifactId>junit</artifactId> <version>3.8.1</version> <scope>test</scope> </dependency> </dependencies> </project></pre>

Figura 1 Struktura dhe file-i pom.xml të krijuara nga krijimi i një projekti Java

Disa detaje të file-it të konfigurimit të Maven settings.xml, pom.xml

Ka dy elementë në konfigurimin e Maven: settings.xml dhe pom.xml. Bashkë me instalimin e programit file-i settings.xml krijohet në direktorinë \conf dhe përfaqëson disa konfigurime bazë që parashikon Maven për çdo projekt. Në se përdoruesi do të donte ta personalizonte këtë file, këshillohet të bëhet një kopje e këtij file-i në direktorinë user\m2 dhe atje mund të shtohen konfigurime të tjera.

File-i tjetër i konfigurimit pom.xml shoqëron çdo projekt. Ekziston një file i quajtur super pom.xml që ka vlera implicite për gjithë projektet dhe çdo file pom.xml që i takon çdo projekti dhe që s'është gjë tjetër por një shtrirje e këtij file-i që specifikon një projekt konkret. Disa element të file-it pom.xml janë:

```
<modelVersion>4.0.0</modelVersion>
```

Përcakton versionin e modelit që është gjithmonë 4.0.0 për Maven 3.x.x

```
<groupId>maven.simple </groupId>
```

Përcakton emrin e grupit të vlerave që identifikon një projekt:emri i projektit.

```
<artifactId>simple</artifactId>
```

Ky element paraqet emrin unik të artifact-it të pare të gjeneruar nga ky projekt. Artifact-et dytësore si paketat burime e përdorin këtë emër si pjesë të emrit të tyre.

```
<version>1.0-SNAPSHOT</version>
```

```
<packaging>jar</packaging>
```

Një artifact tipik i prodhuar nga do të kishte formën <artifactId>-<version>.<extension> (për shembull example, myapp-1.0.jar).

```
<name>simple</name>
```

Emri që afishohet i projektit

```
<url>http://maven.apache.org</url>
```

Site-i i projektit ku gjëndet dokumentacioni i maven

```
<dependencies>
```

```
<dependency>
```

```
<groupId>junit</groupId>
```

```
<artifactId>junit</artifactId>
```

```
<version>3.8.1</version>
```

```
<scope>test</scope>
```

```
</dependency>
```

```
</dependencies>
```

Koordinatat e librarisë së kërkuar: ne këtë rast ky artifact junit i librarisë junit përdoret për të kompiluar dhe ekzekutuar testet

Një projekt Java në Web i krijuar automatikisht nga Eclipse

Ndiqet kjo rradhë veprimesh duke përdorur menutë e Eclipse-it:

File>new>Maven Project >next

Zgjidhet archetype që përcakton llojin e projektit :

Maven- archetype-webapp

>next

Plotësohen disa informacione:

GroupID

artifactID

Version

Package

>next

dhe në këtë mënyrë krijohet një projekt i ri me strukturën si në Figurën 2

Struktura e krijuar




Figura 2 Struktura e një projekti Java në Web

Krijohet një folder i ri Java nën main() ku vendosen servletet. Në këtë folder kemi vendosur servletin me emrin HelloWorldServlet.java.

Klikohet djathtas në projekt >maven>update configuration

File-i pom.xml plotësohet si në Figurën 3:

```

<project xmlns="http://maven.apache.org/POM/4.0.0"
xmlns:xsi="http://www.w3.org/2001/XMLSchema-instance"
xsi:schemaLocation="http://maven.apache.org/POM/4.0.0 http://maven.apache.org/maven-
v4_0_0.xsd">
  <modelVersion>4.0.0</modelVersion>
  <groupId>MavenWeb</groupId>
  <artifactId>MavenWeb</artifactId>
  <packaging>war</packaging>
  <version>0.0.1-SNAPSHOT</version>
  <name>MavenWeb Maven Webapp</name>
  <url>http://maven.apache.org</url>
  <dependencies>
    <dependency>
      <groupId>junit</groupId>
      <artifactId>junit</artifactId>
      <version>3.8.1</version>
      <scope>test</scope>
    </dependency>
    <dependency>
      <groupId>javax.servlet</groupId>
      <artifactId>servlet-api</artifactId>
      <version>2.5</version>
    </dependency>
  </dependencies>
  <build>
    <plugins>
      <plugin>
        <artifactId>maven-compiler-plugin</artifactId>
        <configuration>
          <source>1.6</source>
          <target>1.6</target>
        </configuration>
      </plugin>
      <plugin>
        <artifactId>maven-war-plugin</artifactId>
        <version>2.0</version>
      </plugin>
    </plugins>
  </build>

```

Figura 3 File pom.xml në një projekt Java në Web

File-i web.xml plotësohet si në Figurën 4:

```
<!DOCTYPE web-app PUBLIC
"-//Sun Microsystems, Inc.//DTD Web Application 2.3//EN"
"http://java.sun.com/dtd/web-app_2_3.dtd" >

<web-app>
<display-name>HelloWorldServlet</display-name>

    <servlet>
        <servlet-name>HelloWorldServlet</servlet-name>
        <servlet-class>
            maven.HelloWorldServlet
        </servlet-class>
        <load-on-startup>1</load-on-startup>
    </servlet>
    <servlet-mapping>
        <servlet-name>HelloWorldServlet</servlet-name>
        <url-pattern>/hello-world</url-pattern>
    </servlet-mapping>

</web-app>
```

Figura 4 File web.xml në një projekt Java në Web

Ekzekutohet servlet-i në serverin Tomcat.

Një projekt Java që përdor teknologjinë hibernate

Object Relational Mapping(ORM) është një realizim (persistence) automatik (dhe transparent) i objekteve në aplikimet Java në tabelat e bazave relacionale duke përdorur informacionin metadata për të përshkruar korrespondencën midis objekteve dhe bazës së të dhënave (Christian Bauer Gavin King Java Persistence with Hibernate)

Hibernate është një librari në Java që lehtëson rezervimin dhe gjetjen e objekteve të një modeli Java nëpërmjet ORM. Përdorimi i Hibernate shoqërohet me një file-i xml që pasqyron korrespondencën midis një table të bazës së të dhënave dhe një dhënave të një klase që në fakt është një bean.

Para së gjithash duhet të ngarkojmë librarinë Hibernate dhe të bëjmë konfigurimet përkatëse (<http://www.hibernate.org/>).

Një projekt Java në Web që përdor hibernate në Eclipse

Le të shohim si mund të integrojmë Maven3, Hibernate3.6 and SQL Server 2008 së bashku. Së fundi do të fusim recorde në një bazë të dhënash SQL Server-i nëpërmjet një kuadri Hibernate.

Pra teknologjitë e përdorura janë :

1. Maven 3.0.3
2. JDK 1.6.0_15
3. Hibernate 3.6.3.final
4. SQL Server 2008 R2

Ndjekim hapat e mëposhtme:

1. Krijojmë një tabelë CONTACT në SQL Server. Në se punojmë me një script do të kishim

```
CREATE TABLE [dbo].[CONTACT](  
    [ID] [int] NOT NULL,  
    [FIRSTNAME] [varchar](50) NULL,  
    [LASTNAME] [varchar](50) NULL,  
    [EMAIL] [varchar](150) NULL  
)
```

2. Krijojmë një projekt Maven. Në direktorinë ku duam ta krijojmë projektin përdorim komadën:

```
mvn archetype:generate -DgroupId=com.mkyong  
-DartifactId=HibernateExample  
-DarchetypeArtifactId=maven-archetype-quickstart -DinteractiveMode=false
```

3. Kalojmë Maven në Eclipse:

mvn eclipse:eclipse

Në Eclipse do të kemi plotësojmë strukturën e mëposhtme, Figura 5:




Figura 5 Struktura e një projekti Java që përdor Hibernate

, ku myhibernate është një paketë (package) e krijuar nga ne, App.java është një klasë që ka metodën main () brenda saj, Contact.java është një bean. Më poshtë do të shohim përmbajtjen e te gjithë faile-ve të nevojshëm për këtë projekt:

4. Shtojmë dependency-at e Hibernate dhe SQL Serverit. Modifikojmë file-in pom.xml file, dhe shtojmë të gjitha dependency-at përkatëse
 1. Së pari duhet të deklarojmë “JBoss repository” për librarinë e jar të Hibernate të fundit dhe dependancy-at e tij.
 2. Për sa i përket driver-it të SQL Serverit, duhet ta instalojmë atë në repozitorin lokal të Maven manualisht.

Atëhere file-i pom.xml ka pamjen si në Figurën 6:

```
<project xmlns=http://maven.apache.org/POM/4.0.0
xmlns:xsi="http://www.w3.org/2001/XMLSchema-instance"
xsi:schemaLocation="http://maven.apache.org/POM/4.0.0
http://maven.apache.org/xsd/maven-4.0.0.xsd">
  <modelVersion>4.0.0</modelVersion>

  <groupId>myhibernate</groupId>
  <artifactId>my-hibernate</artifactId>
  <version>1.0-SNAPSHOT</version>
  <packaging>jar</packaging>

  <name>my-hibernate</name>
  <url>http://maven.apache.org</url>

  <properties>
    <project.build.sourceEncoding>UTF-8</project.build.sourceEncoding>
  </properties>

  <repositories>
    <repository>
      <id>JBoss repository</id>
      <url>http://repository.jboss.org/nexus/content/groups/public</url>
    </repository>
  </repositories>

  <dependencies>

    <!--repository JBoss per Hibernate -->
    <dependency>
      <groupId>junit</groupId>
      <artifactId>junit</artifactId>
      <version>4.8.2</version>
      <scope>test</scope>
    </dependency>

    <!--driver SQL Server JDBC , duhet ta instaloni vete -->
    <dependency>
      <groupId>microsoft</groupId>
      <artifactId>sqljdbc</artifactId>
      <version>2.0</version>
    </dependency>

    <dependency>
      <groupId>org.hibernate</groupId>
      <artifactId>hibernate-core</artifactId>
      <version>3.6.6.Final</version>
    </dependency>

    <dependency>
      <groupId>javassist</groupId>
      <artifactId>javassist</artifactId>
```

Figura 6 File-i pom.xml i një projekti Java që përdor Hibernate

5. Krijohet bashkësia e klasave Java që përbëjnë Modelin, në rasti tone kemi vetëm një klasë, klasa Contact, Figura 7. Kjo klasë I korrespondon tabelës “CONTACT”. Të bazës së të dhënave, E vendosim këtë klasë në paketën myhibernate.user.

```
Package myhibernate.user;
import java.util.Date;

public class Contact implements java.io.Serializable {
    private String firstName;
    private String lastName;
    private String email;
    private long id;
    public String getEmail() {
        return email;
    }
    public String getFirstName() {
        return firstName;
    }
    public String getLastName() {
        return lastName;
    }
    public void setEmail(String string) {
        email = string;
    }
    public void setFirstName(String string) {
        firstName = string;
    }
    public void setLastName(String string) {
        lastName = string;
    }
    public long getId() {
        return id;
    }
    public void setId(long l) {
        id = l;
    }
}
```

Figura 7 Klasa Contact që luan rolin e një bean

6. File-i Contact.hbm.xml që bën korespondencën i vendosur në resources/user, Figura 8.

```
<?xml version="1.0" encoding="UTF-8"?>
<!DOCTYPE hibernate-mapping PUBLIC
"-//Hibernate/Hibernate Mapping DTD 3.0//EN"
"http://hibernate.sourceforge.net/hibernate-mapping-3.0.dtd">

<hibernate-mapping>
<class name="myhibernate.user.Contact" table="CONTACT">
<id name="id" type="long" column="ID">
<generator class="increment"/>
</id>

<property name="firstName">
<column name="FIRSTNAME" />
</property>
<property name="lastName">
<column name="LASTNAME"/>
</property>
<property name="email">
<column name="EMAIL"/>
</property>
</class>
</hibernate-mapping>
```

Figura 8 File-i **Contact.hbm.xml** që bën korespondencën

7. Ndërtojme file-in e konfigurimit të Hibernate hibernate.cfg.xml që vendoset në myhibernate nën resources dhe që realizon lidhjen me bazën e të dhënave dhe me file-n e korespondencës, Figura 9.

```
<?xml version="1.0" encoding="UTF-8"?>
<!DOCTYPE hibernate-configuration PUBLIC
"-//Hibernate/Hibernate Configuration DTD 3.0//EN"
"http://hibernate.sourceforge.net/hibernate-configuration-3.0.dtd">
<hibernate-configuration>
<session-factory>
<property
name="hibernate.connection.driver_class">com.microsoft.sqlserver.jdbc.SQLSe
rverDriver
</property>
<property
name="hibernate.connection.url">jdbc:sqlserver://localhost:1433;databaseName
=test
</property>

<property name="hibernate.connection.username">sa</property>
<property name="hibernate.connection.password">kenti1</property>
<property
name="hibernate.dialect">org.hibernate.dialect.SQLServerDialect</property>
<property name="hibernate.default_schema">dbo</property>
<property name="show_sql">>true</property>
<mapping resource="myhibernate/user/Contact.hbm.xml"></mapping>
</session-factory>
</hibernate-configuration>
```

Figura 9 File-i hibernate.cfg.xml i konfigurimit të Hibernate

8. Një klasë utilitare e Hibernate (Hibernate Utility). Mënyra e inicializimit të Hibernate është ndërtimi i një objekti SessionFactory nga objekti Configuration, Figura 10.

```
package myhibernate.util;

import org.hibernate.SessionFactory;
import org.hibernate.cfg.Configuration;

public class HibernateUtil {

    private static final SessionFactory sessionFactory =
        buildSessionFactory();

    private static SessionFactory buildSessionFactory() {
        try {
            // krijohet një objektSessionFactory from
            // hibernate.cfg.xml
            return new
                Configuration().configure().buildSessionFactory();
        } catch (Throwable ex) {
            // menaxhohen rastet e gabimeve
            System.err.println("Krijimi i SessionFactory
                deshton." + ex);
            throw new ExceptionInInitializerError(ex);
        }
    }

    public static SessionFactory getSessionFactory() {
        return sessionFactory;
    }

    public static void shutdown() {
        // Close caches and connection pools
        getSessionFactory().close();
    }

}
```

Figura 10 Klasa utilitare HibernateUtil

Kur thirret **new** Configuration(), Hibernate kërkon për një file të quajtur hibernate.properties në rrënjën e classpath dhe të gjitha vetitë hibernate.* ngarkohen dhe i shtohen objektit Configuration. Kur thirret configuration(), Hibernate kërkon për një file të quajtur hibernate.cfg.xml në rrënjën e classpath-it ku dhe figuron emri i skedarit të correspondences Contact.hbm.xml.

9. Kodi i klasës që ka metodën main(), Figura 11.

Modifikohet "App.java", për kodin e Hibernate që shton një rekord në tabelën "CONTACT".

```

package myhibernate;

import myhibernate.user.Contact;
import myhibernate.util.HibernateUtil;

import org.hibernate.Session;

public class App {
    public static void main(String[] args) {
        System.out.println("Maven + Hibernate + SQL Server");
        Session session = HibernateUtil.getSessionFactory().openSession();
        System.out.println("session");
        session.beginTransaction();
        Contact contact = new Contact();
        contact.setId(3);
        contact.setFirstName("aaa");
        contact.setLastName("aaa");
        contact.setEmail("aaaaa@yahoo.com");
        session.save(contact);
        System.out.println("Done");

        session.save(contact);
        session.getTransaction().commit();
    }
}

```

Figura 11 Klasa me funksionin main()

10. Ekzekutohet “App.java“, dhe ka një pamje të tillë në konsolën e Eclipse-it, Figura 12.




Figura 12 Ekrani gjatë ekzekutimit të projektit

Literatura

1. <http://maven.apache.org/>)
2. http://en.wikipedia.org/wiki/Apache_Maven#Project_Object_Model
3. http://maven.apache.org/pom.html#Plugin_Repositories
4. <http://maven.apache.org/download.html>
5. <http://www.sonatype.com/books/mvnref-book/reference/installation.html>
Christian Bauer Gavin King Java Persistence with Hibernate 2007
6. <http://www.hibernate.org/>

Higher education financing: development _____
between public and private sector _____

Engjell Pere- Luljeta Minxhozi

ABSTRACT. In the new theories of economic growth increasing educational and professional level is at the core being a fundamental element which characterizes the human capital. On the other hand, social development in many countries has changed the social structure of society, increasing significantly the demand for education. In this regard, reforms in higher education for several years represent a phenomenon which perhaps characterizes the most social and economic development in many countries.

Problems that have faced and face this development include a wide range of highly controversial aspects and also they affect very important issues quantitatively and qualitatively. This paper is not intended to address the totality of these aspects. Its perspective is mainly related to economic and financial issues that characterizes today the development of higher education. This aspect, though not often treated in public discussions, in fact associates all the changes observed in this area, if not in some cases, it is at the core of these changes. More widely the problem can be viewed as a trend of transforming the public sector itself, going so in the debate of the controversial partnership between this sector and the private sector.

In this perspective the paper aims: first, to treat the whole content of the reform of higher education funding, putting the spotlight on the relationship between the development of public and private education, secondly, the paper treats the case of controversial reform in Albania on the way of financing higher education, which is thought to mark a radical change in the development of education in this country. The main idea of the paper is to treat and argue, both theoretically and practically, that the development of higher education today makes it necessary to harmonize the development of public education with that of private funding in this area.

Bonds of trading companies: A new form of _____ business financing in Albania _____

Elvin Meka

ABSTRACT. Despite the indirect shock, the Albanian economy, business and banking system experienced, in the course of global financial and economic crisis of 2008, it clearly unfurled the phenomenon of cartel-like financing, provided by banking system to the economy and Albanian companies. This source of financing, derived from an oversized and entirely bank –based economy, transmits and discharges all the problems accompanying the activity of the banking system, towards companies as borrowers, especially in times of economic contraction or crisis, in the form of tightened lending terms & conditions and lacking cost-effective and competitive financing terms.

This paper aims to shed light on, and propose the issuance of corporate bonds, as a still-absent, but efficient & competitive alternative source of financing, for medium and large-sized enterprises in Albania, as compared to bank financing. Some theoretical and practical advantages, regarding corporate bonds' issuance, are also listed in the paper, which could be easily energized and implemented by Albanian companies, in the frame of the existing legal environment in Albania.

Enforcement and education on _____ intellectual property rights _____

Kreshnik Bello - Edmond Bello

ABSTRACT. One of the most discussed issues in the field of intellectual property is the enforcement of intellectual property rights and the education not to infringe these rights. Today technological progress is so high that the issues dealing with the infringement of the intellectual property rights are a priority to many international organizations and different countries as well.

Today in the digital era, when computer technology is reaching the farthest imagination, intellectual property rights are increasingly becoming vulnerable. From this point of view, it is important that these rights get enforced, in order to have encouragement of human mind and creativity, and therefore reward of works created. At this point, in order to benefit and make progress, the education of whole society

plays an important role. In this context the purpose of this paper is to discuss issues that concern protection and education of intellectual property.

Decentralization of power, progress and enlargement — of local government authonomy in Albania —————

Migena Leskoviku

ABSTRACT. In democratic societies, local government remains a major pillar of the functioning of political and social system of the country. After the collapse of communist regime, in the early 90's Albania entered the path of political pluralism as the basis of a free and democratic society. The functioning of local government after free and democratic elections in general was associated with problems, because local governments did not possess sufficient competence and resources to perform its functions. Often local governments were unable to local public investment and financial system was fully centralized. In general, local government units were weak from the economic point of view and the possibility to generate their own resources was almost minimal.

The real reform of decentralization started in 1999, consensually accepted by all the relevant stakeholders and implemented with the assistance of international community. Decentralization is the process of dispersing decision-making governance closer to the people and/or citizens. Decentralization stands for the transfer of authority and responsibility for public functions from the central government to subordinate or quasi-independent government organizations and/or the private sector. It is a complex and multifaceted concept and principle stipulated also in the Constitution of Republic of Albania and one of the core elements of the local government reform. The process of implementing changes in administrative-territorial division of local government units is one of the mechanisms to be used in the reform process with regard to improving the role of local government organs, to be able to better respond by fulfilling their functions to be transferred to them during different phases of the decentralization process.

A distinct place in this reform regards the fiscal decentralization, which is developed in accordance with basic principles of European Charter of Local Autonomy, creating a suitable ground for the consolidation of local finance as schemes, increasing the fiscal autonomy and local finance. However in terms of consolidation of local government one should first say that the level of local government units (municipalities and communes) have been and remain the most consolidated in relation to the second level

(regional councils) which have not yet been completed so clearly with the functions and role that will play at the regional level. However, this is an ongoing reform which requires also the opinion of the community at local government level in order to be efficient and successful.

“The major depression” of liberal capitalism _____ *1929–33: A retrospective analysis _____*

Adrian Civici

ABSTRACT. The crisis of 1929 is the first major shock of capitalism and covers the period from October 1929 until the beginning of World War II. It was a typical Stock Exchange crisis that erupted in the Stock Exchange of New-York between 24 to 29 October 1929 and gradually, over the next two years, spanned almost the whole world. This event marked the beginning of «major depression» which quickly became the biggest economic crisis of the twentieth century. The days of the onset of the crisis were called “Black Thursday of October 24”, “Black Monday of October 28” and “Black Tuesday of October 29”. History of Economy and Finance had not known and does not know any such cynical and negative case like that. Based on the economic consequences (discounts, bank and business failures, reduced consumption, overproduction crisis, currency invalidation, extraordinary unemployment, etc.) and political consequences (extinction political regimes such as the Republic of Weimar in Germany, strengthening of the Nazi Fascist dictatorships and many other authoritarian regimes such as in Spain, Portugal, Uruguay, etc.) it was the most shocking event, which passed the world in the period between two world wars.

“Arab Revolutions” and China _____ *(How to read Marx and Brzezinski nowadays) _____*

Fatos Tarifa

Abstract. The “Arab revolutions” may be seen as marking the beginning of an era of a massive political awakening and radicalization in the developing world. This article examines the impact these “revolutions” may eventually have on China. It reflects on (a) the political and economic factors that make China “immune” to immense

domestic revolutionary upheaval as well as the practical implications that Marxist theory (already abandoned by Beijing's current leadership) might have *vis-à-vis* China's future political and social transformation. Marx's thesis that, when a society is led towards the market and modernization it also tends towards democratization, has been proven true in many countries (in South Korea, Taiwan, Spain, Portugal, Argentina, Turkey etc.), hence confirming an unmistakable historical tendency: the more autocratic regimes have permitted, or allowed the modernization of their economies and the more an economy relies on the free market, or is able to create a stratum of the population that may be considered a "middle class", the more certain the transformation and the consolidation of that society as a liberal democracy. It is argued that China cannot be an exception to the rule since economic development creates increasing pressures for democratization. Whatever it takes to transform its political system, China will change. Sooner or later the trajectories of China's *economic development* and of its *political evolution* will part. At some point, the distance between them will become too wide to sustain and, *ipso facto*, China will face a serious political crisis.

"Economic reforms and democratization of the _____ North African region under European influence _____"

Nevila Xhindi

Abstract. Political uncertainties for regional development, concern for energy stocks and flows of migration culminated in the collapse of authoritarian governments in Tunisia and Egypt in the spring of 2011 of and subsequent to the riots throughout the Arab World. This showed that Western policy for stability in southern and eastern coast of the Mediterranean was built on sand. For Europe, this situation is also a serious indictment of the European policy of "friendship" with the Arab World. European Union, for about half a century, has tried to export the socio-economic and political development in this region, but the results have been, extremely modest, especially when compared to the impressive transformation of the EU in Central and Eastern Europe, even in the Balkans.

Why African Mediterranean economic liberalization continued to have little or no political liberalization? The answer to this question requires a specific analysis of the economic nature of the reforms undertaken and their effects on economic actors.

This paper by analyzing the case of two countries in North African region, that of Tunisia and Egypt, through the arguments, recalls the close relationship that exists between economic and political liberalization. In the past 15 years economic reforms in

these countries have been linked to and supported on a high degree from authoritarian politics. The paper also addresses the support and the growth opportunities particularly the European Union have given these countries. Currently, in the last decade the EU has directed its policy of cooperation with Mediterranean countries towards economic reforms. This is made possible by using financial instruments and supporting the modernization of the production system and the economic framework.

Which Interest Groups influence most into _____ the EU decision-making? _____

Besarta Vladi

ABSTRACT. Discussions on how the EU decision making is realized, have been and continue to be numerous. Some authors think that the decision- making within the EU institutions is almost totally isolated and so interest groups do not have influence on it. Some others support the idea that there are so many interest groups that influence the EU and in this way the decisions are products of broad interests. In fact, it is not easy for these groups to be successful in their attempt to influence the EU. Also, it is difficult to say that all the groups are successful or equally successful on it. Each group uses one or more strategies to influence the EU decision- makings but the result is never certain. Anyway, referring to a considerable number of authors and articles, business groups are the most successful groups in terms of influence in EU decision-making. This essay is going to explain some of the reasons that make business groups as successful as they are in this process.

The importance of sufficient resources on the free _____ movement in European Union _____

Erjona Canaj

ABSTRACT. The availability of sufficient resources is still an important criterion on the free movement and the right of residence of European citizens in another Member State. Union citizens and their family members have the right of residence as long as they do not become an unreasonable burden on the social assistance system of the host

Member State. This criterion takes a more important value in the context of family reunification, a right that can be exercised by EU citizens as well as non-EU citizens.

The purpose of this study is to prove that the criterion of sufficient resources for community citizens is considerably diminished in recent years, by the implementation in all Member States of the 2004/38/EC directive on the right of free movement within the territory of the Member States. Otherwise, the sufficient resources are considered a necessary criterion for the family reunification of non-EU citizens, regulated in the European Union by the 2003/86/EC directive on family reunification.

Greek Crisi and European Solidarity _____

Arlinda Hoti _____

ABSTRACT. This article tends to analyze the Greek debt crisis, its causes and effects and the EU response on this issue. There is an ongoing debate on the ways of solving the Greek debt crisis and the impacts for Euro zone countries. We underline that the key approach to response to this issue is the EU solidarity with Greek state based on the same principle of *solidarity* which EU was created. The solidarity naturally implies the related financial cost and it will depend on how much the EU member states will stand and support this basic principle of European Union.

The power of state and the crisis of globalization _____

Lavdosh Ahmetaj

ABSTRACT. In this part of work, the State is conceived in three perspective theories. Focusing on the attention within the State in order to describe various forms of State power, we have argued different ways in which the States are able to use political and economic instruments. It came to the view that the identified groups and actors within the State are determined of decision-making in regards to the foreign policy. Also it is essential to consider the way in which globalization, international ideologies and ethno nationalist movements can threaten State sovereignty whereby they might create a risk in the stability of the international system (Puto 2004: 498). All these movements are studied in a complex order so that to reach the conclusion that the economic crisis, however, can be managed and directed by political elites, which are important factors, intertwined with economic and political interests (Smith 2005: 233).

European experience in determining the less advanced mountain areas: the application in Albanian context —

Shkelzen Marku

ABSTRACT. Mountainous areas have great social, economic, cultural and environmental significance for the country. In these conditions, the Albanian politics face a number of challenges related to increasing social cohesion and competitiveness of these areas. To achieve this goal, specific policies should be taken. Also, should be used as soon as possible all political instruments and support mechanisms for the operation of resources and accelerating the pace of development of mountainous and less-favored areas. In this context, we have much to learn from the community of European nations where we want to go quickly. Almost all European countries have policies, technical and financial instruments to support the mountain and less-favored areas to increase social cohesion.

What is the value of the land? Information from market creation in the Albanian coastal area —

Fatmir Guri

Abstract. When we recall that there is competition between agriculture and other economic sectors, we almost always find land use competition between agriculture and tourism, or between agriculture and urbanisation. These three activities are the biggest consumers of the land. It is true that agriculture is the largest user of the land but also other activities need broad space for development. In the confrontation between agriculture and tourism, there are two other factors that are detrimental to agriculture: firstly, the level of income generated by agricultural activity is lower than that of tourism. Secondly, agricultural and tourist activities need significant labor, a factor that has become problematic in rural areas of the northern Mediterranean. The process of desertification of rural areas, coupled with the rural exodus to cities, ruining in this way the rural economies, problems which are not yet verified in the South, is always present. The article attempts to analyze the organization of the land market, as more explanatory element of this competition between the actors, the reasons for selling, price and competition implications of Rreth-Greth and Spillej (Kavaja) agricultural area.

Analysis of some problems of cross-border insolvency _____ legislation in Albania _____

Erion Manohasa - Nina Radulovic

ABSTRACT. An efficient system of execution and bankruptcy procedures is an essential condition for access to credit and foreign investments. The international and especially the European mobility of companies or enterprises amplifies the influence that execution procedures have on debtors who have steady business capital and other assets such as real estate, capital investments or shares in foreign companies and bank accounts in other countries different from where they reside. The time as come for secondary bankruptcy procedures after the primary ones in Albania or vice-versa. In this article we will try to define the legal obstacles to a better regulatory system of cross border bankruptcies, by comparing some important aspects of the model law of UCITRAL with the EU regulation for the bankruptcy, the Albanian legislation and that of Montenegro.

Money laundering and negative effects _____ on economy _____

Naim Mëçalla

ABSTRACT. This paper has on its focus the economic and financial threat of money laundry as a criminal activity. The story of money laundry is firstly the story of money and property concealment from the seizure or taxation. Money laundry has negative consequences and indicates considerable distortion of real economic development. It deprives competition from fair and free will, it violates the market rules and orders and it even strikes them harshly by breeding serious market disorders. Access of money laundry in legal economies can lead criminal groups to take under control the legal and financial economy.

Money laundry is a financial crime, and despite its definition it includes the attempts to avoid seizure of income deriving from crime. FATF (Financial Action Task Force) which defines money laundry as “performance of crime income with object to hide their illegal origin”¹

¹ FATF, 1996, Forty Recommendations see www.oecd.org/fatf/40Recs_en.htm

Implementation of Accounting Standards on _____ Financial Statement Analysis _____

Lirola Këri – Flutura Kalemi

ABSTRACT. Financial analysis and final goal is the successful culmination of the building financial statements. The implementation of accounting standards aimed at presenting information fair and sincere for external users. Interpretation of results to decision makers is vital on the effectiveness of their investments. Financial Analysis allows reading so much sense to transactions occurring and the reliability prediction of events expected in the future. This prediction can be made not only to the micro level, but also the macroeconomic level. Have the new standards affected the improvement of quality of financial analysis? How have facilitated the interpretation of financial indicators? A new standard have led to increased use of analysis and level macroeconomic? A reliable are results of analysis? The purpose of this topic is to answer the above questions wanting to highlight the effectiveness or implementation of accounting standards.

Some modern technologies for the implementation — of an application on web _____

Tamara Luarasi

ABSTRACT. The goal of this article is the presentation of a complete and short material that represents some modern technologies that all together work for the creation of a Web Application. A complete example is considered. Eclipse is used as an environment for the development of the application, Apache Tomcat is used to manage the request-response through the browser, Maven is used for the configuration of the application, Hibernate is used to simplify the programmer work for the link and communication with a database, and SQL Server is used as Database Management System. The application inserts some data into a database through Web using the servlets.